

Jeanca Penco
30/10/2023



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. 590 / Prot. 2

Tiranë më, 30.10 2023

Lënda: Dërgim raporti “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2022”

**KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KRYETARES SË KUVENDIT
Znj.Lindita Nikolla**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.4, Tiranë

E nderuar zonja Kryetare,

Në zbatim të kërkesave të nenit 164 të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, neni 31 të Ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neneve 62 e 63 të Ligjit nr. 9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, po Ju paraqesim raportin “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2022”.

Në këtë raport, të dhënat, gjetjet e paraqitura dhe vlerësimet e shprehura për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit të kaluar financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm financiar e auditimit të brendshëm, janë produkt i rezultateve të auditimeve të ushtruara nga KLSH në institucionet e qeverisjes së përgjithshme për llogari të zbatimit të Buxhetit të Shtetit të vitit 2022.

KRYETAR

Arben SHEHU



Hyrje	3
Opinioni mbi Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Vitit 2022	4
Përmbledhje ekzekutive	9
I. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I BUXHETIT	17
1. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I TË ARDHURAVE	17
1.1 Të ardhurat nga ndihmat	18
1.2 Të ardhurat tatimore	18
1.2.1 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat	19
1.2.1.1 Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)	20
1.2.1.2 Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin	22
1.2.1.3 Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	23
1.2.1.4. Taksa nacionale dhe të tjera	24
1.2.1.5. Të ardhurat nga taksat doganore	26
1.2.1.6. Të ardhurat nga akcizat	26
1.3 Të ardhurat nga fondet speciale	27
1.3.1 Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	27
1.3.2 Kontributet e Sigurimit Shëndetësor	29
1.3.3 Fondi i kompensimit të pronarëve	30
1.4 Të ardhurat jotatimore	30
1.5 Performanca fiskale e DPT dhe DPD	31
1.6 Të ardhurat nga pushteti vendor	38
1.7 Rezultatet e auditimeve në fushën e të ardhurave	40
2. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I SHPENZIMEVE	56
2.1. Shpenzimet korrente	59
2.1.1 Shpenzimet për fondet speciale	63
2.1.2 Shpenzimet për buxhetin vendor	67
2.2 Shpenzimet kapitale	72
2.2.1 Fondi i rindërtimit	77
2.3 Fondi rezervë dhe kontigjenca	79
2.4 Koncesionet/PPP dhe risqet fiskale – Impakti buxhetor	82
2.5 Shoqëritë publike dhe ndikimi i tyre në buxhet	93
2.6 Rezultatet e auditimeve në fushën e shpenzimeve	96
2.6.1 Auditime të përputhshmërisë dhe/ose financiar	96
2.6.2 Auditime të Teknologjisë së Informacionit (TI)	114
2.6.3 Auditime të performancës	116
3. DEFICITI	119
4. MENAXHIMI DHE RAPORTIMI I BORXHIT PUBLIK	120
II. MBI KONTABILITETIN E SEKTORIT PUBLIK, SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIN FINANCIAR, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM	130
Anekset e Raportit	174

Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e institucionit më të lartë të kontrollit ekonomik e financiar në vend, auditon veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë; përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor; veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantojnë nga shteti, në zbatim të detyrimit kushtetues i paraqet Kuvendit Raportin për zbatimin e buxhetit të shtetit, si dhe mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar 2022.

Krahas shqyrtimit dhe analizimit të Raportit të përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022” dhe të raporteve të tjera që e shoqërojnë, Kontrolli i Lartë i Shtetit është bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera për aktivitetin ekonomik-financiar të subjekteve për vitin 2022, dhe atje ku është vlerësuar e nevojshme edhe para këtij viti.

Në këtë kontekst, Kontrolli i Lartë i Shtetit, paraqet në Kuvend “Raportin për zbatimin e buxhetit të shtetit 2022”, së bashku me konkluzionin/opinionin përkatës mbi bazën e rezultateve kryesore të 114 auditimeve të kryera për çështje të të ardhurave, shpenzimeve, detyrimeve të prapambetura, borxheve kundrejt buxhetit për të ardhurat, si dhe ato të lidhura me kontabilitetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke reflektuar shkallën më të lartë të zbatimit të standardeve profesionale ndërkombëtare të INTOSAI-t.

Për hartimin e raportit kanë shërbyer rezultatet kryesore të 114 auditimeve nga të cilët 99 auditime financiare dhe/ose të përputhshmërisë si dhe tematike, 6 auditime të teknologjisë së informacionit, si dhe 9 auditime të performancës, të ushtruar në 166 subjekte: institucione qendrore dhe ente në varësi, fonde speciale, njësi të vetëqeverisjes vendore, shoqëri publike, projekte me financime të huaja etj.

“Raporti për zbatimin e buxhetit të shtetit 2022” i paraqitur në Kuvend është i strukturuar në dy çështje kryesore të financave publike (sistemin buxhetor): Planifikimin dhe realizimin e buxhetit, si dhe mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Në këtë kuadër, gjejnë pasqyrim në mënyrë të detajuar planifikimi, realizimi dhe rezultatet e auditimit mbi të ardhurat dhe shpenzimet, deficitin buxhetor, si dhe çështjet e menaxhimit dhe të raportimit të borxhit publik, duke ruajtur klasifikimin ekonomik të treguesve fiskal sipas buxhetit të konsoliduar të MFE.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, krahas zbatimit të detyrimit kushtetues të paraqitjes së këtij Raporti në Kuvend, synon të ndikojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilësuar si shtylla të rëndësishme mbi të cilat mbështetet zhvillimi demokratik dhe tregues thelbësorë në rritjen e cilësisë së qeverisjes, të cilat mbeten sfida për çdo qeveri.

Opinionimi mbi Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Vitit 2022

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 164) dhe ligjin organik të KLSH nr.154/2014 (neni 31), KLSH ka detyrimin të paraqesë në Kuvend raportin mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të mëparshëm financiar përpara se të miratohet nga Kuvendi. Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor (neni 63) kërkon që, KLSH të shqyrtojë dhe certifikojë pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit dhe t'i paraqesë Kuvendit një raport të plotë mbi ekzekutimin e buxhetit të vitit të mëparshëm fiskal.

Këto kërkesa ligjore nënkuptojnë që KLSH duhet të kryejë një auditim financiar në pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit dhe duhet të raportojë për ekzekutimin e buxhetit vjetor.

Nga auditimi në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, si dhe nga raportet e përgatitura nga ana e saj, rezulton se MFE nuk ka realizuar detyrimet e përcaktuara në nenin 63, germa “a” të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për të miratuar dhe përcjellë në Kuvend, pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit.

Gjithashtu, Ministri i Financave nuk ka arritur që të rregullojë me ligj të veçantë kontabilitetin dhe raportimin në sektorin publik, si dhe të nxjerrë udhëzim për standardet e kësaj fushe, i cili vijon të rregullohet me një udhëzim mbi procedurat e kontabilitetit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, sipas kërkesave të nenit 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, të përcaktuara në ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, të ndryshuar.

Nga sa më sipër, rezulton se Qeveria nuk ka përgatitur dhe paraqitur në Kuvend pasqyra të konsoliduara të buxhetit vjetor të ekzekutuar që të krijohet mundësia e auditimit financiar të tyre nga KLSH, qoftë në nivel të përgjithshëm apo në atë qendror. Gjithashtu, nuk janë të mjaftueshme të dhënat që gjenerohen nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), pasi nuk përfshihet informacion financiar mbi të ardhurat dhe shpenzimet gjatë vitit buxhetor nga njësitë shpenzuese ekstrabuxhetore apo institucionet e pa varuara.

Në këto kushte, KLSH ka qenë e detyruar të kryejë auditime të përputhshmërisë për buxhetin ekzekutuar për vitin 2022, sipas parimeve dhe standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe të japë një opinion për besueshmërinë e të ardhurave buxhetore të mbledhura dhe të shpenzuara gjatë këtij viti.

Në zbatim të detyrimeve kushtetuese, ligjit të KLSH-së dhe ligjit të menaxhimit të sistemit buxhetor, Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit i paraqet Kuvendit të Shqipërisë një raport të konsoliduar mbi shqyrtimin dhe analizën e raporteve të përgatitura nga MFE për buxhetin e vitit 2022, si dhe të rezultateve të auditimeve në zbatim të buxhetit 2022, duke dalë me një opinion mbi raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e këtij viti financiar para miratimit nga Kuvendi.

Për këtë, KLSH shqyrtoi raportet e KM të përgatitura nga MFE dhe të dorëzuara në Kuvend, si më poshtë:

- a) Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022;
- b) Raportin mbi përdorimin e fondit rezervë të buxhetit të shtetit gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2022;
- c) Analiza e borxhit publik;

d) Raporti mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të vitit 2022.

Ky raport paraqet një konsolidim të gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimeve individuale për të ardhurat, shpenzimet dhe financimin e qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirë fondet speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë ose me vendim të këshillit bashkiak të njësisë së qeverisjes vendore, duke përfshirë fondet publike të cilat mbliidhen, mbahen, shpërndahen dhe shpenzohen nga njësitë e sektorit publik dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kredi dhe grante për njësitë e sektorit publik.

KLSH auditori përputhshmërinë e shpenzimeve dhe të ardhurave, si dhe të procedurave të zbatuara nëpërmjet auditimit të sistemeve qendrore si të: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik, Drejtorisë së Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, shpenzimet dhe të ardhurat e ISSH, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si dhe një sërë institucionesh të tjera qendrore dhe subjekte në varësi, shoqëri publike, projekte me financim të huaj etj., në total 114 auditime (për referencë shih aneksin 1- Lista e auditimeve që kanë shërbyer për hartimin e raportit të Zbatimit të Buxhetit).

Ky raport përmbledh problemet kryesore, mangësitë e konstatuara në lidhje me çështjet e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit, miradministrimit të fondeve publike, duke përfshirë dhe fondin rezervë dhe kontigjencën. Pjesë përbërëse është trajtimi i gjendjes dhe mangësive të borxhit publik dhe Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

Për të mbështetur përmirësimin e përgjegjshmërisë publike, transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë, KLSH synon të mbështesë institucionet publike në parandalimin e parregullsive, por në të njëjtën kohë evidenton mangësitë, keqpërdorimet dhe shkeljet në kryerjen e rregullt të detyrës nga zyrtarët publikë dhe duke i shoqëruar me rekomandimet përkatëse me qëllim parandalimin e përsëritjes së këtyre rezultateve të keq menaxhimit dhe abuzimeve financiare.

Bazat e auditimeve

Brenda fushëveprimit të mësipërm, Institucioni i Kontrollit të Lartë i Shtetit ka audituar përputhshmërinë e aktiviteteve të hartimit, miratimit, ekzekutimit, raportimit dhe përputhshmërisë së Buxhetit të Shtetit për vitin 2022, si dhe ka rekomanduar masat që duhet të marrin institucionet e qeverisjes së përgjithshme.

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet brenda sistemit buxhetor janë në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i detyrueshëm për zbatim për institucionet e audituara dhe kemi përpiluar opinionin bazuar në shqyrtimin e raportit të konsoliduar për zbatimin e buxhetit 2022, raportit të menaxhimit të borxhit publik, përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës, si dhe të treguesve të buxhetit vjetor të konsoliduar.

KLSH-ja ka kryer auditimet e saj duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare për Institucionin e Lartë të Auditimit (ISSAI) 400 dhe 4000 për auditimin e përputhshmërisë. KLSH-ja është e pavarur nga institucionet e audituara siç kërkohet në Parimin 10 të INTOSAI-Deklarata e Pavarësisë së SAI-t e Meksikës dhe vepron në përputhje me kërkesat etike përkatëse të përcaktuara në Parimin 130 të INTOSAI-t - Kodi i Etikës, duke përfshirë Kodin e Brendshëm të Etikës së KLSH. Ne kemi përmbushur dhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Objektivi ynë ishte të vlerësojm nivelin dhe shkallën e zbatimit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme të parimeve dhe rregullave të menaxhimit të sistemit buxhetor, si transparenca, parashikueshmëria, gjithë përfshirja, disiplina fiskale në përputhje me stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social, kontrollin e buxhetit, ekzekutimin dhe mënyrën se si janë zbatuar objektivat e politikave të programit buxhetor për vitin 2022.

Opinionit për Raportin e Buxhetit të vitit 2022

Ne besojmë se evidenca e auditimit e marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për konkluzionet tona të auditimit. Gjetjet, kriteret dhe konkluzionet tona janë zhvilluar në mënyrë profesionale dhe të arsyetuar. Kombinimi i të gjitha gjetjeve dhe kriterëve tona rezulton në përfundimin e përgjithshëm vijues:

Me përjashtim të disa situatave të theksuara në raportet përfundimtare të auditimit, procedurat për përgatitjen, miratimin dhe ekzekutimin e Buxhetit të Shtetit zbatohen përgjithësisht në përputhje me kuadrin ligjor dhe dispozitat rregullative në fuqi. Përkatesisht, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve dhe transfertave, si dhe planifikimi dhe realizimi i të ardhurave, me disa problematika të evidentuara në këtë Raport, janë në përputhje me shumat dhe dedikimet e përcaktuara në buxhetet e miratuara të njëjsteve shpenzuese buxhetore.

Auditimet e KLSH-së kanë analizuar procedurat që sigurojnë integritetin dhe saktësinë e informacionit të pasqyrave individuale të llogaridhënies vjetore për institucionet buxhetore të sektorit publik, në funksion të vlerësimit të transaksioneve financiare të shtetit.

Pavarësisht treguesve të përfshirë në Raportin Vjetor të përgatitur nga Qeveria për zbatimin e buxhetit vjetor dhe situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022, bazuar në gjetjet dhe rezultatet e auditimeve tona, nënvizojmë se:

- KLSH vlerëson se në përgjithësi, transaksionet ekonomike të shtetit në të gjitha aspektet materiale janë kryer në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2022 dhe Aktet Normative për ndryshimet të tij. Por, nga kryerja e procedurave të auditimit rezulton se në disa njësi shpenzuese janë konstatuar parregullsi dhe veprime jo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi ose transaksionet financiare të kryera prej tyre nuk janë në përputhje me ligjin. Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit tërheq vëmendjen për procedurat e kryera në kundërshtim me kriteret e buxhetit të shtetit dhe parashikimet kryesore buxhetore për financat e pushtetit qendror dhe vendor dhe fondet e veçanta gjatë vitit buxhetor 2022.
- Zbatimi i kontrolleve dhe masave parandaluese, zbuluese dhe korigjuese që do të garantonin disiplinën fiskale të sektorit publik nuk është i plotë dhe paraqet dobësi, veçanërisht në institucionet e vetëqeverisjes vendore. Proceset dhe veprimtaritë mbështetëse të sistemit të kontrollit të buxhetit, rishikimi, ekzekutimi, monitorimi dhe raportimi i tij, vazhdojnë të jenë ende të pa konsoliduara sa duhet, për të parandaluar dhe minimizuar shkeljet e disiplinës fiskale nga subjektet publike, veçanërisht kjo, në kushtet e presioneve në treguesit e deficitit dhe të borxhit publik.
- Bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera, evidentohen: raste të papajtueshmërisë apo shkelje të disiplinës fiskale në kuadër të gjithë subjekteve publike të audituara nga KLSH, për pjesën takuese të mbulimit me auditim për vitin 2022; që jo të gjitha transaksionet dhe aktivitetet janë kryer në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektet e audituara në kontekstin e përdorimit të burimeve

financiare buxhetore; se janë identifikuar në subjektet e audituara parregullsi e shkelje të vlerësuara të rëndësishme materiale në zbatimin e akteve të buxhetit të shtetit; risqe ekzistuese operacionale dhe strategjike, mungesë efikasiteti të masave për minimizimin e riskut për veprimet ekstra-buxhetore, si dhe atyre mbi shmangien e shpërdorimit, të parregullsive apo mashtrimit; dobësi në funksionimin e duhur dhe efektiv të kornizës së kontrollit të brendshëm të harmonizuar në njësitë buxhetore, për të parandaluar dhe zbutur risqet kryesore të subjekteve publike.

- Nga auditimet që kanë shërbyer si bazë për hartimin e Raportit të zbatimit të buxhetit 2022 ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën 4,631,863 mijë lekë, për të cilin është kërkuar dëmshpërblimi i plotë i tij; të ardhura të munguara të vlerësuara paraprakisht në tatime që i përkasin periudhave edhe para vitit 2022, në shumën 63,159,119 mijë lekë për të cilat është kërkuar rikontrolli tatimor me qëllim saktësimin dhe grumbullimin e tyre; si dhe menaxhim joefektiv i të ardhurave dhe shpenzimeve publike në vlerën prej 54,608,837 mijë lekë. Pra, shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, të ardhurat e munguara të konstatuara në institucionet fiskale, si dhe mungesë e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike gjithsej janë evidentuar 122,399,819 mijë lekë.

KLSH arrin në dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë¹, për shkak të rëndësisë dhe shkallës së përhapjes së parregullsive të trajtuara në këtë raport, ku identifikohen devijime materiale (sasiore dhe cilësore) në drejtim të hartimit, ekzekutimit, raportimit dhe monitorimit të buxhetit, jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe akteve normative për ndryshime të këtij ligji; ligjin nr.9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” etj., si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Përgjegjësitë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe strukturave drejtuese të Institucioneve të Qeverisjes së Përgjithshme:

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e sistemit të rregullave, standardeve dhe procedurave, që garantojnë në mënyrë të arsyeshme administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike. Kjo strukturë është ngarkuar për drejtimin e proceseve të vlerësimeve e parashikimeve makroekonomike dhe buxhetore, si dhe drejtimin e procedurave për hartimin, ekzekutimin, monitorimin dhe raportimin buxhetor; nxjerrjen dhe garantimin e zbatimit të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre; kontrollin e procesit të raportimit të treguesve fiskal; administrimin e sistemit të thesarit, vlerësimin e risqeve fiskale dhe detyrimeve kontigjente, ndjekjen e stokut të detyrimeve të prapambetura; bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e shërbimit të auditimit të brendshëm publik, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i

¹ *Opinion i kualifikuar.* Audituesi shpreh një opinion të kualifikuar, kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura.

ndryshuar; ligjin nr.48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” etj., si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Drejtimi i institucioneve të qeverisjes së përgjithshme, është përgjegjës për: procesin e hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit buxhetor për institucionet që drejtojnë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” të ndryshuar etj., si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Përgjegjësitë e KLSH-së mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivat e veprimtarisë audituese synojnë dhënien e sigurisë së arsyeshme për publikun, Kuvendin dhe instancat shtetërore, nëse treguesit e konsoliduar fiskalë të raportuar paraqesin anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një opinion mbi përputhshmërinë e hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2022, sipas parashikimeve në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare Profesionale të fushës së auditimit të jashtëm publik (ISSAI-t), siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por që nuk garanton se auditimi i kryer në përputhje me standardet, të identifikojë çdo gabim apo anomali që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar të buxhetit.

Përmbledhje ekzekutive

Në referencë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 164) si dhe të ligjit organik të KLSH nr. 154/2014 (neni 31), Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit, Raportin për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe mendime për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit pasi ka shqyrtuar treguesit fiskal sipas buxhetit të konsoliduar 2022, të përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të nenit 63 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka përgatitur një raport të plotë për zbatimin e buxhetit të vitit të mëparshëm fiskal, të shoqëruar me problematikat e rezultuara nga procesi auditues në këtë fushë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualët në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit, duke mbuluar fushat e përputhshmërisë, ligjshmërisë, rregullshmërisë, menaxhimit financiar, kontabilitetit, si dhe ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin e administrimit të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore. KLSH, gjatë veprimtarisë së tij ka reflektuar në shkallën më të lartë standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC-it, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse, të konsoliduara për sektorin publik për vitin 2022, dhe për pasojë nuk janë dorëzuar në Qeveri dhe në Kuvend as në nivel grupi (ministrie), as në nivelin e përgjithshëm për njësitë e sektorit publik. Mungon një kuadër i plotë ligjor mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare që t'i shërbejë rritjes së llogaridhënies dhe ushtrimit të autoritetit të MFE nëpërmjet sanksioneve në rast moszbatimi të këtyre dispozitave.

Duhet theksuar që në krye të herës se, në mungesë të përgatitjes së pasqyrave të konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka pasur të pamundur shqyrtimin dhe certifikimin e tyre (auditim financiar), të përcaktuar në ligjin organik të buxhetit.

Pra, Këshilli i Ministrave nuk ka realizuar detyrimet e përcaktuara në nenin 63, germa “a” të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për të miratuar dhe përcjellë në Kuvend, brenda muajit qershor, pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit.

Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka publikuar në faqen zyrtare (web) brenda muajit qershor Raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2022, i cili së bashku me mungesën e pasqyrave financiare nuk ka arritur të zbatohet afatin, për t'i siguruar në kohë Kuvendit, këshillave të njëjësive të qeverisjes vendore dhe publikut të gjerë të dhëna lehtësisht të disponueshme, të shpejta, të kuptueshme e të krahasueshme, integriteti i të cilit të mund të verifikohet në mënyrë të pavarur.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përveç përmbushjes së detyrimit ligjor, e konsideron Raportin e zbatimit të buxhetit një element thelbësor të mbikëqyrjes efektive nga Kuvendi për t'i kërkuar llogari qeverisë për punën që ka kryer në menaxhimin e financave publike, si dhe në përmbushje të rolit dhe të funksionit të rëndësishëm për të miratuar buxhetin dhe për të monitoruar zbatimin e tij, bazuar dhe në rezultatet e auditimeve të jashtme për këtë qëllim.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka shqyrtuar dhe analizuar: raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”; “Raportin mbi përdorimin e fondit rezervë të buxhetit të shtetit gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2022”; “Analizën e

borxhit Publik”; “Raporti mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të vitit 2022”, si dhe “Treguesit fiskal sipas buxhetit të konsoliduar 2022”, të përgatitura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë më 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 549, datë 13.06.2023. Fakti i mbërritjes së këtij dokumentacioni më datë 13 qershor në KLSH, tregon se Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka respektuar afatet ligjore brenda muajit maj për hartimin dhe publikimin e tyre.

Krahas sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në funksion të përgatitjes së këtij Raporti, ka kryer auditimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si dhe të një numri të konsiderueshëm të ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre, njërive të vetëqeverisjes vendore, shoqërive publike, projekte me financime të huaja etj.

Rezultatet e auditimeve, mbi bazën e të cilëve janë pasqyruar gjetjet e auditimit në fushën e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit për secilin subjekt të audituar, i përkasin vitit të plotë 2022 ose periudhave kohore të këtij viti fiskal, pavarësisht periudhës së aktivitetit të audituar, që mund të ketë qenë shtrirë edhe përpara ose pas këtij viti.

Buxheti i shtetit për vitin 2022 është miratuar fillimisht me ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” më datë 25.11.2021, ku në Relacionin e këtij projektbuxheti, midis të tjerave janë dhënë si argumente se, për treguesit kryesor janë bazuar në modelet bashkëkohore të programimit dhe në analizën e detajuar të faktorëve që e ndikojnë; dhe se është harmonizuar me ato makroekonomikë, duke ruajtur parimet dhe rregullat fiskale.

Në fakt, sapo kanë kaluar pak më shumë se dy muaj në vitin buxhetor 2022, qeveria ka miratuar Aktin Normativ (AN) nr. 3, datë 12.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, duke prekur në mënyrë të ndjeshme treguesit kryesor të të ardhurave të buxhetit: të buxhetit të shtetit dhe atij vendor; duke rritur shpenzimet; duke ulur transferimet nga buxheti i shtetit për sigurimet shoqërore dhe duke rritur këto për sigurimin suplementar; duke rritur ndjeshëm të ardhurat tatimore etj.

Më datë 29.07.2022 është miratuar AN nr.12, i cili ndryshon përsëri në rritje të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet, por duke ulur deficitin; rriten transfertat për buxhetin e njërive të vetë qeverisjes vendore; rriten kontributet e sigurimeve shoqërore dhe ulen akoma më tej transferimet nga buxheti i shtetit; vijnë rritjen të ardhurat tatimore etj.

Dy aktet normative të mësipërme, nuk janë në përputhje me kërkesat e paragrafit të parafundit të nenit 46 të ligjit organik të buxhetit, pasi nuk përmbajnë dokumentacionin bazë dhe atë shoqëruar të projektbuxhetit vjetor, si dhe nuk respektohen afatet përkatëse, pa marrë në konsideratë faktin që vetëm pas muajit korrik, Këshillit të Ministrave i jepet mundësia ligjore për të propozuar për votim ndryshime të ligjit të buxhetit me procedurë të përshpejtuar (AN).


AN nr. 17, datë 01.12.2022 ka vendosur rritjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve, të buxhetit vendor; të sigurimeve shoqërore; uljen e transferimeve nga buxheti për sigurimet shëndetësore; rritjen e shpenzimeve të buxhetit qendror etj.

Brenda këtij muaji, qeveria miraton AN nr. 19, datë 29.12.2022, duke rritur të ardhurat dhe shpenzimet; rritur kontributet dhe ulur transferimet nga buxheti për sigurimet shoqërore; ulen shpenzimet e buxhetit qendror etj., pra dy ditë para mbylljes së vitit buxhetor 2022.

Dy aktet normative të mësipërme bien në kundërshtim me nenin 48 të ligjit organik të buxhetit të shtetit që e drejta e njërive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor, pasi ndryshimet në dhjetor të ligjit të buxhetit në shpërndarjen e fondeve, nuk

mundësojnë të bëhen efektive nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme për shkak se janë pas datës 15 nëntor, si dhe është e pamundur që të realizohen brenda dy ditëve (30 dhe 31 dhjetor).

Grafiku 1 Ecuria e planifikimit buxhetor 2022 për të ardhurat, shpenzimet dhe deficitin



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

KLSH mori në shqyrtim 13 zëra kryesor të buxhetit të shtetit, të cilët kanë ndryshuar gjatë vitit ushtrimor 2022 dhe rezultoi se ndryshimi është i konsiderueshëm: mesatarisht $\pm 10\%$. Pra, buxheti i shtetit të vitit 2022 është karakterizuar nga ndryshime të shpejta dhe të shpeshta pas miratimit të ligjit të buxhetit, pasuar me katër AN, duke shfaqur në vijimësi mangësi planifikimi nga ana e MFE në periudhë afatshkurtër, dobësi në parashikimin dhe marrjen në konsideratë të faktorëve me ndikim në buxhet, duke sjellë për pasojë nevojën e rishikimeve të vazhdueshme të zërave buxhetor.

Nga auditimi më MFE ka rezultuar se, për AN nr. 3, datë 12.03.2022; për AN nr. 17, datë 01.12.2022 dhe AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk është kryer një analizë e mirëfilltë dhe e detajuar për ndryshimet e propozuara. Me AN nr. 17, datë 01.12.2022 është miratuar rritja e të ardhurave jostatimore në masën 2 miliardë lekë në zërin “Kthim kapitali nga AIC”, që nga pikëpamja kontabël ka të bëjë me një sistemim veprimi në Llogarinë e Thesarit, por pa efekt në rritjen e të ardhurave.

Bazuar në sa më sipër, rezultoi se nga ana e MFE në planifikimin buxhetor nuk janë harmonizuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike, si rritja nominale e PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare; kursi i pritshëm i këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me lekun; çmimet në bursë që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe Renta minerare; sasitë e pritshme të importit të mallrave etj., duke shfaqur mangësi të theksuara në harmonizimin e faktorëve makroekonomik për planifikimin e treguesve kryesor, si dhe kanë cenuar gjithashtu kredibilitetin e procesit të buxhetit vjetor.

Sipas ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe AN nr. 19, datë 29.12.2022 (i fundit i 4 AN), pasqyrës së treguesve fiskal sipas buxhetit të konsoliduar 2022 të përgatitur nga MFE, si dhe nga auditimi i KLSH të ushtruar në MFE, të ardhurat, shpenzimet dhe deficitin, të planifikuar dhe të realizuar për vitin 2022 janë si më poshtë.

Tabela 1 Treguesit kryesor fiskal të buxhetit 2022

		Në milion lekë						
Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	Ligji buxhetit 2022	AN nr.19 29.12.2022	Fakti 2022	% realizimit ndaj AN	Diferencat ndaj AN	Diferencat ndaj 2021
I.	Totali i të ardhurave	510,572	536,811	583,315	572,790	98 %	-10,525	62,218
II.	Totali i shpenzimeve	595,969	637,694	667,178	651,015	98 %	-16,163	55,046
III.	Deficiti	- 85,397	- 100,883	- 83,863	- 78,226	93 %	5,637	7,171

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se **të ardhurat buxhetore** gjithsej janë realizuar 98 %, nga 583,315 milion lekë të programuara në AN nr. 19, datë 29.12.2022 janë realizuar 572,790 milion lekë, megjithëse ka tejkalim të ndjeshëm krahasuar me ligjin e buxhetit 2022. Totali i të ardhurave gjithsej përbën 26.8 % të Produktit të Brendshëm Bruto², duke pësuar rënie me 0.2 % krahasuar me vitin 2021, megjithëse janë realizuar 62,218 milion lekë më shumë ose mbi +12 %. Duhet theksuar se përkeqësimi i raportit të të ardhurave gjithsej ndaj PBB krahasuar me vitin e kaluar, referuar teorisë ekonomike konsiderohet si një masë e shkallës në të cilën se sa qeveria kontrollon burimet e ekonomisë.


Sipas Raportit të MFE mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2022, paketa fiskale në vitin 2022 ka pasur një efekt pozitiv prej 9,930 milion lekë, ose 1.7 % të të ardhurave publike gjithsej. Duhet theksuar se efektet e paketës fiskale janë akoma më të larta, pasi MFE nuk ka përfshirë në llogaritje efektet në të ardhura për TVSH-në në importimin e makinerive dhe pajisjeve, taksën suplementare mbi lojërat e fatit etj.

Sipas të dhënave të Raportit të zbatimit të buxhetit të përgatitur nga MFE dhe auditimit të KLSH në këtë institucion, kanë rezultuar me mosrealizime të theksuara në krahasim me planin e ndryshuar të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera për -3,679 milion lekë; të ardhurat nga ndihmat për - 2,484 milion lekë; tatimi mbi të ardhurat personale - 2,017 milion lekë; kthim kapitali nga AIC (Korporata e Investimeve Shqiptare) për - 2,000 milion lekë; tatimi mbi vlerën e shtuar -1,588 milion lekë, transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë - 1,000 milion lekë etj.

Nga auditimi në MFE, ka rezultuar se Ministri me Urdhrin nr. 298, datë 30.12.2022 “Për kthim fondi”, në pikën 1 të tij ka urdhëruar AIC kthimin e fondit prej 2 miliard lekë në favor të buxhetit të Shtetit, si dhe ky fond të zbritet nga kapitali themeltar i shoqërisë. Deri në përfundim të auditimit konstatohet se, ky urdhër nuk është zbatuar, pra fondet nuk janë kthyer në buxhetin e shtetit.

Veç kësaj, duhet theksuar se, sipas Relacionit mbi Projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” të paraqitur nga MFE, të ardhurat buxhetore në raport me PBB ka qenë projektuar të pësojnë një rritje në terma realë në 28.7% e PBB në vitin 2022 dhe konstatohet se është pothuajse 2 % më poshtë se parashikimi.

Grafiku 2 Të ardhurat, shpenzimet dhe deficitin për vitin 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga analiza e ecurisë së grumbullimit të të ardhurave gjatë muajve të vitit 2022 konstatohet se niveli më i ulët mujor është në muajin shkurt, që përkon me AN nr.3, datë 12.03.2022 dhe niveli më i lartë në muajt mars, tetor e dhjetor 2022, me intensitet më të lartë në 6-mujorin e dytë të vitit.

² PBB për vitin 2022 është marrë sipas përcaktimeve të INSTAT në vlerën prej 2,134,464 milion lekë

Shpenzimet në total janë realizuar 651,015 milion lekë nga 667,178 milion lekë sipas AN nr.19, ose 98 %, pra 16,163 milion lekë më pak, megjithëse janë më shumë se ligji fillestar i buxhetit, si dhe 55,046 milion lekë më shumë se në vitin 2021. Edhe totali i shpenzimeve në përqindje ndaj PBB ka rënie krahasuar me një vit më parë: nga 31.5 % në 30.5 %, duke demonstruar politikat e ndryshme ekonomike dhe faktorët që ndikojnë në shpenzimet e qeverisë.

Në lidhje me ecurinë mujore të kryerjes së shpenzimeve, konstatohet se niveli më i ulët është regjistruar në muajin janar dhe niveli më i lartë në muajin dhjetor, muaj në të cilin janë kryer mbi 1/5 e shpenzimeve vjetore, e kushtëzuar kryesisht nga shpenzimet kapitale të cilat në këtë muaj arrijnë 44 % të totalit vjetor.

Sipas të dhënave të Raportit të zbatimit të buxhetit të përgatitur nga MFE dhe auditimit të KLSH në këtë institucion, kanë rezultuar me tejkalim të shpenzimeve në krahasim me planin përfundimtar shpenzimet për sigurime shoqërore në vlerën +14,902 milion lekë; shpenzimet për mirëmbajtje me + 1,948 milion lekë, fondi i ndihmës ekonomike me + 1,864 milion lekë; fondi i shpronësimeve me +11,000 milion lekë, pasi nuk ka pasur shpenzime të planifikuara për këtë zë etj. Ndërsa rezultojnë me mosrealizime shpenzimet për fondin e rindërtimit me - 3,526 milion lekë; shpenzimet kapitale me burim të huaj financimi me - 3,406 milion lekë; shpenzimet për buxhetin vendor me - 2,764 milion lekë, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm - 890 milion lekë etj.

Në tabelën e treguesve fiskal sipas buxhetit të konsoliduar 2022, MFE ka shtuar zërin “Plani me ndryshime 2022 (shpërndarje rezervash)”. Duhet theksuar se, MFE me vendosjen në treguesit e buxhetit të konsoliduar të “Plani me ndryshime 2022 (shpërndarje rezervash)”, ka ndryshuar planin e shpenzimeve për disa zëra të veçantë, duke e shtuar dhe/ose pakësuar, për të arritur nivelin mesatar të realizimit të shpenzimeve rreth 100%, pas mbylljes së vitit buxhetor 2022, si dhe pa miratim në Kuvend të këtyre ndryshimeve, duke vepruar në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kjo pasi, ndryshimet buxhetore duhet ose të ndjekin të njëjtën procedurë si për miratimin e buxhetit ose të votohen me procedurë të përshpejtuar.

Pavarësisht, se me ligjin e buxhetit **deficiti për vitin 2022** është planifikuar në rritje në krahasim me faktin e vitit 2021, me AN nr. 19, janë programuar 83,863 milion lekë dhe është realizuar 78,226 milion lekë, pra 5,637 milion lekë më pak se planifikimi, kjo si rezultat i ecurisë pozitive në grumbullimin e të ardhurave dhe ruajtjes së këtij raporti dhe me nivelin e shpenzimeve gjithsej. Në këtë mënyrë, deficiti i vitit 2022 ka shënuar rënie edhe në përqindjen e PBB në -3.7 % nga -4.5 % në 2021.

Nga auditimi në MFE, **borxhi publik për vitin 2022** ka rezultuar 1,378,623 milion lekë, nga i cili borxhi qeverisjes qendrore 1,378,421 milion lekë dhe 202 milion lekë borxhi i pushtetit lokal, pra pothuajse tërësisht nga njësitë e qeverisjes qendrore.

Raporti i borxhit publik ndaj PBB përgjatë vitit 2022, sipas MFE ka rezultuar 64.6%, tregues i cili është në rënie në krahasim me një vit më parë që ishte 74.5%, dhe në vlerë absolute është 4,317 milion lek më pak se viti 2021, por gjithsesi më i larti i periudhës 2015-2020. Rënia e treguesit të borxhit publik në raport me PBB në krahasim me vitin 2021 ka ardhur kryesisht nga dy faktorë: si pasojë e rritjes së PBB-së (278,292 milion lekë më shumë në 2022), si dhe nga rënia e nivelit të stokut të borxhit në vlera nominale (4,317 milion lekë më pak në 2022).

Nga trajtimi i mësipërm, konstatohet se ka pasur ndryshime të shumta të buxhetit vjetor, të cilat sjellin për pasojë mungesën e analizave të qarta dhe të plota në përcaktimin e faktorëve ekonomik dhe fiskal që kanë ndikuar në masën e realizimit të zërave buxhetorë.

Nga auditimi në MFE, kanë rezultuar problematika në lidhje me hartimin e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) nga institucionet buxhetore lidhur me mosrespektimin e afateve procedurale të përgatitjes, kërkesave shtesë dhe për ndryshimin e prioritetëve buxhetore pa bazë ligjore.

Efektiviteti dhe cilësia e rezultateve të **Kontrollit të Brendshëm Publik** konstatohet se kanë rënë në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë, pasi: vlerësimi i përgjithshëm i kontrollit të brendshëm vijon të jetë në të njëjtin klasifikim “Pjesërisht efektiv”, dhe asnjë prej 5 komponentëve nuk është vlerësuar si efektiv; komponenti “Aktiviteti i kontrollit” është përkeqësuar këtë vit duke u renditur “Pjesërisht efektiv” nga “Efektiv” që ishte në vitin 2021. E njëjta gjë ka ndodhur dhe me Parimet 12 dhe 14, respektivisht “Aktivitetet e kontrollit” dhe “Informimi dhe komunikimi”; si dhe asnjë prej 17 parimeve të vlerësuara në vitin 2022 nuk paraqitet në përmirësim nga viti i mëparshëm.

Përgjatë vitit 2022 kanë funksionuar 126 **Njësi të Auditit të Brendshëm**, të cilët kanë përfunduar 1 008 angazhime auditimi ose 91% të Planit vjetor, i cili është më i ulti i 5 viteve të fundit. Nga 499 auditues të brendshëm sipas strukturave organike të institucioneve publike, në fund të vitit 2022 rezultojnë 435, ose 64 auditues më pak; janë 12 % e audituesve të brendshëm të pa certifikuar, kryesisht në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore; kriteri i eksperiencës për vjetërsi pune mbi 5 vjet plotësohet vetëm nga 245 prej tyre, pra nuk plotësojnë këtë kriter 44% e audituesve të brendshëm; rezultojnë 12 bashki që nuk kanë ngritur njësitë e auditit të brendshëm etj.

Vlerësohet se Njësitë e Auditit të Brendshëm vijojnë të vuajnë mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, planifikime të pabazuar në mundësitë reale, procedura të zgjatura të auditimit, vlerë të gjetjeve në shkelje të disiplinës financiare në ulje krahasuar me një vit më parë etj.

Nga auditimet e kryera dhe të evaduara, të cilët kanë pasur periudhë të plotë ose të pjesshme auditimi aktivitetin e subjekteve të vitit 2022, ka rezultuar dëm ekonomik gjithsej 4,631,863 mijë lekë, nga të cilat 3,243,019 mijë lekë në zërin e shpenzimeve të tjera ose 70 % e totalit; 1,351,488 mijë lekë në fushën e shpenzimeve operative ose 29% e shumës gjithsej dhe 1 % përfaqëson dëmin në fushën e investimeve në vlerën 37,357 mijë lekë.

Nga auditimet kanë rezultuar të ardhura të munguara në vlerën prej 63,159,119 mijë lekë, pothuajse tërësisht si rezultat i parregullsive dhe shkeljeve të legjislacionit tatimor dhe doganor në vlerën paraprake prej 63,105,827 mijë lekë, që i përket kryesisht periudhave para vitit 2022; 49,999 mijë nga zëri të ardhura të tjera; 1,748 mijë lekë nga shkeljet e zbatimit të legjislacionit për taksat dhe tarifatat vendore si dhe 1,545 mijë lekë nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qira dhe koncesion

Nga auditimet rezultojnë 54,608,837 mijë lekë menaxhim joefektiv i të ardhurave dhe shpenzimeve (mungesë efektiviteti, efience dhe ekonomiciteti- 3 E-të), në pjesën më të madhe në fushën e shpenzimeve në shumën prej 40,756,302 mijë lekë (75%) dhe këto kryesisht në zërin “shpenzime të tjera”, në shpenzimet për investime, si dhe në shpenzimet për paga, shpërblime, sigurime shoqërore dhe në shpenzimet operative.

Menaxhimi jo efektiv i të ardhurave ka rezultuar në shumën 13,852,535 mijë lekë, nga e cila në të ardhurat e tjera 88 %, nga shkeljet në zbatimin e legjislacionit për taksat dhe tarifatat

vendore 987,405 mijë lekë si dhe nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qira dhe koncesione 708,035 mijë lekë të efektit negativ gjithsej.

Situata ekonomike në vendin tonë është përbalhur dhe vijon të përballet me presione të shtuara mbi buxhetin publik, si pasojë e globalizimit, tërmetit, pandemisë, konflikteve, luftërave etj., e cila ka sjellë në vëmendje të veçantë përmirësimin e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të shpenzimeve publike, duke e konsideruar si rrugë potenciale të mirëmenaxhimit të financave publike.

Në këtë kuadër, në këndvështrimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, përdorimi i fondeve publike në mungesë të efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit është parë dhe vlerësuar si një element i rëndësishëm që gërryen ekonominë, frenon zhvillimin e qëndrueshëm dhe konsolidimin fiskal të vendit.

Megjithëse mungesa e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e shpenzimeve publike vijon të mbetet një sfidë në veprimtarinë e administratës publike, kjo nuk e ka penguar Kontrollin e Lartë të Shtetit ta trajtojë këtë çështje me kujdes, objektivitet dhe vlerësim profesional, me një rëndësi të veçantë po aq sa edhe dëmi ekonomik, pa i kthyer në qëllim në vetvete, por në synim të efektit parandalues nëpërmjet identifikimit dhe rekomandimeve për përmirësim, në funksion të mirëmenaxhimit dhe të mirëqeverisjes.

Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson se, pavarësisht përpjekjeve të Qeverisë e cila nëpërmjet buxhetit të vitit 2022 ka synuar të arrijë balancimin e nevojave të mbështetjes së rikuperimit të ekonomisë dhe reduktimit të pasojave të tërmetit dhe të pandemisë, përfshirë dhe influencën e faktorëve rajonalë, si dhe ruajtjes dhe konsolidimit të qëndrueshmërisë së financave publike, institucionet publike, nuk kanë rezultuar plotësisht efektive në procesin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit, për forcimin e disiplinës fiskale, drejtimin e shpërndarjes së burimeve sipas objektivave të politikës dhe për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.

Në referencë të shqyrtimit të Raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022” dhe të raporteve të tjera të përgatitura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe nga rezultatet e auditimeve në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit i rekomandon Qeverisë:

- *Orientimin drejt konsolidimit fiskal, të mbështetur në reformën për rritjen e të ardhurave dhe minimizimin e shpenzimeve jo efektive, si dhe vijimit të reduktimit të borxhit publik, si çështje thelbësore për uljen e risqeve, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike.*
- *T'i kushtojë një vëmendje të veçantë planifikimit të të ardhurave dhe buxhetimit të mirë-integruar dhe efikas të shpenzimeve publike, me qëllim që të rritet saktësia në planifikim, duke marrë në shqyrtim dhe analizë të gjithë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë zhvillimin e vendit, me qëllim arritjen e objektivave për konsolidimin e mëtejshëm të rimëkëmbjes ekonomike.*
- *Në fushën e shpenzimeve publike, në vijim duhet të përqendrohet gjithnjë e më shumë në aspektin e tyre cilësor përkundër aspektit sasior, në përpjekje të vazhdueshme për rritjen e shpenzimeve efektive dhe eficiente që ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe rritjen e ekonomisë kombëtare.*
- *Të sigurojë një lidhje më të mirë ndërmjet politikave strategjike dhe Programit Buxhetor Afatmesëm, me prioritetet përkatëse në buxhetet vjetore, në funksion të qëndrueshmërisë ekonomike dhe forcimit të menaxhimit të financave publike.*

- *Në kushtet e një ekonomie të vogël dhe të hapur, Shqipëria vijon të jetë e ekspozuar ndaj ngjarjeve rajonale dhe më gjerë, e cila kërkon nga qeveria të marrë masa efektive për të zbutur risqet e brendshme potenciale të lidhura me partneritetet publike-private, shoqëritë publike (kryesisht ato të sektorit energjetik), si dhe detyrimet e prapambetura, përfshirë dhe kontigjencat për vendimet e gjykatave ndërkombëtare.*
- *Të tregojë kujdes të shtuar në hartimin dhe zbatimin e ndryshimeve të politikave fiskale, jo vetëm në respektim të afateve dhe diskutimeve me palët e interesit, por të synojë zgjerimin e bazës së tatimpaguesve për të mbledhur më shumë të ardhura tatimore, në harmoni të plotë të barrës fiskale me zhvillimet ekonomike brenda vendit dhe atyre rajonale, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.*
- *Zhvillimin dhe konsolidimin e kapaciteteve institucionale të administratës fiskale (tatimore dhe doganore) për të pasur efektivitetet në luftën kundër informalitetit, evazionit dhe nënraportimit, me qëllim që të rritet mbledhja e të ardhurave brenda potencialeve të sistemit fiskal shqiptar, me një kosto optimale për buxhetin e shtetit.*

I. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I BUXHETIT


1. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I TË ARDHURAVE

Nga shqyrtimi ecurisë së planifikimit të të ardhurave për vitin 2022 konstatohet se është karakterizuar nga ndryshime të shumta, duke filluar menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, miratuar më datë 25.11.2021, hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë. 21.12.2021, me efekte financiare nga data 1 janar 2022. Ndryshimet e të ardhurave buxhetore kanë ndodhur me katër akte normative, duke filluar nga muaji shkurt, korrik dhe dy ndryshime në muajin dhjetor 2022. Ndryshimet e të ardhurave në përgjithësi, dhe kryesisht AN fundit i miratuar më datë 29.12.2022, kanë zhvleftësuar çështjet dhe procesin e planifikimit buxhetor të kryera nga MFE dhe strukturat e tjera përkatëse në institucionet e varësisë.

Gjithashtu, nga auditimi në MFE ka rezultuar se mungon analiza e mirëfilltë e situatës, si dhe mungon një akt administrativ (udhëzim, metodologji, manual etj.) për procedurën se si duhet të veprojë ky institucion për ndryshimin e treguesve të buxhetit me akte normative gjatë vitit ushtrimor, në bashkëpunim dhe me institucionet fiskale të varësisë.

Të ardhurat buxhetore sipas treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar 2022 përbëhen nga të ardhurat nga ndihmat, të ardhurat tatimore dhe të ardhurat jotatimore.

Grafiku 3 Ecuria e nivelit të planifikimit të të ardhurave për vitin 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit 2022, të përgatitur nga MFE dhe sipas auditimit të KLSH në MFE, rezulton se të ardhurat në total janë realizuar 572,790 milion lekë nga 583,315 milion lekë të planifikuara ose në masën 98 %, me një diferencë prej 10,525 milion lekë, por që janë mbledhur më shumë të ardhura se viti 2021 në vlerën prej 62,218 milion lekë ose + 12 %.

Tabela 2 Të ardhurat gjithsej sipas zërave kryesor të buxhetit 2022

Në milion lekë								
Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	Ligji buxhetit 2022	AN nr.19 29.12.2022	Fakti 2022	% realizimit ndaj AN	Diferencat ndaj AN	Diferencat ndaj 2021
I.	Totali i të ardhurave	510,572	536,811	583,315	572,790	98	- 10,525	+ 62,218
a	Të ardhurat nga ndihmat	12,671	13,994	11,994	9,510	79	- 2,484	- 3,161
b	Të ardhurat tatimore	475,612	500,167	546,671	541,342	99	- 5,329	+ 65,730
c	Të ardhurat jotatimore	22,289	22,650	24,650	21,938	89	- 2,712	- 351

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme, konstatohet se asnjëri prej tre treguesve kryesor të të ardhurave gjithsej nuk është realizuar krahasuar me AN nr.19, datë 29.12.2022, për më tepër që dy zëra (Të ardhurat nga ndihmat dhe Të ardhurat jotatimore) nuk janë realizuar as

aq sa ishin planifikuar në ligjin e buxhetit, dhe më pak se realizimi i vitit të kaluar, duke shfaqur dobësi në planifikimin e tyre nga mungesa e marrjes në konsideratë të faktorëve të brendshëm e të jashtëm që ndikojnë këto zëra.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, me shkresën nr. 22351/129 prot., datë 30.12.2022 është përcjellë zbatimi i AN nr. 17 datë 01.12.2022, ku nga ana e aparatit të MFE i është çelur kodi i produktit 21AA201 “Transferta kapitale për AIC” në vlerën 2,120 milion lekë. Për Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC) efekti neto i veprimeve të autorizuara me këtë akt normativ është 0 (zero) lekë lëvizim fondesh, pasi specifikohet -Rritja e të ardhurave jotatimore në masën 2,000 milion lekë në zërin “Kthim kapitali nga AIC” dhe shtesë 2,000 milion lekë në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit. Pavarësisht efektit neto 0 të vendimeve 112 dhe 112/1, nga ana e MFE-së zgjidhet të raportohet vetëm efekti i daljes së mjeteve monetare, me pakësim fondesh për buxhetin e shtetit, pa marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e të njëjtës shumë të specifikuar si kthim kapitali 2,000 milion lekë, vlerë e cila nuk është arkëtuar.

1.1 Të ardhurat nga ndihmat

Të ardhurat nga ndihmat janë rishikuar në planifikim gjatë vitit duke i ulur ato me AN nr.17, datë 01.12.2022 në krahasim me ligjin e buxhetit nga 14,000 milion lekë në vlerën e 11,994 milion lekë dhe janë realizuar 9,510 milion lekë ose 79 %, duke krijuar një mosrealizim prej 2,484 milion lekë, si dhe 3,161 milion lekë më pak se viti i kaluar, niveli më i ulët i tre viteve të fundit.

Megjithëse të ardhurat nga ndihmat përfaqësojnë një përqindje të pa konsiderueshme në plan dhe në fakt në totalin e të ardhurave për vitin 2022, përkatësisht 2.1% dhe 1.7 %, ndryshimi i programimit në rënie gjatë vitit, si dhe realizimet faktike me luhajtje nga viti në vit, mbartin me vete rrezikun e shtuar që këto fonde të përfutuara në formën e ndihmës që jepen nga qeveritë e shteteve të tjera dhe donatorë të tjerë, në të ardhmen të vijnë duke u zvogëluar, duke sjellë si pasojë kufizimin e burimeve financiare të buxhetit.

1.2. Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore përfaqësojnë të ardhurat që merren nga vjelja e të gjitha llojeve të taksave dhe tatimeve që zbatohen dhe kontributet nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Në vitin 2022, të ardhurat tatimore sipas buxhetit përfundimtar të rishikuar me AN nr.19, datë 29.12.2022 janë përcaktuar në vlerën prej 546,671 milion lekë dhe janë realizuar 541,342 milion lekë, ose 99 % me një diferencë prej - 5,329 milion lekë, por që janë tejkaluar ndjeshëm krahasuar me ligjin fillestar të buxhetit 2022, dhe 65,730 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2021.

Të ardhurat tatimore në vitin 2022 përbëjnë 25.2 % të PBB, ndërkohë që në vitin 2021 ishte 25.4 %, pra me një ulje prej 0.2 pikë përqindje.

Të ardhurat tatimore përbëjnë të ardhurat kryesore të buxhetit në masën 94.5 % të totalit të të ardhurave publike faktike.

Sipas pasqyrës së treguesve të buxhetit të konsoliduar të përgatitur nga MFE, të ardhurat tatimore përbëhen nga të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti vendor dhe të ardhurat nga fondet speciale. Nga shqyrtimi i këtyre zërave, konstatohet se nuk janë realizuar të ardhurat nga tatimet dhe doganat për - 7,107 milion lekë, ndërkohë që kjo diferencë zbutet nga tejkalimi i të ardhurave nga fondet speciale (+ 1,772 milion lekë) dhe për të ardhurat nga pushteti vendor me + 6 milion lekë, megjithëse këto zëra janë tejkaluar në krahasim me faktin e vitit të kaluar 2021.


1.2.1 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbëjnë zërin kryesor të të ardhurave tatimore të buxhetit të shtetit, pasi përfaqësojnë 72 % të të ardhurave tatimore dhe 68 % të të ardhurave gjithsej në fakt për vitin 2022.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat në buxhetin e rishikuar me AN nr.19, datë 29.12.2022 janë planifikuar 398,000 milion lekë dhe janë realizuar në fakt 390,893 milion lekë ose 98 %, me një mosrealizim prej 7,107 milion lekë. Ato përbëjnë në fakt 18.3 % të PBB në krahasim me 17.9 % në vitin 2021, si dhe janë grumbulluar më shumë të ardhura për 52,819 milion lekë ose rreth 16 %. Duhet theksuar se, sipas Relacionit mbi Projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, MFE ka programuar rritjen e të ardhurave nga tatimet dhe doganat me 9.9 % ose +32.5 miliardë lekë, gjë që tregon për mungesë të aftësisë parashikuese dhe saktësisë në planifikim nga ana e MFE.

Planifikimi buxhetor i të ardhurave nga tatimet dhe doganat ka pësuar ndryshime të konsiderueshme që nga ligji fillestar, si dhe me AN, duke reflektuar mangësi parashikimi të treguesve buxhetor nga ana e MFE, në pamjaftueshmëri harmonizimi të faktorëve makroekonomikë me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike, atribut i tatimeve dhe doganave.


Grafiku 4 Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave tatimore dhe doganore 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbëhen nga të ardhurat për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, akcizat, tatimin mbi të ardhurat personale, taksa nacionale dhe taksa doganore, programi sipas buxhetit të rishikuar dhe realizimi faktik i të cilëve paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 5 Programi dhe realizimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat sipas përbërjes



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

1.2.1.1 Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Sipas, pasqyrës së treguesve të buxhetit të konsoliduar, TVSH e arkëtuar (bruto) është realizuar në vlerën 213,893 milion lekë, ndërsa plani është vendosur vetëm për TVSH neto (pasi i është zbritur vlera e rimbursimit).

Arkëtimi i TVSH bruto kryhet nga administrata tatimore dhe ajo doganore, e cila sipas Raportit të zbatimit të buxhetit të përgatitur nga MFE rezulton e programuar 211,500 milion lekë (193,000 milion lekë TVSH neto e planifikuar dhe 18,500 milion lekë rimbursim i saj) dhe është realizuar 213,893 milion lekë ose 101 %, me vlerën shtesë prej + 2,393 milion lekë. Nga analiza e ecurisë së arkëtimit mujor të TVSH gjatë vitit 2022, rezulton se vlera ka ndryshuar nga 15,500 milion lekë në muajin shkurt në 21,456 milion lekë në muajin dhjetor.

Në krahasim me realizimin e vitit 2021 të ardhurat bruto nga TVSH janë rritur 15 %. Sipas Raportit vjetor të aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve 2022 dhe për vitin 2021 nuk ka ndryshuar numri i subjekteve tatimpaguese të TVSH prej 28,945 subjekte, me ndryshim strukture në ulje të subjekteve tatimpagues të biznesit të vogël nga 32 % në 30 %, gjë që demonstroi se rritja e të ardhurave të TVSH në vitin 2022 nuk është rezultat i zgjerimit të bazës së tatim paguesve të TVSH, por i rritjes së aktivitetit të atyre ekzistues, krahas të tjerave me ndikim të politikave fiskale dhe rritja e çmimeve.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, me ligjin nr. 111/2021 datë 25.11.2021 është përcaktuar shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizimin e inpleteve bujqësore në 10%; është ndryshuar niveli i përjashtimit të makinerive dhe pajisjeve të importuara për vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë (nga 50 milion që ishte); si dhe norma e kompensimit të prodhuesve bujqësorë është bërë 0% nga 6% që ishte më parë, me efekt financiar të parashikuar nga MFE në shumën 1,650 milion lekë, dhe të rezultuar me +60 milion lekë, pra gjithsej 1,710 milion lekë.

Tabela 3 Efekti i parashikuar dhe i realizuar i paketave fiskale për TVSH buxhetit 2022

Në milion lekë

Nr.	Masat	Efekti i parashikuar i paketës	Të ardhura të mbledhura si efekt i masës fiskale	Diferenca Parashikimi/ Të ardhura të mbledhura
1	Eliminimi i skemës së kompensimit të prodhuesit bujqësor për qëllime të TVSH-së (nga 6% në 0%)	750	900	150
2	Trajtimi me shkallë të reduktuar të TVSH-së 10% i furnizimit të inpleteve bujqësore	900	810	-90
	Gjithsej	1,650	1,710	60

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga sa më sipër konstatohet se MFE, nuk ka arritur të konsolidojë saktësinë në planifikimin e treguesve fiskal dhe të masave përkatëse, për të analizuar dhe marrë në konsideratë të gjithë faktorët dhe mobilizimin e tyre në realizimin e programit buxhetor. Sipas të dhënave të MFE rezulton se 73 % e TVSH bruto mbledhet nga administrata doganore dhe 27 % nga administrata tatimore.

Tabela 4 Të ardhurat nga TVSH për vitin 2022

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	AN nr.19 29.12.22	Fakti 2022	% realizimit ndaj AN	Diferencat ndaj AN	Diferencat ndaj 2021
I.	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar neto (a-b)	161,536	193,000	191,412	99	-1,588	29,876
a	TVSH e arkëtuar (bruto) (1+2)	185,638	211,500	213,893	101	2,393	28,255
b	TVSH e rimbursuar (Tatimet)	24,102	18,500	22,481	122	3,981	-1,621
1	Nga TVSH e arkëtuar, mbledhur nga Tatimet	54,337	56,000	56,995	102	995	2,658
2	Nga TVSH e arkëtuar, mbledhur nga Doganat	131,301	155,500	156,898	101	1,398	25,597

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Referuar Raportit të MFE mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike fiskale gjatë vitit 2022, rezulton se nga ana e tatimeve kanë qenë planifikuar të arkëtohen bruto 56,000 milion lekë dhe janë arkëtuar 56,995 milion lekë, me një tejkalim prej 995 milion lekë, si dhe 2,658 milion lekë më shumë se viti 2021.

Referuar auditimit në DPT dhe sipas Raportit vjetor 2022 të saj për këtë vit (tabela fq.11 e atij raporti), të ardhurat tatimore nga TVSH bruto janë realizuar 57,068 milion lekë, pra me një raportim të DPT prej 73 milion lekë më shumë se raportimi i MFE në pasqyrën e treguesve të konsoliduar të buxhetit për vitin 2022, diferencë që në terma bruto konstatohet se i përket përfshirjes së raportimit të kamatëvonesave sipas llogarisë 7090102 “Kamatëvonesa nga tatimi mbi vlerën e shtuar”.

Në terma bruto, konstatohet se realizimi i të ardhurave tatimore të TVSH në krahasim me një vit më parë është vetëm 2,600 milion lekë më shumë, duke mos reflektuar rritjen në të ardhura tatimore shtesë të efekteve të inflacionit të përgjithshëm në nivelin e çmimeve si tregues real i nivelit të qarkullimit të realizuar. Ky konkluzion vjen pasi rritja në të ardhura tatimore nga tatimi mbi vlerën e shtuar vlerësohet të jetë rreth 4.8% në krahasim me një vit më parë ndërkohë që inflacioni mesatar i raportuar është 6.7%.

Sipas Raportit të MFE për zbatimin e buxhetit 2022, nga ana e administratës doganore TVSH në import kanë qenë programuar 155,500 milion lekë dhe janë arkëtuar 156,898 milion lekë ose realizuar 101 %, si dhe 25,597 milion lekë më shumë se sa viti 2021.

Nga auditimi i KLSH në DPD rezulton se, sipas saj rritja e të ardhurave nga TVSH gjatë vitit 2022, në krahasim me planin përfundimtar dhe në krahasim me vitin e kaluar është stimuluar kryesisht nga rritja e çmimit të karburantit, nga rritja e importit të energjisë elektrike, rritja e mallrave të konsumit të përgjithshëm etj., si dhe efekt negativ në realizimin e të ardhurave kanë sjellë autoveturat e përdorura, me një rënie prej 650 milion lekë dhe telefonat celularë me një rënie prej 555 milion lekë.

TVSH e rimbursuar nga administrata tatimore ishte programuar 18,500 milion lekë dhe rimbursimet e kryera sipas MFE për vitin 2022 janë 22,481 milion lekë, ose 3,981 milion lekë më shumë se plani, si dhe 1,621 milion lekë më pak se rimbursimet e vitit 2021. Tejkalmi me mbi 1/5 e vlerës së rimbursimit të programuar, tregon se MFE vijon të shfaq mangësi planifikimi të treguesve, pasi ndryshimin në rritje të të ardhurave nga TVSH gjatë vitit, nuk e ka shoqëruar dhe me rritjen vlerës së rimbursuar, me pasoja kjo në të ardhurat në dispozicion të buxhetit që shërbejnë si burim i shpenzimeve.

Nga auditimi i KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) rezulton se vlera e TVSH së rimbursuar sipas tyre është 22,469 milion lekë, pra me një diferencë më pak në vlerë prej 12 milion lekë krahasuar me treguesit e buxhetit të konsoliduar paraqitur nga MFE, pasi DPT në statistikat e saj nuk ka përfshirë rimbursimin e TVSH nga drejtoritë rajonale tatimore.

Megjithëse nga ana e MFE në Raportin e zbatimit të buxhetit faktik 2022 është cilësuar “Për periudhën 12M 2022, detyrimet e prapambetura të rimbursimit të TVSH-së janë zeruar, krahasuar me 0.48 miliardë lekë, të regjistruara në 12M 2021” ashtu edhe nga DPT është raportuar se gjendja e stokut të rimbursimit të TVSH-së deri më 31.12.2022 është në shumën 0 lekë, nga auditimi i KLSH në DPT rezulton se në mbyllje të periudhës ushtrimore 2022, janë 32 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale për 1,844 milion lekë, të cilat megjithëse kanë kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre nuk janë rimbursuar. Pra, bazuar në sa më sipër rezulton se stoku i rimbursimit të TVSH më 31.12.2022, sipas vlerësimit të KLSH është së paku në vlerën

1,844 milion lekë, vlerë e cila do të bënte që vlera e rimbursimit të TVSH të kalonte dhe vitin 2021.

Sipas të dhënave të MFE, të ardhurat neto nga TVSH kanë qenë programuar 193,000 milion lekë me buxhetin e rishikuar me AN nr.19, datë 29.12.2022 dhe janë realizuar 191,412 milion lekë ose 99.2 %, pra me mosrealizim prej 1,588 milion lekë, megjithëse krahasuar me vitin 2021 janë grumbulluar 29,876 milion lekë të ardhura më shumë. Ashtu si dhe buxhetin e vitit të kaluar, TVSH neto, nuk realizohet edhe në kushtet e tejkalimit të TVSH së arkëtuar (bruto), për shkak të mangësive në programimin e rimbursimit të këtij tatimi.

Të ardhurat neto nga TVSH përbëjnë të ardhurat kryesore të arkëtimeve faktike nga tatimet e doganat në masën 49 %, si dhe përfaqësojnë 9 % të PBB

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit 2022 të përgatitur nga MFE, nga ana e DPT është planifikuar të arkëtohen 37,500 milion lekë TVSH neto (brenda vendit) dhe 155,500 milion lekë nga TVSH në import dhe është realizuar përkatësisht 34,514 milion lekë (92%) dhe 156,898 milion lekë (101%).

Nga auditimi në DPT, rezulton se nga ana e tyre raportohet TVSH neto në shumën 34,587 milion lekë, ose 73 milion lekë më shumë, e cila reflekton vlerën më të lartë të raportimit të TVSH së arkëtuar (bruto) nga ana e tyre.

Në nivelin e të ardhurave nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar kanë ndikuar dhe politikat fiskale të miratuara me ligjin nr.111/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, i datës 25.11.2021, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 197/2021, e cila ka dalë nga shtypi më 21.12.2021, me hyrje në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare, pra në vitin 2022.

Ligji i mësipërm është miratuar jashtë afateve kohore të përcaktuara në nenin 4/1, pika 3 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal, dhe në fakt janë bërë një muaj para vitit fiskal 2022.

Megjithatë, sipas Raportit të MFE efekti fiskal nga eliminimi i skemës së kompensimit të prodhuesit bujqësor për qëllime të TVSH nga 6 % në 0 % vlerësohen të kenë dhënë një efekt pozitiv prej 15 milion lekë, ndërsa trajtimi me shkallë të reduktuar të TVSH 10 % të inpueteve bujqësore ka pasur efekt negativ prej 0.8 milion lekë.

Nga auditimi në DPT rezulton se gjatë vitit 2022 detyrimet për TVSH janë rritur me 10,208 milion lekë dhe nga zbritja e arkëtimeve, sistemimeve dhe transferimeve, ndërsa shtesa e detyrimeve në fund të vitit rezulton se është rritur me 4,396 milion lekë, me rënie në krahasim me vitin 2021 që ishte 5,782 milion lekë. Stoku i detyrimeve të prapambetura për TVSH në fund të vitit 2022 përbën 35 % të detyrimeve tatimore gjithsej, si dhe vetëm 57 % është vlera e detyrimit dhe pjesa e tjetër 43 % janë penalitete dhe kamatë vonesa.

Ndërsa nga auditimi në DPD rezulton se nga ana e tyre nuk ndiqet vjelja e detyrimeve sipas llojit të tatimit dhe taksës, por në total detyrime të prapambetura, duke sjellë për pasojë mungesë qartësie në detajimin e stokut të borxhit doganor (përfshirë dhe TVSH) dhe mangësi në marrjen e masave për vjeljen e tij.

1.2.1.2 Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin

Sipas Raportit të MFE, Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë realizuar në vlerën 47,683 milion lekë nga 46,000 milion lekë të programuar në buxhetin e rishikuar, ose 104 %, me një tejkalim prej 1,683 milion lekë.

Rezulton se planifikimi i këtij zëri fiskal gjatë vitit 2022 ka pësuar një ndryshim të dukshëm, pasi nga 35,586 milion lekë në ligjin e buxhetit ka arritur përfundimisht në 46,000 milion lekë me AN nr.17, datë 01.12.2022, me një rritje afër 30%, duke e zhvleftësuar ndjeshëm procesin e planifikimit nga ana e MFE.

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit faktik 2022 të përgatitur nga MFE, rezulton se të ardhurat nga tatim fitimi në pjesën më të madhe vijnë nga sektori i shërbimeve, ai i tregtisë dhe më pas nga sektori i prodhimit etj. Gjithashtu, krahasuar me vitin 2021 rritja më e madhe tatimit mbi fitimin ka ardhur nga sektori i prodhimit, tregtisë, shërbimeve etj. Strukturimi i kontributit të sektorëve të ekonomisë në tatimin e fitimit, në të cilin nuk ka përparësi sektori i prodhimit shfaq paqëndrueshmëri në perspektivën e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit.

Nga analiza e ecurisë së grumbullimit të të ardhurave nga tatimi mbi fitimin rezulton se 36 % e kësaj vlere është mbledhur në dy muaj: mars dhe dhjetor 2022.

Krahasuar me vitin 2021 janë realizuar 34 % të ardhura më shumë nga tatimi mbi fitimin.

Nga auditimi i kryer në DPT, rezulton se sipas llogarive analitike akumulimi i gjendjes së të ardhurave nga tatimi mbi fitimin është realizuar në pjesën më të madhe prej 71 % nga parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimin në formën e depozitimeve të përkohshme për deklaratën e tatimit mbi fitimin, e cila krijon detyrime për mjete në ruajtje në konsolidim sipas pasqyrave financiare të konsoliduara. Veç kësaj, nga auditimi rezulton se DPT raporton të realizuar 47,797 milion lekë, d.m.th 114 milion lekë më shumë se shifra e pasqyruar nga MFE në Raport dhe në treguesit e buxhetit të konsoliduar 2022. Në vlerësimin e KLSH, kjo diferencë është për shkak dy faktorëve: të përfshirjes së kamatë-vonesave si e ardhur dhe mungesa e evidentimit të kthimeve të këtij tatimi të kryera nga drejtoritë rajonale tatimore; Faktori i dytë që ndikon në mosrakordimin e të dhënave të raportuara nga DPT me atë të treguesve fiskalë të konsoliduar konstatohet se është teprica e llogarisë 7090106 “Kamatëvonesa nga tatim fitimi” në shumën 104 milion lekë që për efekt të planit është raportuar si e ardhur tatimore nga DPT ndërkohë që në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar është raportuar në zërin e të ardhurave jo tatimore.

Nga auditimi në DPT ka rezultuar se detyrimet e prapambetura për tatimin mbi fitimin gjatë vitit 2022 janë shtuar me 10,253 milion lekë, dhe duke zbritur arkëtimet gjatë vitit sistemimet dhe transferimet, rritja neto është 3,898 milion lekë më e ulët se sa ajo e vitit 2021.

1.2.1.3 Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Administrata tatimore në vitin 2022 ka realizuar 44,983 milion lekë nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga 47,000 milion lekë të planifikuara ose 96 %, me një mosrealizim prej 2,017 milion lekë, por që janë 14 % më të larta se viti i kaluar 2021, dhe akoma nuk është arritur niveli i të ardhurave për këtë lloj tatimi i vitit 2019.

Duhet theksuar se tatimi nga të ardhurat personale në vitin 2022 nuk është realizuar as plani i arkëtimeve në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” në shumën 45,161 milion lekë, e megjithatë MFE ka vijuar planifikimin në rritje të këtyre të ardhurave me Akte normative deri në 47,000 milion lekë.

Sipas Raportit vjetor të DPT, 57 % të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale e përbën tatimi mbi pagë nga listë-pagesa, me nga 9 % tatimi mbi të ardhurat nga qiratë dhe nga tatimi mbi dividendët dhe aksionet etj.

Nga struktura e pagesave sipas sektorëve të ekonomisë, rezulton se 69 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale arkëtohen nga sektori i shërbimit, 14 % sektori i ndërtimit, 10% sektori i tregtisë etj.

Mosrealizimi i të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale do të ishte akoma më i madh për të paktën 440 milion lekë, pasi sipas MFE nga zbatimi i ndryshimeve fiskale për indeksimin e pagave të administratës me 7 % janë rritur të ardhurat me 140 milion lekë, si dhe 300 milion lekë nga rritja e bazës së pa tatueshme për efektin e tatimit mbi të ardhurat personale nga 30,000 lekë në 40,000 lekë.

Nga auditimi i kryer në DPT, rezulton se tatimi nga të ardhurat personale raportohet se është realizuar 50,696 milion lekë ose 5,713 milion lekë më e lartë se raportimi i MFE në treguesit e buxhetit të konsoliduar. Sipas vlerësimit të KLSH kjo diferencë vjen në pjesën më të madhe si pasojë e të ardhurave nga rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme, në zbatim të Udhëzimit nr. 2727 datë 04.02.2020 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme dhe përcaktimin e tarifës së shërbimit”.

Nga auditimi në DPT konstatohet se detyrimet e prapambetura janë ulur gjatë këtij viti, ndonëse përbëjnë një përqindje të pa konsiderueshme (1.5 %) në stokun e detyrimeve tatimore gjithsej në fund të vitit 2022.

1.2.1.4. Taksa nacionale dhe të tjera

Sipas Raportit të MFE mbi zbatimin e buxhetit vjetor 2022 të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera në buxhetin e rishikuar kanë qenë planifikuar 48,500 milion lekë dhe janë realizuar 44,821 milion lekë, pra 92 % ose 3,679 milion lekë më pak, ndonëse janë realizuar 4.5 % më shumë se në vitin 2021.

Ndryshe sa ka ndodhur me planin e llojeve të tjera të tatimeve dhe taksave që janë rritur gjatë vitit 2022 në krahasim me ligjin e buxhetit, për taksat nacionale dhe të tjera kanë ndjekur trend zbritës: nga 49,741 milion lekë në ligjin e buxhetit 2022 në 48,500 milion lekë me planin përfundimtar të ndryshuar me akte normative.

Të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera mban peshë të përafërt me rreth 11 % me të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin.

Këto të ardhura përbëhen nga taksat nacionale dhe renta minerare, nga të cilat e para mbledhet nga administrata tatimore etj., si dhe e dyta nga administrata doganore.

Tabela 5 Të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera për vitin 2022

<i>Në milion lekë</i>							
Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	AN nr.19 29.12.22	Fakti 2022	% realizimit ndaj AN	Diferencat ndaj AN	Diferencat ndaj 2021
I.	Taksa nacionale dhe të tjera	42,521	48,500	44,821	92	- 3,679	2,300
a	Taksa nacionale dhe të tjera	40,076	44,000	40,623	92	- 3,377	547
b	Renta minerare	2,445	4,500	4,198	93	- 302	1,753

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Taksat nacionale të cilat përbëjnë pjesën kryesore të këtij zëri (mbi 90 %), nuk janë realizuar për 3,679 milion lekë (92 %), megjithëse janë realizuar pak më shumë se 1 % krahasuar me vitin 2021.

Duhet theksuar se sipas përbërjes strukturore, planifikimi i të ardhurave nga taksat nacionale dhe të tjera ka ardhura në zbritje gjatë vitit 2022: nga 46,740 milion lekë në ligjin e buxhetit në 44,000 në planin e rishikuar, dhe realizuar 40,623 milion lekë ose 92 %, me një mosrealizim prej 3,377 milion lekë, sipas Raportit të zbatimit të buxhetit 2022 të përgatitur nga MFE.

Sipas auditimit në DPT rezulton se të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera, përbëhen nga:

- Taksat Kombëtare dhe Tarifa, planifikuar 18,900 milion lekë dhe janë realizuar 13,666 milion lekë ose 72 %, me një mosrealizim prej 5,234 milion lekë;
- Taksa e Qarkullimit Rrugor, të cilat janë programuar 23,400 milion lekë dhe janë arkëtuar 18,250 milion lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 5,150 milion lekë ose 22 % më pak;
- Të ardhurat nga lojërat e fatit raportohen se janë realizuar në shumën 1,973 milion lekë, me një tejkalim prej 273 milion përkundrejt planit përfundimtar prej 1,700 milion lekë.

Pavarësisht se të ardhurat nga lojërat e fatit paraqiten me tejkalim përgjatë vitit 2022, të krahasuar me planin fillestar prej rreth 4 miliard lekë, këto të ardhura paraqiten me mosrealizim në shumën prej rreth 2 miliard lekë. Shkaku i këtyre diferencave në raport me planin fillestar i cili është reflektuar në ndryshimin me akte normative përgjatë vitit, konstatohet se ka ardhur si pasojë e mos implementimit në kohë të legjislacionit në lidhje me legalizimin e veprimtarisë së lojërave të fatit për sektorë të cilët ishin mbyllur më parë.

Nga auditimi në DPT rezulton se, mos realizimi më i madh në grupin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat kombëtare të raportuara në tabelën e treguesve fiskalë si një komponent i taksave nacionale dhe të tjera është shkaktuar nga mos realizimi i taksës së qarkullimit rrugor dhe taksës së karbonit. Sipas statistikave fiskale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përgjatë vitit 2022, importi i karburanteve të cilat janë subjekt i këtyre taksave në sasi ka rënë në raport me një vit më parë. Ulja e konsumit të këtyre mallrave me peshë në të ardhurat buxhetore vlerësohet në 54,622 ton ose 9 % në raport me vitin 2021, të cilat në kuadër të taksave fikse të indeksuara mbi sasinë e aplikueshme, kanë sjellë një performancë jo të mirë me efekt në mos realizimin e të ardhurave të përgjithshme tatimore në përgjegjësi mbledhje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga auditimi i KLSH në DPT, rezulton se nga administrata tatimore për këtë zë është krijuar një mosrealizim mbi 10,000 milion lekë, e ndarë në mënyrë të barabartë midis taksave nacionale dhe taksës së qarkullimit rrugor, madje kjo e fundit është realizuar më pak se në vitin 2021 për rreth 1,456 milion lekë. Përfshirja në të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera dhe i dënimeve administrative, ka sjellë për pasojë zbutjen e mosrealizimit dhe në zërat e tjerë.

Duhet të vihet në dukje se në Relacionin e Projektbuxhetit 2022, MFE e ka bazuar rritjen e këtyre të ardhurave në rritjen e mbledhjes së taksës së qarkullimit të automjeteve, si dhe për rentën në rritjen e sasive të karburantit dhe mineraleve, që në fakt pikërisht këto dy faktor kanë rezultuar negativë.

Gjithashtu, konstatohet se ka një rritje të stokut të detyrimeve për “Të tjera” në vlerën neto prej 155 milion lekë, pasi detyrimet e shtuara gjatë vitit janë 1,835 milion lekë.

Nga auditimi i kryer në MFE, ka rezultuar se me ligjin nr. 112/2021 datë 25.11.2021 është ndryshuar ligji “Për taksat kombëtare”, lidhur me taksat për importimin dhe prodhimin e qumështit pluhur, si dhe taksa për lëndën djegëse të përdorur si karburant për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, me destinacion përdorimi jashtë ujërave territoriale shqiptare në vlerën 40 lekë/litri. Sipas MFE për këtë të fundit është parashikuar një rritje në vlerë prej 800 milion lekë, nga e cila kanë rezultuar 600 milion lekë.

Të ardhurat nga renta minerare për vitin 2022 të grumbulluara nga administrata doganore janë në të njëjtën përqindje realizimi me taksat nacionale dhe të tjera, me një diferencë prej 302 milion lekë: nga 4,500 milion lekë të planifikuara me AN nr.19 dhe janë realizuar 4,198

milion lekë, pra – 302 milion lekë, por me rritje të konsiderueshme (mbi 70 %) krahasuar me vitin e kaluar 2021.

Nga auditimi i kryer në DPD rezulton se rritja e të ardhurave nga renta minerare është për shkak të rritjes së çmimit të bursës për naftën bruto dhe mineralet e tjera, pasi në vitin 2022 ka rënie të sasisë së tyre krahasuar me 2021, pasi rezulton të jenë eksportuar më pak 20 000 ton naftë bruto dhe 410 000 ton minerare të tjera.

1.2.1.5. Të ardhurat nga taksat doganore

Sipas Raportit të MFE, të ardhurat nga taksat doganore me buxhetin e rishikuar kanë qenë programuar 8,500 milion lekë dhe janë realizuar 8,447 milion lekë ose në masën 99 %, me mosrealizim prej 53 milion lekë, si dhe 989 milion lekë më shumë se viti paraardhës (13% më tepër), ku si faktorë të rritjes nga ana e DPD konsiderohet rritja e importeve nga Kina. Sipas strukturës, peshën më të madhe në taksat doganore e zënë produktet si cigaret (11%), mish importi (10%), veshjet e këmbës, (9%) elektro-shtëpiake (7%) etj. Nga analiza e ecurisë së mbledhjes së këtyre të ardhurave gjatë vitit 2022 rezulton se niveli më i ulët është në janar dhe niveli më i lartë në muajin korrik dhe dhjetor.

1.2.1.6. Të ardhurat nga akcizat

Të ardhurat neto nga akciza mbledhen nga administrata doganore dhe për vitin 2022 janë realizuar 53,547 milion lekë, nga 55,000 milion lekë të programuara në buxhetin e rishikuar ose 97 %, me mosrealizim prej 1,453 milion lekë, si dhe afër 4 % më shumë se në 2021. Duhet theksuar se programi i të ardhurave nga akciza ka pasur luhatje të theksuara në vlerë nga 56,478 milion në ligjin fillestar, ka arritur në 58,478 milion lekë me AN nr.3 dhe ka zbritur përfundimisht në 55,000 milion lekë me AN nr.12, datë 29.07.2022, duke ndjekur trend zbritës në krahasim me planifikimin e treguesve të tjerë buxhetor.

Të ardhurat e bruto të arkëtuara nga akciza janë 53,781 milion lekë, pasi 234 milion lekë janë akcizë e rimbursuar, me rënie të kësaj të fundit me 91 milion lekë krahasuar me vitin 2021, duke ndikuar pozitivisht në të ardhurat nga akciza në dispozicion të buxhetit të shtetit.

Duhet theksuar, se të ardhurat nga akciza janë ndikuar dhe nga ligji nr. 114/2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” miratuar më 25.11.2021, me hyrje në fuqi 15 ditë pas botimit (Fletorja zyrtare nr.195, datë 17.12.2021), pra më datë 01.01.2022, për llogaritjen e akcizës të indeksuar çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit për dy vitet paraardhëse shpallur nga INSTAT-i; unifikimi i akcizës së aplikueshme për gazin e lëngshëm, si dhe rritja sipas kalendarit për të gjithë kategoritë e “Duhan dhe nënprodukteve të tij”, i cili sipas MFE është parashikuar një efekt financiar gjithsej prej 1,630 milion lekë dhe ka rezultuar me efekt + 950 milion lekë. Kjo tregon se të ardhurat e realizuara nga akciza, faktikisht janë mbi 1,000 milion lekë më pak se në vitin 2021 (91 + 950). Ligji i mësipërm është miratuar jashtë afateve kohore të përcaktuara në nenin 4/1, pika 3 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal, dhe në fakt janë bërë një muaj para vitit fiskal 2022.

Nga auditimi i kryer në DPD, rezulton se faktorët që kanë ndikuar në këtë nivel realizimi të të ardhurave nga akciza konsiderohen rritja e konsumit të duhanit (cigares), të gazit, të pijeve alkoolike, si dhe indeksimi i akcizës me 3.3%.


Negativisht në arkëtimet e akcizës ka ndikuar importi i karburantit, si pasoje e rënies së konsumit të tij me rreth 57 000 tonë, në një kohë që në Relacionin mbi Projektbuxhetin e vitit 2022 është cilësuar si faktor kryesorë që do të ndikojnë në rritjen e parashikuar të të ardhurave nga akciza lidhur me rritjen e importit të mallrave të fortë si karburante etj.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, efektet financiare në të ardhurat nga unifikimi i akcizës së aplikueshme të gazit të lëngshëm në masën 6 lekë/litër duke filluar nga muaji korrik 2022, parashikohen të jenë me rreth 375 milionë lekë në vit, çka do të thotë se rritja në këtë vlerë është efekt i ndryshimeve në paketën fiskale.

1.3 Të ardhurat nga fondet speciale

Të ardhurat nga fondet speciale janë zëri i dytë i të ardhurave buxhetore, të cilat përfaqësojnë 23 % të të ardhurave tatimore dhe 21 % të totalit të të ardhurave publike, si dhe përbëhen nga të ardhurat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të ardhurat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe fondi për kompensimin e pronarëve. Sipas të dhënave të Raportit të MFE, rezulton se të ardhurat nga fondet speciale janë realizuar në vlerën prej 122,811 milion lekë nga 121,039 milion lekë të programuara në buxhetin e rishikuar, në masën 101.5 % ose 1,772 milion lekë më shumë. Programi i të ardhurave nga fondet speciale ka pësuar rritje në krahasim me ligjin e buxhetit, që ishte në vlerën prej 112,000 milion lekë. Krahasuar me vitin 2021 janë realizuar 11,939 milion lekë më shumë të ardhura nga fondet speciale, me rritje të konsiderueshme në kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Të ardhurat nga fondet speciale në vitin 2022 përbëjnë 5.6 % të PBB.

Grafiku 6 Programi dhe realizimi i të ardhurave nga fondet speciale sipas përbërjes 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

1.3.1 Kontribute të sigurimeve shoqërore

Kontributi i sigurimeve shoqërore përbën pjesën kryesore prej 86 % të të ardhurave nga fondet speciale, programuar në buxhetin e rishikuar në vlerën prej 104,009 milion lekë dhe realizuar 105,640 milion lekë, pra 102 % dhe 1,631 milion lekë më shumë se programi përfundimtar.

Plani i kontributeve të sigurimeve shoqërore është rritur me akte normative gjatë vitit 2022 në krahasim me ligjin e buxhetit që ishte në vlerën 112,000 milion lekë.

Krahasuar me një vit më parë janë realizuar 11% më shumë të ardhura ose 10,740 milion lekë.

Kontributi i sigurimeve shoqërore mblihdet nga DPT pothuajse plotësisht dhe një pjesë e vogël (kontributet shoqërore të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe kontributet vullnetare) mblihdhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Tabela 6 Të ardhurat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 2022

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	AN nr.19 29.12.2022	Fakti 2022 sipas treguesve të konsoliduar	Fakti 2022 sipas rakordimeve	% realizimit ndaj AN	Diferencat ndaj AN	Diferencat ndaj 2021
1.	Kontribute shoqërore gjithsej	94,900	104,009	105,640	105,656	101.6	+ 1,647	+ 10,756
a	Mbledhur nga DPT	91,630	101,514	x	102,034	100.5	+ 520	+ 10,404
b	Mbledhur nga ISSH	3,270	2,495	x	3,622	145	+ 640	+ 352

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Duhet theksuar se në pasqyrën e treguesve të buxhetit të konsoliduar dhe Raportit të zbatimit të buxhetit faktik 2022 të përgatitur nga MFE realizimi i këtyre kontributeve cilësohet në shifrën e 105,640 milion lekë, ndërsa nga auditimet e KLSH sipas rakordimeve të ndërsjella institucionale rezultojnë 105,656 milionë lekë ose 16 milion lekë më shumë se sa raportimi i MFE.

Nga auditimi në ISSH rezulton se, nga ana e MFE në të ardhurat kontributive të sigurimeve shoqërore janë planifikuar dhe të ardhura të tjera në shumën 746 milion lekë (57 % në DPT dhe 43 % në ISSH), në kundërshtim me përcaktimet e ligjit të buxhetit i ndryshuar me AN nr.19, datë 29.12.2022, në të cilin është përcaktuar se të ardhurat nga kontributet janë 104,009 milion lekë, dhe jo dhe nga të ardhura të tjera.

Po kështu, edhe në realizimin faktik të kontributeve të sigurimeve shoqërore MFE në raportimin e kontributeve shoqërore gjithsej prej 105,656 milion lekë, ka përfshirë të ardhura të tjera jo kontributive në vlerën 1,197 milion lekë ose 1 % të realizimit.

Nga auditimi në DPT rezulton se, gjatë vitit 2022 kanë dhënë efekt në rritjen e të ardhurave nga kontributet dy ndryshimet e bëra në vlerën e pagës minimale në shkallë vendi të cilat kanë ndikuar edhe kufirin e poshtëm edhe kufirin maksimal të deklarimit të kontributeve të sigurimeve: në mars nga 30 në 32 mijë lekë dhe në shtator ku paga minimale është miratuar në nivelin e 34 mijë lekëve. Këto ndryshime kanë dhënë efekt në rritjen e të ardhurave nga kontributet në kategorinë e të vetëpunësuarve dhe kryesisht në sektorin privat.

Ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave nga kontributet për sektorin shtetëror dhe atë buxhetor përgjatë vitit 2022 vlerësohen të jenë edhe politikat në rritjen e pagave sipas vendim-marrjeve të vitit 2022 për sektorë të veçantë të administratës publike, si dhe mbështetja me fonde për përballimin e efekteve të inflacionit për kategori të caktuara sociale.

Realizimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore do të ishte më i lartë, pasi nga ana e DPT kontributi i sigurimeve suplementare është realizuar 95 %: nga 1,896 milion lekë të programuara janë realizuar 1,795 milion lekë, duke krijuar një mosrealizim prej 101 milion lekë.

Nga auditimi në ISSH për analizën e realizimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e lidhur kjo me numrin e kontribuuesve dhe rritjen e kontributit mesatar vjetor, ka rezultuar se, rritja e të ardhurave kontributive ka ardhur kryesisht nga rritja e kontributit mesatar në masën 80 % dhe nga rritja e numrit të kontribuuesve për 20 %.

Gjithashtu, ka rezultuar se, megjithëse DPT ka realizuar dhe tejkaluar të ardhurat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në raportim janë përfshirë kamatëvonesat e gjobat për

listë-pagesat të cila nuk lidhen vetëm me kontributet por edhe me tatimin mbi të ardhurat personale në vlerën gjithsej 429 milion lekë, zbritja e të cilave çon në mosrealizim të këtij treguesi.

Nga auditimi në ISSH, rezulton se kontributet e sigurimeve shoqërore të mbledhura nga DPT janë në shumën 99,965 milion lekë të siguruar nga 686 757 kontribues (13 277 më shumë se në vitin 2021), nga të cilët 24 % e tyre i përket sektorit publik, 56 % janë subjekte private dhe 20 % të vetëpunësuar. Duhet theksuar se rritja më e konsiderueshme e kontribuesve është në subjektet private, e pa konsiderueshme në sektorin publik (+ 2 263), si dhe me rënie të kontribuesve të vetëpunësuar me 480 kontribues.

Kontributet e sigurimeve shoqërore të mbledhura nga ISSH përbëhet nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi 2,365 milion lekë, që iu përket 62 070 kontribuesve (180 më shumë se në vitin 2021), si dhe 573 milion lekë nga sigurimi vullnetar i 6 904 personave (467 më shumë se në 2021), e kuptueshme më shumë se numri i planifikuar për te dy rastet.

Nga auditimi në ISSH, konstatohet se janë raportuar 3,622 milion lekë të ardhura nga kontributet shoqërore (të vetëpunësuarit në bujqësi dhe kontributi vullnetar), nga 2,495 milion lekë të planifikuara, pra sipas tyre janë tejkaluar 11 %, si dhe 352 milion lekë më shumë se në vitin 2021. Është konstatuar se në këtë vlerë realizimi, nga ISSH janë përfshirë dhe 768 milion lekë të ardhura nga penalitetet dhe të ardhura jo tatimore, të cilat përfaqësojnë 21 % të të ardhurave kontributeve të raportuara prej tyre.

Nga auditimi në ISSH konstatohet se detyrimet debitore për kontributin e sigurimeve shoqërore në vitin 2022 janë shtuar me 1,262 milion lekë që iu përket 5,482 subjekteve, pothuajse tërësisht nga sektori privat dhe brenda tyre, në vlerën më të madhe prej 73 % i përket biznesit të vogël.

Gjendja e detyrimeve debitore në DPT për kontributin e sigurimeve shoqërore në fund të vitit 2022, rezulton për 109,110 subjekte në vlerën 17,128 milion lekë, nga të cilët 5 % i përkasin sektorit publik (buxhetorë dhe jo buxhetorë). Duhet theksuar se detyrimi kontributiv është 84 %, ndërsa pjesa e tjetër janë gjoba dhe kamatë-vonesa.

Në ISSH është krijuar detyrim debitor për kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi gjendje në fund të vitit 2022 në vlerën prej 897 milion lekë.

1.3.2 Kontribute të sigurimeve shëndetësore

Sipas të dhënave të pasqyrës së treguesve të buxhetit të konsoliduar të përgatitur nga MFE, konstatohet se të ardhurat nga kontributet shëndetësore dhe të tjera kanë qenë planifikuar 16,030 milion lekë dhe janë realizuar 16,266 milion lekë, ose 101.5 %, duke tejkaluar programin me 236 milion lekë, si dhe 1,725 milion lekë më shumë se në vitin 2021. Duhet theksuar se, shifrat e planifikimit të të ardhurave për kontributeve e sigurimeve shëndetësore kanë ndryshuar në rritje gjatë vitit 2022 me akte normative, krahasuar me ligjin e buxhetit, në të cilin ishin përcaktuar 14,985 milion lekë, pra me një rritje përfundimtar prej 7 %.

Konstatohet se në vitin 2022 nuk ka ndryshime të ritmit të rritjes faktike të kontributeve krahasuar me periudhën 2020 - 2021 prej +11.5%. Sipas Raportit të MFE, kontribuesit aktivë për sigurimet shëndetësore (përfshirë dhe ato shoqërore) sipas sektorëve të ekonomisë janë në nivelin 59 % nga sektorit të shërbimit, prodhimi dhe tregtia me nga 16 %, ndërtime 6 % etj.

Duhet theksuar se janë të njëjtët faktorë që kanë ndikuar në rritjen e kontributit të sigurimeve shoqërore në krahasim me vitin e kaluar 2021 si, ndryshimet e pagës minimale, ndryshimet e pagave në sektorin publik etj.

Tabela 7 Të ardhurat gjithsej nga kontributet e sigurimeve shëndetësore 2022

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	AN nr.19 29.12.2022	Fakti 2022 sipas treguesve të konsoliduar	Fakti 2022 sipas rakordimeve	% realizimit ndaj AN	Diferencat ndaj AN	Diferencat ndaj 2021
1.	Kontribute shëndetësore gjithsej	14,541	16,030	16,266	16,164	101	134	1,623
a	Mbledhur nga DPT	x	15,625	x	16,106	103	481	x
b	Mbledhur nga ISSH	x	305	x	58	19	-247	x
c	Mbledhur nga FSDKSH	x	100	x	0.4	0	-100	x

Burimi: Të dhëna të MFE dhe FSDKSH të përpunuara nga KLSH

Nga auditimi në FSDKSH, rezulton se nga DPT janë mbledhur 16,100 milion lekë, ndërsa 6 milion lekë kontribute shëndetësore i përket kontributeve të naftëtarëve të arkëtuar nga buxheti i shtetit në FSDKSH. Kështu, nga DPT të ardhurat për kontributet shëndetësore janë realizuar 103% ose janë mbledhur 475 milion lekë më shumë nga programi. Duhet theksuar se, në të ardhurat kontributive të sigurimeve shëndetësore të grumbulluara nga DPT, janë përfshirë 73 milion lekë dhe të ardhura nga gjopa dhe penalitete, pra të ardhura jotatimore.

Nga ISSH janë mbledhur 58 milion lekë kontribute shëndetësore prej të vetëpunësuarve në bujqësi nga 305 milion lekë të planifikuara ose 19 %, duke krijuar një mosrealizim prej 247 milion lekë. Fakti që ISSH ka tejkaluar mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe ka mosrealizime të ndjeshme në kontributin e sigurimeve shëndetësore, tregon për mangësi planifikimi nga ana e MFE në përgjegjësinë e mbledhjes së kontributeve.

Realizimi i kontributeve gjithsej nga MFE sipas Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, nga MFE është raportuar në shumën 16,266 milionë lekë, ndërsa nga auditimi në FSDKSH rezultojnë të jenë në total 16,164 milion lekë, me një diferencë midis raportimeve (MFE/FSDKSH) për 102 milionë lekë më shumë, referuar të ardhurave të tjera të mbledhura nga kontributet dhe të tjera.

1.3.3 Fondi i kompensimit të pronarëve

Fondi i kompensimit të pronarëve është realizuar 905 milion lekë nga 1,000 milion lekë, me një realizim prej 90 %, duke krijuar një mosrealizim prej 95 milion lekë, si dhe janë realizuar 526 milion lekë më pak se në vitin 2021.

1.4 Të ardhurat jotatimore

Të ardhurat jotatimore përfaqësojnë të ardhurat e tjera që merren nga burime të ndryshme si aktiviteti ekonomik i sektorit buxhetor, transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë etj. Të ardhurat jotatimore janë realizuar 89 %: nga 24,650 milion lekë të planifikuara të ardhura sipas AN nr.19, janë realizuar 21,938 milion lekë, me një mosrealizim prej 2,712 milion lekë. Duhet theksuar se programimi buxhetor për të ardhurat jotatimore ka pësuar ndryshime në rritje gjatë vitit 2022 dhe në fund të vitit kanë rezultuar më të ulta se vlera në ligjin fillestar, si dhe më të ulta krahasuar me faktin e vitit të kaluar 2021. Sipas Pasqyrës së treguesve të buxhetit të konsoliduar, në të ardhurat jotatimore klasifikohen: transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë, të ardhura nga institucionet buxhetore, të ardhurat nga dividendi, tarifatat e shërbimeve, si dhe zëri të tjera.

Nga një analizë e detajuar e zërave përbërës të këtyre të ardhurave, sipas pasqyrës së treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar rezulton se, për dy zëra nuk janë realizuar të ardhura në vlerën 3,000 milion lekë (transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë dhe kthim kapitali nga AIC); të ardhurat nga dividendi janë realizuar 21 %, nuk janë realizuar tarifatat e shërbimeve dhe rezultojnë me tejkalim dy zëra të tjerë (të ardhurat nga institucionet buxhetore dhe të tjera). Të ardhurat jotatimore të realizuar në vlerën prej 21,938 milion lekë, të cilat përbëjnë 3.8 % të të ardhurave të përgjithshme publike në vitin 2022, kontribut kanë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në vlerën 3,331 milion lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë realizuar 351 milionë lekë më pak.

Në Raportin e zbatimit të buxhetit të paraqitur nga MFE ka pasaktësi në krahasim me pasqyrën e treguesve të buxhetit të konsoliduar në lidhje me: mos realizimin, pasi është cilësuar 2.5 miliard lekë (faqe 16) dhe në fakt rezulton 2.7 miliard lekë; transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë cilësohet 1.4 miliardë, në fakt është 0 lekë; të ardhurat nga institucionet buxhetore cilësohen 11.9 miliardë dhe në fakt janë 12.3 miliardë etj.

Duhet theksuar se ndikim të ndjeshëm në këtë mosrealizim kanë dhënë: kthimi i kapitalit nga Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC) e cila ka qenë planifikuar 2,000 milion lekë dhe nuk është realizuar; mungesa e transferimit të fitimit të Bankës së Shqipërisë në vlerën prej 1,000 milion lekë, për shkak se ka rezultuar me humbje; mosrealizimi të ardhurave në tarifën e shërbimeve për 629 milion lekë, si dhe mungesa e të ardhurave nga dividendi në vlerën prej 236 milion lekë.

Nga auditimi në DPT, rezulton se ky nivel realizimi do të ishte akoma më i madh, pasi në realizimin e të ardhurave tatimore sipas rakordimit me degën e thesarit mbi arkëtimet në sistemin e-tax në shumën totale janë përfshirë edhe arkëtimet për tarifatat jo tatimore si: tarifë shërbimi për përdorimin e aparateve televizive, tarifë shërbimi për kalimin e kufirit me avion etj., në shumën gjithsej prej 3,295 milion lekë ose rreth 1% e të ardhurave tatimore gjithsej, të cilat nuk kanë një plan për t'u mbledhur nga ana e tyre, gjë e cila do të sillte për pasojë realizimin dhe tejkalimin e të ardhurave jotatimore për vitin 2022.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, janë katër shoqëri publike të cilat deri më 31.12.2022 kanë dividend të prapambetur të pa likuiduar në shumën 4,054 milion lekë: “Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor” SHPK Tiranë 9 milion lekë; 3,979 milion lekë i përket shoqërive “KESH” SHA dhe “Albpetrol” SHA, si dhe “HEC Ulëz- Shkopet” për 66 milion lekë të bilancit të vitit 2012.

1.5 Performanca fiskale e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), për vitin 2022, ka raportuar se të ardhurat tatimore janë programuar 193,000 milion lekë dhe janë realizuar 189,600 milion lekë, me një mosrealizim prej 3,400 milion lekë ose 1.8% më pak. Nga auditimi konstatohet se të ardhurat tatimore bruto janë realizuar në shumën 183,900 milion lekë dhe diferenca me raportimin e DPT qëndron në faktin se janë përfshirë të ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në të ardhura tatimore. Efekti i këtyre të ardhurave të përkohshme me normë të reduktuar tatimore nga rivlerësimi raportohet në shumën 5.6 miliard lekë ose rreth 2% e të ardhurave. Në krahasim me planin përfundimtar prej 193,000 milion lekë, efekti i mos realizimit është në shumën 9,000 milion lekë, megjithëse në raport me një vit më parë të ardhurat janë realizuar 15,200 milion lekë më tepër. Në terma neto, të ardhurat janë realizuar në shumën 161,500 milion lekë, përkundrajt planit prej 174,5 milion lekë, me një mos realizim në shumën 13,000 milion lekë e ndikuar nga tejkalimi i

rimbursimeve të kryera për tatimin mbi vlerën e shtuar më tepër se plani për rreth 4,000 milion lekë. Të analizuara sipas llojit, problematika konstatohen në drejtim të mos realizimit me ndikim më të madh nga taksat nacionale dhe taksa e qarkullimit rrugor.

Tabela 8 Plani dhe realizimi i të ardhurave tatimore sipas llojit 2022

Te ardhurat sipas llojit		Fakti 2021	Plani final 2022	Fakti 2022	Plan- fakt	% e realizimit	Fakt 2022- fakt 2021
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)	168,708,730	193,000,000	183,965,016	-9,034,984	-4.7%	15,256,286
1	TVSH (bruto)	54,461,470	56,000,000	57,068,399	1,068,399	1.9%	2,606,929
	- TVSH (neto)	30,359,542	37,500,000	34,587,338	-2,912,662	-7.8%	4,227,796
	- Rimbursimi i kryer	24,102,122	18,500,000	22,481,061	3,981,061	21.5%	-1,621,061
2	Tatim mbi Fitimin	35,664,554	46,000,000	47,796,671	1,796,671	3.9%	12,132,117
3	Ardhura Personale	43,801,087	47,000,000	45,084,609	-1,915,391	-4.1%	1,283,522
4	Taksat Nacionale	13,429,961	18,900,000	13,666,033	-5,233,967	-27.7%	236,072
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	19,706,202	23,400,000	18,249,964	-5,150,036	-22.0%	-1,456,238
6	Lojrat e Fatit	1,534,803	1,700,000	1,972,682	272,682	16.0%	437,879
7	Dënimet Administrative	110,653	0	126,659	126,659		16,006
	Te Ardhurat Tatimore (neto)	144,606,607	174,500,000	161,483,955	-13,016,045	-7.5%	16,877,348

Në mijë lekë

Burimi: Të dhëna të DPT të përpunuara nga KLSH

Për vitin 2022, të ardhurat tatimore nga:

- *Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (bruto)* janë tejkuluar me 1,100 milion lekë ose 1.9% më shumë. Nga auditimi konstatohet se në terma neto, këto të ardhura rezultojnë me mos realizim në shumën 2,900 milion lekë, si efekt i rimbursimit të kryer përtej planit të miratuar prej 4,000 milion lekë me tejkulim prej 1,100 milion lekë në të ardhurat bruto.
- *Tatimi mbi Fitimin*, sipas raportimit të DPT janë tejkuluar për 1.8 milion lekë ose 3.9% më shumë. Nga auditimi konstatohet se sipas llogarive analitike akumulimi i gjendjes së të ardhurave nga tatimi mbi fitimin është realizuar në pjesën më të madhe nga parapagimet e kësteve të tatimit mbi fitimin në formën e depozitimeve të përkohshme për deklaratën e tatimit mbi fitimin.
- *Tatimi mbi të Ardhurat Personale* është tejkuluar me 3.7 miliard lekë ose 7.9% më shumë sipas raportimit në raportin e performancës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- *Taksa kombëtare dhe të tjera: Taksat Kombëtare dhe Tarifa* kanë një mosrealizim prej 5,200 milion lekë ose 27.7% më pak.
- *Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit*, nuk janë realizuar për vlerën prej 5,200 milion lekë ose 22.0% më pak.
- *Të ardhurat nga lojërat e fatit* raportohen se janë tejkuluar me 273 milion përkundrejt planit përfundimtar.

Mos realizimi më i madh në grupin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat kombëtare të raportuara në tabelën e treguesve fiskalë si një komponent i taksave nacionale dhe të tjera është shkaktuar nga mos realizimi i taksës së qarkullimit rrugor dhe taksës së karbonit, të cilat janë taksa të indeksuara me sasinë e konsumuar të produkteve dhe nënprodukteve të naftës, për të cilën kemi rekomanduar që DPT nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore të drejtojnë burimet e kontrollit në sektorët që janë objekt i taksave kombëtare.

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave tatimore, konstatohet se raportohen si të ardhura të realizuara për efekt të planit, gjoha të sistemit tatimor në shumën 707 milion lekë, me përjashtim të gjobave të tjera të cilat janë raportuar në dënimet administrative në shumën 123 milion lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Llogaria 70 “Tatime dhe taksat”. Përveç shumëve të raportuara si më sipër, konstatohet se raportohen si e ardhur edhe gjobat

e vendosura nga kontrollet e realizuara në tatimpagues, pasi elementët përbërës të tatimit të munguar si pasojë e rivlerësimeve tatimore përfshijnë detyrimin për tatimin dhe gjobën përkatëse, për të cilat kemi rekomanduar të kryhet ripublikimi i treguesve të të ardhurave në raportin e performancës, duke hequr komponentin e gjobave nga realizimi dhe në të njëjtën kohë të bëhet në raportim ndarja e të ardhurave nga detyrimi kryesor dhe gjoba shoqërues e detyrimet për rivlerësimet tatimore të deklaratave në përfundim të kontrollit tatimor.

Për vitin 2022, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 115,700 milion lekë dhe janë realizuar 118,500 milion lekë, me një rritje prej 2,800 milion lekë ose 2.4% më shumë. Në raportimin e të ardhurave nga kontributet konstatohet se janë përfshirë edhe depozitimet e përkohshme dhe kamatëvonesat e gjobat për listë-pagesat të cila nuk lidhen vetëm me kontributet por edhe me tatimin mbi të ardhurat personale.

Kontributet shoqërore gjithsej përbëhen në masën 85% nga ato shoqërore, 14% nga ato shëndetësore dhe 1% kontributet e sigurimit suplementar.

Kontributet shoqërore gjithsej vijnë 39 % nga sektori shtetëror (buxhetor dhe shtetëror) dhe 61 % nga sektori privat (subjekte juridike dhe persona fizikë).

Gjendja e detyrimeve tatimore gjithsej të papaguara në fillim të vitit 2022 rezulton në vlerën rreth 134,934 milion lekë, që i përket një numri prej 192,701 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 146,767 milion lekë që i përket një numri prej rreth 182 379 subjektsh debitorë. Pra rezulton një rritje prej rreth 11,800 milion lekë të detyrimeve të papaguara dhe me një ulje prej 10 322 debitorëve në fund të vitit.

Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2022 janë 37,000 milion lekë ose afërsisht 4,000 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2021, ku detyrimet e shtuara ishin 33,000 milion lekë.

Arkëtimet paraqiten në vlerën 24 miliard lekë, afërsisht 5 miliard lekë më shumë krahasuar më vitin paraardhës. Rritja më e madhe e detyrimeve të shtuara gjatë vitit 2022 vjen në pjesën më të madhe nga sigurimet shoqërore me rreth 14,344 milion lekë, tatimi mbi vlerën e shtuar me 10,208 milion lekë dhe tatim fitimi 10,253 milion lekë. Gjithashtu, konstatohet se megjithëse arkëtimet respektive për uljen e borxhit janë për sigurimet 11.420 milion lekë, për TVSH 4,602 milion lekë dhe tatim fitimin 5,111 milion lekë, duke marrë parasysh edhe sistemimet dhe transferimet të vitit, stoku i borxhit është rritur në krahasim me vitin 2021 respektivisht për sigurime 2,702 milion lekë, për tatimin mbi vlerën e shtuar 4,396 milion lekë dhe tatim fitimi 3,898 milion lekë.

Subjekte me status Aktiv rezultojnë në numër 64 543 ose 37 % e total numrit të subjekteve debitore, me vlerë detyrimi tatimor të papaguar 40,700 milion lekë ose 28 % e total detyrimit tatimor të papaguar. Subjekte me status Pasiv rezultojnë në numër 110 948 subjekte ose 63 % mbi numrin gjithsej të subjekteve debitore, me vlerë detyrimi tatimor të papaguar 105,900 milion lekë ose 72 % e total detyrimit tatimor të papaguar. Krahasuar me vitin paraardhës rezulton një rritje e subjekteve Pasive në numër dhe në vlerë, përkatësisht 6% dhe 7% të masës së detyrimit total të papaguar. Për sa i përket subjekteve në proces gjyqësor rezultojnë 1,391 subjekte me detyrim total 13,000 milion lekë. Krahasuar me vitin 2021 janë rreth 200 subjekte më pak me një vlerë të detyrimeve të papaguara të ankimuar në gjykatë prej rreth 1,000 milion lekë më pak.

Nga lista e debitorëve, rezulton se janë 18 subjekte me vlerë detyrimi të papaguar në fund të vitit 2022 afërsisht 30 % e total detyrimit të papaguar, nga të cilët 13 subjekte janë pasive me vlerë detyrimi të papaguar 35,000 milion lekë dhe 5 subjekte janë aktive me detyrim të papaguar në vlerën 8,000 milion lekë.

Referuar moshës së detyrimeve të papaguara në vitin 2022 rezulton se peshën më të madhe të stokut të detyrimit tatimor të papaguar e zënë detyrimet me moshë borxhi nga 2-5 vite prej 28% të total detyrimit të papaguar dhe ato mbi 5 vite zënë rreth 49 % të total detyrimit tatimor të papaguar. Krahasuar me vitin paraardhës rezulton se borxhi me moshë 1-2 vjet është rritur me afërsisht 5,000 milion leke ose 4 % më shumë mbi totalin e detyrimit dhe borxhit me moshë mbi 5 vite me 18,000 milion lekë ose 10 % më shumë mbi totalin e detyrimit.

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara sipas llojit të tatimit, rezulton se është TVSH me peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat, 36% me një vlerë prej rreth 52,085 milion lekë, ndjekur nga Tatim Fitimi me 29% ose në vlerën prej rreth 42,651 milion lekë, e më pas zëri “Të tjera” me 16% ose në vlerën prej rreth 23,691 milion lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 14% ose në vlerën prej rreth 20,445 milion lekë dhe zëri Tatim në Burim me rreth 4%, ose në vlerën prej rreth 5,199 milion lekë. Sipas të dhënave të paraqitura nga DPT sipas llojit të tatimit dhe moshës së borxhit, konstatohet një rritje e borxhit me moshë të re (3-12 muaj) në rreth 18,333 milion lekë, me rritjen më të madhe në TVSH prej 5,780 milion lekë ose 31.5%, tatim fitimi 6,253 milion lekë ose 34.1% dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 4,185 milion lekë ose 22.8%.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve detyrim tatimor të papaguar jashtë sistemit në vlerën 2,354 milion lekë, i cili paraqitet me ulje krahasuar me vitin paraardhës, ku pjesën më të madhe e zë akciza para vitit 2012, kur kjo lloj e ardhure deklarohet dhe paguhej në Administratën Tatimore, ndërkohë që tani arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara rezultoi se gjatë vitit 2022 nuk ka kryer asnjë inspektim në asnjë drejtori rajonale tatimore, në kundërshtim me Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Kreu 2.1.1”Inspektimi”, si dhe nuk janë kontrolluar apo monitoruar rajonet nëse kanë zbatuar plotësisht planet e tyre operacionale, nëse kanë mbajtur regjistra të saktë dhe të azhornuar të debitorëve, nëse kanë ndjekur procedurat e përcaktuara për masat shtrënguese.

Nga auditimi konstatohet se realizimi i kontrolleve të planifikuara për vitin 2022 është në masën 57.5%, me një mosrealizim në masën 42.5 %. Nivelin më të ulët të realizimit të planit të kontrolleve e kanë DRT Tiranë me 29 %, DRT Kukës me 31 %, DRT Sarandë dhe DRT Fier me nga 58% etj. Gjithashtu, konstatohet se për vitin 2022 gjendja e kontrolleve të pezulluara, të pafilluara ose në proces është gjithsej 1140 kontrolle, rritur në krahasim me vitin 2021 për 671 kontrolle, me një rritje të lartë të numrit të kontrolleve të pafilluara.

Nga auditimi për menaxhimin dhe administrimin e marrëdhënieve të punës konstatohen një numër i lartë vakancash ku për vitin 2022 DPT ka funksionuar me 82% të kapaciteteve të saj organizative.

Si konkluzion, nga auditimi mbi performancën fiskale për mbledhjen e të ardhurave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vitin buxhetor 2022 janë konstatuar problematika në drejtim të planifikimit të të ardhurave, realizimit të tyre dhe nga efektet e aktivitetit operacional në drejtim të kontrolleve tatimore me pasojë rritjen e borxhit tatimor. Në këtë drejtim, plani i të ardhurave tatimore nga ligji fillestar nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2021”, është rritur në mënyrë të ndjeshme përgjatë vitit me akte normative me efekt rreth 35,000 milion lekë. Ndryshimet e planit të të ardhurave tatimore, janë dërguar me vonesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe nga kjo drejtori janë reflektuar me vonesë


efektet e këtyre ndryshimeve në planin e detajuar për Drejtoritë Rajonale Tatimore. Megjithëse plani i të ardhurave është ndryshuar me Aktin Normativ nr. 19 datë 29.12.2022, vetëm 2 ditë përpara mbylljes së vitit buxhetor dhe pa asnjë mundësi reale për kryerjen e veprime operacionale për pasqyrimin e tij, konstatohet se të ardhurat tatimore neto paraqiten me mos realizim në rreth 13 miliard lekë. Ky mos realizim ka ardhur kryesisht si pasojë e tejkalimit të kufirit ligjor për kryerjen e rimbursimit të TVSH, si dhe mos realizimi i taksave dhe tarifave kombëtare të lidhura me produktet e naftës dhe gazoilin.

Në opinionin e KLSH, potenciali fiskal për realizimin e të ardhurave është më i madh se realizimi vjetor 2022, por mungesa e fillimit dhe përfundimit të kontrolleve tatimore, së bashku me mos marrjen e masave për inspektimet në lidhjen me borxhin tatimor kanë sjellë si pasojë rritjen e këtij të fundit me rreth 11,800 milion lekë në krahasim me një vit më parë. Për këto arsye kemi rekomanduar marrjen e masave për përmirësimin e aktivitetit operacional të DPT në drejtim të kryerjes së inspektimeve për borxhin tatimor në rritje dhe realizimin e kontrolleve tatimore drejt tatimpaguesve me qëllim përmbushjen e detyrimeve tatimore të tatimpaguesve dhe rritjen e të ardhurave tatimore për Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi në **Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD)**, rezultojnë se plani i të ardhurave doganore në zbatim të ligjit nr.115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, nga ana e MFE është vijuar me komunikim shkresor deri më datë 25.02.2022 në të cilën është përcaktuar vlera 202,988 milion lekë. Më pas, ky plan është rishikuar me Akte Normative nr.3 dhe nr.12, duke u rritur në vlerën 221,000 lekë, me një rritje në vlerën 18,014 milion lekë, ose në masën 8.8% më shumë, dhe krahasuar me një vit më parë, ky plan rezultojnë 39,949 milion lekë më shumë, pra me një rritje në masën 22%.

Plani i rishikuar përfundimtar i vjeljes së të ardhurave për administratën doganore, nga MFE është caktuar në vlerën prej 223,500 milion lekë.

Grafiku 7 Plani dhe realizimi i të ardhurave nga DPD për vitin 2022



Burimi: Të dhëna të DPD të përpunuara nga KLSH

Realizimi i të ardhurave doganore për vitin 2022 kundrejt planit përfundimtar të rishikuar (223,500 milion lekë), në terma bruto rezultojnë në vlerën 223,324 milion lekë dhe në terma neto 223,090 milion lekë, të cilat respektivisht rezultojnë 99.9% dhe 99.8%. Pra, nga administrata doganore nuk janë realizuar të ardhurat doganore sipas ligjit të buxhetit të ndryshuar për 176 milion lekë më pak në terma bruto dhe 410 milion lekë më pak se plani në terma neto. Krahasuar me vitin 2021 rezultojnë 30,249 milion lekë të ardhura doganore më shumë.

Tabela 9 Plani dhe realizimi i të ardhurave doganore sipas llojit 2022

Në milion lekë

Të ardhurat doganore sipas llojit	Realizimi 2021	Plani dhe realizimi 2022			2022		Realizimi 2022 / 2021	
		Plani fillestar 2022	Plani i përfundimtar 2022	Realizimi 2022	Diferenca me planin e rishikuar	% e realizimit mbi planin përfundimtar	Diferenca me 2021	Ndryshimi në %
TVSH	131,301	136,000	153,001	156,898	3,897	103%	25,597	19%
Akcizë	51,962	56,478	55,000	53,781	-1,219	98%	1,819	4%
Rentë minerare	2,445	3,000	4,500	4,198	-302	93%	1,753	72%
Taksë doganore	7,458	7,508	8,499	8,447	-52	99%	989	13%
Total	193,166	202,988	221,000	223,323	2,323	101%	30,157	16%

Burimi: Të dhëna të DPD të përpunuara nga KLSH


Të ardhurat nga TVSH janë realizuar në shumën 156,898 milion lekë, nga 153,001 milion lekë të planifikuara, pra 103 %, me një tejkalim në shumën 3,897 milion lekë sipas DPD, dhe 1,398 milion lekë më shumë sipas MFE (realizimi 101%); ose 25,597 milion lekë më shumë se viti paraardhës (ritje në masën 19%).

Realizimi i të ardhurave bruto nga akciza paraqitet në shumën 53,781 milion lekë, dhe të ardhurat neto nga akciza rezultojnë me një realizim 53,547 milion lekë. Krahasuar me 55,000 milion lekë të planifikuara, të ardhurat neto nga akciza janë me mos realizim në vlerën 1,453 milion lekë, megjithëse janë 1,910 milion lekë më shumë se viti paraardhës.

Të ardhura nga renta janë realizuar në vlerën 4,198 milion lekë, nga 4,500 milion lekë të planifikuara, me një tejkalim prej 302 milion lekë, si dhe 1,753 milion lekë më shumë se në vitin 2021.

Realizimi i të ardhurave nga taksë doganore është 8,447 milion lekë, nga 8,499 milion lekë të planifikuara, me mos realizim në vlerën 52 milion lekë, si dhe 989 milion lekë më shumë se viti paraardhës (13% më tepër).

Grafiku 8 Plani dhe realizimi i të ardhurave doganore sipas zërave 2022



Burimi: Të dhëna të DPD të përpunuara nga KLSH

Nga auditimi në DPD u konstatua se nuk dokumentohet roli i saj gjatë procesit të planifikimit të të ardhurave doganore, nëpërmjet propozimeve apo analizave të kryera nga strukturat përgjegjëse të institucionit, duke konsideruar faktorë të tillë si efektet e paketës fiskale, shkalla e reduktuar e TVSH-së 10 % e furnizimit me inpute bujqësore apo efekti i ndryshimit të ligjit për akcizën etj. Kjo situatë paraqitet edhe më problematike në kushtet kur DPD nuk disponon një metodologji konkrete të miratuar për procedurën që do të ndiqet për planifikimin e të ardhurave doganore, ku ndarja e planit bëhet në bazë të përqindjes që zë secila degë doganore, për secilën taksë, në periudhën paraardhëse progresive, e cila përgjatë vitit mund të korrigjohet nga faktorë të jashtëm, referuar informacioneve që gjenerohen nga burime të tjera.

Lidhur me metodikën e përdorur për planifikimin e të ardhurave doganore dhe aplikimin e modelit ekonometrik të 60 mallrave kryesore, nuk janë vënë në dispozicion analiza/ informacione/ dokumentacione që argumentojnë veprimtarinë e DPD gjatë këtij procesi, duke u kufizuar vetëm me një informacion të përgjithshëm në bazë të cilit KLSH e ka pasur të pamundur të vlerësojë procesin e planifikimit nga DPD, lidhur me planin e miratuar me ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2022 dhe ndryshimet e mëvonshme.

Nga analiza e veprimtarisë së DPD lidhur me performancën e realizimit të të ardhurave doganore konstatohet se plani i rishikuar nuk është i njëjtë me planin e MFE, për shkak të mos reflektimit të ndryshimeve të AN nr.17, datë 1.12.2022, i cili ka rritur nivelin e të ardhurave të planifikuara për TVSH nga 153,001 milion lekë që paraqitet sipas DPD, në 155,500 milion lekë. Për rrjedhojë, edhe plani i rishikuar në total në zërat për të ardhurat doganore rezultojnë me diferencë, të cilat nuk janë reflektuar në analizat e institucionit dhe rezultojnë të mos jenë marrë në konsideratë për monitorimin më pas realizimin e të ardhurave për këtë zë sipas degëve doganore.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në fund të vitit 2022 rezultojnë me një nivel *borxhi doganor* në shumën 46,690,911 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4,858 raste. Borxhi doganor i trashëguar përgjatë viteve rezultojnë gjithmonë në rritje, ku për vitin 2022 rritja konstatohet në vlerën 979,324 mijë lekë, ose me + 2,14 %. Peshën kryesore të stokut të borxhit doganor në 31 dhjetor 2022, e mban Dega Doganore Tiranë në masën 39%, Fier me 31%, Durrës me 16 %, Lezhë me 4 % etj.

Nga totali i borxhit për vitin 2022 prej 46,690 milion lekë, rezultojnë se 2,513 raste (që përfaqësojnë 27,370 milion lekë) janë me urdhër ekzekutimi; 482 raste janë në proces gjyqësor në vlerën 18,083 milion lekë dhe 1,863 raste për 1,236 milion lekë janë detyrime të papaguara në ndjekje. Gjatë vitit 2022, konstatohen 3 711 raste shpesh të debitorëve në vlerën 1,469,071 mijë lekë, si dhe pakësim të debitorëve në 3 543 raste për vlerën 489,746 mijë lekë, pra me prirje në rritje të numrit të debitorëve krahasuar me vitin 2021, si dhe në vlerë në shumën 979,324 mijë lekë. Kryesisht rritja më e madhe të debitorëve rezultojnë në Degën Doganore Tiranë me 23%, Durrës 12% dhe Fier në 43%.

Bazuar në sa më sipër, arrihet në konkluzionin se administrata doganore ka dështuar në rikuperimin e stokut të borxhit të krijuar gjatë viteve. Për këtë qëllim, për përmirësimin e situatës, KLSH ka rekomanduar plotësimin e strukturës organike dhe ndjekjen e procedurave ligjore me qëllim rikuperimin e borxhit doganor.

Përgjatë vitit ushtrimor 2022 performanca institucionale e DPD është ndikuar nga mos zbatimi në afat i efekteve të VKM-së 355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, për personelin e administratës doganore” për ristrukturimin e institucionit, duke rezultuar në një numër të konsiderueshëm të vakancave dhe transferimeve në administratën doganore. Pavarësisht se reduktimi në numër i punonjës të institucionit sipas strukturës së re organizative miratuar me këtë VKM nuk ka patur efekte financiare, kjo situatë ka kontribuar për thellimin e mangësive në garantimin e performancës optimale në punë. Referuar objektivave institucional të cilat raportohen të realizuar, pavarësisht vakancave, nga ana e DPD nuk është kryer vlerësimi për impaktin e vakancave dhe transferimeve të vazhdueshme në ecurinë e veprimtarisë së institucionit, nëse ato kanë cenuar efektivitetin dhe eficiencën, për sa kohë detyrat janë realizuar nga një personel më i pakët nga sa parashikuar, apo me qëllim rishikimin e strukturës nëse ajo rezultojnë e planifikuara në nivele më të larta nga sa janë nevojat reale të institucionit për sa kohë këto a nuk kanë ndikuar në rezultatet e veprimtarisë.

1.6 Të ardhurat nga pushteti vendor

Të ardhurat nga pushteti vendor, sipas pasqyrës së treguesve të buxhetit të konsoliduar janë realizuar 27,638 milion lekë nga 27,632 milion lekë të programuara me buxhetin e rishikuar, pra në nivelin 100%, me një tejkalim prej 6 milion lekë.

Duhet cilësuar se, ndryshe nga treguesit e tjerë fiskal që kane pasur ndryshime në planifikim gjatë vitit, të ardhurat nga pushteti vendor nuk kanë ndryshuar me akte normative nga përcaktimet në ligjin e buxhetit. Ato përbëjnë 4.8 % të të ardhurave të përgjithshme publike, 1.3 % të PBB, si dhe janë mbledhur 972 milion lekë më shumë se në vitin 2021 ose + 4 %.

Duhet theksuar, se treguesi i të ardhurave nga burimet e veta vendore në raport me të ardhurat tatimore në nivelin prej 5.1 %, ka shënuar rënie me rreth 0.5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, gjë e cila përbën një element thelbësor për një qeverisje të pavarur të bashkive. Por, me përjashtim të vitit 2020, që është ritmi vjetor më i ulët në rritjen e të ardhurave prej 4% në periudhën 2016 - 2022, luhatjet e këtij treguesi tregojnë që, krahas faktorëve të tjerë, ka mungesë qëndrueshmërie në financat e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Referuar zërave përbërës të të ardhurave nga pushteti vendor, konstatohet se nuk janë realizuar taksa mbi pasurinë dhe taksa lokale përkatësisht me - 49 milion lekë dhe - 17 milion lekë, por janë realizuar 72 milion lekë të ardhura të paplanifikuara nga biznesi i vogël. *Kjo tregon se njësitë e vetëqeverisjes vendore vijnë të vuajnë paaftësinë e grumbullimit të taksave lokale dhe të atyre mbi pasurinë, me pasoja negative në aftësinë paguese për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve për komunitetin, si dhe riskun e krijimit të detyrimeve të prapambetura.*

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, referuar bazës së të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore në total të ardhurat e realizuara nga njësitë e qeverisjes vendore janë 30,969 milion lekë, nga të cilat të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore janë 27,638 milion lekë dhe të ardhurat jo tatimore janë 3,331 milion lekë. Të ardhurat jo tatimore, janë të ardhura të cilat përfitohen dhe realizohen nga pushteti vendor, por për efekt të raportimit të Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë raportuar në zërin “Të ardhura jo tatimore”.

Nga 36 auditimet e kryera në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në 29 prej tyre është përfshirë aktiviteti i vitit 2022 dhe janë auditime të kombinuara (përputhshmërie dhe financiar). Këto auditime, kanë rezultuar me 26 opinione financiare³: 8 të pakualifikuar⁴ me rezervë (31%), 17 të kualifikuar⁵ (65%) dhe në një rast refuzim opinionit⁶-4% (Tirana Parking, Bashkia Tiranë), ndërsa opinione të përputhshmërisë të kualifikuar janë 28 dhe 1 opinion negativ-Bashkia Patos (97 % me 3 %).

Krahasuar me vitin 2021 ka një ndryshim pozitiv në strukturën e opinioneve, duke u ulur përqindja opinioneve negative dhe/ose rastet e refuzimit të opinionit.

Sipas të dhënave në 26 bashkitë që është mbuluar e gjithë periudha e vitit ushtrimor buxhetor 2022, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave është miratuar me vendime të Këshillave

³ Kryerja e auditimit në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore është finalizuar para dates 31 mars, pra para depozitimit të pasqyrave financiare.

⁴ Një *opinion i pakualifikuar* jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar.

Audituesi tërheq vëmendjen e përdoruesit për një ose disa çështje të paraqitura ose të evidentuara në pasqyrat financiare, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare.

⁵ Një *opinion i kualifikuar/modifikuar* shprehet kur audituesi ka marrë evidencë të mjaftueshme të auditimit dhe konstaton se ka gabime materiale të pasqyrat financiare ose nëse audituesi nuk mund të marrë evidencë të përshtatshme për aspektet e auditimit.

⁶ Një *refuzim i opinionit* jepet kur audituesi nuk është në gjendje të marrë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit mbi të cilat të bazojë opinionin dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet themelore të kësaj pamundësie janë materiale edhe të përhapura.

Bashkiak, konstatohet se nga 5,016,925 mijë lekë të ardhura të planifikuara gjithsej, niveli i realizimit është në masën 4,077,085 mijë lekë ose 81%. Pra deviacioni në nivelin e të ardhurave të realizuara, krahasuar me planifikimin është në vlerën 939,840 mijë lekë, tregues që reflekton problematikë në lidhje me administrimin e taksave dhe tarifave vendore si e ardhur e munguar në buxhetet e këtyre bashkive dhe pengesë në realizimin e projekteve të planifikuara në shërbim të komunitetit.

Për këto 26 bashki, nivelin më të ulët të realizimit e kanë bashkitë: Peqin 35 % , Peqin 35%, Mallakastër 47%, Delvinë 55%, Rrogozhinë 58 % , Gramsh 63 % etj. Mos realizimin e të ardhurave në vlerën më të madhe e ka bashkia Mallakastër me 189,678 mijë lekë, e ndjekur nga bashkia Berat me 173,658 mijë lekë, bashkia Shijak me 126,104 mijë lekë etj.

Nga auditimet e kryera në 26 njësi shpenzuese të vetëqeverisjes vendore vetëm për buxhetin e vitit 2022, kanë rezultuar shkelje financiare me impakt negativ në të ardhurat e buxhetit vendor në vlerën gjithsej prej 381,132 mijë lekë.

Nga këto auditime, 1,746 mijë lekë kanë rezultuar të ardhura të munguara nga shkelje të legjislacionit tatimor, nga e cila 68 % e evidentuar në bashkinë Gramsh, si dhe në bashkinë Përmet e Berat përkatësisht 359 mijë lekë 203 mijë lekë.

Gjithashtu, kanë rezultuar efekte negative në të ardhurat për vlerën 379,392 mijë lekë: nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qira dhe koncesione në vlerën prej 146,235 mijë lekë, nga shkeljet në zbatim të legjislacionit për taksat e tarifave vendore 78,255 mijë lekë, nga shkeljet në zbatimin e legjislacionit tatimor 76,458 mijë lekë, 43,182 mijë lekë të tjera dhe 35,262 mijë lekë penalitete të IMTV.

Me efekte negative në të ardhurat në vlerën më të lartë kanë rezultuar bashkitë: Berat me 99,346 mijë lekë, Sarandë me 48,960 mijë lekë, Përrenjas me 39,569 mijë lekë etj.

Nga 29 njësi shpenzuese të vetëqeverisjes vendore të audituara që kanë pasur aktivitet të vitit 2022, kanë rezultuar me të ardhura të munguara dhe/ose me efekte negative në të ardhurat 25 subjekte ose 86 % e tyre. Të ardhurat e munguara në vlerën e mësipërme janë evidentuar në pjesën më të madhe në bashkitë: Berat me 99,346 mijë lekë, Sarandë me 48,960 mijë lekë, Përrenjas me 39,569 mijë lekë, Rrogozhinë me 23,423 mijë lekë etj.

Sipas pasqyrave financiare dhe evidencave të tjera lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet, për 26 bashki, detyrimet progresive të pa likuiduara për taksat dhe tarifave vendore nga debitorët privat dhe familjar në datën 31.12.2022 kanë rezultuar gjithsej në vlerën 6,188,273 mijë lekë. Krahasuar me vitin buxhetor 2021, në fund të të cilit vlere progresive e debitorëve për këto njësi ka qenë 4,925,660 mijë lekë, konstatohet se vlere e debitorëve është rritur në vlerën 1,262,613 mijë lekë, ose në masën 24%, e cila është një tregues për një punë të pa mjaftueshme nga struktura e taksave dhe tarifave vendore dhe kryetarët e bashkive.

Por, nga auditimet e kryera është konstatuar se njësitë vendore administrojnë dhe raportojnë shifra jo të njëjta lidhur me vlerën e debitorëve progresiv për taksat dhe tarifave vendore në datën 31.12.2021. Konkretisht, nga auditimet e kryera në vitin 2022, vlere progresive e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për 26 bashki, në datën 31.12.2021, është 4,925,660 mijë lekë (vlerë me të cilën është bërë dhe krahasimi i mësipërm), ndërsa nga auditimet e kryera gjatë vitit 2023, kjo vlerë është raportuar nga njësitë vendore 5,376,823 mijë lekë, pra 439,299 mijë lekë, ose 9% më e lartë se vlere e raportuar në auditimet e vitit 2022. Mos rakordimi i shifrave që administrohen nga njësitë vendore për të njëjtën periudhë, tregon për mungesën e saktësisë që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me të dhënat për debitorët e taksave dhe tarifave vendore. Në vlerësimin e KLSH, në këto mangësi kanë ndikuar çështje të regjistrimit, pasi të dhënat për taksat dhe tarifave vendore mbahen në

program Excel, apo në ndonjë rast me sisteme të cilët nuk gjenerojnë të dhënat e duhura lidhur me debitorët etj. Gjithashtu jo të gjitha njësitë vendore bëjnë kontabilizimin e saktë të debitorëve, duke bërë që nga viti në vit të mos ketë siguri për saktësinë e këtyre të dhënave.

Në disa bashki nuk ka evidenca të sakta për familjet që kanë përfituar tokë bujqësore sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi, duke mos evidentuar numrin e saktë të familjarëve, sipërfaqen e tokës, detyrimin e tyre për këtë lloj takse. Për këtë arsye numri i debitorëve dhe vlera pësojnë ndryshime, në varësi të evidentimeve të reja që mund të bëhen. Këto subjekte nuk janë të pajisura me një sistem të mirëfilltë të licencuar elektronik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, në të cilin eliminohen ndërhyrjet në mënyrë të pa autorizuar, apo mund të gjurmohet çdo lloj ndërhyrje e ndryshimi që mund të bëhet etj.

Vetëm për vitin 2022, në pasqyrat financiare të 26 bashkive të audituara, detyrimet e pa arkëtuara nga debitorët privat dhe familjar për taksat dhe tarifatat vendore, kanë vlerën 823,707 mijë lekë, e cila për vitin ushtrimor 2021 ishte 451,163 mijë lekë.

Në të gjitha subjektet e audituara, nga KLSH është evidentuar fakti se për taksapaguesit privat dhe familjar, të cilët janë debitor ndaj njërive vendore lidhur me detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, nga strukturat e administratës së këtyre njërive dhe kryetarët e bashkive, nuk janë marrë masa të plota shtrënguese në rend shterues për arkëtimin e debitorëve, pavarësisht faktit se një pjesë e konsiderueshme e subjekteve janë debitorë në vite dhe me status aktiv. Nuk janë aplikuar masa për sekuestrim dhe konfiskimi i pasurisë apo kallëzime penale etj. Disa masa të tjera, si bllokime të llogarive bankare, vendosja e barrës siguroese në Drejtoritë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo ASHK (për asetet) etj., nuk janë aplikuar në të gjitha bashkitë. Mos marrja e masave të plota shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore ka sjellë jo vetëm mos arkëtimin në kohë të detyrimit, por edhe fenomenin që një numër subjektësh, edhe pse nuk bëjnë deklaram për mbyllje aktiviteti në QKB, nga vetë kontrolli që bënë administrata tatimore e njërive vendore, realisht konstatohet se këto subjekte mbyllin aktivitetin, duke bërë që të vështirësohet apo vihet në pikëpyetje arkëtimi i detyrimeve.

Niveli më i lartë i debitorëve progresiv për taksat dhe tarifatat vendore më datën 31.12.2022, konstatohet në Bashkitë: Kavajë në vlerën 1,166,150 mijë lekë, Mallakastër në vlerën 1,247,574 mijë lekë, Krujë në vlerën 722,871 mijë lekë, Sarandë në vlerën 434,747 mijë lekë etj. Vlera totale e debitorëve të pa arkëtuar për këto 4 bashki është 3,571,342 mijë lekë, ose 58% e detyrimit të pa paguar nga debitorët e 26 bashkive të cilave ju referohet kjo analizë. Megjithëse nga KLSH në zbatim të dispozitave ligjore, mënyrë të vazhdueshme në të gjitha auditimet e kryera, janë rekomanduar masa për arkëtimin e debitorëve, vazhdohet ende të konstatohet fenomeni i krijimit të debitorëve të rinj dhe i mos arkëtimeve në nivele të larta të detyrimeve të mëparshme të debitorëve.

Në këto 26 bashki që janë shqyrtuar pasqyrat financiare, vlera e debitorëve nga kategoria e taksapaguesve familjarë është 3,056,621 mijë lekë, ndërsa vlera e debitorëve nga kategoria e taksapaguesve privat është 3,106,035 mijë lekë, pra me një detyrim pothuaj të njëjtë prej 50% ndaj detyrimit total të debitorëve.

1.7 Rezultatet e auditimeve në fushën e të ardhurave

- * Nga auditimi i përputhshmërisë i kryer në *Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE)* për aktivitetin e vitit 2022 është dhënë opinioni i modifikuar/kualifikuar, pasi ka rezultuar rishikim i prioriteteve buxhetore pa kaluar më parë në PBA, pagesa të detyrime të prapambetura për investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën 6,169 milion lekë,

ose rreth 6.8% të totalit, duke deformuar vëllimin e investimeve të realizuar për vitin fiskal 2022; nënshkruar 1,319 kontrata pas datës 15 Tetor me vlerë të kontraktuar 10,045 milion lekë, në një kohë që vlera totale e kontraktuar rezulton 34,468 milion lekë; raportuar investime kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar në vlerën për 1,352 milion lekë, investime që nuk kanë plan buxheti të miratuar; kryerje e rikonstruksioni dhe shpenzime nga buxheti i shtetit për objekte që nuk janë në pronësi të shtetit në vlerën 31,961 mijë lekë etj.

Përveç sa është cilësuar më lart, në fushën e të ardhurave janë konstatuar vonesa në hartimin e dokumenteve të Programit Buxhetor nga institucionet buxhetore: konkretisht, kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është miratuar me VKM nr. 15, datë 20.01.2021, si dhe udhëzimi për përgatitjen e PBA, janë miratuar në tejkalim të afatit të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB).

- * Nga auditimi i përputhshmërisë të kryer në *Bankën e Shqipërisë* për periudhën e aktivitetit nga data 01.09.2021 deri më datën 31.12.2022, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë jomateriale dhe kanë justifikuar dhënien e një opinionit të pakualifikuar⁷.

Kanë shërbyer si bazë për këtë opinion:

- Rezultati financiar negativ për vitin 2022 që sipas pasqyrave financiare është në vlerën 17,650 milion lekë, tregues i cili jep efekt në uljen e vlerës totale të kapitalit dhe korrigjohet për efektet nga kurset e këmbimit, duke rezultuar në një humbje bruto në vlerën - 3,084 milion lekë. Sipas Bankës së Shqipërisë, kjo humbje është rrjedhojë e luhatjeve të kurseve të këmbimit (zhvlerësimi i valutave kundrejt monedhës lekë), si dhe situatës në tregjet financiare, ku rritja e normave të interesit ka sjellë zhvlerësimin e portofolit të letrave me vlerë.
 - Mos realizimi i investimeve sipas buxhetit të miratuar, duke mbartur objektet e programuara vit pas viti dhe nisjen e procedurave për prokurim në fund të vitit, duke sjellë pa mundësinë për realizimin e fondeve të miratuara;
 - Asgjësimi i vetëm atyre bonove të privatizimit që sillen nga bankat e nivelit të dytë, për të cilat nuk ka siguri nëse përfaqësojnë të gjitha bonot e përdorura apo vetëm një pjesë të tyre, duke mbartur risk që pjesa e pa dorëzuar në Bankën e Shqipërisë, të vijojë të mbahet nga bankat e nivelit të dytë jashtë monitorimit dhe mbikëqyrjes;
 - Mos konfirmimi sipas periodicitetit të parashikuar në rolin e agjentit fiskal sipas parashikimeve të marrëveshjes për ofrimin e shërbimeve financiare;
 - Mos mbulimi i rezervës negative të rivlerësimit të valutave nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë brenda afatit të parashikuar në nenin 64 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - Parregullsi në vendosjen e kriterëve kualifikuese për kandidatët gjatë procedurave të prokurimit, si dhe parregullsi në zbatimin e kontratave të lidhura;
 - Zhvillimi i procedurave të rekrutimit të testuara nëpërmjet procedurës së pranimit pa konkurrim dhe pagesa të shpërblimeve për punonjës me leje lindje etj.
- * Nga auditimi i përputhshmërisë të kryer në *Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD)*, për aktivitetin e vitit 2022, është konkluduar me dhënien e një opinionit të modifikuar/kualifikuar, për shkak të disa problematikave të konstatuara si niveli i lartë i

⁷ *Opinionit i pa modifikuar/ i pa kualifikuar* në auditimet e përputhshmërisë jepet kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme

borxhit doganor, mangësi në zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në strukturën përgjegjëse të hetimit, antikontabandës me pasojë mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit, efekte financiare negative për punonjësit e larguar nga puna etj. Nga auditimi është konstatuar se strukturat përkatëse në DPD nuk kanë ushtruar asnjë kontroll mbi procedurat e miratimit të kërkesave për rimbursim akcize në vlerën 234 milion lekë, si dhe për 8 magazina fiskale të pa mbuluara me garanci të vlefshme nuk kanë nisur procedurat e revokimit të autorizimit dhe nuk janë marrë masat përkatëse nga DPD për mosveprimet dhe monitorimin e veprimtarisë së degëve.

Sektori i Ankimeve i Drejtorisë Juridike në DPD në ndjekjen e proceseve gjyqësore lidhur me vlerësimin doganor nuk ka paraqitur argumentet e mjaftueshme mbështetur në prova për metodën e vlerësimit doganor të zbatuar, plotësimin e kushteve në mospranim të vlerës së transaksionit, mungesë argumenti për moszbatimin e metodave detyruese të vlerësimit doganor dhe nuk ka ndjekur praktikën përbarimore për ecurinë në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe zbatimin e kontratave nga përbaruesit gjyqësor. Gjithashtu, janë konstatuar parregullsi në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Aposterior që kanë të bëjnë me dokumentimin e plotë të gjurmës së auditimit në dosjet e kontrollit, përzgjedhjen e operatorëve të akcizës për kontroll në mungesë të një analize risku periodike me tregues të përcaktuar, shkelje procedurale në plotësimin e proces-verbaleve etj.

Përveç sa është evidentuar më lart në fushën e të ardhurave nga auditimi në DPD, kanë rezultuar mangësi në procedurat e ndjekura për planifikimin dhe parashikimin e drejtë të vlerave të të ardhurave doganore në ligjin e buxhetit dhe ndryshimet e mëvonshme, duke filluar nga faza e PBA-së, në projekt buxhet dhe për t'u finalizuar më pas me ligjin vjetor. Gjithashtu, të ardhurat doganore në total dhe sipas zërave përbërës kanë ndryshuar gjatë vitit, të cilat në rastin e të ardhurave për TVSH nuk janë vënë në dispozicion nga MFE për DPD. Kjo ka sjellë si pasojë që plani i të ardhurave nga TVSH sipas AN nr.17, datë 1.12.2022, në vlerën 155,500 milion lekë, nga ana e DPD është shpërndarë, ndjekur, monitoruar dhe paraqitur për vlerën 153,001 milion lekë.

Të ardhurat doganore gjithsej në vitin 2022 nuk janë realizuar për 410 milion lekë, kryesisht nga mosrealizimi i taksës doganore në shumën 53 milion lekë, renta minerare për 302 milion lekë dhe akciza për 1,219 milion lekë.

Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit janë konstatuar 5 raste të klasifikimit të gabuar të shkeljes së kryer nga ana e subjekteve, duke sjellë për pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 2,087 mijë lekë.

Gjithashtu nga auditimi i kësaj drejtorie, janë konstatuar edhe 75 raste në të cilat kundërvajtja nuk është shoqëruar me masë administrative duke sjellë për pasojë të ardhura të munguara në total në vlerën 3,750 mijë lekë.

Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Antikontabandës janë konstatuar 3 raste për të cilat nuk janë vendosur sanksionet e plota dhe klasifikim i gabuar i shkeljes së kryer nga ana e subjekteve me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej (detyrime dhe penaltete) 2,038 mijë lekë.

Mangësitë e evidentuara në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Aposterior kanë sjellë për pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 11,439 mijë lekë, detyrime dhe penaltet.

Për përmirësimin e situatës, KLSH ka rekomanduar marrjen e masave përkatëse si dhe arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të rezultuara nga auditimi.

- * Nga auditimi i përputhshmërisë të kryer në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021- 31.12.2022, për të cilin është konkluduar me dhënien e një opinionit të modifikuar/kualifikuar, për shkak të çështjeve kryesore si më poshtë:
 - Nga auditimi i dosjeve të kontrolleve tatimore në vend objekt auditimi u konstatuan efekte negative në grumbullimin e të ardhurave buxhetore gjatë auditimit të raporteve të kontrolleve tatimore, duke shkaktuar mungesën e evidentimit dhe të kërkimit për arkëtim të shumës prej 2,024,711 mijë lekë nga të cilat detyrimi në vlerën 1,407,390 mijë lekë dhe penalteti 617,321 mijë lekë, si dhe uljen e humbjes në vlerën 230,296 mijë lekë në një rast të konstatuar. Problematikat më të përhapura paraqiten si më poshtë:
 - Në rastet kur subjektet kanë qenë në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, janë kryer faturime të situacioneve të punimeve poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, të cilat duhet të ishin rivlerësuar, për të çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale. Në aspektin ekonomik të situatës këto transaksione kanë rezultuar në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, pasi në raportet e kontrolleve tatimore këto transaksione nuk janë justifikuar nën kostot mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonominë e shkallës të subjektit. Për këto raste parregullsi të konstatuara, është bërë rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë, të cilat nuk i janë njohur subjekteve si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk është lejuar kreditimi i TVSH-së në blerje, dhe kanë kaluar si shpenzime të panjohura, ku të gjithë të ardhurat janë klasifikuar si fitim. Për diferencat midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohura dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura, është kryer vlerësim alternativ i situatës financiare të subjekteve.
 - Nga kontrolli i listë-pagesave të subjekteve të deklaruara në sistemin C@ts, kanë rezultuar deklarime për punonjësit me 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe mos kryerja e pagesave për ditët shtesë, me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH. Gjithashtu janë konstatuar raste ku janë deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Për këto raste është kryer vlerësim alternativ i situatës financiare, duke rivlerësuar fondin e pagave të padeklaruara, duke qenë se për subjektet me parregullsitë e mësipërme nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës, regjistrat e punës, llogaritja e pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH, deklaratimet në sistemin C@ts etj.
 - Nga kontrolli i çmimeve të shitjes së njësive ndërtimore si apartamente, dyqane, parkim, kanë rezultuar shitje nën çmimin fiskal minimal sipas zonave të përcaktuara në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Për të cilat është rivlerësuar situata financiare e subjekteve për këto parregullsi, duke rritur të ardhurat, për pjesën e padekluar të diferencës midis çmimit të shitjes dhe referencës së zonës.

- Nga kontrolli i blerjeve ka rezultuar se për shoqëritë që kanë bërë blerje karburanti për të cilat kanë kredituar edhe TVSH në blerje, nga ana e DTM nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj. Referuar inventarit të mjeteve të transportit sipas anekseve të bilanceve të këtyre subjekteve dhe normave mesatare të konsumit dhe harxhimit të karburantit, duke kryer rregullimin e TVSH-së së kredituar të karburantit të përdorur për këto autovetura.
 - Gjithashtu problematika të tjera të konstatuara konsistojnë në transaksione huamarrje dhe huadhënie me ortakun pa aplikuar interesa, të cilat janë në kundërshtim me parimet e tregut të lirë dhe legjislacionit tatimor; për rastet e të ardhurave nga parapagimet për shitjen e njësisve nga objektet ndërtimore të pajisura me certifikatë shfrytëzimi nga ana e disa subjekteve nuk janë njohur të ardhurat nga shitja në PASH, por është vazhduar me njohjen e detyrimit përkatës në pasiv të bilancit kontabël si “Parapagime të arkëtuara”, deri në kalim të titullit të pronësisë tek klienti; problematika në respektimin e afateve procedurale gjatë evadimit të raporteve të kontrolleve në vend etj.
- Nga shitja e mallit naftë bruto e kryer nga kompania “Bankers Petroleum” me destinacion jashtë territorit të Shqipërisë rezultuan diferenca të pagesës së rentës minerare ku sipas çmimit të bursës brend të rivlerësuar në procedurë eksporti në shumën totale 1,315,285 mijë lekë si dhe rillogaritje të pagesës së rentës minerare me një detyrim tatimor të taksës kombëtare të rentës minerare në shumën 131,528 mijë lekë, bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 153/2020 për “Regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur renta minerare.
- Të ardhurat bruto nga tatimet në DTM paraqiten me realizim 101% të planit, të ardhurat tatimore neto rezultojnë me një realizim në masën 97% kundrejt planit, pra me një mos realizim në vlerën 2,656 milion lekë, e ndikuar kryesisht nga niveli i realizimit të të ardhurave nga TVSH, taksave nacionale dhe lojërat e fatit.
- Nga auditimi konstatohet nuk është realizuar detyrimi për kryerjen e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë në raportin 50% të kontrolleve propozuar nga DTM dhe 50% nga DPT. Referuar regjistrin të vendosur në dispozicion nga Sektori i Analizës së Riskut, duke kryqëzuar informacionin me subjektet e propozuara për kontroll të plotë, nga totali prej 106 subjektësh të propozuara, rezultojnë se vetëm 15 subjekte (ose 14% e totalit) paraqiten si subjekte me risk, 70% pa risk (75 subjekte); dhe 15 të tjera (16%) nuk ishin subjekte të analizës së riskut (risk “NA”).
- Nga auditimi lidhur me funksionimin e ndërveprimit mes Strukturës së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Sektorit të Analizës së Riskut për të garantuar një mbulim të plotë të subjekteve të klasifikuara si me risk në programet e kontrollit, u konstatuan problematika që kanë çuar në dublikimin e punës, dhe mungesë efektiviteti në funksionet e këtyre strukturave në drejtim të analizave të kryera për propozimet për kontroll në vend për tatimpaguesit pranë DTM. Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Kontrollit nga zyra u konstatuan 22 raste me diferenca kase për të cilat nuk janë dokumentuar procesverbalet e gabimeve të kasës. Gjithashtu u konstatua se ekzistojnë diferenca mes deklarimit të kryer nga DPT dhe DPD për të dhënat e importeve dhe eksporteve , duke përbërë kështu një risk për ekzistencën e një anomalie të sistemeve; apo pasaktësi për shkak të modulit të aplikuar në sistemin C@TS në momentin e gjenerimit të të dhënave nga DPD. Kjo problematikë nuk është dokumentuar në korrespondencat mes DTM dhe DPT, dhe nuk rezulton të jenë ndërmarrë iniciativat e nevojshme për verifikimin e shkakut

të diferencave, me qëllim kryerjen e veprimeve të nevojshme në sistem. Në DTM rezultojnë 11 subjekte që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe 37 subjekte që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2022, pavarësisht rikujtesave dhe penalizimit të tyre për mos deklarim në kohë.

- Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimit Tatimor të Papaguar në DTM rezulton se nuk janë marrë të gjithë masat shtrënguese në ushtrimin e kompetencave të dhëna sipas legjislacionit në fuqi, duke sjellë për pasojë rritje të detyrimit të detyrimit tatimor të papaguar afërsisht me 700 milion lekë dhe me 37 të debitorëve të shtuar në fund të vitit 2021. Gjendja e detyrimit tatimor të papaguara në fund të vitit 2022 rezulton në vlerën 12,484 milion lekë që i përket një numri prej rreth 257 subjektsh debitorë. Gjatë vitit 2022 janë lidhur 26 akt marrëveshje për 24 subjekte me vlerë totale të detyrimit prej 1,023,388 mijë lekë, nga të cilat kanë përfunduar me sukses 9 prej; 8 janë në proces dhe 8 nuk kanë përmbushur pagesat e dakordësuara. Nga akt marrëveshjet e anuluar, për periudhën objekt auditimi rezultojnë edhe disa akt marrëveshje të lidhura për të njëjtat subjekte, si një mjet për mos aplikimin e masave të tjera shtrënguese pas përfundimit të afatit për marrëveshjet ekzistuese.
 - Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në *Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës* për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022 është konkluduar me dhënien e opinionit të modifikuar, pasi në fushën e të ardhurave janë konstatuar, të vlerësuara paraprakisht të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 133,327 mijë lekë, nga të cilat 61 % detyrime tatimore (në vlerën 81,255 mijë lekë) dhe 39% penalitete tatimore (në vlerën 52,072 mijë lekë).
Detyrimet tatimore të konstatuara, të vlerësuara të munguar, përfaqësohen në masën 72 % nga TVSH (në vlerën 58,205 mijë lekë) dhe 28% për Tatim Fitimit (në vlerën 23,050 mijë lekë). Nga auditimi me përzgjedhje i 40 raporteve të kontrollit tatimor, është konstatuar se nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, ku janë konstatuar paraprakisht mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në vlerësimin e inventarit fizik ku përfshihen shitje mallrash nën kosto, në identifikimin e shpenzimeve të panjohura në përputhje me legjislacionin tatimor nga ana e inspektorëve të kontrollit, si dhe në identifikimin e kriterëve ligjore për përfitimin e rimbursimit të TVSH-së nga ana e subjekteve tatimore, duke sjellë efekte negative në të ardhurat e buxhetit të shtetit në shumën 56,196 mijë lekë, nga të cilat 82 % detyrime tatimore (në vlerën 46,139 mijë lekë) dhe 18% gjobë tatimore (në vlerën 10,057 mijë lekë).
Detyrimet tatimore të konstatuara në vlerën 46,139 mijë lekë të detajuara sipas llojit të tatimit, përfaqësohen në masën 79% nga TVSH dhe 21% nga Tatim Fitimi.
- Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e Tatim Fitimit të Thjeshtuar dhe Tatim Fitimit për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për 325 tatimpagues, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale duke shkaktuar efekte negative në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën 77,131 mijë lekë, nga të cilat 46 % detyrime tatimore (në vlerën 35,116 mijë lekë) dhe 54% gjobë tatimore (në vlerën 42,015 mijë lekë).
- Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në *Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan* për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më 30.06.2022 është konkluduar me dhënien e Opinionit të modifikuar.

Në fushën e të ardhurave janë konstatuar paraprakisht të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit vlerësuar në shumën 162,773 mijë lekë, nga të cilat 53 % detyrime tatimore (në vlerën 86,695 mijë lekë) dhe 47% lekë penalitete tatimore (në vlerën 76,078 mijë lekë).

Detyrimet tatimore të konstatuara në vlerën 86,695 mijë lekë të detajuara sipas llojit të tatimit, përfaqësohen në masën 86 % nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (në vlerën 74,723 mijë lekë), 12% nga Tatim Fitimi (në vlerën 10,642 mijë lekë) dhe 2 % nga Tatimi në Burim (në vlerën 1,329 mijë lekë), analizuar si më poshtë:

Nga auditimi me përzgjedhje i 30 raporteve të kontrollit tatimor, në 12 subjekte nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, ku janë konstatuar paraprakisht mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në vlerësimin e inventarit fizik ku përfshihen shitje mallrash nën kosto, në identifikimin e shpenzimeve të panjohura në përputhje me legjislacionin tatimor nga ana e inspektorëve të kontrollit si dhe në identifikimin e kriterëve ligjore për përfitimin e rimbursimit të TVSH-së nga ana e subjekteve tatimore, duke sjellë efekte negative në të ardhurat e buxhetit të shtetit në shumën 51,722 mijë lekë, nga të cilat 60 % detyrime tatimore (në vlerën 31,169 mijë lekë) dhe 40% gjobë tatimore (në vlerën 20,552 mijë lekë). Detyrimet tatimore të konstatuara në vlerën 31,169 mijë lekë të detajuara sipas llojit të tatimit, përfaqësohen në masën 62% nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe 34% nga Tatim Fitimi dhe 4 % tatim në burim.

Spektori i Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin e qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave të deklaruara në deklaratat e Tatim Fitimit të Thjeshtuar dhe Tatim Fitimit për tatimpaguesit, nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për 325 tatimpagues, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale duke shkaktuar efekte negative në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën 111,051 mijë lekë, nga të cilat nga 50 % detyrime tatimore dhe 50% gjobë tatimore (secila në vlerën 55,525 mijë lekë).

- Nga Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë i ushtruar në *Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër*, për periudhën e veprimtarisë janar 2020 deri në qershor 2022, KLSH ka arritur në konkluzionin se, për sa i përket përputhshmërisë së çështjeve të audituara, subjekti i audituar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, duke dhënë opinion të modifikuar/kualifikuar për përputhshmërinë, ndërsa për sa i përket auditimit financiar, KLSH ka arritur në konkluzionin se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë situatën financiare të subjektit më datë 31.12.2021, duke dhënë opinion të pa modifikuar për pasqyrat financiare.

Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend dhe vlerësimit tatimor nga zyra, nga vlerësimet paraprake të kryera nga KLSH, kanë rezultuar të ardhura të munguara në shumën totale 1,196,591 mijë lekë, nga e cila detyrimet TVSH dhe Tatim Fitimi në shumën 960,335 mijë lekë dhe penalitete në shumën 236,256 mijë lekë, të periudhave tatimore 2020-2021, për të cilat është kërkuar të kryen rivlerësimet përkatëse për arkëtimin e kësaj shume, konkretisht:

Nga auditimi i procedurave të kryera mbi vlerësimin tatimor nga zyra është konstatuar se si pasojë e moskryerjes në kohë dhe me efektivitetin e kërkuar të detyrave funksionale, kanë rezultuar mangësi në administrimin dhe monitorimin e situatave financiare të tatimpaguesve, me pasojë diferenca në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në kasat fiskale me të ardhurat e deklaruara në deklaratat e TFTH-së dhe TVSH-së; në qarkullimin e deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit për periudhën objekt auditimi, në shumën 754,915 mijë lekë, dhe në vlerën e importeve dhe eksporteve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë, për periudhën

objekt auditimi, në shumën 355,266 mijë lekë, të cilat janë konsideruar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, ka rezultuar se në disa raste nuk ishin analizuar në përputhje me Ligjin nr. 9920/2008, me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, me kërkesat e Programit të Kontrollit, pasqyrat financiare të subjekteve tatimpagues dhe deklarimet e tatimpaguesve, gjë e cila ka sjellë ri karakterizimin e situatës, si dhe evidentimin paraprak të të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në shumën 86,410 mijë lekë.

Nga 30 dosje të audituara, të kontrolli tatimor në vend, në 15 prej tyre, nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk ishin zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e programeve të kontrollit, si dhe Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime.

Nga auditimi mbi gjendjen e detyrimeve të papaguara (Rajoni verior), ka rezultuar se gjendja e tyre në 30.06.2022, është në shumën 13,290,528 mijë lekë, që i përkasin 23,816 debitorëve, nga 11,007,343 mijë lekë që paraqitej në fund të muajit dhjetor 2020. Tendenca e gjendjes së detyrimeve për periudhën janar 2020-qershor 2022 paraqitet me një rritje të ndjeshme, situatë e ndikuar nga mungesa e efektivitetit të masave shtrënguese të ndërmarra për arkëtimin e borxhit, moszbatimi i tyre në mënyrë shteruese, ristrukturimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në Rajon Verior dhe periudha e vështirë shkaktuar nga pandemia e Covid-19 gjatë vitit 2020.

Nga KLSH i janë rekomanduar DRF Shkodër, për përmirësimin e situatës në të ardhmen, 10 rekomandime “Masa organizative”; 6 rekomandime “Për rivlerësim të diferencave të konstatuara dhe konsideruara të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit” në shumën 1,196,591 mijë lekë, si dhe janë kërkuar “Masa disiplinore” për 12 punonjës të DRT Shkodër.

- Nga auditimi financiar dhe i përputhshmërisë i ushtruar në *Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2018-31.12.2020, u konkludua me një opinion të kualifikuar pasi rezultuan veprime apo mosveprime në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore e rregullative në fuqi, nga të cilat kanë ardhur pasoja me ndikim në menaxhimin, mirëfunksionimin e institucionit dhe me efekt në buxhetin e shtetit, të vlerësuara të ardhura të munguara në vlerën totale 59,569,095 mijë lekë, e përbërë nga 48,893,177 mijë lekë detyrim tatimor plus 10,675,918 mijë lekë penalitet, nga të cilat:
 - Shuma prej 148,152 mijë lekë detyrime plus penalitet, ka rezultuar nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të plota dhe rimbursimit të TVSH-së, të Sektorit të Kontrollit Operacional, ku janë konstatuar parregullsi në veprimet e inspektorëve të kontrollit si: verifikimin e rregullshmërisë së shpenzimeve të njohura në PASH, gabim në llogaritjen e kostos së mallrave të shitur (KMSH), keq llogaritje e shpenzimeve të amortizimit në PASH, kreditim i gabuar i TVSH-së së karburantit, transaksione shitjesh me marzhe fitimi jo në përputhje me parimet e tregut të lirë, çmime shitjesh të njëjësive ndërtimore poshtë nivelit të referencës së përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, faturime të situacioneve të punimeve ndërtimore të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2016” dhe Udhëzim Nr.3, Datë 3.2.2010 “Për Miratimin e Kostos Mesatare të Ndërtimit të Banesave nga EKB, për vitin 2010”.

- Shuma prej 58,068,672 mijë lekë detyrime plus penalitet, rezulton nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Kontrollit dhe Monitorimit nga Zyra, konkretisht të ardhurat e munguara në buxhetin e shtetit janë konstatuar rrjedhojë e mungesës së vlerësimit nga ana e inspektorëve nga zyra të: diferencave në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në kasat fiskale me të ardhurat e deklaruara në deklaratat e TFTH-së dhe TVSH-së për biznesin e vogël pa TVSH, për biznesin e vogël me TVSH, për biznesin e madh; diferencave në qarkullimin e deklaruar në FDP-në e TVSH-së dhe deklaratës së Tatimit mbi Fitimit, diferencave për TVSH-në e deklaruar në tatime dhe TVSH-në e deklaruar në doganë, rishikimi në ulje i kësteve të tatimit mbi fitimin, biznese pa ndryshuar përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, problematika në plotësimin e Deklaratës të TFTH-së, me pasoja diferenca të pajustificuara, në vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në zërat e tatimit mbi fitimin, tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe TVSH-së për të cilat DRT Tiranë, i është kërkuar të kryejë vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.
- Shuma 1,352,271 mijë lekë rezulton detyrim total i principalit, kamatëvonesave dhe gjobave të pa mbledhura nga Drejtoria Rajonale Tiranë, për 3,957 subjekte të cilët kanë kryer deklarimin e tatim fitimit për periudhën 2018-2019 dhe nuk kanë kryer pagesën e tij.
- Nga Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë i ushtruar në *Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe DRSSH Tiranë*, për periudhën e veprimtarisë janar - dhjetor 2022, KLSH ka arritur në konkluzionin se, për sa i përket përputhshmërisë së çështjeve të audituara, subjekti i audituar ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe përsa i përket auditimit financiar, ka arritur në konkluzionin se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë situatën financiare të subjektit më datë 31.12.2022, duke konkluduar me opinion të pa modifikuar me theksim çështjeje për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë.

Në fushën e të ardhurave, përveç sa trajtuar më sipër, ka rezultuar se:

- Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të buxhetit të ISSH ka rezultuar se, sipas Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022”, me ndryshime plani i të ardhurave për ISSH, nga kontributet është në shumën 104,009 milion lekë dhe përfaqëson të ardhura tatimore, të klasifikuara si të tilla edhe në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit. Nga ISSH, nga plani i të ardhurave nga kontributet 104,009 milion lekë, shuma prej 745,477 mijë lekë është detajuar si plan për të ardhura jo tatimore, në kundërshtim me Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe “Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit të vitit 2022”. Kjo ka sjellë që plani i të ardhurave nga kontributet sipas ISSH të jetë 745,477 mijë lekë më pak, se plani i miratuar me ligjin e buxhetit.
- Nga auditimi mbi saktësinë në raportimin e të ardhurave të realizuara nga derdhja e kontributeve, ka rezultuar se ISSH, ka raportuar si të ardhura nga kontributet edhe të ardhura jo tatimore në shumën totale 1,197 milionë lekë, gjë e cila ka ndikuar në analizën e realizimit të treguesve buxhetorë. Për përmirësimin e situatës në të ardhmen janë lënë rekomandime, ku është kërkuar marrja e masave për pasqyrim të drejtë të treguesve buxhetorë si në planifikim dhe realizimin e tyre.
- Nga Auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në *FSDKSH*, për periudhën e veprimtarisë janar - dhjetor 2022, KLSH ka arritur në konkluzionin se për sa i përket përputhshmërisë së çështjeve të audituara, subjekti i audituar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, gabimet e evidentuara kanë rezultuar materiale por jo të përhapura, duke konkluduar me opinion të modifikuar/ të kualifikuar.

Në fushën e të ardhurave, përveç sa trajtuar më sipër, ka rezultuar se:

- Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për shpenzime administrative dhe investime, ka rezultuar një nivel i ulët i realizimit të tyre në vitin 2022, i cili varion nga 37.7% investimet deri në 85 % shpenzimet për paga. Gjithashtu, pavarësisht se dhe në vitin e mëparshëm paraqitet e njëjta situatë, pra ka nivel të ulët të realizimit të shpenzimeve, ky fakt nuk është marrë në konsideratë gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2022, pasi plani i vitit 2022 është në nivele më të larta se plani dhe fakti i vitit 2021, pavarësisht se edhe ky vit ka rezultuar në nivele të ulta realizimi, duke shkaktuar angazhim të fondeve buxhetore më tepër se nevojat reale. Niveli i ulët i realizimit të shpenzimeve të planifikuara është evidentuar edhe në nivel DRF, në të gjithë zërat e buxhetit paga, sigurime, operative dhe investime.
- Nga auditimi mbi financimin e kontratave koncesionare për vitin 2022, ka rezultuar se financimi i tyre paraqitet me tendence në rritje, duke tejkaluar parashikimet buxhetore sipas kontratave respektive, gjë e cila do të kërkon një angazhime buxhetore shtesë deri në përfundim të tyre. Kjo tendencë reflektohet edhe në PBA 2022-2024 të FSDKSH.
- Nga auditimi i përputhshmërisë dhe financiar të kryer në *MFE dhe DPD “Mbi kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”*, për periudhën nga identifikimi/propozimi i projektit deri në zbatimin e tij në 31.12.2022, kanë rezultuar çështjet e mëposhtme:
 - *Oferta e pa kërkuar* për dhënien me koncesion të këtij shërbimi nuk rezulton të jetë mbështetur në prioritetet strategjike të qeverisë për periudhën në fjalë dhe nuk rezulton nëse në momentin e propozimit për dhënien me koncesion të këtij shërbimi, të jetë kryer një studim, për të parashikuar kostot respektive të mbështetjes buxhetore, apo për të identifikuar nëse ky projekt ka qenë i përballeshëm për buxhetin e shtetit, pasi nuk janë përfshirë analiza të tilla si kostoja e shpronësimeve; kostoja e investimit; kostot e mirëmbajtjes; kostot operative për skanimet e kryera; burimet e financimit të koncesionarit; normën e brendshme të kthimit (IRR) dhe vlerën aktuale neto (NPV); argumentimin e çmimit, etj. Vlerësimi i kryer nga Grupi për Identifikimin e Propozimit (GIP) paraqet vetëm konkluzionet, duke mos dokumentuar analizat e kryera krahas vendimmarrjes së tyre për pikëzimin e kryer; vlerësimin e skemës financiare dhe vlerës; shtuar këtu edhe afatin e tejkaluar nga data e propozimit të pa kërkuar.
 - *Gjatë vlerësimit të ofertës* nuk dokumentohen analizat e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) dhe Njësisë së Hartimit të Dokumenteve (NJHD) për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të ofertës. Nuk rezulton të jetë analizuar nga ana e GIP sipërmarrja e koncesionarit në fazën e propozimit për kryerjen 100% skanim në fazën e vlerësimit të propozimit, apo KVO-së, për të vlerësuar lidhur me realizueshmërinë e këtij procesi. Pavarësisht pretendimeve të ngritura fillimisht nga përfaqësuesit e ATRAKO-s se tarifimi nuk duhet të bëhet për çdo deklaratë pa marrë shërbimin, me argumentimin që nuk mund të paguajë dikush për një shërbim që nuk merret, pasi çmimi i shërbimit është pjesë e aktivitetit sipërmarrës që do të kryejë koncesionari dhe nuk mund të jetë detyrim monetar, por të paguhet sipas deklaratave që do të skanohen; në mbledhjet e ardhshme përfaqësuesit kanë pranuar skanimin 100% të deklaratave dhe tarifimi të bëhet për çdo deklaratë (pra, jo për çdo njësi transporti të mallit që skanohet), vendimmarrje e cila është konkretizuar edhe në miratimin e kontratës me Ligjin nr. 123, datë 25.04.2013 “*Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoriteti kontraktues dhe shoqërisë Rapiscan Security Inc si koncesionar*” . Ndryshimet e vendosura nga KVO, NJHD dhe ekspertët e jashtëm reflektojnë automatikisht nevojën për kryerjen e

ndryshimeve në propozimin e pa kërkuar të Rapiscan, në NPV, IRR, periudhën e vetëshlyerjes, çmimin. Këto ndryshime bëjnë të pavlefshëm vlerësimin me pikë që GIP i ka dhënë fizibilitetit të vënë në dispozicion nga Rapiscan. Gjithashtu rezulton se ndryshimet e cilësuar më sipër nuk janë vijuar me rishikimin e treguesve nga ana e Rapiscan, dhe se vendimmarrja pasuese e KVO dhe NJHD është bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Rapiscan në fillim të procedurës, ku kushtet ishin tërësisht të ndryshme.

- Për rrjedhojë, edhe kontrata e nënshkruar paraqet ndryshime të theksuara nga faza e propozimit të ofertës së Rapiscan, deri në finalizimin e saj, të cilat kanë konsistuar në ndryshime të treguesve të paraqitur fillimisht gjatë propozimit të ofertës së pa kërkuar, apo termave të referencës të saktësuar nga ana e MFE në vijim të kërkesave për sqarim të paraqitura nga Operatorët Ekonomikë (OE). Pavarësisht se ekspert i ndërkombëtar i kontraktuar nga MFE kishte sugjeruar se çmimi i kontratës do të ishte më i lartë nëse do të bëhej për 100% të skanimit të ngarkesave që futen në pikat doganore (25 dollarë) dhe më i ulët nëse do të bëhet për çdo deklaratë doganore pasi në një mjet transporti mund të kishte disa deklarata (12 dollarë), çmimi i kësaj kontrate me ligjin 123/2013 është përcaktuar më i lartë (39 euro) edhe pse për çdo deklaratë, dhe jo për çdo mjet transporti, pra, duke detyruar tarifimin për çdo deklaratë pavarësisht nëse është marrë shërbimi, dhe duke paguar disa herë për të njëjtin shërbim). Kontrata nuk ka parashikuar specifikisht operatorët objekt skanimit; nuk ka parashikuar formatet tip të raportimit; nuk ka përfshirë penalitete apo masa që do të ndërmerren për mos realizimin e detyrimeve të koncesionarit në lidhje me investimet, trajnimet apo angazhimet e tjera kontraktuale. Nuk janë përkrahur saktë përdorimi i konceptit të pronësisë intelektuale dhe teknologjisë sekrete, duke përbërë kështu një risk të shtuar për kushtet sipas së cilave do të bëhet dorëzimi i pajisjeve që mundësojnë shërbimin e skanimit në përfundimin e kontratës. Pas miratimit të ligjit nr. 123, datë 25.04.2013, kontestimeve të shumta dhe refuzimeve të bizneseve për të zbatuar këtë kontratë referuar tarifave shumë të larta të shërbimeve, është evidentuar nevoja për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit.
- Pas miratimit të kontratës me ligjin nr. 123/2013, deri në *rishikimin e saj* me ligjin nr. 74/2015 dhe ligjin nr. 118/2015 ku është ndryshuar skema e financimit dhe tarifat ndaj bizneseve që operojnë në sistemin doganor, shoqëria koncesionare nuk ka vijuar punën në zbatimin e kontratës. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë kufizuar me emërimin e vetëm një menaxheri projekti, përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së shoqërisë koncesionare, pa përcaktuar mënyrën se si duhet të realizohet ky proces, linjat e raportimit dhe njësinë përgjegjëse përgjatë zbatimit të kontratës. Nga këto dy institucione nuk është kryer në asnjë rast një vlerësim se sa janë rritur të ardhurat e buxhetit të shtetit nga ky shërbim apo sa është ulur trafiku i mallrave të paligjshme, i cili ka qenë edhe objektivi fillestar i dhënies me koncesion të këtij shërbimi. DPD në cilësinë e përfaqësuesit ekzekutiv të autoritetit në kontratë dhe autoritetit përgjegjës për aktivitetin në doganat e RSH, dhe MFE në cilësinë e autoritetit kontraktor nuk kanë realizuar mbikëqyrjen e përshtatshme për zbatimin e kësaj kontrate duke mos identifikuar problematikat e konstatuara nga auditimi, ku konkretisht, nga *auditimi i realizimit të detyrimeve të shoqërisë koncesionare sipas kontratës është konstatuar se:*
 - Nuk dokumentohet analiza e miratimit nga MFE të përzgjedhjes së "ICMS" SHPK për shitjen e 49% të kuotave të koncesionit, duke përfshirë këtu shqyrtimin e eksperiencës së shoqërisë në fushën e ndërtimit; mirëmbajtjes së objekteve; personelit të punësuar etj., dhe se si ky partneritet do të sillte përfitime apo vlerë të shtuar për kontratën koncesionare.
 - Investimi paraprak i shoqërisë sipas Planit të Biznesit të paraqitur në propozim parashikuar në vlerën 21.7 milion Euro, nuk dokumentohet të jetë realizuar në këtë vlerë

- nga analiza e kryer nga MFE si AK. Për më tepër, kjo analizë nuk është bazuar në dokumentacion vërtetues për evidentimin e vlerës reale të këtij investimi si dhe nga ana e MFE nuk është marrë asnjë masë vijuese për përmbushjen e investimit.
- Nuk rezulton të jetë kryer zëvendësimi i detyrueshëm periodik i pajisjeve çdo 6 muaj, përkthyer në investime në vlerën rreth 7.8 milionë Euro, të parashikuar në Planin e Biznesit nga shoqëria koncesionare.
 - Nuk është realizuar detyrimi për lidhjen me serverin ose switch-in lokal më të afërt të vendit të Autoritetit (me sistemin Asycuda në DPD) me qëllim transferimin e imazheve dhe analizimin e të dhënave të tyre, një detyrim ky që në fazën e miratimit të koncesionit është pretenduar se do të garantonte transparencë jo vetëm për DPD por edhe për çdo qytetar që do t'i mundësohej kjo e drejtë.
 - Nuk dokumentohen analizat me bazë fluksi dhe risku për përcaktimin e 5 pikave doganore me skaner të cilat nuk rezultojnë të jenë rivlerësuar gjatë zbatimit të kontratës, për të vlerësuar prioritetet ku shërbimi i skanimit do të ishte më efektiv, pavarësisht se përgjatë kontratës janë ngritur problematika, përfshirë zhvendosjen e skanerit të Durrësit, apo shtimin e një skaneri në portin e Vlorës/Hanin e Hotit, pavarësisht se përgjatë propozimit, përfshirja e skanerëve të lëvizshëm është parashikuar specifikisht për qëllime të lehtësive në zhvendosjen e tyre sipas nevojës përgjatë ekzekutimit të kontratës.
 - Detyrimi kontraktual për kryerjen e përditësimeve në software të pikave të skanimit, konsiderohen të realizuara nga ana e DPD vetëm referuar raporteve të përcjella nga koncesionari ku këto shërbime vetë-deklarohen si të kryera, pasi menaxheri i projektit nuk disponon njohuritë e duhura teknike për vlerësimin e tyre.
 - Angazhimi i pretenduar i koncesionarit për skanimin 100% të mjeteve të transportit në pikat e vendosura të skanerit konstatohet se nuk është i realizueshëm, dhe nga ana e autoritetit kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës nuk është kryer asnjë analizë lidhur me numrin maksimal të mjeteve që mund të skanohen nga koncesionari sipas pikave doganore, krahasimisht me numrin e mjeteve që kanë qenë për skanim sipas ditëve.
 - Skanimi rezulton se është kryer nga për 51.2% të deklaratave në vitin 2015; 31.1% në 2016; 36.1% në 2017; 36% në 2018; 32% në 2019; 36.1% në 2020; 18% në 2021 dhe vetëm 22% në vitin 2022. Nëse analizojmë total deklaratat që kanë kryer pagesë skanimi, pavarësisht pikës doganore, krahasimisht me total deklaratat në import dhe eksport që i janë nënshtruar skanimit, rezulton se për vitin 2015 kemi një mbulim me 33%, në vitin 2016 në 18%, 2017 në 22%, 2018 në 23%, 2019 në 22%, 2020 në 20%, 2021 në 19%, 2022 në 20%.
 - Pra, për afërsisht të 80% të deklaratave doganore të degëve ku kryhet skanim, paguhet tarifa e skanimit, pa e kryer këtë shërbim.
 - Gjatë skanimit rezultati ka përfshirë edhe elementit të ngjyrës së verdhë (*dyshime të bazuara për parregullsi*), ndërkohë që në kontratë është parashikuar se rezultati i skanimit do të kufizohet në identifikimin (*ngjyra e kuqe*) ose jo të parregullsive (*pa ngjyrë*). Rezultati i verdhë shoqërohet me kontrolle fizike shtesë të AK, për të cilat në asnjë fazë të kësaj procedure nuk është kryer vlerësimi, për më tepër që në fazën e propozimit është raportuar për një mbulim me kontroll në masën 10%. Në portin e Durrësit (i cili është edhe skaneri me fluksin më të lartë) analizat e Rapiscan rezultojnë të kenë konkluduar në dyshime të bazuara për parregullsi + dyshime të forta për parregullsi që variojnë nga 6% të total deklaratave në vitin 2016; 13% në vitin 2017; 36% në vitin 2018; 42% në vitin 2019 dhe 51% në vitin 2020 dhe 55% në vitin 2021. Kapacitetet e DPD e kanë të pamundur të kryejnë kontrolle fizike në mbi 55%, për më

- tepër kur përpara marrjes së angazhimit për këtë koncesion, kontrollet kryheshin në masën 10%.
- Për sa i përket “gjetjeve” të skanerit, ky informacion nuk paraqitet në raportet e shoqërisë koncesionare, dhe strukturat përgjegjëse të DPD nuk administrojnë të dhëna historike lidhur me rezultatet e kontroleve të iniciuara nga rezultati i skanimit (dyshime për parregullsi bazuar në analizën e imazhit) apo nga palë të treta si autoritetet ligj-zbatuese (dyshime për parregullsi pavarësisht imazhit të klasifikuar si pa parregullsi).
 - Nivelet e shërbimit të kësaj kontrate janë përcaktuar të maten nga disponueshmëria e vendit dhe koha e shërbimit të përgjigjes, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me pajisjet e skanimit, në një kohë ku koncesioni i shërbimit të skanimit i referohet një shërbimi që bazohet në vlerësimin e personelit të punësuar për të analizuar imazhet e skanimit, pasi pajisjet në vetvete ofrojnë vetëm “fotografimin” e pamjeve të brendshme të kontejnerëve, dhe nuk mundësojnë sinjalizime të tjera shtesë për evidentimin e parregullsive në mjetet e skanuara. Për personelin e punësuar në pikat e skanimit nuk kryhen verifikime lidhur me kapacitetet profesionale të personelit të punësuar, apo numrin e tyre, për të garantuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.
 - Asetet e kësaj kontrate dhe pagesat/obligimet lidhur me të nuk raportohen në pasqyrat financiare të MFE në cilësinë e autoritetit kontraktor, apo të DPD në cilësinë e institucionit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës, duke mbetur jashtë kuadrit të raportimit financiar; çështje kjo me një rëndësi të veçantë referuar faktit se koncesioni parashikon transferimin e tyre në përfundim. Si rezultat, konstatohet se nuk dokumentohet të jetë kryer në asnjë moment të zbatimit të kësaj kontrate vlerësimi nëse ky koncesion ka mundësuar ofrimin e një asemi efikas dhe ekonomik, apo nëse është mundësuar ofrimi i një inovacioni teknologjik dhe përsosmërie menaxheriale për të ulur koston, rritur efikasitetin dhe përmirësuar shërbimet për përfituesit .
 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë, apo DPD nuk kanë mundësuar krijimin e një sistemi që monitoron nivelet e kënaqësisë/ankesat e konsumatorëve, me qëllim mbrojtjen e interesit të konsumatorëve lidhur me sasinë, cilësinë dhe nivelin e tarifës të aplikuar për këtë shërbim.

Nga auditimi u konstatua se referuar procedurave aktuale të implementuara nga DPD nuk ekziston asnjë mundësi që të identifikohen gabime të skanerit, në kushtet kur nuk kryhet një verifikim i saktësisë/vërtetësisë së tij, pasi kontrole fizike nga AD kryhen vetëm në skanimet e dyshuara për pasaktësi (*të verdha dhe të kuqe*). Për deklaratat e identifikuar nga skaneri si të pastra (pa ngjyrë) AD nuk kryhen kontrole fizike, pavarësisht se kontrata ka parashikuar se për rastet kur në to identifikohen parregullsi do të konsiderohen si gabime të skanerit dhe do aplikohen penalitete që variojnë nga 30,000 euro për çdo analizë të dështuar të imazheve deri në pezullim të përkohshëm të kontratës koncesionare.

- Nga auditimi i përputhshmërisë “Mbi vlerësimin e sistemit të licencimit, shfrytëzimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarisë minerare i zhvilluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM) dhe në tre (3) shoqëri tregtare në likuidim e sipër që veprojnë në sektorin Minerar, për periudhën 2018 – 2022, është arritur në konkluzion se ky sistem është pjesërisht funksional dhe pjesërisht efikas. Nga auditimi ka rezultuar se, këto institucione shtetërore kanë mangësi domethënëse të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tyre zyrtare, me ndikim të mundshëm në shfrytëzimin e zonave minerare, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre pasurive publike, duke u ekspozuar ndaj risqeve ligjore, ekonomike, financiare, mjedisore. Gjetjet e auditimit dëshmojnë për një sërë dobësish, parregullsish e

shkeljesh të karakterit tekniko-ekonomik, financiar e administrativ, kundrejt kërkesave të ligjit minerar dhe legjislacionit mbështetës, të dalë në zbatim të tij.

Nga auditimi në AKBN dhe MIE për periudhën 2018-2022 janë konstatuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit gjithsej 49,999 mijë lekë, si më poshtë :

- Në AKBN, detyrimet e papaguara të subjekteve që kanë qenë zotërues të lejeve minerare referuar të dhënave të vëna në dispozicion, për periudhën 2018-2022 për garanci rehabilitimi sipas lejes, janë në vlerën prej 21,999 mijë lekë; Gjithashtu, në AKBN rezultoi se për 85 % të gjobave të zotëruesve të lejeve minerare për periudhën 2018-2022 (vlerësuar në shumën 27,200 mijë lekë), nuk ka nisur procedura e vjeljes së detyrimit, duke ulur ndjeshëm efektet e masave të ndëshkimit me gjobë të zotëruesve të lejeve minerare në drejtim të disiplinimit të veprimtarisë së sektorit minerar;
 - Në MIE, Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative ka shfuqizuar 7 masa administrative në vlerën 800 mijë lekë, në mungesë të shqyrtimit të plotë të provave, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.
- Në auditimin e kryer në institucioni “Avokatura e Shtetit” me objekt “Ecuria e detyrimeve shtetërore për Vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. (Stoku i detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura, gjendje në datën 31.12.2022. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare)”, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022 rezultoi se Procesi i arbitrazhit, i regjistruar me nr. “ICSID ARB/14/26” ka përfunduar me Vendimin e Tribunalit të datës 3 mars 2020, i cili i ka dhënë të drejtë pretendimeve të Republikës së Shqipërisë dhe ka rrëzuar të gjitha kërkesat e paditësve. Kjo çështje ka përfunduar në Arbitrazh Ndërkombëtar me vendim, por nuk ka ende asnjë kërkesë për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas. Detyrimi i vendosur nga Tribunali i Arbitrazhit është në vlerën e 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £. Si pasojë e mosveprimit në kohë nga autoritetet shtetërore si palë të interesuara, për njohje të vendimit nga Gjykata e Apelit, nuk janë arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit shumat prej 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £.
- Nga auditimi i përputhshmërisë në Drejtorinë e Shërbimit Diplomatik (DSHTD) për aktivitetin e vitit 2022 ka rezultuar se subjekti ka aplikuar derdhjen e 30% të të ardhurave të krijuar nga qiraja vetëm nga “subjektet vendase”, me pretendimin se, meqenëse procedura e dhënies me qira e parashikuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” nuk mund të aplikohet për trupin diplomatik apo organizatat e tjera ndërkombëtare, rrjedhimisht, as derdhja e detyrimit 30% nuk duhet të aplikohet. VKM e mësipërme nuk e parashikon konceptin e subjektit vendas apo subjektit të huaj, kjo ndarje është bërë nga vetë DSHTD për efekt lehtësie në administrimin e procedurave, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhet të shtetit vlerën prej 52,358 mijë lekë.
- Në auditimin e ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) në lidhje me zbatimin e përcaktimeve të kontratave dhe pagesën e qerasë për tokat bujqësore për vitin 2022, rezultoi se:
- Në 10 nga 21 të kontratave të lidhura, ose 48% të tyre, qiramarrësit nuk kanë paguar në kohë detyrimin për qiranë duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit si dhe shtim të detyrimeve të prapambetura në lidhje me kamatëvonesat e llogaritura në vlerën totale 55,830 mijë lekë;

- Në 12 nga 21 të kontratave të lidhura, ose 57% të kontratave të qirasë, qiramarrësit nuk kanë kryer investime në terren për të cilat në dosjet e kontratave të audituara nuk ka dokumente justifikuese (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë për këto kontrata nuk provohet realizimi i investimit. Pra, për 12 kontratat e qirasë nuk janë kryer investimet në nivelin deri 20% të vlerës së investimit, të cilat duhej të realizoheshin brenda 3 vjetëve nga momenti i dorëzimit, si dhe nuk kanë kryer investimet në nivelin deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para në një vlerë prej 426,029 mijë lekë.
- Për auditimin e përputhshmërisë të ushtruar në *Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)*, për periudhën e veprimtarisë 01.10.2017-31.12.2022, KLSH ka konkluduar në një opinion të kualifikuar. Në fushën e të ardhurave ka rezultuar se, në raportimet e AAPSK-së rezulton se janë përfshirë në të ardhurat e veta edhe të ardhurat e marra nga buxheti i shtetit, për të mbuluar shpenzimet, duke mbivlerësuar në këtë mënyrë raportimin e të ardhurave, konkretisht: për periudhën objekt auditimi të ardhurat nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara rezultojnë 177,358 mijë lekë ndërsa shpenzimet në vlerën 298,044 mijë lekë, ku diferenca prej 120,686 mijë lekë rezulton kosto për buxhetin e shtetit. Për vitin 2022 të ardhurat rezultojnë në vlerën prej 82,134 mijë lekë ndërsa shpenzimet 83,460 mijë lekë. Diferenca prej 1,326 mijë lekë rezulton kosto për buxhetin e shtetit për vitin 2022.
 - Nga auditimi i përputhshmërisë së *Drejtorisë Vendore e ASHK Sarandë*, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi materiale por jo të përhapura, të cilat justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar. Konkretisht, në zonën e Ksamilit me përparësi të zhvillimit të turizmit është tjetërsuar prona publike me sipërfaqe totale prej 31,003,8 m² duke kualifikuar dhe miratuar parcela ndërtimore të objekteve informale jashtë afatit të parashikuar në ligj dhe për objekte të ndërtuara me materiale të lehta provizore të paqëndrueshme.
 - Në 27 raste është miratuar “Leje legalizimi” për objekte “Godinë me funksion Banimit 1 kat”, duke tejkalluar kufirin ligjor të sipërfaqes së parcelës ndërtimore mbi 3-fishin e sipërfaqes të bazës të ndërtimit, veprime që kanë sjellë përfitim të padrejtë të pronës publike nga poseduesi i ndërtimit informal, në një sipërfaqe totale prej 7327.1 m².
 - Për vitin 2022, nga DVASHK Sarandë për legalizimin e ndërtimeve në shkelje të lejes së ndërtimit nuk është përlllogaritur penalteti për mosrespektimin e lejes së ndërtimit nga subjektet ndërtuese, në vlerën 706 mijë lekë, në kundërshtim me nenin 67 pika 1/f dhe 3 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.
 - Nga auditimi i kombinuar (financiar dhe të përputhshmërisë) në subjektin *Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës* për periudhën e aktiviteti nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022 është dhënë opinion i pakualifikuar për pjesën financiare dhe i kualifikuar për pjesën e përputhshmërisë. Në mënyrë të veçantë është konstatuar se Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, pas krijimit të saj në vitin 2019, nuk ka hartuar ende rregulloret e nevojshme për funksionimin e veprimtarinë së Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Drejtorive Vendore të ASHKK, si dhe Manualët e Sistemit Multifunksional të Kadastrës. Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK për marrjen me qira të ambienteve për zyra pune, për drejtoritë vendore të ASHK Durrës dhe Krujë, u konstatua se nuk është zhvilluar garë, nuk është respektuar parimi i transparencës dhe konkurrencës, ekonomikitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.

- ♣ Nga auditimi i përputhshmërisë së *Drejtorisë Vendore e ASHK Kamëz-Vorë*, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datën 31.12.2022, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi materiale por jo të përhapura, të cilat justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Në mënyrë të veçantë është konstatuar se nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë (ish- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t) për periudhën objekt auditimi, janë lëshuar 6 629 leje legalizimi për objektet informale, duke mos zbatuar kriteret përkatëse në 15 raste.

- Në 3 raste, janë kryer legalizime të objektit informal të ndërtuar në buzë të kanaleve kulluese ujëmbledhëse, pa respektuar distancat dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit, pasi në dosje nuk ndodhet dokumentacioni argumentues. Në 2 raste, janë regjistruar toka bujqësore me AMTP, ku rezulton se poseduesit e këtyre akteve, kanë përfituar më tepër, sipërfaqen prej 3 380 m², ndërsa nuk është bërë bilanci i sipërfaqes që ka përfituar me akt pronësie me atë të regjistruar në fakt, për të veçuar e kaluar në pronësi “shtet” sipërfaqen e tepërt.
 - Në 1 rast, është regjistruar pasuri e AMTP kur statusi i pasurisë është zëri kadastral “Kanal”, pronë “Shtet”.
- ♣ Nga auditimi i përputhshmërisë së Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP), për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datën 31.12.2022, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi materiale por jo të përhapura, të cilat justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Në mënyrë të veçantë ka rezultuar se përgjatë 7 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 133/2015 deri në 31 dhjetor 2022, nga ATP janë ekzekutuar në total vetëm 794 vendime për kompensim financiar, nga 18 734 vendime përfundimtare të vlerësuara nga Sektori i Kompensimit i ATP-së, pra janë ekzekutuar vetëm 4,5 % e vendimeve, që do të thotë se me këto ritme, ekzekutimi financiar i Vendimeve Përfundimtar për Kompensim që do të vlerësohen financiarisht sipas mënyrës dhe formave të përcaktuara në VKM-në 223/2016, të ndryshuar, është një proces pothuajse e pa realizueshëm, për zbatimin e nenit 16, pika 6 të ligjit nr. 133/2015.

Në 17 raste nga ana e ATP-së është punuar me dy standarde, ku për disa subjekte edhe pse kanë aplikuar ndër vite për kompensimin financiar të pronës, janë marrë vendime mbas 2-3 vitesh ndërsa për disa subjekte janë shqyrtuar dhe janë marrë vendime nga ATP brenda muajt nga momenti i aplikimit nga subjektit i shpronësuar.


2. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE AUDITIMI I SHPENZIMEVE

Një ndër prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2022 -2024 është përcaktuar “Mirëplanifikim i shpenzimeve dhe mirëadministrimi i të ardhurave me qëllim mbështetjen e një rritje ekonomike të shpejtë dhe të qëndrueshme”⁸.

Shpenzimet totale përfaqësojnë pagesat e pakthyeshme të qeverisë për blerjen e mallrave, shërbimeve, për transfertat dhe pagesat e interesave, për realizimin e funksioneve të shtetit.

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore, në tërësi dhe për zëra të veçantë, ka ndjekur trendin e ndryshimeve të të ardhurave gjatë vitit 2022. Kështu, sipas ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, shpenzimet buxhetore janë miratuar 637,694 milion lekë; me AN nr.3, datë 12.3.2022 shpenzimet gjithsej kanë ndryshuar në rritje 647,694 milion lekë; me AN nr.12, datë 29.07.2022 janë miratuar 660,694 milion lekë; me AN nr.17, datë 01.12.2022 janë miratuar 665,694 milion lekë; dhe ndryshimi i fundit është miratuar me AN nr.19, datë 29.12.2022, në të cilin përfundimisht totali i shpenzimeve për këtë vit buxhetor është planifikuar 667,178 milion lekë, pra janë rritur në krahasim me ligjin fillestar me 28,000 milion lekë ose 4.6 %.

Grafiku 9 Planifikimi gjatë vitit i të ardhurave dhe shpenzimeve



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Ndryshimet substanciale gjatë vitit të shpenzimeve publike tregojnë se planifikimi buxhetor në përgjithësi dhe ai i shpenzimeve në veçanti, nuk ka qenë i duhuri, si dhe nuk ka pasur një përqendrim të kapaciteteve të stafit të MFE dhe institucioneve të tjera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për të pasur një nivel të lartë saktësie gjatë këtij procesi.

MFE, në pasqyrën e treguesve të buxhetit të konsoliduar ka vijuar dhe këtë vit të paraqesë dhe një kolonë me të dhëna, të emërtuar “Plani me ndryshime 2022 (shpërndarje rezervash)”, në të cilin rritet plani i shpenzimeve korrente për 20,632 milion lekë (duke ulur planin e shpenzimeve për nën-zërin për personelin, si dhe duke rritur nën-zërat për shpenzime operative, për fondet speciale, si dhe subvencionet), si dhe zvogëlohet po me këtë vlerë “Fondi rezervë dhe kontigjenca”. Një veprimi i tillë i MFE, para së gjithash është ndryshim i planit të shpenzimeve buxhetore pas miratimit të buxhetit të rishikuar në kuvend, duke marrë atributet e ligjvënësit, dhe në të njëjtën kohë e bën kompleks shqyrtimin dhe analizën e ecurisë së treguesve dhe klasifikimit e planifikimit të tyre, duke e shndërruar atë në një veprim për të rregulluar përqindjet e realizimit të disa prej treguesve të shpenzimeve.

Nga auditimi në MFE janë evidentuar ndryshime në buxhetin e planifikuar të ministrive për vitin 2022 sipas PBA-së 2022-2024 dhe PBA-së 2021-2023, me rritjen më të lartë në planifikim rezulton për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me vlerën 2,577 milion lekë, dhe me rënien më të madhe rezulton Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

⁸ PBA 2022-2024 faza III, faqe 50

Tabela 10 Ndryshimet në planin e shpenzimeve dhe realizimi i tyre sipas zërave kryesor

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Ligji i buxhetit	AN nr.3, 12.03.22	AN nr.12, 29.07.22	AN nr.17, 01.12.222	AN nr.19, 29.12.222	Plani me ndryshime	Realizimi
	Shpenzimet gjithsej	637,694	647,694	660,693	665,694	667,178	667,178	651,015
I	Shpenzimet korrente	507,349	501,549	504,802	501,295	498,291	518,923	499,991
1	Personeli	91,590	89,388	88,972	87,036	86,684	85,622	84,696
2	Interesat	50,757	50,757	50,757	44,800	44,680	44,680	39,624
3	Shpenzimet operative	63,241	59,643	63,173	67,479	66,556	73,065	68,504
4	Subvencione	1,550	1,550	1,689	1,689	1,605	1,655	1,650
5	Shpenzimet për fondet speciale	212,271	212,271	212,271	211,271	209,771	221,717	216,515
6	Shpenzimet për buxhetin vendor	60,290	60,290	60,290	61,460	61,460	61,680	58,696
7	Shpenzime të tjera	27,650	27,650	27,650	27,560	27,535	30,504	30,306
II	Fondi rezerve	2,900	8,650	15,450	13,720	20,840	208	-
III	Shpenzime kapitale	119,445	109,496	112,441	122,678	120,047	120,047	112,117
IV	Të tjera	8,000	28,000	28,000	28,000	28,000	28,000	27,907
V	Fondi i shpronësimeve							11,000

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit faktik 2022 të përgatitur nga MFE, shpenzimet publike gjithsej në vitin 2022 janë realizuar 651,015 milion lekë ose 98 %, me një mosrealizim prej 16,163 milion lekë, referuar buxhetit të rishikuar, si dhe në krahasim me vitin 2021 janë shpenzuar më shumë 55,047 milion lekë ose + 9 %.

Shpenzimet gjithsej për vitin 2022 përbëjnë 30.5 % të PBB, përqindje e cila përbën nivelin më të ulët të tre viteve të fundit, pavarësisht vlerës më të lartë të tyre për këtë vit.

Tabela 11 Plani dhe realizimi i shpenzimeve gjithsej dhe sipas zërave kryesor të buxhetit 2022


Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	AN nr.19 29.12.2022	Fakti 2022	% realizimit ndaj AN	Diferencat ndaj AN	Diferencat ndaj 2021
I.	Totali i shpenzimeve	595,968	667,178	651,015	98	-16,163	55,047
a	Shpenzime korrente	461,075	498,291	499,991	100	1,700	+ 38,916
b	Shpenzime kapitale	127,723	120,047	112,117	93	-7,931	- 15,606
c	Transferime kapitale	3,709	0	0		0	0
d	Të tjera	0	28,000	27,907	100	-93	+ 27,907
e	Fondi Rezervë, Kontigjenca	461	20,840	-		-20,840	0
f	Fondi i shpronësimeve	3,000	-	11,000		+ 11,000	+ 8,000

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Referuar të dhënave të treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar, rezulton se në strukturën e shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2022, shpenzimet korrente përbëjnë 77 %, duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin e kaluar 2021, shpenzimet kapitale 17 %, të tjera shpenzime 4 % dhe 2 % fondi i shpenzuar për shpronësimet.

Grafiku 10 Struktura e shpenzimeve publike gjithsej, sipas treguesve të buxhetit të konsoliduar, 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH


Megjithëse shpenzimet gjithsej nuk janë realizuar për 16,163 milion lekë, shpenzimet korrente janë tejkaluar për 1,700 milion lekë dhe 8 % më shumë se viti 2021; shpenzimet kapitale (përfshirë dhe shpenzimet për rindërtimin) nuk janë realizuar për 7,931 milion lekë, ose realizuar në masën 88 % e vlerës së shpenzimeve kapitale të vitit të kaluar; ndërsa shpenzimet e tjera nuk janë realizuar për 93 milion lekë, ndonëse nuk ka pasur zë shpenzimesh “Të tjera” në vitin 2021. Gjithashtu, nuk është shpenzuar kontigjenca për risqet e borxhit dhe janë shpenzuar për shpronësimet 11,000 milion lekë të paplanifikuara në buxhet, krahasuar me 3,000 milion lekë të një viti më parë.

Struktura e shpenzimeve në vitin 2022 ka ndryshuar duke e krahasuar me vitin 2021, pasi kanë njohur rritje të konsiderueshme shpenzimet korrente, fondi i shpronësimeve dhe zëri të tjera (Hua e dhënë për energjinë dhe Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik) përkatësisht me + 38,916 milion lekë, + 8,000 milion lekë dhe + 27,907 milion lekë. Ndërsa shpenzimet kapitale dhe fondi i rindërtimit kanë pësuar rënie përkatësisht në nivelin - 14,960 milion lekë dhe - 647 milion lekë.

Bazuar në sa më sipër, vërehet tendenca rënies së shpenzimeve kapitale, duke qenë në kahe të kundërt me synimin e qeverisë të paraqitur në Relacionin mbi Projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022” se: “Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2022-2024 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në procesin e rindërtimit, si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike”.

Referuar nivelit të shpenzimeve kapitale të kryera në vitin 2022 të cilat janë në vlerën 83,243 milion lekë (pa përfshirë fondet e rindërtimit), nuk janë brenda kuadrit të parametrave fiskale të synuara nga qeveria⁹ për të ruajtur një raport të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) targetohen të jenë rreth 5 % e PBB në çdo vit buxhetor pasi në fakt rezultojnë 3.9 %.

Grafiku 11 Shpenzimet publike sipas strukturës faktike për vitin 2021 dhe 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga shqyrtimi i ecurisë së kryerjes së shpenzimeve publike, në nivelin më të ulët rezultojnë në muajin janar dhe në nivelin më të lartë në muajin dhjetor me 21 % të totalit, ose vetëm 40 % shpenzimeve kryhen në 6-mujorin e parë, dhe pjesa e tjetër kryesisht në fund të vitit. Meqenëse shpenzimet korrente janë përgjithësisht të njëtrajtshme, konstatohet se përqendrimi i shpenzimeve në fund të vitit ka të bëjë kryesisht me investimet publike, duke komprometuar përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore për shpenzime kapitale.

⁹ Relacioni mbi Projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, faqe 15

Gjithashtu, ky fenomen i përsëritur dhe i kushtëzuar në masën më të madhe nga mungesa e realizimit të njëtrajtshëm të investimeve, krijon luhatje gjatë vitit në treguesit e likuiditetit me ndikim në normat e interesit në tregun e brendshëm financiar.

Nga auditimi në MFE, ka rezultuar se nga përgatitja me vonesë e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike, si pjesë përbërëse e kalendarit të planifikimit strategjik, nuk ka qenë efektiv në ditën e parë të vitit 2022, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, janë kryer 2956 rishikime buxhetore me pasojë ndryshime për 25508, me numrin më të lartë rishikimeve prej 26% në muajin dhjetor, duke theksuar se kërkesat për rishikime nisin sapo ka përfunduar procesi i detajimit fillestar buxhetor në nivel njësite ekonomike (muaji shkurt); janë kryer 763 rishikime buxhetore pas datës 15 nëntor të vitit 2022, nga të cilët 266 janë në periudhën janar-mars 2023 për llogari të vitit 2022.

Nga procedurat analitike mbi bazën e të dhënave të pagesave, janë konstatuar gjithsej 9349 transaksione pagesash në vitin 2022 në shumën totale 16,809 milion lekë të cilat i përkasin faturave me datë të viteve buxhetore të mëparshme, duke ndikuar në pasqyrimin e pa saktë të shpenzimeve të realizuara që i përkasin vitit fiskal 2022.


2.1. Shpenzimet korrente

Shpenzimet korrente në vitin 2022 janë planifikuar me buxhetin e rishikuar në vlerën prej 498,291 milion lekë dhe janë realizuar 499,991 milion lekë, ose 1,700 milion lekë mbi planifikimin, si dhe përbëjnë 77 % të shpenzimeve publike gjithsej. Krahasuar me vitin 2021 niveli i shpenzimeve korrente është 8 % më i lartë.

Shpenzimet korrente përbëjnë 23.4 % të PBB.

Duhet theksuar, se shpenzimet korrente gjithsej kanë pësuar ndryshime të theksuara në planifikim gjatë vitit 2022 me akte normative dhe nga MFE me planin e ndryshuar (me shpërndarje rezerve), me ulje dhe ngritje të konsiderueshme referuar ligjit të buxhetit të këtij viti.

Grafiku 12 Ndryshimet e planit të shpenzimeve korrente gjatë vitit 2022




Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga shqyrtimi i ecurisë mujore të shpenzimeve korrente konstatohet se rreth 45 % e tyre shpenzohen në 6 mujorin e parë dhe pjesa e tjetër, në 6-mujorin e dytë, duke arritur maksimumin mujor në dhjetor me 15 % të shpenzimeve vjetore.

Struktura faktike e përbërjes së shpenzimeve korrente për vitin 2022 është sipas grafikut të mëposhtëm.

Grafiku 13 Struktura faktike e shpenzimeve korrente për vitin 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Shpenzimet për fonde speciale përbëjnë 43% të shpenzimeve korrente, shpenzimet e personelit 17%, shpenzimet operative mirëmbajtje 14%, shpenzimet për buxhetin vendor 12% dhe shpenzimet e tjera sociale 6 %.

Referuar Raportit të MFE mbi zbatimin e buxhetit vjetor 2022, lidhur me treguesit kryesor të performancës sipas ministrive të linjës, për shpenzimet korrente gjithsej, rezulton se ka pasur ndryshime në planifikim gjatë vitit, të cilat në total janë rritur me 18,571 milion lekë, ndërkohë që për 4 institucione (Turizmi dhe mjedisi, Drejtësia, Mbrojtja dhe Politika e jashtme) kanë pësuar ulje të planit gjithsej të këtyre shpenzimeve.

Ndryshimet e bëra gjatë vitit për shpenzimet korrente gjithsej në ulje për 4 institucione dhe niveli i ulët i realizimit të tyre, shfaqin dhe një herë mungesën e aftësive të administratës së tyre në planifikim dhe realizim, si dhe mungesën e bashkëpunimit dhe monitorimit nga ana e MFE për ecurinë e shpenzimeve publike.

Tabela 12 Shpenzimet korrente gjithsej sipas ministrive 2022

Nr.	Institucionet	Plan fillestar	Plan i rishikuar përfundimtar	Diferenca + ose -	Realizimi	% realizimit	% ministri
1	Shëndetësia dhe mbrojtja sociale	74,750,068	75,120,016	369,948	74,604,871	99	28
2	Arsimi	41,207,347	45,120,467	3,913,120	41,884,959	93	16
3	Bujqësia dhe zhvillimi rural	6,807,274	8,621,430	1,814,156	8,536,755	99	3
4	Infrastruktura dhe Energjia	5,153,656	7,809,742	2,656,086	7,779,201	100	3
5	Turizmi dhe Mjedisi	1,368,720	1,288,039	(80,681)	1,200,535	93	0
6	Drejtësia	10,593,432	7,982,140	(2,611,292)	7,813,563	98	3
7	Institucionet e sistemit te Drejtësisë	712,656	682,053	(30,603)	669,821	98	0
8	Financat, Ekonomia, Punësimi dhe arsimi profesio	62,389,730	75,006,992	12,617,262	73,867,667	98	28
9	Mbrojtja	22,393,305	20,820,938	(1,572,367)	20,118,488	97	8
10	Kultura	1,889,760	2,777,241	887,481	2,666,756	96	1
11	Rendi dhe siguria publike	19,841,110	20,726,804	885,694	20,585,227	99	8
12	Politika e jashtme	2,948,363	2,670,697	(277,666)	2,342,360	88	1

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Me përjashtim të infrastrukturës dhe energjisë që i ka realizuar shpenzimet korrente gjithsej, të gjitha institucionet e tjera nuk i kanë realizuar dhe niveli më i ulët i realizimit të shpenzimeve rezulton në arsim dhe në turizëm e mjedis me 93%. Duhet theksuar se, është shëndetësia dhe mbrojtja sociale së bashku me financat dhe ekonominë që kanë përqindjen më lartë të shpenzimeve ndaj institucioneve të tjera me nga 28% (pra 56%), si dhe arsimi me 16%.

Shpenzimet për personelin përbëhen nga paga, kontributi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, fondi i veçantë i pagave, politika të reja pagash, si dhe shpenzimet për arsimin e lartë nga të ardhurat e veta.

Ato përbëjnë 17 % të shpenzimeve korrente për vitin 2022.

Tabela 13 Shpenzimet për personelin me nënzërat përkatës 2022

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2022 (AN nr.19)	Diferenca	% realizimit	Diferenca
1	Personeli	83,268	84,696	86,684	- 1,989	98	1,428
a	Paga	71,179	72,103	72,568	- 464	99	924
b	Kontributet shoqërore	11,402	11,784	11,817	- 33	100	382
c	Fondi i veçantë i pagave	0	0	300	- 300	0	0
d	Politika të reja pagash	0	0	1,200	- 1,200	0	0
e	Arsimi i lartë të ardhurat e veta	686	808	800	8	101	122

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga pasqyra e mësipërme rezulton se shpenzimet për personelin janë realizuar 98 %, nga 86,684 milion lekë të planifikuara janë kryer 84,696 milion lekë, si dhe 1,428 milion lekë më shumë se në vitin 2021 (+1.7%). Në nivelin e mosrealizimit kanë ndikuar mungesa e shpenzimeve për politika të reja pagash për - 1,200 milion lekë dhe mungesa e shpenzimit të fondit të veçantë për - 300 milion lekë, si dhe - 464 milion lekë në shpenzimet për pagat.

Shpenzimet faktike për paga përbëjnë 85 % të shpenzimeve të personelit dhe kanë pësuar ndryshime të dukshme në planifikim: duke filluar me 75,630 milion lekë në ligjin e buxhetit dhe duke përfunduar me 72,103 milion lekë me planin e ndryshuar të MFE (me shpërndarje rezervash), pra me një diferencë prej - 3,527 milion lekë. Për më tepër ndryshimet kanë ndodhur duke filluar në muajin shkurt me ulje, pra dy muaj pas miratimit të buxhetit, por ndryshime ka dhe brenda muajit dhjetor nga data 1 në datën 29 duke u ulur me 288 milion lekë.

Edhe me planin e shpenzimeve për kontributet shoqërore ka ndodhur ndryshime të këtij treguesi, ku nga 12,460 milion lekë në ligjin e buxhetit kanë ndryshuar në ulje deri në AN nr.19, datë 29.12.2022 në 11,817 milion lekë, dhe barazuar me realizimin 11,784 milion lekë në planin e ndryshuar (me shpërndarje rezervash) të MFE.

Referuar tabelës mbi numrin e punonjësve sipas ministrive dhe institucioneve, që shoqëron Raportin e përgatitur nga MFE mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2022, konstatohet se për 744 njësi të qeverisjes qendrore kanë qenë planifikuar 83 005 punonjës dhe janë realizuar 76 936 gjithsej, pra 93 %. Krahasimi i nivelit të shpenzimeve për paga dhe të atyre për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me nivelin e realizimit të numrit të punonjësve të ministrive dhe institucioneve qendrore shfaq mangësi të planifikimit nga ana e MFE, pasi shpenzimet për 93% të numrit të punonjësve publikë realizohen pothuajse 100% sipas findit të planifikuar të pagave, shtu këtu dhe faktin që megjithëse planifikohen shpenzime për fond të veçantë dhe politika të reja pagash dhe ka dy vjet që faktikisht nuk kryhen shpenzime në këto drejtime.

Një fenomen i tillë tregon se, krahas të tjerave, MFE dhe njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk bashkëpunojnë sa dhe si duhet me DAP për plotësimin e vendeve të punës, me pasojë në performancën institucionale në ofrimin e shërbimeve.

Shpenzimet për interesat kanë qenë planifikuar 44,680 milion lekë dhe janë realizuar 39,624 milion lekë, 89 %, me një diferencë prej 5,056 milion lekë, kjo kryesisht në interesa të huaja, pasi interesat e brendshme janë realizuar pothuajse 100 %: nga 24,243 milion lekë të planifikuara në 24,210 milion lekë të realizuara. Nga auditimi në MFE ka rezultuar se,

krahasuar me vitin 2021, këto shpenzime janë realizuar më shumë për vlerën 3,802 milion lekë, ose rreth 10.6% më shumë. Shpenzimet për interesa përbëhen nga interesa të brendshme në masën 61%, ose 24,210 milion lekë dhe interesa të huaja në masën 39%, ose 15,414 milion lekë.

Duhet theksuar se në përbërje të shpenzimeve për interesa përfshihet dhe kontigjenca për risqet e borxhit, për të cilën ka vite që nuk shpenzohet, megjithëse ka qenë e planifikuar 4,800 milion lekë.

Shpenzimet operative mirëmbajtje janë realizuar 103 %: nga 66,556 milion lekë të planifikuara janë kryer 68,504 milion lekë ose me një tejkalim prej + 1,948 milion lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë kryer 15 % më shumë shpenzime operative mirëmbajtje ose + 9,140 milion lekë. Këto shpenzime zënë 10 % të shpenzimeve gjithsej të planifikuara me AN nr.19 datë 29.12.2022 dhe 10.5% të shpenzimeve të realizuara. Nga krahasimi i përqindjes që zënë shpenzimet operative të mirëmbajtjes në totalin e shpenzimeve në vitin 2022 në krahasim me 2021, rezulton tendenca e rritjes së këtyre shpenzimeve nga 10 % në 10.5 %, duke reflektuar prirjen e rritjes së këtyre shpenzimeve.

Duhet theksuar se, 26 % e shpenzimeve operative të mirëmbajtjes janë kryer në muajin dhjetor 2022, duke shfaqur përqendrim të këtyre shpenzimeve në fund të vitit dhe me mungesë monitorimi, me pasoja në komprometimin e eficiencës, efektivitetit dhe ekonomikitetit në përdorimin e fondeve publike.

Subvencionet janë realizuar në vlerën 1,650 milion lekë, nga 1,605 milion lekë të planifikuara, pra + 45 milion lekë, ose 103 %. Në krahasim me vitin 2021 rezultojnë 16 % më shumë subvencione ose + 229 milion lekë. Nga auditimi në MFE konstatohet se AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM apo shkresa të tjera për shpenzimet për subvencionet, pasi plani përfundimtar për këtë zë rezulton të jetë në vlerën 1,655 milion lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet e subvencionit janë realizuar në masën 99.7%, ose realizuar më pak për vlerën 5 milion lekë.

Shpenzime të tjera sociale janë realizuar 110 % ose + 2,771 milion lekë më shumë se planifikimi: kanë qenë planifikuar 27,535 milion lekë dhe janë realizuar 30,306 lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë kryer 4 % më shumë shpenzime ose + 1,157 milion lekë.

Ato zënë 4 % të shpenzimeve gjithsej të planifikuara dhe 5 % të shpenzimeve të realizuara.

Tabela 14 Shpenzime të tjera sociale 2022

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	Fakti 2022	Plani 2022	Diferenca	% realizimit	Diferenca
1	Shpenzime të tjera sociale	29,149	30,306	27,535	2,771	110	1,157
<i>a</i>	<i>Pagesa e Papunësisë</i>	952	746	735	11	101	-206
<i>b</i>	<i>Ndihma Ekonomike</i>	23,981	25,464	23,600	1,864	108	1,483
<i>c</i>	<i>Kompensim për ish-të përndjekurit politik</i>	913	996	1,000	-4	100	83
<i>d</i>	<i>Bonusi i lindjeve</i>	3,303	3,100	2,200	900	141	-203

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga katër nënzërat që përbëjnë shpenzimet e tjera sociale, rezultojnë me tejkalim të ndjeshëm ndihma e ekonomike dhe bonusi i lindjeve, ndonëse ky i fundit është më i ulët se viti 2021, sëbashku me pagesën e papunësisë.

Nga auditimi në MFE konstatohet se AN nr. 19, datë 29.12.2022 nuk reflekton ndryshimet e planit të ndodhura gjatë vitit me VKM apo shkresa të tjera për shpenzimet për shpenzimet e tjera sociale pasi plani përfundimtar për këtë zë rezulton të jetë në vlerën 30,504 milion

lekë. Për sa më sipër kundrejt planit përfundimtar, shpenzimet e tjera sociale janë realizuar në masën 99 %, ose me një mosrealizim për vlerën 198 milion lekë.

Nga auditimi në MFE konstatohet se vlera e detyrimit të mbetur për ish të përndjekurit politik deri në fund të viti 2022 është 29,882 milion lekë. Nëse buxheti dhe çelja e fondit për ish të përndjekurit do të vazhdojë me këtë ritëm apo të ulet më tej, ky detyrim do të mund të shlyhet mesatarisht pas rreth 30 vitesh.

Megjithëse në vitin 2022 shpenzimet për pagesën e papunësisë kanë rënë 22 % krahasuar me vitin 2021, referuar të dhënave të INSTAT niveli i papunësisë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 ka rënë me vetëm 2 %, çka nuk reflekton përkujdesjen ekonomike për këtë shtresë të popullsisë.

Megjithëse në vitin 2022 në krahasim me vitin e kaluar ka një rënie të shpenzimeve për bonusin e lindjeve me 6 %, referuar të dhënave të INSTAT për numrin e lindjeve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, rezulton se ka një rënie prej 9 %, gjë që tregon se mund të mos kryhen në kohë këto shpenzime.

2.1.1 Shpenzimet për fondet speciale

Referuar Raporti të MFE mbi zbatimin e buxhetit 2022 rezulton se shpenzimet për fondet speciale janë realizuar 216,515 milion lekë nga 209,771 milion lekë të planifikuara ose 103%, pra me + 6,744 milion lekë më shumë se buxheti përfundimtar i rishikuar me AN nr.19, datë 29.12.2022. Këto shpenzime përbëjnë 33 % të shpenzimeve publike gjithsej, në të njëjtën nivel me vitin e kaluar 2021, ndonëse janë shpenzuar më shumë + 17,058 milion lekë ose 8 % më shumë.

Shpenzimet për fondet speciale përbëjnë 10.1 % të PBB, me një ulje të lehtë prej 0.5 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021

Shpenzime për fondet speciale përfshijnë shpenzimet për sigurime shoqërore, për politika të reja pensionesh, për bonusin e pensionistëve, shpenzimet për sigurimet shëndetësore, si dhe ato për kompensimin e pronarëve, vlera e të cilëve jepet në pasqyrën e mëposhtme.

Tabela nr.15 Shpenzimet për fondet speciale 2022

<i>Në milion lekë</i>								
Nr.	Emërtimi	Fakt 2021	Fakt 2022	Plani vjetor	Dif.	% Realizimit	Dif	Plani
I	Shpenzime për fonde speciale	199,457	216,515	209,771	6,744	103%	17,058	221,717
a	Sigurime Shoqërore	148,030	163,037	148,135	14,902	110%	15,007	166,881
b	Politika të reja pensionesh	0	0	3,300	-3,300	0%	0	0
c	Bonusi i pensionistëve	0	0	3,500	-3,500	0%	0	0
d	Sigurime Shëndetësore	49,130	52,244	52,836	-592	99%	3,114	52,836
e	Shpenzim për kompensim pronarësh	2,297	1,234	2,000	-766	62%	-1,063	2,000

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Në shpenzimet për fondet speciale në pjesën më të madhe përbëhen nga shpenzimet për sigurimet shoqërore 75%, për sigurimet shëndetësore 24% dhe rreth 1% shpenzime për kompensim pronarësh.

Pavarësisht se politikat e reja të pensioneve dhe bonusi i pensionistëve, nga MFE në Raportin e treguesve të buxhetit të konsoliduar janë paraqitur me realizim zero, nga auditimi në ISSH, rezulton se janë përfshirë në shifrën e realizimit në total, pra nuk janë detajuar në tabelën raportuese.

Shpenzimet për sigurime shoqërore sipas Raportit të MFE përbëjnë 75 % të shpenzimeve për fondet speciale dhe për vitin 2022 janë realizuar 105 %: nga 154,935 milion lekë të

planifikuara (përfshirë politikat e reja të pensioneve dhe bonusin), janë kryer shpenzime për 163,037 milion lekë, me një shtesë prej + 8,102 milion lekë, si dhe 15,007 milion lekë më shumë se në vitin 2021. Këto shpenzime përbëjnë 7.64 % PBB.

Shpenzimet faktike për sigurimet shoqërore përfaqësojnë 25% të shpenzimeve publike gjithsej, pothuajse në të njëjtin nivel përqindjeje me ato të vitit 2021.

Duke analizuar ecurinë mujore të kryerjes së këtyre shpenzimeve rezulton se në muajin dhjetor janë paguar 15 % e shpenzimeve vjetore për përfitimet nga sigurimet shoqërore.

Në lidhje me planifikimin, sipas Raportit të MFE për zbatimin e buxhetit, plani me ndryshime 2022 (shpërndarje rezervash) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore është 166,881 milion lekë, duke ja kaluar shpenzimet për politika të reja pensionesh dhe bonusin e pensionistëve tek shpenzimet për sigurime shoqërore. Pra nga 154,935 milion lekë sipas ligjit të buxhetit me ndryshime në AN (përfshirë nënzërat a, b dhe c), sipas MFE plani i shpenzimeve për sigurime shoqërore për vitin 2022 bëhet 166,881 milion lekë ose +11,946 milion lekë më shumë të shpërndara në planifikim, për të cilat nuk janë të miratuara në buxhetin e shtetit me ndryshime.

Trajtimi i planifikimit të zërave të buxhetit në këtë mënyrë nga ana e MFE, sjellë komplikime në analizat e mundshme për planifikimin dhe realizimin e buxhetit për sigurimet shoqërore.

Nga auditimi i kryer në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH), rezulton se plani i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore është referuar për shumën 166,881 milionë lekë, pasi këtu janë përfshirë dhe katër VKM për financimin e programeve të veçanta në shumën 11,946 milionë lekë, që fillojnë në mars 2022 dhe përfundojnë me 29.12.2022, të destinuar për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë (referuar nenit 11 të ligjit të buxhetit të ndryshuar, duke i konsideruar si shpenzime nga kontingjenca për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës), për indeksimin e pensioneve (nga paketa e rezistencës), mbështetje financiare të menjëhershme të pensionistëve për zbutjen e impaktit të krizës etj. Tre nga katër VKM kanë burim financimi fondin rezervë të Këshillit të Ministrave për vlerën 6,341 milion lekë, ndërsa i fundit është mbështetje buxhetore nga Ministria e Linjës (MFE) në vlerën 5,605 milion lekë.

Nga auditimi në ISSH, rezulton se shpenzimet në fakt gjithsej janë 163,037 milion lekë, nga të cilat 62,872 milion lekë financim i planifikuar dhe tërhequr nga buxheti i shtetit 57,380 milion lekë, i cili përbën 35 % të shpenzimeve gjithsej. Ndërsa pjesa e tjetër shpenzimeve prej 105,657 milion lekë e ka burimin e financimit nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të tjera në masën 65%. Në krahasim me vitin 2021 konstatohet një rritje e shpenzimeve gjithsej prej 10 %, por që shoqërohet dhe me rritjen e financimit nga buxheti i shtetit me 4,978 milion lekë ose me 9 % rritje. Pra, raporti i burimit të shpenzimeve të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore ndaj mbështetjes buxhetore për skemën e sigurimeve shoqërore në vitin 2022 është 65:35.

Sipas të dhënave të auditimit në ISSH, shpenzimet e sigurimeve shoqërore për buxhetet familjare e individët janë realizuar 97.8 %, me një kursim në shpenzime prej 3,647 milion lekë, kjo në pjesën më të madhe është nga shpenzimet për programe të veçanta shtetërore (- 1,691 milion lekë) dhe nga shpenzimet për programe e skema suplementare (- 1,098 milion lekë). Nuk janë realizuar as shpenzimet për përfitime për - 857 milion lekë, e gjitha pothuajse në totalin e pensioneve, por që tejkalohen shpenzimet për kompensim për paaftësi të përkohshme për shkak të sëmundjeve me 51 milion lekë.

Financimi i buxhetit të shtetit shërben për mbulimin e shpenzimeve të disa skemave të pensioneve nëpërmjet granteve dhe për mbulimin e deficitit të skemës së pensioneve. Për mbulimin e deficitit të skemës së pensioneve për vitin 2022 janë akorduar 34,241 milion lekë ose 667 milion lekë më shumë se një vit më parë (+2 %). Pjesa e tjetër 28,631 lekë janë financime nga buxheti për kontribute të ndryshme, për pagesa të posaçme, si dhe për trajtime të veçanta, të cilët kanë rritje në krahasim me vitin 2021, me përjashtim të buxhetit për kontributet e sigurimeve shoqërore për kategori të ndryshme e cila ka rënie me 514 milion lekë.

Financimet buxhetore për kontributin e sigurimeve shoqërore për të papunët janë rritur me 55 milion lekë ose 6 % në krahasim me vitin 2021, në një kohë që në një farë mënyre konteston rënien e papunësisë me 0.8 pikë përqindje të cilësuar nga MFE në Raportin e zbatimit të buxhetit të vitit 2022¹⁰.

Nga analiza e treguesve të sistemit të sigurimeve shoqërore rezulton se shpenzimet në rritje përgjatë vitit 2022 janë të larta dhe pritet edhe në vitet në vijim për shkak të trendit rritës të: numrit të pensioneve me 1.9%, kohës mesatare të gëzimit të pensionit e rritur me 2.2 % dhe treguesit të varësisë së sistemit i rritur me 1.3 % (nga 1.15 kontribues për çdo përfitues në 2021, në vitin 2022 duheshin 1.17 kontribues), për shkak se rritja e numrit të përfituesve (1.9%) është më e lartë se rritja e numrit të kontribuuesve (1.3%), të ndikuara dhe nga faktorët demografikë të popullsisë së vendit tonë, duke e goditur qëndrueshmërinë financiare në perspektivën e afërt dhe të largët të skemës së sigurimeve shoqërore.

Pra qëndrueshmëria sociale dhe financiare e sistemit të pensioneve mbetet e pambrojtur, pasi vijon të vuajë nga një deficit i lartë që e bën atë financiarisht të kushtueshme për buxhetin e shtetit. Për më tepër që, vlerësimet për projeksionet e popullsisë për të ardhmen tregojnë se numri i njerëzve në moshë madhore do të rritet gjithnjë e më shumë krahasuar me një rënie më të madhe të numrit të atyre në moshë të re, çka do të thotë më pak burime financiare nga kontributet në skemë, dhe nga ana tjetër më shumë përfitues të pensionit, pa marrë në konsideratë nevojën dhe domosdoshmërinë e rritjes së përfitimeve nga skema e sigurimeve shoqërore në vendin tonë.

Shpenzimet për sigurimet shëndetësore në vitin 2022 janë realizuar 52,244 milion lekë në krahasim me 52,836 milion lekë të planifikuara, ose 99 %, me një mos realizim prej 592 milion lekë, përbëjnë rreth $\frac{1}{4}$ e shpenzimeve për fondet speciale të këtij viti, si dhe përfaqësojnë afër 2.5 % të PBB.

Shpenzimet faktike për sigurimet shëndetësore përfaqësojnë 8% të shpenzimeve gjithsej duke qëndruar në të njëjtin nivel përqindjeje me vitin e kaluar 2021.

Në krahasim me vitin 2021 janë shpenzuar 3,114 milion lekë më shumë ose + 6%, çka do të thotë se shpenzimet për sigurimet shëndetësore kanë ritëm më të ngadaltë rritjeje se ato për sigurimet shoqërore (9%).

Nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), rezulton se buxheti vjetor është planifikuar 4% më i lartë se në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2022-2024, kryesisht në shpenzimet për shëndetin parësor dhe shërbimin spitalor.

Po ashtu, buxheti vjetor prej 52,836 milion lekë ka ndryshuar strukturën me akte normative duke rritur kontributin e sigurimeve shëndetësore nga 14,985 milion lekë në 16,030 milion

¹⁰ Raport "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022", faqe 9

lekë (+ 1,045 milion lekë), si dhe duke zvogëluar po me këtë vlerë financimet e buxhetit: nga 37,851 milion lekë në 36,806 milion lekë. Pra shpenzimet e planifikuara për sigurimet shëndetësore në masën 30 % kanë burim financimi kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe 70% nga buxheti i shtetit.

Struktura e shpenzimeve të planifikuara për FSDKSH përbëhen nga ato të shërbimit spitalor në vlerën 29,466 milion lekë ose 56 % të totalit, për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve 11,820 milion lekë ose përfaqësojnë 22 %, për kujdesin shëndetësor parësor 10,470 milion lekë ose 20%, si dhe 2 % janë për shpenzime administrative dhe investime, përkatësisht: 1,070 milion lekë dhe 10 milion lekë.

Tabela 16 Shpenzimet për sigurimet shëndetësore 2022

					<i>Në milion lekë</i>	
Nr.	Emërtimi	Plani	Fakti	Diferenca në vlerë	Realizimi në %	
I.	Shpenzimet gjithsej	52,836	52,244	- 592	99	
<i>a</i>	<i>Financime për shërbimin spitalor</i>	<i>29,466</i>	<i>29,152</i>	<i>- 314</i>	<i>99</i>	
<i>b</i>	<i>Rimbursimi i barnave e pajisjeve</i>	<i>11,820</i>	<i>11,808</i>	<i>- 12</i>	<i>100</i>	
<i>c</i>	<i>Shpenzime për kujdesin shëndetësor parësor</i>	<i>10,470</i>	<i>10,398</i>	<i>- 72</i>	<i>99</i>	
<i>d</i>	<i>Shpenzimet administrative</i>	<i>1,070</i>	<i>882</i>	<i>- 188</i>	<i>83</i>	
<i>e</i>	<i>Investime</i>	<i>10</i>	<i>4</i>	<i>- 6</i>	<i>38</i>	

Burimi: Të dhëna të FSDKSH të përpunuara nga KLSH

Nga auditimi në FSDKSH ka rezultuar se, *financimi për shërbimin spitalor* ka qenë planifikuar 29,466 milion lekë për shpenzime për paga, sigurime, mallra e shërbime, buxhetimin e paketave shëndetësore dhe buxhetimin për spitalet Fier dhe Durrës, i cili është realizuar 29,152 milion lekë, me një rritje prej 1,282 milion lekë në krahasim me vitin 2021. Brenda këtij zëri konstatohet se janë realizuar 100% financimi për spitalet publike, koncesioni i sterilizimit, si dhe ai i dializës, ndërsa kanë mosrealizim të theksuar shpenzimet për trajtimin e pacientit me VKM dhe bonusi për mjekët dhe specialistët.

Duhet theksuar se në strukturën e shpenzimeve për financimin e shërbimit spitalor vërehet një rritje e shpenzimeve për koncesionin e sterilizimit dhe të dializës së bashku, pasi nga 8 % në vitin 2021 arrin në 9% në 2022, ose me një rritje prej 255 milion lekë për dy koncesionet së bashku, në kushtet e ruajtjes së tavanit buxhetor vjetor prej 1,700 milion lekë (shpenzuar në fakt 1,699 milion lekë) për sterilizimin dhe 835 milion lekë (shpenzuar në fakt 804 milion lekë) për dializën.

Nga auditimi në FSDKSH rezulton se pagesat për sterilizimin në vitin 2022 janë rritur me 199 milion lekë krahasuar me vitin 2021 ose 13 % më shumë, megjithëse janë realizuar 61 230 ndërhyrje, të cilat janë 10 % më shumë, pasi ka ndryshim të strukturës së setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë me rritje 17 % të kompleksitetit të lartë, 3% i mesëm dhe 16% kompleksiteti i ulët.

Nga auditimi në FSDKSH është konstatuar se, koncesionarit të dializës “Dia Vita” SHPK i janë likuiduar faturime për shërbime të pakryera për 8 854 raste në shumën 99 milion lekë pa TVSH.

Pjesë e shpenzimeve të përfshirë në shërbimin spitalor është dhe mbulimi i shpenzimeve të paketave shëndetësore të kostifikuara në spitale publike dhe private, të cilat përfshijnë shërbime për kardiologjinë, kardiokirurgjinë, dializën etj. Nga auditimi konstatohet se për këto shërbime kanë qenë planifikuar 3,075 milion lekë dhe janë shpenzuar në fakt 2,993 milion lekë, nga e cila 51 % në spitalet publike dhe 49 % në spitalet private, dhe që përfaqësojnë përkatësisht 29% dhe 71 % të rasteve gjithsej.

Krahasuar me vitin 2021 ka një rritje të rasteve të këtyre shërbimeve në krahasim me vitin e kaluar prej 3 %, kryesisht në seancat e dializës, të radioterapisë, paketat e kardiologjisë etj.

Shpenzime për rimbursimin e barnave e pajisjeve mjekësore gjithsej janë planifikuar në shumën 11,820 milionë lekë, nga të cilat 11,800 milionë lekë sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 115/2021, ndryshuar me AN nr. 17, datë 01.12.2022, për rimbursim barnave duke përfshirë likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe barnat për Covid-19, si dhe 20 milion lekë janë planifikuar për rimbursim fisha diabeti.

Nga auditimi në FSDKSH rezulton se janë realizuar gjithsej 11,808 milion lekë, nga të cilat rimbursimi i barnave 11,799 milion lekë dhe 9 milion lekë për fishat e diabetit.

Krahasuar me vitin 2021 rezulton se rimbursimi i barnave është rritur me 1,185 milion lekë ose 10%, me rritje të konsiderueshme në barnat spitalore, ndonëse ata përbëjnë 32% të totalit përfshirë dhe barnat e farmacive të rrjetit të hapur.

Konstatohet se në vitin 2022 ka një rritje të vlerës së rimbursimit të recetave prej 4 % si rezultat i rritjes së nivelit të rimbursimit për recetë, duke sjellë për pasojë rritjen me 6% të rimbursimit për pacient.

Shpenzimet për kujdesin shëndetësor parësor në vitin 2022, që janë të destinuara për të financuar aktivitetin e qendrave shëndetësore, si dhe aktivitetin e kontratës koncesionare të kontrollit mjekësor bazë (KMB), paraqiten me realizim në masën 99 %: nga 10,470 milion lekë në planin përfundimtar janë kryer 10,398 milion lekë.

Financimi i KMB është realizuar në vlerën e planifikuar prej 876 milion lekë, pra është ruajtur tavani buxhetor i shpenzimeve për këtë koncesion. Megjithatë, nga auditimi në FSDKSH ka rezultuar se janë likuiduar fatura referuar numrit të projektuar të KMB sipas kontratës dhe jo sipas numrit faktik të kryer, për rrjedhojë është faturuar shërbim i pakryer për 20,172 raste, me një kosto në vlerën 37 milion lekë me TVSH.

Krahasuar me vitin 2021, shpenzimet për kujdesin shëndetësor parësor janë rritur në fakt në total në shumën 648 milion lekë, pothuajse tërësisht për financimin e KMB, pasi në vitin 2021 është ofruar vetëm në periudhën shtator-dhjetor, si rezultat i masave shtrënguese për pandeminë Covid-19.

Shpenzimet administrative nga 1,070 milion lekë janë realizuar 882 milion lekë (83%) ose - 188 milion lekë më pak, përafërsisht në nivelin e realizimit të këtyre shpenzimeve në vitin 2021 prej 878 milion lekë.

Ndërsa *investimet* nga FSDKSH janë realizuar 4 milion lekë nga 10 milion lekë të planifikuara, shumë më pak se realizimi i vitit 2021 prej 18 milion lekë.

Niveli i realizimit të dy treguesve të fundit, tregon për mungesë bashkëpunimi të MFE dhe FSDKSH në hartimin dhe planifikimin buxhetor në funksion të performancës institucionale të saj.

2.1.2 Shpenzime për Buxhetin Vendor


Sipas treguesve të buxhetit të konsoliduar të MFE për vitin 2022, shpenzimet për buxhetin vendor përfundimtar kanë qenë planifikuar 61,460 milion lekë dhe rezultojnë të jenë realizuar 58,696 milion lekë ose 95%, me një mosrealizim prej 2,764 milion lekë. Ky mosrealizim është akoma më i madh në se merret në konsideratë plani me ndryshime (shpërndarje rezervash) përgatitur nga MFE, i cili arrin në - 2,984 milion lekë, pasi është një plan i rritur që shkon në 61,680 milion lekë. Shpenzimet për buxhetin vendor në vitin 2022 përbëjnë 9% të shpenzimeve gjithsej, ndërkohë që të ardhurat përkatëse përbëjnë 4.8 % të të ardhurave të përgjithshme publike, si dhe 2.7 % të PBB, me një rritje të papërfillshme krahasuar me vitin 2021.

Në krahasim me vitin 2021 shpenzimet për buxhetin vendor janë rritur me 6,103 milion lekë ose 12 % më shumë, si dhe përbën nivelin më të lartë në 10 vitet e fundit: janë sa dyfishi i shpenzimeve në vitin 2013.

Në strukturën e shpenzimeve vendore, shpenzimet e personelit zënë 43% të totalit, shpenzimet operative 32%, ato kapitale 20 % etj., të cilët konstatohen se në raport me një vit më parë kanë pësuar rritje. Duhet theksuar se rritja më e madhe vërehet në shpenzimet operative në vlerën prej 3,048 milion lekë ose afër 20%, çka duhet konsideruar si një prirje që nuk është në drejtimin e duhur, për sa kohë që nuk trajtohen me prioritet investimet kapitale, ndryshe nga sa cilësohet në Raportin e MFE për zbatimin e buxhetit të vitit 2022.¹¹

Shpenzimet kapitale vendore rezultojnë në një vlerë prej 11,913 milion lekë, ose 20% të totalit të shpenzimeve, me një rritje prej 631 milion lekë ose rreth 6% kundrejt vitit paraardhës. Duhet të vihet në dukje se, Fondi i Rindërtimit shton kufijtë e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me vendimet përkatëse.

Grafiku 14 Struktura e shpenzimeve faktike vendore sipas klasifikimit ekonomik 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga testimet e kryera mbi pagesat e regjistruara në SIFQ, konstatohet se për vitin 2022, njësitë e qeverisjes vendore kanë paguar 3,410 milion lekë detyrime të prapambetura, nga të cilat 2,396 milion lekë detyrime të prapambetura për shpenzime kapitale. Pagesat për detyrime të prapambetura përbëjnë 5.8% të shpenzimeve totale të realizuara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe 28.6% të shpenzimeve kapitale të realizuara nga këto njësi.

Nga analiza e ecurisë së kryerjes së shpenzimeve konstatohet se, ashtu si edhe tek institucionet qendrore, rreth 17% e shpenzimeve kryhen në muajin dhjetor, duke krijuar vështirësi në lidhje me nivelin e cash-it në fund të vitit, si dhe duke komprometuar përdorimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Shpenzimet faktike të vitit 2022 për buxhetin vendor përbëjnë 2.7 % të PBB, ndërkohë që të ardhurat në buxhet përbëjnë 1.7 % të saj.

Nga auditimi në MFE rezulton se, gjatë vitit 2022, për 11 bashki janë shtuar fondet në shumën 26,684 milion lekë në formën e transfertave të pakushtëzuara për Fondin e rindërtimit. Në këtë rast dhe për të gjitha transfertat e pakushtëzuara, nga ana e MFE janë vendosur limite mbi çeljen dhe përdorimin e saj, si dhe marrja e miratimit nga Nëpunësi i Parë Autorizues për avancimin e limitit tremujor, duke cenuar autonominë e njësive të vetëqeverisjes vendore për përdorimin e të ardhurave nga transfertat e buxhetit të shtetit.

Në fund të vitit 2022, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki dhe qarqe), sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së

¹¹ Raport "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022", faqe 44

Financave dhe Ekonomisë është 5,429 milion lekë, vlerë kjo më e ulët për shumën 1,154 milion lekë krahasuar me vitin 2021.

Nivelin më të lartë të detyrimeve të prapambetura e ka bashkia Tiranë me 1,180 milion lekë, e ndjekur nga bashkia Kavajë me 837 milion lekë, bashkia Vorë me 413 milion lekë etj., si dhe tek qarqet është ai i Durrësit me 51 milion lekë etj.

Vlera më e lartë i detyrimeve të prapambetura i përket zërit “Investime” me 44 %, “Të tjera” me 28%, “Shërbime” me 11% etj.

Nga auditimi i kryer në MFE, sipas Drejtorisë së Financave Vendore në lidhje me statusin e gjendjes financiare (afatin e likuidimit të detyrimeve financiare ndaj palëve të treta, si dhe vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj palëve të treta rritet progresivisht mbi nivelin prej 20 %, 25 % dhe 80% të shpenzimeve vjetore të miratuara, përkatësisht “me probleme financiare”, “në vështirësi financiare” dhe “në vështirësi serioze financiare”) të njësive të qeverisjes vendore për vitin 2022, janë cilësuar 49 bashki të klasifikuara pa probleme financiare, 8 bashki me probleme financiare (Poliçan, Dibër, Tropojë, Pogradec, Devoll, Libohovë, Delvinë, Peqin) dhe 4 bashki janë klasifikuar në vështirësi financiare (Dimal, Cërrik, Vorë, Kavajë).

KLSH ka konstatuar se, klasifikimi i mësipërm i kryer mbi bazën e shpenzimeve të miratuara, nuk reflekton situatën reale financiare të njësive të qeverisjes vendore, pasi referimi në shpenzimet e realizuara dhe trashëgimi i të ardhurave në vitin buxhetor përkatës e ndryshojnë strukturën bashkive dhe të qarqeve, duke e saktësuar gjendjen e tyre reale financiare në raportin bashki pa probleme financiare, me probleme financiare dhe në vështirësi financiare përkatësisht 45, 9 dhe 7, nga 49, 8 dhe 4 njësi.

Nga auditimi në MFE kanë rezultuar 12 bashki të cilat krahas të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, kanë dhe detyrimeve të prapambetura, raporti i të cilave lëviz nga 12% në 155%, e njëjta gjë dhe për 3 qarqe të vendit.

Nga auditimet e KLSH në njësitë e vetëqeverisjes vendore, konstatohet se si rezultat i raportimeve të pasakta të stokut të borxhit dhe/ose shpenzimeve vjetore të miratuara statusi i gjendjes financiare është i ndryshëm nga ai i paraqitur nga MFE (Drejtoria e Financave vendore). Kështu, për bashkinë Cërrik ky raport është 24.6 % dhe nuk duhet të klasifikohet në bashkitë “në vështirësi financiare”, por “me probleme financiare”, duke ju shtuar këtyre të fundit dhe bashkinë Këlcyrë raporti i së cilës është 19%.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin që nga auditimet e njësive të vetëqeverisjes vendore ka rezultuar që shpenzimet e realizuara janë rreth 25 % më të ulëta se ato të miratuara, konstatohet se statusi i gjendjes financiare të bashkive të vendit nuk paraqet gjendjen reale të klasifikimit të tyre.

Nga auditimet e kryera në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, rezulton se vlera e stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura që 26 bashki kanë ndaj të tretëve, në datën 31.12.2022 është në vlerën 1,771,244 mijë lekë. Kjo vlerë përbën 11.4% të totalit të shpenzimeve të planifikuara vjetore, ose 15.3% e totalit të shpenzimeve faktike vjetore.

Nëse do të shtohet edhe vlera e detyrimeve për likuidimin e huave që kanë Bashkitë Berat¹², dhe Kavajë, vlera e stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura është 1,821,027 mijë lekë (pra 49,783 mijë lekë më tepër), e cila përbën 12% e totalit të shpenzimeve të planifikuara vjetore, ose 15.7% e totalit të shpenzimeve faktike vjetore, pra me një rritje rreth 1%.

¹² Vlera e huas në Bashkinë Berat është 114,512 Euro dhe konvertuar në 14,154,828 lekë.

Në vlerën totale të stokut të detyrimeve të prapambetura, rezulton se peshën specifike më të madhe e ka Bashkia Kavajë me vlerë të detyrimeve prej 798,951 mijë lekë, ose 44% të totalit të këtyre bashkive, e ndjekur nga Bashkia Rrogozhinë në vlerën prej 165,692 mijë lekë dhe Bashkia Dimal me 146,824 mijë lekë detyrime. Nga 26 bashki të audituara, 3 prej tyre (Bashkia Kavajë, Rrogozhinë dhe Dimal) përbëjnë 61.4% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të këtyre njësive të vetëqeverisjes vendore.

Nga auditimet e kryera, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura të krijuara vetëm përgjatë vitit 2022, për këto 26 bashki është në vlerën 489,471 mijë lekë, e cila përbën 28% të vlerës totale të stokut progresiv të detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2022 të tyre. Kjo e dhënë është një tregues i cili shpjegon se megjithëse KLSH ka evidentuar në çdo auditim këtë fakt dhe ka rekomanduar që të merren masa për të mos krijuar detyrime të reja të prapambetura dhe, për likuidimin e atyre detyrimeve të krijuara më parë, ende nga bashkitë vijon fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor, duke sjellë për pasojë likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara ndër vite dhe nga ana tjetër të krijohen përsëri detyrime të reja gjatë vitit.

Bashkitë që kanë krijuar më tepër detyrime të prapambetura përgjatë vitit 2022, janë: Dimal në vlerën 110,854 mijë lekë (22.6% të totalit të detyrimit), Peqin në vlerën 81,587 mijë lekë (16.7% të vlerës totale të detyrimit), Rrogozhinë në vlerën 75,499 mijë lekë (15.4% ndaj totalit), Cërrik në vlerën 54,987 mijë lekë, ose 11.2% ndaj totalit etj. Duhet theksuar se Bashkia Peqin ka detyrime të prapambetura për likuidimin e pagave të punonjësve në vlerën 36,552 mijë lekë, që i përkasin pagave për periudhën Qershor - Gusht të vitit 2022.

Bashkitë të cilat nuk kanë krijuar detyrime të prapambetura përgjatë vitit 2022, janë: Mallakastër, Konsipol, Patos, Kuçovë, Memaliaj, Përrenjas dhe Përmet.

Nga auditimet e kryera ka rezultuar se, krijimi i detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2022, ka ardhur si rezultat i marrjes së angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion.

Sa i përket peshës së llojit të detyrimit të prapambetur, nga auditimet e kryera në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore rezulton se 938,490 mijë lekë, ose 52% ndaj totalit, janë detyrimet për likuidimin e faturave tatimore për shpenzime korrente (mallra, shërbime dhe mirëmbajtje), ndjekur nga detyrimet për likuidimin e faturave tatimore për investime në vlerën 617,935 mijë lekë, ose 34% ndaj totalit, detyrimet për likuidimin e vendimeve gjyqësore në vlerën 135,051 mijë lekë, ose 7% ndaj totalit, detyrimet për likuidimin e huave afatgjata në vlerën 49,783 mijë lekë, ose 3% ndaj totalit, detyrimet të tjera (shpronësime, shpërblime) në vlerën 41,579 mijë lekë, ose 2% ndaj totalit, si dhe detyrimet për paga në vlerën 36,552 mijë lekë, ose 2% ndaj totalit.

Referuar analizës së detyrimeve të prapambetura në likuidimin e faturave tatimore për shpenzime për investime, rezulton se peshën më të madhe të këtij lloji detyrimi e ka Bashkia Cërrik me vlerën 116,117 mijë lekë, ose 19.1% të totalit, ndjekur nga Bashkia Dimal me vlerën 104,636 mijë lekë, ose 17.2% të totalit, Bashkia Rrogozhinë me vlerën 83,318 mijë lekë, ose 13.7% të totalit etj.

Sa i përket peshës së detyrimeve të prapambetura për likuidimin e vendimeve gjyqësore, ndaj totalit të detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore, rezulton se peshën më të madhe e ka Bashkia Kavajë me vlerën 45,616 mijë lekë, ose 34%, ndjekur nga Bashkia Përmet me vlerën 22,404 mijë lekë, ose 17%, ndjekur nga Bashkia Peqin me vlerën 20,308 mijë lekë, ose 15% dhe Bashkia Libohovë me vlerën 14,585 mijë lekë, ose 11% të totalit. Duhet theksuar se, rreth 88,967 mijë lekë ose 66% të totalit të detyrimeve të prapambetura për likuidimin e vendimeve gjyqësore, e zënë shpenzimet për likuidimin e vendimeve gjyqësore nga ndërprerjet e paligjshme të marrëdhënieve të punës së punonjësve. KLSH në

vijimësi ka rekomanduar që njësitë vendore të respektojnë kuadrin ligjor në fuqi lidhur me këtë çështje. Nga auditimet konstatohet se, vendimet gjyqësore për largimet e paligjshme nga puna nuk analizohen dhe nuk nxirret përgjegjësia administrative për to, duke sjellë për pasojë mungesën e koriggjimit të praktikave të gabuara të ndjekura në proceset e largimit të punonjësve nga puna, me qëllim shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare me efekte negative në buxhetet vendore.

Sa i përket peshës së detyrimeve për likuidimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page, rezulton se peshën më të madhe e ka Bashkia Kavajë me vlerën 45,616 mijë lekë, ose 51.3% ndaj totalit të detyrimeve për likuidimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page, ndjekur nga Bashkia Përmet me vlerën 22,404 mijë lekë, ose 21%, ndjekur nga Bashkia Libohovë 7,940 mijë lekë, ose 8.9%.

Nga krahasimi i vlerës së stokut të detyrimeve të prapambetura të evidentuara nga auditimet e KLSH me 26 bashki me vlerën e stokut të detyrimeve të prapambetura raportuar nga MFE për këto njësi, rezultojnë se janë 30,225 mijë lekë më tepër nga shifrat e raportuara nga MFE. Nëse do të shtohet edhe vlera e detyrimeve për likuidimin e huave afatgjata, atëherë stoku i detyrimeve të prapambetura i evidentuar nga KLSH është 80,008 mijë lekë më tepër se stoku i raportuar nga MFE, pra me një rritje në vlerën 49,783 mijë lekë.

Tabela 17 Të ardhurat, huatë dhe totali i detyrimeve për 26 bashkitë e audituara 2022

Në mijë lekë

Nr	Bashkia	KLSH			MFE Totali i detyrimeve	Diferenca pa përfshirë detyrimet nga huat	Diferenca duke përfshirë huat
		Të ardhurat	Hua afatgjatë	Total detyrime			
1	Mallakastër	10,420	-	10,420	10,420	-	-
2	Dropull	8,960	-	8,960	8,960	-	-
3	Konsipol	14,757	-	14,757	14,252	505	505
4	Cërrik	121,557	-	121,557	157,794	-36,237	-36,237
5	Patos	-	-	-	-	-	-
6	Finiq	33,756	-	33,756	34,738	-982	-982
7	Gramsh	15,296	-	15,296	12,644	2,652	2,652
8	Krujë	31,581	-	31,581	28,508	3,073	3,073
9	Berat	36,018	14,155	50,173	36,018	-	14,155
10	Kuçovë	44,601	-	44,601	38,555	6,046	6,046
11	Kavajë	763,324	35,628	798,952	837,518	-74,194	-38,567
12	Has	9,694	-	9,694	8,808	887	887
13	Prrenjas	1,583	-	1,583	1,583	-	-
14	Dimal	146,825	-	146,825	146,825	-	-
15	Sarandë	11,455	-	11,455	7,764	3,691	3,691
16	Rrogozhinë	165,693	-	165,693	77,899	87,793	87,793
17	Libohovë	28,158	-	28,158	28,894	-736	-736
18	Librazhd	1,216	-	1,216	9,977	-8,761	-8,761
19	Këlcyrë	28,453	-	28,453	-	28,453	28,453
20	Përmet	45,482	-	45,482	45,482	-	-
21	Peqin	121,413	-	121,413	103,378	18,035	18,035
22	Tepelenë	26,173	-	26,173	26,173	-	-
23	Delvinë	49,022	-	49,022	49,022	-	-
24	Shijak	33,198	-	33,198	33,198	-	-
25	Gjirokastër	9,199	-	9,199	9,199	-	-
26	Memaliaj	13,410	-	13,410	13,410	-	-
	TOTAL	1,771,245	49,783	1,821,028	1,741,019	30,225	80,008

Burimi: Të dhëna nga MFE dhe auditimeve të KLSH

Duke marrë në konsideratë krahasimin, stoku i detyrimeve të prapambetura është evidentuar më tepër në Bashkitë: Rrogozhinë me 87,793 mijë lekë, Peqin me 18,035 mijë lekë, Këlcyrë me 28,453 mijë lekë, Sarandë me 3,690 mijë lekë, Krujë me 3,073 mijë lekë dhe Gramsh me 2,652 mijë lekë.

Në krahasim me vitin 2021, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura për 26 bashki, ka pësuar rënie në vlerë absolute 781,750 mijë lekë, si në bashkitë: Kavajë, Berat, Kuçovë, Rrogozhinë, Cërrik, Memaliaj Konispol etj.

Megjithatë, nga auditimet e kryera KLSH ka konstatuar se janë 6 bashki, të cilat kanë pasur rritje të vlerës së stokut të detyrimeve të prapambetura krahasuar me vitin 2021, si: Bashkia Peqin, Përmet, Shijak, Libohovë, Dimal dhe Dropull.

Nga auditimet e ushtruara në 29 njësi shpenzuese, vetëm për buxhetin e vitit 2022 shkeljet financiare me impakt negativ në buxhetin e pushtetit vendor lidhur me administrimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore (shpenzime), krahas punës së bërë, janë konstatuar edhe mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi të cilat kanë rezultuar në vlerën gjithsej prej 178,365 mijë lekë.

Nga këto auditime, dëmi ekonomik për buxhetin vendor në fushën e shpenzimeve, ka rezultuar në vlerën prej 12,557 mijë lekë, e cila është rekomanduar për t'u shpërblyer plotësisht.

Kjo vlerë dëmi, përbëhet nga shuma 12,224 mijë lekë, (ose 97% të totalit) shkelje të konstatuara nga KLSH në zbatimin e projekteve me financim të huaj lidhur me zbatimin e kontratave të punimeve në 8 Bashki, për likuidimin e punimeve të pakryera; vlera 277 mijë lekë konstatuar në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, lidhur me kualifikimin/skualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomikë, pasi nuk është vepruar për konfiskimin e sigurimit të ofertës; si dhe 76 mijë lekë në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime.

Vlerat më të larta të dëmit ekonomik janë konstatuar në bashkitë: Gjirokastrë me 7,831 mijë lekë, Librazhd me 1,449 mijë lekë, Patos me 1,236 mijë lekë etj.

Nga këto auditime kanë rezultuar efekte negative në shpenzime e buxhetit vendor (3 E-të) në vlerën gjithsej 165,518 mijë lekë, nga të cilat 81 % në shpenzimet për investime lidhur me kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, si dhe 19 % në shpenzimet operative lidhur me pagesat e vendimeve gjyqësore për largimin e padrejtë të punonjësve nga puna.


Vlerat më të larta të efekteve negative në shpenzimet e buxhetit janë konstatuar në bashkitë: Sarandë me 69,959 mijë lekë, Dropull me 58,648 mijë lekë, Finiq 26,456 mijë lekë etj.

Nga 29 auditime të kryera në njësitë shpenzuese të qeverisjes vendore, janë konstatuar dëme dhe/ose efekte financiare në 16 subjekte ose në 55% të tyre. Vlera më e lartë e dëmit ekonomik dhe efekteve financiare negative në fushën e shpenzimeve ka rezultuar në bashkinë Sarandë në vlerën prej 70,089 mijë lekë, e ndjekur nga Hasi me 29,866 mijë lekë, Finiqi me 27,305 mijë lekë etj.

2.2 Shpenzimet kapitale

Referuar treguesve fiskale të buxhetit të konsoliduar 2022 të përgatitur nga MFE, konstatohet se shpenzimet kapitale gjithsej (përfshirë dhe fondin e rindërtimit) janë realizuar 112,117 milion lekë nga 120,047 milion lekë të planifikuara me ndryshime ose 93%, me një mosrealizim prej 7,930 milion lekë. Niveli i realizimit të investimeve është 5 pikë përqindje më poshtë se niveli mesatar i përqindjes shpenzimeve publike të kryera gjithsej (98%), duke demonstruar një tregues të moderuar mjaftueshëm të qëndrueshmërisë së zhvillimit ekonomik të vendit.

Grafiku 15 Shpenzimet kapitale gjithsej dhe sipas zërave për vitin 2021 dhe 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Shpenzimet kapitale faktike në vitin 2022 përfaqësojnë 17 % të shpenzimeve publike gjithsej dhe 5.2 % të PBB, kundrejt përkatësisht 21 % dhe 6.7% të këtyre treguesve në vitin 2021. Duhet theksuar se përqindja e shpenzimeve kapitale ndaj PBB në vitin 2022 është më e ulta e tre viteve të fundit 2019-2022.

Krahasuar me një vit më parë konstatohet se shpenzimet kapitale janë pakësuar me 15,607 milion lekë, me rënie të ndjeshme të shpenzimeve kapitale me burim të brendshëm dhe të jashtëm financimi, si dhe shpenzimet e fondeve për rindërtimin, gjë që tregon se prirja e rritjes së investimeve, të cilat janë dhe duhen konsideruar si burim i zhvillimit, janë akoma larg së qeni të konsideruar si të tilla nga praktikatat qeverisëse të vitit 2022. Rënia e investimeve publike (shpenzimeve kapitale) nuk është në përputhje me përcaktimin e PBA 2022-2024 se: “Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përsheptimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë.”

Sipas klasifikimit të bërë nga MFE në treguesit e buxhetit të konsoliduar, zërat e burimeve të shpenzimeve kapitale janë: financim i brendshëm, financim i huaj, fondet e rindërtimit si dhe investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë, plani dhe realizimi i tyre paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 18 Plani dhe realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2022

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Plani përfundimtar	Realizimi	Përqindja e realizimit	Diferenca + ose -
1	Shpenzime Kapitale	120,047	112,117	93	-7,930
a	Financim i brendshëm	64,565	63,675	99	-890
b	Financim i huaj	22,082	18,676	85	-3,406
c	Fondi i rindërtimit	32,400	28,874	89	-3,526
d	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	1,000	892	89	-108

Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nga nënzërat e shpenzimeve kapitale, mosrealizimi në nivelin më të lartë konstatohet në fondet e rindërtimit me - 3,526 milion lekë, ndjekur nga shpenzimet kapitale me burim të huaj financimi me - 406 milion lekë, si dhe shpenzimet kapitale me burime të brendshme financimi nuk janë realizuar për - 890 milion lekë.

Veç sa më sipër, duke analizuar ecurinë e kryerjes së shpenzimeve publike për investime kapitale konstatohet se ka një përqendrim të tyre në muajin dhjetor 2022, në të cilin rezultojnë 44 % e shpenzimeve gjithsej, duke cenuar ndjeshëm efektivitetin e zbatimit të kontratave publike të lidhura gjatë vitit, me pasoja në afatin, koston dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit dhe punëve publike për taksapaguesit shqiptarë, krahas implikimit të ndikimit të likuiditetit të shtuar në tregjet financiare.

Sipas projekt ligjit të Buxhetit, ligjit për Buxhetin e vitit 2022, akteve normative për ndryshimin e tij dhe tabelës fiskale, planifikimi i *investimeve kapitale me financim të brendshëm* ka pasur ndryshime të konsiderueshme, që nisin nga 61,791 milion lekë në 64,565 milion lekë përfundimisht me AN nr.19. Investimet kapitale me burim të brendshëm financimi (përfshirë dhe fondin e rindërtimit) janë realizuar 63,675 milion lekë, ose 99%, me një mosrealizim prej 890 milion lekë, dhe përbëjnë 10% të shpenzimeve publike gjithsej. Në krahasim me vitin 2021 janë realizuar më pak investime kapitale me burim të brendshëm financimi në shumën 8,441 milion lekë.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, në treguesit e paraqitur për investimet tek tabela e treguesve fiskal përfshihen edhe investimet të cilat realizohen nga të ardhurat dytësore, për të cilat nuk kanë plan buxheti të miratuar, por raportohen si investime të realizuara ndaj planit të buxhetit në vlerën totale prej 1,352 milion lekë, çka do të thotë se niveli i realizimit të investimeve të planifikuara është akoma më i ulët.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, gjatë muajit Janar 2023 janë paguar investime, për llogari të buxhetit të vitit 2022, në vlerën totale 17,278 milion lekë ose 18.95% të vlerës totale të investimeve të realizuara.

Krahasuar me vitin 2021, janë shpenzuar më pak për investime kapitale gjithsej (duke përfshirë dhe fondet e rindërtimit) në shumën 15,607 milion lekë.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se niveli i planifikuar i shpenzimeve kapitale me burim të huaj financimi, nga 34,502 milion lekë në ligjin e buxhetit të vitit 2022, ka zbritur në 22,082 milion lekë me AN nr.19, me ndryshime të dukshme ndryshimi gjatë vitit. Gjithashtu, ka ndryshime të theksuara ulje dhe ngritje në tre vitet e fundit, duke mos kapur në vitin 2022 nivelin e planifikuar të vitit 2021, për 658 milion lekë. Kështu kanë ndryshuar në rritje në krahasim me vitin 2021 programet “Programe zhvillimi” dhe “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, dhe kanë pësuar ulje “Forcat e luftimit” etj. *Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin e një planifikimi të dobët dhe mangësi në monitorimin e shpenzimeve kapitale me burim të huaj financimi nga ana e MFE.*

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, buxheti i vitit 2022 është përdorur për kryerjen e pagesave për detyrime të viteve të mëparshme buxhetore për investime në 44 projekte në shumën 11,800 milion lekë.

Kanë rezultuar 202 projekte investimesh të procesuara për pagesë në shumën 2,168 milion lekë faturat e të cilëve janë likuiduar deri në 10 ditë me vonesë, gjë që dëshmon formalitetin e regjistrimit të transaksioneve në SIFQ dhe pa ndjekur procedurat e parashikuara në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit, si pasojë e anashkalimit të kontrolleve të brendshme.

Nga auditimi në MFE i investimeve me financim të brendshëm u konstatua se për 67 projekte në vazhdim nga vitet e mëparshme, fondet nuk janë çelur në fillim të vitit, por janë çelur kryesisht gjatë muajit Mars dhe Korrik, në kundërshtim me pikën 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të brendshëm janë evidentuar problematika në drejtim të detajimit të investimeve pa kaluar ciklin e menaxhimit të investimeve publike, marrjes së angazhimeve nëpërmjet kontraktimit të fondeve publike të pa miratuara në momentin e nënshkrimit të kontratave nga nëpunësit autorizues, detajimit të fondeve të investimeve vetëm për 20% të vlerës dhe pa pasur fonde të miratuara për periudhën e mbetur sipas vlerës dhe kohëzgjatjes totale të projektit, etj, konkretisht:

- Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për programin buxhetor 04520 “Transport rrugor” janë audituar 14 projekte investimi, ku është konstatuar se: 3 projekte nuk kanë qenë pjesë e PBA-së; 11 projekte nuk kanë qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; 6 kontrata janë regjistruar jashtë afatit kohor; për 9 projekte kontratat e lidhura janë 6,153,761 mijë lekë më shumë se vlera e tyre e planifikuar në PBA; për 4 projekte shumëvjeçare rezulton se alokimi prej 20% i fondeve është bërë për qëllim të lidhjes së kontratës duke qenë se pak ditë më vonë këtyre projekteve u janë hequr fonde; për 7 projekte janë marrë angazhime pa pasur fonde në dispozicion në shumën 2,461,488 mijë lekë.
- Për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për programin buxhetor 06730 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, është konstatuar se: 1 projekt nuk ka qenë pjesë e PBA-së dhe pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; për 1 projekt regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit; për 1 projekt është marrë angazhim pa fond buxhetor në vlerën 17,386 mijë lekë; për 1 projekt është paguar me vlerë 102,600 mijë lekë, ose 19.3% e vlerës së kontratës, 16 ditë pas lidhjes së saj.
- Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është audituar 1 projekt, ku është konstatuar se projekti nuk ka qenë pjesë e listës së investimeve publike në projekt buxhet; kontratat e lidhur është 81,430 mijë lekë më shumë se vlera totale e këtij projekti të planifikuar në PBA; regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit; është marrë angazhim pa fonde buxhetore në vlerën 119,048 mijë lekë.
- Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është audituar 1 projekt, ku është konstatuar: për 1 kod projekti janë zhvilluar 2 procedura prokurimi; të dy kontratat janë regjistruar jashtë afatit; është marrë angazhim pa fond buxhetor në vlerën 63,320 mijë lekë.
- Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë janë audituar 4 projekte, ku është konstatuar se: për 1 projekt vlera e kontratës është 26,530 mijë lekë më shumë se vlera e planifikuar në PBA; për 2 projekte edhe pse kontrata është nënshkruar me afat zbatimi 26 javë fondet janë parashikuara të shtrira për 3 vite buxhetore; për 2 projekte regjistrimi i kontratës është bërë jashtë afatit, për 4 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 249,496 mijë lekë;
- Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit janë audituar 6 projekte ku është konstatuar se: për 6 projekte kontratat janë regjistruar jashtë afatit; për 6 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 644,231 mijë lekë.
- Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit janë audituar 8 projekte, ku është konstatuar se: për 3 kode projekti janë zhvilluar 7 procedura të ndryshme prokurimi; 8 kontrata janë regjistruar jashtë afatit; për 8 projekte janë marrë angazhime pa fonde buxhetore në vlerën 2,060,892 mijë lekë.

Në vitin 2022, *shpenzimet kapitale me burim të huaj financimi* janë realizuar në vlerën 18,676 milion lekë ose 85% e planit të ndryshuar, me një mosrealizim prej 3,406 milion lekë. Krahasuar me vitin 2021 janë shpenzuar më pak për investimet e huaja 6,702 milion lekë, duke theksuar se është realizimi më i ulët i dhjetë viteve të fundit. *Kjo tregon për një mungesë monitorimi sistematik dhe aktiv të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të institucioneve publike përfutuese të këtyre financimeve, si dhe mungesën e një analizë më të thellë për zbatimin e projekteve, për të përcaktuar se ku dhe nëse mund të bëhen përmirësime, veçanërisht në lidhje me zbatimin e tyre.*

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, janë realizuar 8 projekte të investimeve me financim të huaj, në vlerën 1,953 milion lekë, pa pasur plan buxhetor të miratuar, duke sjellë për pasojë ndryshimin e prioritetëve qeverisëse gjatë vitit; 8 projekte janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit të miratuar për vlerën 986 milion lekë; 18 projekte në vlerën 247 milion

lekë janë realizuar pa pasur plan buxhetor të miratuar, fakte të cilët tregojnë për mangësi monitorimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; 95 projekte investimesh me financim të huaj në vlerën totale 3,272,501 mijë lekë, referuar përshkrimin të projektit dhe produkteve të prishme prej projekteve janë keq klasifikuar kryesisht në llogarinë 231 “Investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale”.

Nga auditimi në MFE janë konstatuar 29 raste ku projektet e investimit të miratuara për PBA 2021-2023, nuk reflektohen në PBA 2022-2024, ose reflektohen me vlera konsiderueshëm më të ulëta me qëllim ruajtjen e tavaneve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja; 16 raste ku projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2021-2023 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuar dhe më pas rriten në PBA 2022-2024 me vlerë të konsiderueshme. Ndryshimet e vlerave të shpenzimeve në planifikimin e investimeve kapitale rrezikojnë krijimin e detyrimeve të prapambetura, sjellin ndryshime në prioritetet e projekteve, si dhe mund të cenojnë dhe/ose favorizojnë projekte specifike.

Nga auditimi i përputhshmërisë kryer nga KLSH në ARRSH për Projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate, për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i projektit (2016) - mars 2022”, është arritur në konkluzionin se ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

Nga auditimi në fushën e shpenzimeve rezulton një dëm ekonomik në vlerën prej 7,638 mijë lekë, e cila ka ardhur si pasojë e mos respektimit të kushteve të kontratës së shërbimit të konsulencës. Gjithashtu, po nga auditimi i shpenzimeve ka rezultuar përdorim i fondeve pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet në shumën prej 86,837 mijë lekë, nga e cila:

- shuma prej 65,803 mijë lekë (594,000 euro) ka ardhur si pasojë e mos përshtatjes dhe mos ndryshimeve të pagesave sipas kostove reale të kontraktorit të shërbimeve të konsulencës;
- shuma prej 21,034 mijë lekë (189,875 euro) ka ardhur si pasojë e mos përfundimit në kohë me pasojë pagesa komisionesh angazhimi më tepër nga ato të parashikuara.

Investimet nga të ardhurat e Arsimit të Lartë janë realizuar 892 milionë lekë ose 89 % në krahasim me planin përfundimtar prej 1,000 milion lekë, 184 milion lekë më shumë se në vitin 2021

Referuar Raportit të MFE mbi zbatimin e buxhetit vjetor 2022, lidhur me treguesit kryesor të performancës sipas ministrive të linjës, për shpenzimet kapitale gjithsej, rezulton se gjatë vitit plani i tyre është ulur me 10,255 milion lekë për 9 institucione (mbrojtjen, infrastrukturën dhe energjinë, arsimin, bujqësinë, financat dhe ekonominë, kulturën etj.) nga 12 gjithsej, ndryshe nga sa ka ndodhur me shpenzimet korrente gjithsej të cilat janë rritur me gati dyfishin e vlerës së ulur të investimeve.

Një ndryshim i tillë i buxhetit gjatë vitit, duke rritur shpenzimet korrente dhe ulur investimet, konsiderohet një mungesë harmonizimi të shpenzimeve publike në planifikim dhe në realizim, me pasojë në perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Tabela 19 Shpenzimet kapitale gjithsej sipas ministrive 2022

Nr .	Institucionet	Plan fillestar	Plan i rishikuar	Diferenca + ose -	Realizimi	Në mijë lekë	
						% realizimi t	% ministri
1	Shëndetësia dhe mbrojtja sociale	2,752,944	2,859,088	106,144	3,046,754	107	5
2	Arsimi	4,251,000	3,107,390	(1,143,610)	2,243,504	72	4
3	Bujqësia dhe zhvillimi rural	5,929,095	4,978,724	(950,371)	5,037,312	101	8
4	Infrastruktura dhe Energjia	42,318,069	39,625,429	(2,692,640)	37,549,283	95	62
5	Turizmi dhe Mjedisi	1,070,740	979,240	(91,500)	905,673	92	2
6	Drejtesia	686,700	552,840	(133,860)	514,802	93	1
7	Institucionet e sistemit te Drejtësisë	70,000	20,600	(49,400)	17,932	87	0

8	Financat, Ekonomia, Punësimi dhe arsimiti profesional	3,083,329	2,235,961	(847,368)	1,884,395	84	3
9	Mbrojtja	10,239,500	6,134,500	(4,105,000)	5,729,073	93	10
10	Kultura	2,422,500	1,598,500	(824,000)	1,379,595	86	2
11	Rendi Dhe siguria publike	1,350,290	1,722,889	372,599	1,660,499	96	3
12	Politika e jashtme	171,780	275,235	103,455	235,818	86	0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga shqyrtimi të dhënave të mësipërme, rezulton se, niveli i ekzekutimit të buxhetit për shpenzimet kapitale nga ministritë (realizimi kundrejt planit) është 94 % e planit të rishikuar dhe 81 % e planit fillestar. Vetëm dy institucione (shëndetësia dhe mbrojtja sociale, si dhe bujqësia) kanë realizuar dhe tejkaluar planin e ndryshuar të shpenzimeve kapitale, ndërsa të gjitha institucionet e tjera edhe pse plani është rishikuar në ulje, nuk e kanë realizuar atë.

Kjo tregon se administrata publike në këto institucione dhe ato të varësisë nuk ka aftësitë e duhura në programimin dhe zbatimin e investimeve, e cila rrezikon të shoqërohet me vonesa në realizimin e projekteve, si dhe detyrimeve kontraktuale të shtuara etj.

Duhet theksuar se infrastruktura dhe energjia thithin 62% të shpenzimeve kapitale të të gjitha ministrive. Nga investimet gjithsej në këtë ministri, 65 % shkojnë për programin buxhetor transporti rrugor, dhe 26 % për furnizim me ujë dhe kanalizime.

Bazuar në sa më sipër, qeveria duhet të tregojë kujdesin e duhur në lidhje me investimet në infrastrukturën rrugore, për t'i harmonizuar ndërtimet e reja me mirëmbajtjen e atyre ekzistuese, me qëllim që të mos rritet akoma më shumë kostoja e tyre për shkak të amortizimit nga mungesa e mirëmbajtjes.

Gjithashtu, përqendrimi i investimeve edhe në furnizimin me ujë, në një kohë që ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve janë ndërmarrjet publike me detyrimet më të mëdha kundrejt OSHEE SHA dhe MFE, si dhe janë pikërisht Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve të cilat edhe nga vetë MFE konsiderohen me një risk fiskal potencial për buxhetin e shtetit për shkak, midis të tjerave, të stokut të detyrimeve të akumuluar të cilat rriten çdo vit, pa hartuar më parë një strategji të veçantë për ecurinë e tyre në perspektiven e afërt.

Alokimi i shpenzimeve kapitale publike midis niveleve të qeverisjes, rezulton se në vitin 2022 është në raportin 90:10, respektivisht qeverisja qendrore dhe ajo vendore, me një ndryshim të lehtë prej 2 % krahasuar me vitin 2021, në favor të shpenzimeve kapitale vendore.

2.2.1 Fondi i rindërtimit

Sipas pasqyrës së treguesve të buxhetit të konsoliduar të MFE konstatohet se fondi i rindërtimit, i përfshirë në shpenzimet kapitale, për vitin 2022 ka qenë programuar fillimisht 20,000 milion lekë, për të arritur në 32,400 milion lekë me AN nr.17, datë 01.12.2022 dhe është realizuar 28,874 milion lekë ose 89 %, me një diferencë prej 3,526 milion lekë më pak se plani, si dhe 647 milion lekë më pak se vitin 2021.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se në vlerën e raportuar tek tabela e treguesve fiskalë janë përfshirë edhe shpenzimet e rindërtimit që janë realizuar nga të ardhurat e veta të institucioneve, në vlerën 416 milion lekë, nga të cilat 415 milion lekë nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore dhe 1 milion lekë nga të ardhurat e veta të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, çka tregon se niveli shpenzimeve buxhetore të realizuara për këtë vit është akoma më i vogël se 28,874 milion lekë.

Rezultoni se për projektet e rindërtimit është përdorur i njëjti kod projekti për disa investime të ndryshme, pa identifikuar specifikisht investimet e kryera për çdo projekt, duke sjellë vështirësi në ndjekjen, monitorimin dhe auditimin e ecurisë të secilit prej tyre.

Sipas të dhënave të Tabelës analitike të përdorimit të fondit të rindërtimit -pjesë e raportimit të MFE, fondet e akorduara gjatë vitit 2022 kanë qenë gjithsej 35,114 milion lekë, nga të cilat: fonde të pashpenzuara nga viti 2021 dhe të mbartura në 2022 në vlerën 9,765 milion lekë (28%) dhe 25,349 milion lekë fondet e akorduara gjatë vitit 2022 (72%), me destinacion 24% për Njësitë e Qeverisjes Qendrore dhe 76% për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Niveli i përqindjes së realizimit të shpenzimeve të fondeve të rindërtimit në njësitë e qeverisjes vendore varion nga 47 % bashkia Krujë në 92 % bashkia Mirditë, me vlerën më të lartë bashkia Tiranë me 9,300 milion lekë dhe nivelin më të ulët bashkia Rrogozhinë me 316 milion lekë.

Nga shqyrtimi i ecuresisë së shpenzimeve për fondin e rindërtimit gjatë vitit 2022, rezultojnë se ka luhata të theksuara të fondeve të përdorura: nuk ka shpenzime të kryera për muajin janar dhe shkurt dhe ka 47 % të shpenzimeve vjetore në dhjetor, gjë që tregon jo vetëm mungesën e vijmësisë në ndërtim, por dhe në të njëjtën kohë cenim të përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Duhet theksuar se, në vitin 2022 nuk është arritur të përdoren fonde as sa janë përdorur në vitin 2021, që ishte 29,521 milion lekë, pra 647 milion lekë më pak, gjë që tregon se ka rënie të ritmeve të strehimit të banorëve dhe të ndërtimit të infrastrukturës publike të dëmtuar nga tërmeti.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se Fondi i Rindërtimit sipas ligjit të buxhetit 2022 shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar¹³. Megjithatë transfertat e pakushtëzuar të njësitëve të vetëqeverisjes vendore, ndahet sipas formulës me kritere të përcaktuara,¹⁴ Fondet e rindërtimit shpërndahen me VKM, të cilat në rastin e njësitëve të vetëqeverisjes vendore rrisin transfertën e pakushtëzuar në shumën e caktuar në VKM, pa u bazuar dhe marrë në konsideratë formulën përkatëse dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Në këtë mënyrë gjatë vitit 2022, bashkive u janë shtuar fonde në shumën 26,684 milion lekë në formën e transfertave të pakushtëzuara për Fondin e rindërtimit.

Nga auditimi në MFE rezultojnë se, në periudhën 2020-2022 me VKM janë miratuar rreth 119,833 milion lekë projekte rindërtimi për njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, nga të cilat janë realizuar për këtë periudhë në vlerën 75,097 milion lekë dhe mbeten për t'u realizuar për vitin 2023 investime në rindërtim në vlerën 44,736 milion lekë. Ndërkohë në buxhetin e vitit 2023, në tabelën 4 "Treguesit fiskal të konsoliduar", fondet për rindërtimin janë planifikuar në shumën 5,000 milion lekë, dhe për vitet 2024 e 2025 është 0 lekë, duke shfaqur mungesë bashkërendimi të kostos totale të projekteve me planifikimin e vlerave përkatëse në ligjin e buxhetit për vitet pasardhëse buxhetore.

Nga auditimi në MFE rezultojnë se gjatë vitit 2022, në 18 VKM të dala për përdorimin e fondit të rindërtimit, burim financimi është cilësuar edhe ngurtësimi i fondeve nga projekte të tjera me ecuri të ngadaltë të rindërtimit në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në formën e transfertës së pakushtëzuar, pa përcaktuar projektet specifike dhe vlerën e secilit prej tyre. Për vitin 2022, shuma e ngurtësuar për projektet me ecuri të ngadaltë dhe përdorim si burim financimi për projektet e tjera, është 2,763 milion lekë.

Përdorimi i ngurtësimit të fondeve, si formë financimi për projektet e investimit nuk është e mbështetur në bazë ligjore, pasi në ligjin organik të buxhetit dhe ligjin e buxhetit të vitit nuk

¹³ Ligji nr. 115, datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", neni 7.

¹⁴ Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 24.

parashikohet ngurtësimi, si mënyrë për alokimin e fondeve ndërmjet projekteve të investimit.

Ecuria në mungesë të ritmeve të duhura të ndërtimit të banesave për të dëmtuarit nga tërmeti i vitit 2019, po sjell në mënyrë të vazhdueshme kosto shtesë për buxhetin në kuadër të strehimit. Në fillim të vitit 2022 ishin parashikuar 1,000 milion lekë për qiranë e akomodimit të 11 300 familjeve të pastreha nga tërmeti, me supozimin se një pjesë e familjeve do të strehoheshin në objektet e filluara gjatë viteve 2020-2021. Por numri i familjeve përfituese të subvencionit të qirasë vijoj të jetë ende i lartë, duke sjellë për pasojë rishikimin dhe miratimin e buxhetit shtesë për vlerën 1,698 milion lekë dhe në dhjetor 2022, u ul me 350 milion, për shkak se Bashkia Tiranë ka mbuluar me fondet e veta pagesat për 2 muaj, dhe përfundimisht plani për shpenzim qiraje në vlerën 2,300 milion lekë dhe rezultoi se fondi i përdorur për vitin 2022 është 2,193 milion lekë ose 95%.

Nga sa më sipër konstatohet se, mungesa e arritjes së kryerjes së shpenzimeve të planifikuara për rindërtimin, krahas problemeve sociale për strehimin dhe infrastrukturën publike, vijon të sjellë kosto shtesë për buxhetin, e cila për vitin 2022 është më së paku 1,300 milion lekë.

Nga auditimi në MFE konstatohet se ka disa bashki të cilat nuk kanë kryer çdo muaj subvencionime për qiratë, si: Bashkia Tiranë nuk ka kryer pagesa për qiratë në muajt shkurt, qershor, korrik, gusht, nëntor; Bashkia Mirditë nuk ka kryer pagesa për muajin janar, shkurt, maj, nëntor; Bashkia Rrogozhinë nuk ka kryer pagesa për muajin janar, shkurt, prill, qershor, korrik etj.

Mosrealizimi i shpenzimeve të programuara për rindërtimin, sjell kosto shtesë për buxhetin edhe në drejtim të zgjatjes së afatit të qirasë për banorët, ndërtesat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti dhe kanë qenë parashikuar që të përfundojë ndërtimi i tyre, krahas problemeve të tjera sociale të strehimit.

2.3 Fondi rezervë dhe kontigjenca

Sipas treguesve të buxhetit të ndryshuar të vitit 2022 në këtë zë përfshihen Fondi rezervë dhe Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit.

Nga shqyrtimi i ecurisë së planifikimit të vlerës së këtyre dy treguesve të marrë së bashku gjatë vitit 2022 rezultoi se ka ndryshuar nga 7,700 milion lekë në ligjin fillestar në 25,640 milion lekë me AN nr.19, datë 29.12.2022.

- * Ndryshe nga vitet e tjera, *Fondi rezervë* në ligjin e buxhetit 2022 nr.115/2021, është miratuar në vlerën prej 2,900 milionë lekë, nga e cila: 2,400 milionë lekë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe 500 milionë lekë për projektin për fëmijët dhe rininë.


Planifikimi nga qeveria dhe miratimi i vlerës 500 milion lekë për projektin për fëmijët dhe rininë me burim fondin rezervë është në kundërshtim me nenin 5 i ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pasi fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, dhe projekti për fëmijët dhe rininë është plotësisht i parashikueshëm dhe i mundshëm për t’u programuar më parë, duke sjellë për pasojë denatyrim të fondit rezervë në planifikim.

Ndërsa, gjatë vitit 2022 me ndryshimet e ligjit të buxhetit Fondi rezervë është planifikuar i ndarë në Fond rezervë i buxhetit dhe Kontigjenca për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës

Ashtu si edhe disa tregues të tjerë, planifikimi i fondit rezervë i buxhetit dhe kontigjenca sociale ka pësuar ndryshime të dukshme në raport me realizimin e vitit 2021 si dhe më pas

me PBA (faza I+II), ligjin fillestar të buxhetit, si dhe ndryshimet vjetore të buxhetit me Akte Normative.

Grafiku 16 Ecuria e planifikimit të buxhetit për Fondin rezervë për vitin 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Nisur nga vlerat e Fondi rezervë dhe Fondit të Kontigjencës për risqet e borxhit në AN nr.12, datë 29.07.2022 dhe AN nr.19 datë 29.12.2022, përkatësisht 20,250 milion lekë dhe 25,640 milion lekë, MFE ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 5, pasi janë planifikuar mbi kufirin e lejuar deri në masën 3 për qind të vlerës totale të fondeve të miratuara, përkatësisht rezultojnë 3.06% dhe 3.84% të totalit të shpenzimeve të miratuara (660,693 milion lekë dhe 667,178 milion lekë).

Nga sa më sipër konstatohen ndryshime të theksuara të vlerës së fondit rezervë nga 3,400 milion lekë në 20,840 milion lekë me AN nr.19, për më tepër që ndryshon edhe brenda muajit dhjetor, më datën 1 është 13,720 dhe më datë 29 rritet me 7,120 milion lekë, duke shfaqur edhe këtu dobësi në saktësinë e parashikimit të treguesve kryesor buxhetor nga ana e MFE dhe institucioneve të tjera të qeverisjes së përgjithshme.

Veç, këtyre ndryshimeve të theksuara, nga auditimi në MFE ka rezultuar se buxhetit i miratuar për fondin rezervë dhe kontigjencën me AN nr. 19, datë 29.12.2022 ka diferenca të theksuara me planin e operativ dhe planin e ngarkuar në Sistemin informatik financiar të Qeverisë (SIFQ)¹⁵, përkatësisht 20,840, 5,008 dhe 7,700 milion lekë, duke sjellë për pasojë mangësi të raporteve që ofrohen nga sistemi për qëllime të planifikimit buxhetor, si dhe të kontrolleve të mundshme të regjistrimeve e deri te analizat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të buxhetit. nëpërmjet të cilit Qeveria e Republikës së Shqipërisë kryen të gjitha proceset e ekzekutimit dhe raportimit financiar të Buxhetit të Shtetit.

Sipas pasqyrës së treguesve të buxhetit të konsoliduar të përgatitur nga MFE, rezulton se plani përfundimtar për fondin rezervë të buxhetit të shtetit dhe kontigjencën pas 4 ndryshimeve gjatë vitit 2022 është 20,840 milion lekë, i strukturuar në 10,620 milion lekë fondi rezervë i buxhetit të shtetit, nga i cili: Mbështetje financiare e menjëhershme për përbalimin e inflacionit të luftës 7,800 milion lekë, si dhe 10,220 milion lekë Kontigjenca për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, realizimi të cilave është paraqitur zero.

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit të përgatitur nga MFE, konstatohet se deri më datë 31.12.2022, Fondi rezervë është përdorur në masën 20,632 milionë lekë nga 20,840 milion lekë të planifikuara me AN nr.19, ose në masën 99%, vlerë e cila është disa herë më e lartë se ajo e shpenzuar në vitin 2021 që ka qenë 461 milion lekë.

¹⁵ Nëpërmjet SIFQ Qeveria e Republikës së Shqipërisë kryen të gjitha proceset e ekzekutimit dhe raportimit financiar të Buxhetit të Shtetit (Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 3/45)

Fondi rezervë i buxhetit të shtetit i planifikuar për raste të paparashikuara nga 2,820 milion lekë të planit buxhetor përfundimtar konstatohet se është realizuar 2,809 milion lekë ose pothuajse 100 %, me një diferencë mosrealizimi pre 11 milion lekë, nëpërmjet 8 Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Ky fond është përdorur nga 10 ministri dhe institucione të tjera qendrore, në pjesën më të madhe nga MFE në masën 26 %, pothuajse plotësisht për shpenzime korrente (98 %) dhe shumë pak për shpenzime personeli. Nga auditimi në MFE i procedurave për akordimin e shpenzimeve nga përdorimi i fondit rezervë për raste të paparashikuara kanë rezultuar mangësi në dokumentacionin e kërkuar në lidhje me mungesën e argumentimit të arsyeve të mos planifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit, mungesën e përcaktimit të produkteve që përfitohen, kontributet në qëllimin e politikave, zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm etj., në 5 raste në shumën 1,491 milion lekë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 45 “Kërkesat për fonde shtesë”, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Mbështetja financiare e menjëhershme për përballimin e inflacionit të luftës, planifikuar përfundimisht si pjesë e fondit rezervë në vlerën prej 7,800 milion lekë rezulton se është realizuar 7,736 milion lekë, me një diferencë fondesh të papërdorura prej 64 milion lekë.

Sipas tre Vendimeve të Këshillit të Ministrave, 72% është përdorur për mbështetje financiare të menjëhershme të pensionistëve për zbutjen e impaktit të krizës, 15% për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta dhe 12% për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik.

- * Fondi i kontigjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës është miratuar fillimisht me AN nr.3 datë 12.03.2022 në vlerën 6,000 milion lekë për mbështetjen e shtresave në nevojë, për mbështetjen e sektorit të transportit dhe për mbështetjen e sektorit të bujqësisë. Ky fond është ndryshuar dhe dy herë të tjera, duke planifikuar përfundimisht 10,220 milion lekë, dhe realizuar 10,087 milion lekë ose 98 %, duke mbetur të papërdorura 133 milion lekë. Fondi i kontigjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës është përdorur 64% për mbështetjen financiare të pensionistëve dhe indeksimin e pensioneve; 17% për mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe 14% për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta dhe 5 % për mbështetjen e shoqërive të linjave të transportit urban qytetëse dhe ndër-qytetëse. Fondi i kontigjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës është përdorur 9,694 milion lekë ose 96% për shpenzime operative (transferta të brendshme) dhe 393 milionë lekë ose 4% për shpenzime personeli.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, Fondi i kontigjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës gjatë vitit 2022 në një rast, me VKM 621, datë 28.09.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 187, datë 8.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar është përdorur në vlerën prej 507.9 milion lekë për përballimin e rritjes së pagave në disa institucione qendrore dhe njësi vartësie. Argumentet e përdorura për rritjen e elementit të pagës mujore “shtesa e pozicionit” për disa kategori të veçanta në disa institucione janë të diferencuara dhe përjashtuese për strukturat e ngjashme në institucionet e tjera. Pavarësisht se në relacionin për nxjerrjen e këtij vendimi citohet se në themel të çdo përcaktimi të nivelit të pagës dhe elementëve përbërës të saj, qëndron parimi “shpërblim i njëjtë për punë të njëjtë/ngjashme”, mënyra e trajtimit të këtyre strukturave krijon pabarazi në trajtimin e punonjësve.

Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit planifikuar në masën 4,800 milion lekë, konstatohet se nuk është përdorur gjatë vitit 2022, ashtu siç ka ndodhur dhe vitin e kaluar.

2.4 Koncesionet/PPP dhe risqet fiskale – Impakti buxhetor

Megjithëse MFE në Raportin e zbatimit të buxhetit faktik 2022 cilëson se ka monitoruar risqet kryesore fiskale/buxhetore, KLSH konstaton vonesa në hartimin dhe zbatimin nga ana e saj të Udhëzimit nr.35 datë 29.12.2022 “Për procedurat standarde të raportimit dhe monitorimit të risqeve fiskale nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik”.

Sipas Raportit të MFE për zbatimin e buxhetit faktik 2022, rezultojnë 11 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, pagesat faktike për të cilat janë 12,641 milion lekë nga 12,706 milion lekë të planifikuara, ose janë realizuar 99.5 %, të cilat përbëjnë afër 2 % të shpenzimeve publike gjithsej.

MFE ka respektuar kufirin e lejuar ligjor të pagesave për kontratat koncesionare/PPP të përcaktuara në nenin 4/3 të ligjit organik të buxhetit prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2021, pasi ato përbëjnë vetëm 2.7 % të tyre.

Nga krahasimi në dinamikë i shpenzimeve për kontratat koncesionare në periudhën 2020-2022 rezulton që shpenzimet për kontratat koncesionare të shtohen çdo vit: në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 janë shtuar 20 % dhe në 2022 në krahasim me 2021, që ishin 11,518 milion lekë rriten 10 % ose 1,123 milion lekë. Rritja e shpenzimeve për kontratat koncesionare/PPP nga viti në vit përbën një risk fiskal për buxhetin, për më tepër që në mungesë të treguesve të matshëm të performancës së tyre bën të diskutueshme dhe arritjen në kohë të objektivave të tyre me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet. Veç sa më sipër, mungesa e treguesve të matshëm të performancës së tyre e shoqëruar me mungesën e analizave financiare lidhur me raportin kosto/përfitim kanë sjellë pamundësinë e vlerësimit të dobishmërisë së tyre në ofrimin e shërbimeve në kohë, me cilësi dhe me shpenzime optimale.

MFE, në “Raportin mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, lidhur me Koncesionet/PPP (kreu 7.3, faqe 60) është cilësuar se: “Informacion më të detajuar dhe gjithë përfshirës për këtë qëllim, do të gjeni në ”Raportin e kontratave PPP, për vitin 2022”, që i bashkëlidhet këtij relacioni”, por që nuk gjendet bashkëlidhur Raportit të mësipërm, dhe as të cilësuar në përmbajtjen e tij.

Në këtë mënyrë MFE nuk ka vepruar sipas kërkesave të pikës 7, të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” të ndryshuar: “Ministri përgjegjës për financat përgatit një raport vjetor të përmbledhur mbi ecurinë e kontratave aktive të koncesionit/ PPP, si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit, në përputhje me legjisllacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.”

Mungesa e publikimit të Raporti vjetor 2022 të ecurisë së kontratave koncesionare, si një dokument i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në të cilin përfshihen mbledhja dhe raportimi i të dhënave të ecurisë dhe performancës financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/PPP, ka cenuar synimin për të siguruar që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike.

Sipas raportit të buxhetit faktik 2022, të detajuara sipas kontratave respektive plani dhe pagesat për kontratat koncesionare/PPP aktualisht në zbatim paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi i kryer në MFE rezulton se në pagesat e kryera për kontratat koncesionare/PPP të vitit 2022, ka dhe likuidime të detyrimeve të prapambetura të cilat janë në shumën 3,322 milion lekë ose 26 % pagesave faktike, si më poshtë:

- Pagesat e kryera gjatë vitit 2022 për kontratën koncesionare “Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit” janë në shumën 2,940 milion lekë, sipas 4 urdhër shpenzimeve të regjistruara në SIFQ të kryera nga ana e MIE, ndërkohë që i përkasin shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, konkretisht faturave të vitit 2019 dhe 2020, pra për këtë koncesion nuk janë likuiduar akoma faturat e vitit 2021 dhe 2022;
- Për koncesionin “Përmirësim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Oriku - Dukat (Ura e Shën Elizës)” janë 2 fatura të vitit 2021 në vlerën totale 150 milion lekë;
- Për koncesionin “Shërbimi i Skanimit në Dogana” janë 8 urdhër-shpenzime në shumën 232 milion lekë i përkasin detyrimeve të prapambetura periudhës 2020-2021;

Tabela 20 Plani dhe pagesat për kontratat koncesionare/PPP 2021 - 2022

Në mijë lekë

A.K.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti fillimi	Viti mbarimi	2021		2022		Fakt
				Plan	Fakt	Plan	Plani i	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022	752,771	690,040	188,200	376,400	376,385
	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	50,000	40,292	-	-	-
	Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit	2018	2031	3,393,100	3,392,727	2,940,000	2,940,000	2,940,000
	Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot – Morinë	2019	2032	792,259	790,027	743,000	740,978	740,978
	Përmirësim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Oriku – Dukat (Ura e Shën Elizës)	2019	2032	48,029	47,069	312,000	224,699	224,698
	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Ballëren	2020	2033	3,100	3,100	-	-	-
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerëve të automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	2013	2030	1,660,686	1,660,686	1,965,913	1,925,922	1,925,903
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)	2015	2025	366,090	219,021	876,090	876,090	876,083
	Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril një përdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	1,564,982	1,500,924	1,700,000	1,700,000	1,699,975
	Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2026	754,000	747,195	835,000	835,000	802,583
	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	1,137,845	1,103,199	1,574,900	1,639,002	1,612,914
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1"	2018	2025	0	0		395,074	395,074
MIE / Bashkia Tiranë	Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike"	2017	2047	1,300,000	1,249,399	650,000	1,052,990	1,046,397
				700,000	651,626	450,000	872,990	866,675
				600,000	597,773	200,000	180,000	179,722
TOTAL				11,822,862	11,443,679	11,785,103	12,706,156	12,640,991

Burimi: Të dhëna të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Mungesa e likuidimit në kohë të pagesave për kontratat koncesionare, krahas krijimit të detyrimeve të prapambetura, sjell për pasojë një prezantim të deformuar të nivelit të shpenzimeve gjithsej për vitin buxhetor raportues.

Nga auditimi në MFE mbi ecurinë e pagesave për koncesionet/PPP rezulton se nuk ka pasur njëtrajtshmëri në kryerjen e shpenzimeve, pasi në muajin dhjetor janë kryer 16 % e totalit të këtyre shpenzimeve për vitin 2022, nga e cila 80% për kontratën “Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”.

Nga auditimi në MFE i kontratës koncesionare “Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës” nënshkruar më datë 17.10.2018 ndërmjet MAS dhe Bashkisë Tiranë me BOE në shumën 2,364 milion lekë, kryerja e pagesave të së cilës bëhet për shtatë vjet nga momenti i marrjes në dorëzim dhe është një angazhim pa fonde buxhetore. Kjo kontratë është regjistruar në modulën e kontratave në datën 31.05.2022 në vlerën 197 milion lekë, në mënyrë të copëzuar dhe jo në vlerën e saj të plotë. MFE ka paraqitur pagesat gjithsej në vlerën prej vlerë 395 milion lekë, duke përfshirë 50% të financimit nga bashkia Tiranë e cila nuk është me burim nga buxheti i shtetit.

Nga auditimi në MFE i kontratës koncesionare “Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të vend-depozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike” rezulton se, vlera e detajuar në fillim të vitit është në shumën 200,000 milion lekë dhe në mënyrë të paargumentuar e rishikuar në ulje përfundimisht në shumën 180,000 milion lekë. Pagesat e realizuara përgjatë vitit 2022 sipas raportimit të MFE në “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatës makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, rezultojnë 1,046,397 mijë lekë. Këto pagesa sipas SIFQ janë financuar në shumën 179,722 mijë lekë nga buxheti i MIE, programi i mbetjeve urbane dhe pjesa tjetër prej 866,675 mijë lekë është financuar prej të ardhurave të veta të Bashkisë Tiranë.

Nga auditimi në FSDKSH në lidhje me financimin e Kontratës së Koncesionit të Kontrollit Mjekësor Bazë (Check-up), nr. 3082/20, datë 07.01.2015, të lidhur midis MSHMS dhe Shoqërisë Koncesionare “3P LIFE LOGISTIK” SHPK, ka rezultuar se edhe në vitin 2022, janë kryer pagesa për shërbim të pakryer për 20,172 raste, me një kosto në shumën 31,004 mijë lekë pa TVSH dhe 37,198 mijë lekë me TVSH.

Gjithashtu, nga analizimi i disa treguesve ka rezultuar se, pavarësisht shtimit të numrit të KMB në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, sëmundjet kronike janë shtuar me 8,603 raste, vlera e rimbursimit të barnave për shkak të rritjes së sëmundshmërisë dhe kompleksitetit të tyre me 1,184,831 mijë lekë më shumë; rritja e numrit të shtrimeve në spitale me 18,979 raste më shumë, rritja e vizitave ambulatorë në Spitalet Universitare dhe Bashkiake me 123,354 raste më shumë etj., tregojnë se efektet e masës profilaktike “Kontrolli Mjekësor Bazë”, nuk janë reflektuar në rezultat konkrete, në uljen e sëmundshmërisë së popullatës, duke cenuar efektshmërinë e përdorimit të këtyre fondeve.

Nga auditimi mbi zbatimin e Kontratës Koncesionare nr. 1503/44, datë 10.02.2016 “Përfshirja e hemodializës”, të lidhur midis MSHMS dhe Shoqërisë “Dia Vita” SHPK, ka rezultuar se edhe për vitin 2022, pagesa e koncesionarit nuk kryhet për shërbim të kryer, por për shërbim të faturuar, i cili përfshin likuidimin e rasteve të pakryera ose shprehur ndryshe nën projektion vjetor, si dhe të rasteve të realizuara mbi projektion mujor, të secilës qendër dialize, në total 8,854 raste, nga të cilat 6,918 raste nën projektion dhe 1,936 raste mbi projektion, në shumën 99,191 mijë lekë, që përfaqëson pagesë për shërbim të pa kryer me fekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.

Planifikimi i projeksioneve nuk është në përputhje me nevojat reale për kryerjen e shërbimit, mjafton të evidentojmë faktin që rajonet Shkodër dhe Vlorë, që prej fillimit të këtij shërbimi

në vitin 2016, paraqiten me realizim nën projeksion, konkretisht në Rajonin Vlorë me 12,091 seanca nën projeksion ose 162,546 mijë lekë të paguara për shërbim të pakryer; Rajoni Shkodër me 15,805 seanca nën projeksion, ose 212,476 mijë lekë shpenzime për shërbim të pa kryer, ndërkohë që sipas kontratës i paguhet koncesionarit çdo mbi projeksion mujor, për rajonet Lezhë, Elbasan dhe Korçë, të cilat paraqiten me mbi projeksion respektivisht me 2,531 raste, 12,672 raste dhe 481 raste, gjë që ka sjellë pagesa jo vetëm për nën projeksionin e këtyre qendrave, por dhe pagesa për mbi projeksionin, evitimi i të cilave bëhet nëpërmjet një planifikimi real të numrit sipas qendrave.

Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për financimin e Kontratës Koncesionit nr.1440/33, datë 10.12.2015 *“PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore”*, të lidhur midis MSHMS Shoqërisë Koncesionare *“Sani Service”* SHPK, sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH, për ndërhyrjet kirurgjikale të kryera gjatë vitit 2022, në tre llojet e spitaleve, universitare, rajonale dhe bashkiake, ka rezultuar se ka përdorim të seteve të ndryshme për të njëjtën tipologji kirurgjikale: në 15,339 raste në Spitalet Universitare; në 8,708 raste në Spitalet Rajonale dhe në 55 raste në Spitalet Bashkiake. Niveli i lartë i deviacioneve, ku për të njëjtën tipologji kirurgjikale përdoren nivele të ndryshme të kompleksitetit të seteve, ku në spitalet universitare arrin deri në 52 % të rasteve, në spitalet rajonale deri në 48.5 % të rasteve, kundrejt totalit të ndërhyrjeve, reflekton mangësitë në përfshirjen e kirurgjive sipas tipologjisë, referuar nivelit të seteve, por dhe të përmbajtjes me instrumente mjekësorë të seteve referuar nivelit të kompleksitetit, gjë e cila shoqërohet me rritje të shpenzimeve referuar çmimeve sipas kompleksitetit të seteve. Ri konfigurimi i tyre në vitin 2020, nuk ka minimizuar problematikën e evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga KLSH. Shpenzimet faktike për këtë kontratë koncesionare në vitin 2020 kanë qenë në shumën 1,288,269 mijë lekë, në vitin 2021 në shumën 1,500,924 mijë lekë dhe në vitin 2022 në shumën 1,699,975 mijë lekë, duke paraqitur rritje të nevojës për financim përtej parashikimeve.

Gjithashtu, rezulton se është rritur përdorimi i seteve kirurgjikale të kompleksitetit të lartë dhe të mesëm, të cilët kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve me 13 % më shumë se në vitin 2021.

Nga auditimi i Kontratës koncesionare/PPP *“Shërbimi laboratorik”* ofrimi i këtij shërbimi është i kufizuar, sipas kushteve të kontratës nr. 1924/2, datë 10.04.2019, pika 22.4 *“Tavanet e buxhetit”*. Kufizimet buxhetore për financimin e shërbimit të analizave laboratorike janë të lidhura me tavanin buxhetor të secilit spital, të sanksionuar në kontratën koncesionare të laboratorëve, duke rrezikuar ofrimin e analizave laboratorike, në masën e duhur, sipas nevojave spitalore dhe duke sjellë për pasojë drejtimin e pacientëve në marrjen e këtij shërbimi tek subjektet private, me kosto për qytetarët, si dhe përkeqësim të shëndetit nga moskryerja në kohë e analizave përkatëse.

Referuar të dhënave mbi shpenzimet e kryera në vitin 2020 dhe 2021, në shumat respektive 1,103,199 mijë lekë dhe 1,612,914 mijë lekë, si dhe ecurisë së planifikimit afatmesëm të buxhetit për financimin e këtij shërbimi rezulton se, vlera e tij do shkojë më tepër se parashikimi, duke kërkuar çdo vit më shumë angazhim fondesh buxhetore.

Gjatë vitit 2022 ka rezultuar se numri i ekzaminimeve është rritur me 827,617 raste, ndërsa shpenzimet buxhetore me 509,715 mijë lekë, ose thënë ndryshe, niveli i rritjes së numrit të ekzaminimeve në total është 24.5 % më shumë se në vitin 2021, ndërsa niveli i rritjes së shpenzimeve buxhetore 46.2 % më shumë. Këta tregues demonstrojnë një rritje më të lartë të shpenzimeve buxhetore në krahasim me rritjen e numrit të ekzaminimeve, gjë e cila reflektohet në koston mesatare të ekzaminimit, ku në vitin 2021 rezulton në 326.5 lekë, ndërsa në vitin 2022 në 383.5 lekë, ose 17 % më shumë. Në kushtet kur çmimet referuese nuk kanë ndryshuar, kjo rritje është rezultat i kryerjes së ekzaminimeve me tarifa të larta,

kundrejt atyre me tarifa të ulta, tendencë e identifikuar në të gjitha spitalet me përjashtim të SU “Trauma”, ku rritja e numrit të ekzaminimeve në krahasim me vitin 2021, është më i lartë se rritja e shpenzimeve buxhetore.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion në lidhje me financimin dhe likuidimin e shpenzimeve për Kontratën e Koncesionit “PPP-Kontrolli Mjekësor Bazë” dhe “PPP-Sterilizimi i pajisjeve mjekësore”, është evidentuar se vlera e shpenzimeve të kryera për dhënien e këtyre shërbimeve është likuiduar me TVSH, referuar kushteve të kontratave, përcaktuar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore për TVSH në Republikën e Shqipërisë të cilat përcaktojnë përjashtimin nga pagesa e TVSH për furnizimet e barnave dhe shërbimeve shëndetësore, si dhe me Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe PPP”, neni 27 “Përmbajtja e kontratës”, pika 1, ku cilësohet: “Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë”.

Fondet e përdorura për pagesën e TVSH, në shumën 417,175 mijë lekë në vitin 2022, kanë ndryshuar destinacionin e përdorimit të tyre. Për rrjedhojë nëse TVSH e paguar për sterilizimin në vitin 2022, do të përdorej në destinacionin e duhur do të ishin kryer edhe 12,705 ndërhyrje kirurgjikale të kompleksitetit të mesëm më shumë. Ndryshimi i destinacionit të fondeve ka sjellë uljen e nivelit të shërbimit, po të konsiderojmë dhe faktin që ky shërbim është realizuar në masën 100 % të buxhetit të planifikuar, çka do të thotë që tavani buxhetor ka kufizuar ofrimin e shërbimit.

Nga auditimi i kryer në MFE dhe në DPD lidhur me “Kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” rezulton se diferenca ndërmjet detyrimeve të pagesës fikse të koncesionarit që kryhet nga buxheti i shtetit dhe të ardhurave të realizuara nga skanimi (përfshirë dhe deklaratat e pa skanuara), pra mbështetja buxhetore për vitin 2022 është në vlerën e 418,284 milion lekë dhe për periudhën e funksionimit të kësaj kontrate 2015-2022 janë paguar nga buxheti i shtetit në vlerën rreth 3,193 milion lekë, në kushtet kur ka qenë një propozim i pa kërkuar pa mbështetje buxhetore të finalizuar me ligj në vitin 2013 dhe ndryshuar në vitin 2015 në kontratë koncesionare me mbështetje buxhetore, në të cilën mungojnë treguesit e matshëm të performancës dhe analizë financiare kosto/përfitim.

Nga auditimi i kryer në MFE, rezulton se, vlera e paguar për këtë kontratë për vitin 2022 sipas databazës së pagesave në SIFQ është 1,898,906 mijë lekë me diferencë 26,997 mijë lekë krahasuar me vlerën e pasqyruar në raportin e buxhetit faktik 2022 në shumën 1,925,903 mijë lekë.

· *Ndërmarrjet e sektorit energjetik (KESH SHA, OSHEE SHA dhe OST SHA)* vijojnë të kenë ndikim të konsiderueshëm fiskal në buxhetin e shtetit, si dhe të kushtëzojnë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Risku fiskal i ndërmarrjeve të sektorit energjetik përkthehet në dy drejtime kryesore: mbështetja e konsiderueshme nga buxheti i shtetit përgjatë vitit 2022 për sektorin e energjisë për shkak të situatës jo të favorshme hidrike dhe përshkallëzimi i krizës globale energjetike shkaktuar nga konflikti në Ukrainë; si dhe ulja e performancës financiare dhe mungesës së likuiditetit për këto shoqëri publike, duke krijuar edhe detyrime tatimore.

Për vitin 2022, impakti fiskal i sektorit energjetik, i llogaritur si kosto buxhetore dhe të ardhura të munguara në financat publike, vlerësohet në 33,017 milion lekë, nga rreth 5,504 milion lekë në vitin 2021, pra me një gjashtëfishim të efektit negativ në buxhet, krahasuar me një vit më parë, duke zhvleftësuar dhe monitorimin e kryer nga MFE për këto ndërmarrje.

Mbështetja buxhetore me fonde nga buxheti i shtetit përbën 84% të impaktit fiskal negativ në buxhet për vitin 2022 pasi ka vlerën prej 27,907 milion lekë etj.

Veç kësaj, përbëjnë një rrezik fiskal për financat publike detyrimet e prapambetura të ndërsjella ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike.

Tabela 21 Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjetik, ML/IB, MFE dhe DPT

Në miliard lekë

Nr.	Emërtimi	KESH	OST	OSHEE	MFE	DPT	Gjithsej
1	<i>KESH ndaj:</i>				33.69		33.69
2	<i>OST ndaj:</i>	9.19		1.66	8.66		19.51
3	<i>OSHEE ndaj:</i>	51.13	9.5		2.69	5.19	68.51
4	<i>Ndërmarrjet UK ndaj:</i>			25.35	10.39		35.74
5	<i>Ministritë e Linjës/Institucionet Buxhet:</i>			5.67			5.67
	Gjithsej	60.32	9.5	32.67	55.42	5.19	163.11

Burimi: Të dhëna të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nga sa më sipër rezulton se detyrimet e ndërsjella në ndërmarrjet e sektorit energjetik janë në vlerën 71.48 miliard lekë, detyrimet e ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve ndaj këtyre ndërmarrjeve janë 25.35 miliard lekë, ndërsa ndërmarrjet e sistemit energjetik dhe ujësjellësve kanë detyrime në vlerën 55.42 miliard lekë ndaj MFE dhe 5.19 miliard ndaj DPT.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, detyrimet e ndërsjella në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2021 kanë qenë në vlerën 144.21 miliardë lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqiten me një vlerë prej 18.9 miliardë lekë me tepër.

Veç kësaj, kjo vlerë paraqet riskun për të qenë akoma më e lartë për arsye se detyrimet e ndërmarrjeve të Ujësjellës-kanalizimeve dhe detyrimet e ML/IB ndaj OSHEE, janë raportuar për periudhën deri më 31.09.2022, në kundërshtim me pikën 143, të kreut 6, të Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” ku parashikohet ndër të tjera monitorimi nga MFE dhe raportimi periodik mbi bazë tremujore të detyrimeve të ndërsjella të sektorit energjetik dhe palëve të treta.

Gjithashtu, vlera e stokut të detyrimeve që sektori i ujësjellësve ka raportuar ndaj sektorit energjetik, përfshin si detyrim të prapambetur vetëm principlin (pa kamatëvonesat), gjë që do të thotë se kjo vlerë rritet akoma më tej.

Në këtë mënyrë, vlerësohet se nga MFE ka progres të pamjaftueshëm në mbledhjen, përpunimin dhe analizën e informacionit të nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjetik, dhe për pasojë në identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjetik në veçanti.

Ndërmarrjet e Ujësjellës –Kanalizimeve edhe gjatë vitit 2022 vijnë të kenë vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave të faturuara korrente dhe të prapambetura, duke sinjalizuar probleme potenciale të likuiditetit në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë.

Sipas Raportit të zbatimit të buxhetit, qeveria nëpërmjet AKUM-it gjatë vitit 2022 i ka shpërndarë shoqërive të Ujësjellës –Kanalizimeve një vlerë totale subvencionit prej 360 milion lekë, kryesisht për ndërmarrjet të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes.

Stoku i detyrimeve të akumuluar nga ndërmarrjet Ujësjellës –Kanalizimeve ndaj sektorit të energjisë elektrike përbëjnë risk potencial fiskal për financat publike, pasi në dhjetor 2022 rezultojnë të jenë 14.01 miliard lekë, kundrejt rreth 12 miliardë lekë që ishin në fillim të vitit

2022, pra janë shtuar me mbi 2 miliard lekë. Duhet theksuar se, sipas sqarimeve të MFE në stokun e detyrimeve të vitit 2022 nuk është përlogaritur vlera e kamatëvonesave, duke e nënvlerësuar vlerën e detyrimeve të prapambetura.

Kjo tregon se MFE dhe MIE, në vlerësimin e KLSH kanë shfaqur mangësi në zbatimin e dy urdhrave të përbashkët të viteve 2020 dhe 2021 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, pasi detyrimet janë shtuar me 17 % në vitin 2022.

Po ashtu, nuk kanë qenë rezultate as intensifikimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës: ndërmarrjet e Ujësjetllës - Kanalizimeve me MIE, si dhe me ndërmarrjet e sektorit të energjisë.

Sipas të dhënave të MFE, Ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve Durrës ka detyrimin ndaj OSHEE SHA në vlerën 4.93 miliard lekë ose 35 % të detyrimeve gjithsej të këtyre ndërmarrjeve, dhe me detyrimet më të larta vijojnë Ndërmarrja e Ujësjetllës kanalizimeve Vlorë, Patos, Fier etj.

Në përgjigje të trendit rritës të akumulimit të detyrimeve të prapambetura, kryesisht për shkak të performancës së ulët të shumicës së shoqërive Ujësjetllës kanalizimeve, ka nisur procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të Ujit, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030, me synim ridimensionimin e 58 ndërmarrjeve UK aktuale, përmes rigrupimit të tyre në 15 shoqëri rajonale, për një menaxhim optimal dhe rritjen e performancës së tyre financiare.

Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme përcaktohen si fushë me risk të lartë fiskal për ecurinë dhe qëndrueshmërinë e financave publike, si dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Aktualisht detyrimet e prapambetura vijojnë të jenë një fenomen shqetësues pasi konstatohet ende nivel i lartë i stokut ekzistues dhe gjithashtu krijim i detyrimeve të reja nga institucione të ndryshme publike.

Sipas MFE, në fund të muajit dhjetor 2022 është regjistruar një stok kumulativ i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme prej 12,200 milion lekë, nga të cilat: 6,770 milion lekë detyrime të qeverisë qendrore ose 55% dhe 5,430 milion lekë totali detyrimeve të qeverisë vendore (45%).

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për vitin 2021, rezulton se, niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 1,030 milion lekë më i ulët, ose një rënie me 8%, dhe sipas nivelit të qeverisjes rezultojnë me rritje 620 milion lekë për njësitë e qeverisjes qendrore dhe me ulje prej 1,180 milion lekë për vetëqeverisjen vendore.

Duke analizuar në tërësi ecurinë e zbatimit të buxhetit në vitin 2022 sipas treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar, rezulton se, përgjatë 11 muajve janar-nëntor ka pasur tepriçë të ardhurash, ndryshe nga sa ka ndodhur në vitin 2021 që ka pasur deficit të të ardhurave, detyrimet e prapambetura të qeverisjes qendrore rriten me 9%, gjë që tregon për mangësi të theksuara në menaxhimin dhe monitorimin e shpenzimeve nga ana e institucioneve qendrore dhe enteve në varësi të tyre.

Sipas MFE, për vitin 2022, nuk rezultojnë detyrime të prapambetura të rimbursimit të TVSH-së, krahasuar me 0.48 miliardë lekë të raportuara për vitin 2021.

Nga auditimi i KLSH në MFE rezulton se në të dhënat e raportuara nuk janë paraqitur treguesit e detyrimeve të prapambetura për njësitë ekstrabuxhetore vendore, si dhe të

universiteteve, të cilat sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në këtë ministri janë përkatësisht 548 milion lekë dhe 7 milion lekë, duke sjellë për pasojë që detyrimet e prapambetura të jenë 12,753 milion lekë, nga 12,199 milion lekë të raportuara, ose raportuar më pak nga MFE janë 555 milion lekë, diferencë që rezulton edhe midis të dhënave të faqes zyrtare të MFE dhe Raportit të përgatitur prej saj.

Gjithashtu, rezultojnë diferenca në treguesit e detyrimeve të prapambetura sipas të dhënave të marra nga SIFQ dhe DPB, kryesisht për qeverisjen qendrore ku raportohen më të larta dhe në vetëqeverisjen vendore reflektohen më të ulta.

Detyrimet e prapambetura të njërive të qeverisjes së përgjithshme qendrore, sipas raportimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit (MFE) në Dhjetor 2022 rezultojnë 6,770 milion lekë në 15 institucione, me detyrimet më të mëdha të MIE me 3,955 milion lekë ose 58 % e detyrimit, e ndjekur nga MB dhe MM përkatësisht 833 milion lekë dhe 813 milion lekë etj.

Struktura e detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme qendrore përbëhet në masën 48 % për vendimet gjyqësore, 35 % për investimet, 9 % për të tjera, 2% për mirëmbajtje etj. Në krahasim me vitin e kaluar 2021 konstatohet pothuajse pesëfishim i detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore, ulje të detyrimeve për investimet dhe ulje të ndjeshme të detyrimeve për shërbimet.

Detyrimet e prapambetura të njërive të vetëqeverisjes vendore prej 5,430 milion lekë, janë në të gjitha bashkitë dhe qarqet e vendit, por konstatohet se vetëm 13 bashki në totalin e mësipërm përbëjnë rreth 73% të stokut të detyrimeve të prapambetura, e kryesuar nga bashkia Tiranë me 1,180 milion lekë, Kavajë 837 milion lekë, Vorë 413 milion lekë etj.

Referuar strukturës së detyrimeve të prapambetura rezulton se 44 % i përkasin detyrimeve të prapambetura në investime, 28 % atyre në zërin të tjera, 11 % shërbimeve, 10% vendimeve gjyqësore, 4% mallrave dhe 2 % detyrime të prapambetura për mirëmbajtje. Krahasuar me vitin 2021 vërehet një dyfishim i detyrimeve të prapambetura në zërin “të tjera”, ndërkohë që zërat e tjera janë në raporte pak a shumë të njëjta.

Megjithëse sipas MFE, për vitin 2022, nuk rezultojnë detyrime të prapambetura të rimbursimit të TVSH-së, nuk rezulton një situatë e tillë nga auditimi i KLSH në DPT. Nga auditimi u konstatua se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2022, rezultojnë 32 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar por të pa miratuara në vlerën totale për 1,844 milion lekë, për të cilat megjithëse ka kaluar afati maksimal prej 60 ditëve nga data e paraqitjes së tyre, nuk janë rimbursuar, pra duhej të ishte përshirë dhe raportuar në stokun e detyrimeve të prapambetura.

Nga auditimi në MFE kanë rezultuar mangësi në Raportimin e detyrimeve të prapambetura nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Janë 502 institucione nga 1031 gjithsej të cilët kanë rezultuar me diferenca në raportim dhe atyre të pasqyruara në SIFQ. Nga testimet e kryer nga KLSH me të dhënat e paraqitura nga DPTH për detyrimet e prapambetura të vitit 2022, lidhur shumat e deklaruara “të paguara” gjatë vitit 2022 dhe të dhënave të SIFQ, ka rezultuar se pagesat për faturat dhe detyrime të tjera janë 9,828 milion lekë më shumë se pagesat e raportuara, gjë që nënkupton fatura të prapambetura të padeklaruara më parë sipas skemës së parashikuar në Udhëzimin nr. 5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, procedurë që do të rriste balancën fillestare të vitit 2022 me vlerën e mësipërme.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, mënyra e kontabilizimit të stokut të faturave të prapambetura si "shpenzime të periudhave të ardhshme", duke mos prekur klasën e duhur të shpenzimeve apo investimeve, bën që stoku i detyrimeve të prapambetura i krijuar nga

angazhime të pa buxhetuara apo parashikuara në PBA, të mos raportohet në treguesit e konsoliduar fiskal me arsyetimin që “ligji lejon njohjen, regjistrimin dhe pagesën vetëm të faturave për të cilat ka fonde disponibël”, duke sjellë pasojë mungesën e saktësisë dhe të plotësisë të stokut të faturave të prapambetura në fund të vitit.

Ashtu siç ka përcaktuar dhe MFE në Raportin e saj për zbatimin e buxhetit faktik të vitit 2022, *KLSH vë theksin në risqet fiskale nga vendime gjyqësore dhe arbitrazhit ndërkombëtare* që mund të sjellin kosto financiare shtesë në buxhet në vitet e ardhshme.

Nga shqyrtimi i Raportit të paraqitur nga MFE, si dhe nga auditimi i kryer në MFE dhe në Avokaturën e Shtetit duhen konsideruar në mënyrë të veçantë vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar, si dhe të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, mbi detyrimet kontingjente, në të ardhmen, si rezultat i risqeve të mundshme, të lidhura me ngjarje apo nisma, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të viteve të mëparshme.

Megjithëse, MFE ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve, KLSH e konsideron të pamjaftueshme veprimtarinë e tyre, pasi nuk evidentohet marrja e masave parandaluese për të mos ardhur deri te detyrimet kontingjente, me pasoja në rritjen e barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.

Sipas Raportit të MFE, në vitin 2022, vlera totale e kostove ligjore, të përfaqësimit, mbrojtjes, shpenzimeve gjyqësore apo kostove të tjera lidhura me vendime të arbitrazhit ndërkombëtar, të paguara nga buxheti i shtetit ka rezultuar në vlerën rreth 940.25 milionë lekë nëpërmjet ministrive, shoqërive publike e institucioneve të tjera. Referuar detajimit të pagesave në këtë Raport (faqe 60) sipas institucioneve rezultojnë se pagesat e kryera janë në vlerën 1,004 milionë lekë, ose 64 milionë lekë më tepër se sa raportimi.

Totali i detyrimeve të mbetura dhe kontingjente për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, sipas MFE, i cili referohet të dhënave të Avokaturës së Shtetit dhe Ministrive të linjës të muaji maj 2023 janë në vlerën gjithsej 173,914,609 euro për 10 vendime të arbitrazhit ndërkombëtar, kryesisht ndaj MIE (ARRSH dhe AKBN), MFE etj.

Zbatimi i vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, gjatë vitit 2022 konsiston me miratimin e shtatë Vendimeve të KM me një vlerë totale për rreth 12.37 milion lekë. MFE ka ekzekutuar edhe 13 vendime të GJEDNJ, me vlera nën 10,000 Euro, me një vlerë totale 40,200 Euro, rreth 4.92 milionë lekë, pra gjithsej 17,29 milion lekë. Deri në fund të vitit 2022, detyrimet faktike dhe kontingjente për vendimet e GJEDNJ-së, sipas MFE cilësohen të jenë 21,717,886 Euro për shtatë vendime të saj.

Në total, detyrimet e mbetura dhe kontingjente për vendimet e GJEDNJ-së dhe të arbitrazhit ndërkombëtar në fund të vitit 2022 janë gjithsej në vlerën 195,632,495 Euro, ose sa 3.4 % e të ardhurave buxhetore të vitit 2022.

Nga auditimi në MFE mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, rezulton se janë paguar nga buxheti i shtetit nga MFE sipas sistemit ORACLE për kostot paraprake, shërbimet juridike dhe kosto të tjera ligjore rreth 291 milionë lekë, pra rreth 98 milionë lekë më tepër sesa janë raportuar në raportin “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, pa përfshirë pagesat e kryera për këtë qëllim nga institucionet e tjera.

Nga auditimi i kryer në MFE, lidhur me zbatimin e vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, gjatë vitit 2022 ka rezultuar se, ka pagesa që nuk janë kryer brenda afatit 3-mujor duke rritur koston për kamatë-vonesat.

Kështu, ka rezultuar se janë tre vendime të vitit 2015, 2016 dhe 2018 të pa ekzekutuara nga MFE për vlerën e principalit 17,880,650 Euro, për të cilat buxheti i shtetit mund të penalizohet edhe me kosto shtesë për kamatë-vonesa të përlllogaritura në vlerën 2,840,740 Euro, si dhe të pagesave për tarifën e përmbartimit.

Nga auditimi në subjektin “Avokatura e Shtetit” (ASH) lidhur me procedurat dhe shpenzimet për vendime gjyqësore rezultoi se: Për proceset gjyqësore të përfunduara në GJEDNJ dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, nga të cilat kanë rezultuar detyrime e pagesa të fondeve të buxhetit të shtetit, si dhe në disa raste penalitete për mos likuidimin e detyrimeve në afatet e parashikuara, ka munguar një analizë e çështjeve gjyqësore të humbura nga ana e institucioneve shtetërore pjesë e këtyre proceseve dhe Avokatura e Shtetit. Për pasojë, në asnjë rast nuk konstatohet adresim i problematikave të rezultuara prej tyre, mungon analiza e thelluar e shkaqeve dhe e masave që duhet të ndërmerren ndaj shkaktarëve, apo sugjerime/propozime për Këshillin e Ministrave mbi hapat e nevojshëm me qëllim kryerjen me korrektësi të procedurave të përfaqësimit ligjor dhe shmangies, për aq sa është e mundur, e ngarkimit të kostove abuzive shtesë për financat publike, të cilat impaktojnë buxhetin e shtetit gjatë periudhave të ardhshme.

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se:

- Sa i takon dokumentimit dhe regjistrimit fizik të çështjeve gjyqësore, si dhe informacionit mbi ndjekjen e tyre rezultoi se, regjistri i GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar nuk ka nja databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara, nuk ka gjurmë mbi të dhënat dhe vlerat reale (totale) të efekteve financiare për të gjitha çështjet që kanë përfunduar shqyrtimin e Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe ato që janë ende në proces shqyrtimi;
- Janë 2 çështje të përfunduara në Arbitrazhin Ndërkombëtar me një vendim, ku kanë lindur detyrime dhe të drejta për institucionet e shtetit shqiptar, por nuk kanë vijuar kërkesat për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas, përkatësisht:
 - Një rast me efektin e dëmit të mundshëm për buxhetin e shtetit (ku palë e paditur është “Autoriteti Rrugor Shqiptar” me një detyrim të shtetit shqiptar sipas Tribunalit të Arbitrazhit në vlerën 44,262,681.77 USD dhe 573,081,13 Euro;
 - Një rast me efektin e të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit (ku palë e paditur është “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit” në vlerën 2,407,000 Euro, 427,488 USD dhe 106,755£.
- Nga ana e institucioneve shqiptare pjesë e procesit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), nuk rezulton të kenë gjetur zbatim afatet 3 mujore për zbatimin e tyre, sipas parashikimeve të dispozitivit të vendimeve, si dhe të nenin 19/4, të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Në total gjatë periudhës nën auditim, (vitet 2021-2022), evidentohen 5 (pesë) vendime të pa ekzekutuara me një vlerë financiare (vetëm principal) prej 17.911.600 Euro, pa përfshirë këtu interesat e pagueshëm në rast vonesash, referuar pikës 3, të nenit 19/5 në ligjin e sipërcituar. Vlera e referuar më lartë mund të rritet për shkak të penaliteteve si rrjedhojë e vonesave dhe mosrespektimit të afateve të ekzekutimit të vendimit. (Referuar likuidimit të dy çështjeve përgjatë vitit 2023, kosto aktuale potenciale, e vitit 2023, që ekspozohet buxheti shtetit nga moszbatimi i 3 (tre) prej vendimeve të GJEDNJ-së rezulton të jetë **17,880,650 Euro** e cila do të vijojë të rritet edhe më për shkak të penaliteteve të shtuara si rrjedhojë e vonesave).

Vendimet e pazbatuara datojnë që prej vitit 2015 deri në vitin 2021, dy prej tyre përbëjnë dhe peshën kryesore të vlerës financiare për tu përballuar nga buxheti i shtetit, përkatësisht:

- Peshën më të lartë e mban çështja “Sh.... k. Shqipërisë”, mbartur prej vitit 2018, (me 75% të totalit të vlerës), e cila vijon të jetë në proces për shkak të mungesës së fondeve të buxhetit të shtetit, ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 13,447,300 Euro, vlerë e cila pritët të shtohet për shkak të interesave;
- Çështja “R.... k. Shqipërisë” mbartur prej vitit 2015, vijon në proces pritje të miratimit të VKM-së ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 4,417,750 Euro, vlerë e cila pritët të shtohet për shkak të interesave.

Mosekzekutimi në afat i këtyre detyrimeve krijon risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme. Mosveprimi ose veprimet me vonesë nga ana e institucioneve respektive në këtë çështje krijojnë risk të lartë për efekte të tjera shitesë në dëm të buxhetit të shtetit, gjë që kërkon vëmendje të shtuar në vijim nga ana e ASH-së si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre vendimeve, por veçanërisht nga MFE e cila vijon në mospërputhje me qëndrimet ligjore të njëjësive të specializuara, siç është Avokatura e Shtetit.

Nga auditimi u konstatua se, pranë GJEDNJ-së janë edhe 30 çështje me statusin “Kërkesa në shqyrtim, por pa vendim”, ku praktika më e hershme daton prej vitit 2011, për të cilat Gjykata nuk është shprehur ende. Vlera ekonomike sipas pretendimit të palëve paditëse rezulton të jetë rreth 151,914,617 Euro dhe 115,300,417 ALL, por këto vlera mund të jenë të ndryshueshme në varësi të ecurisë së çështjes në gjykim, rast pas rasti.

Lidhur me stokun e detyrimeve për vendimet e Tribunalit të Arbitrazhit dhe GJEDNJ ka rezultuar:

- Nga auditimi i ekzekutimit dhe shlyerjes së *detyrimeve që rrjedhin nga Arbitrazhi Ndërkombëtar* rezulton se, sipas Raportit Vjetor për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2022, të hartuar nga ana e MFE, (fq.61), Qeveria ka regjistruar totalin e detyrimit fillestar më 1.1.2022 për 12 institucione shpenzuese, në vlerën 192.6 milionë Euro; Detyrimet e faturuara janë për 62,6 milionë Euro; Likuiduar gjithsej 18,2 milionë Euro, (nga e cila, pjesa e likuiduar gjatë vitit 2022 është vetëm 7,9 milionë Euro); Detyrimi i mbetur 63 milionë Euro; Detyrimet kontigjente janë vendosur për 111 milionë Euro, duke arritur në totalin e detyrimit të mbetur dhe kontigjent (së bashku) për 174 milionë Euro, gjë që tregon për një nivel shumë të lartë të këtyre detyrimeve me impakt ndaj buxhetit të shtetit.
- Nga ana e MFE në këtë raport është vendosur shënimi se, “informacioni bazohet në të dhënat më të fundit që janë të muajit maj 2023, të raportuara nga Avokatura e Shtetit dhe Ministrinë e Linjës/ institucionet buxhetore. Për pasojë, vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për validimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit”.
 - Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e Tribunalit të Arbitrazhit, sipas Raportit të Mesvitet të Buxhetit, MFE evidenton 161,938,494 EURO, ndërsa më datën 31.12.2022 për 173,914,609 EURO, ose me një rritje prej 11,976,115 EURO.
 - Në vlerësimin e KLSH, në përllogaritjen e detyrimeve të papaguara gjithsej nuk janë përfshirë interesat e pagueshme në vlera të konsiderueshme pas njohjes së vendimit nga Gjykata e Apelit, por që rezultojnë të jenë pjesë e stokut të detyrimeve të papaguara në ngarkim të buxhetit të shtetit.
- Nga auditimi u konstatua se, mes të dhënave të vendosura në dispozicion nga Avokatura e Shtetit dhe atyre të pasqyruara në raportin vjetor mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, publikuar

nga MFE për vitin 2022 rezultojnë mospërputhje në totalin e vlerës së detyrimit faktik më 31.12.2022 nga vendimet e GJEDNJ-së (për 30,950 EURO). Më konkretisht:

- “Detyrimet faktike nga vendimet e GJEDNJ-së (në EURO)” sipas ASH rezultojnë për 17,911,600 Euro, ndërkohë në raportin e MFE-së (raporti zbatimit të buxhetit të shtetit 2022, fq. 59), janë evidentuar për 17,880,650 Euro, me një diferencë prej 30,950 Euro, (si rrjedhojë e mos pasqyrimin në raportin e MFE-së të dy vendimeve, konkretisht “Prizreni k. Shqipërisë” me vlerë 13,450 Euro dhe “Strazimiri k. Shqipërisë” me vlerë 17,500 Euro, të cilat janë likuiduar më datën 26.1.2023 dhe nga MFE nuk janë konsideruar të likuiduara për llogari të buxhetit të vitit 2022);
- Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e GJEDNJ, sipas Raportit të Mesvitit të Buxhetit të MFE, ato evidentohen për 21,796,565 EURO, ndërsa me 31.12.2022 për 21,717,665 EURO, ose me një pakësim prej vetëm 78.900 EURO.

2.5 Shoqëritë publike dhe ndikimi i tyre në buxhet

Sipas Raportit të MFE mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2022, duke u përqendruar në tre shoqëritë e sektorit energjetik dhe ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, nga 196 institucionet ekstrabuxhetore të qeverisjes qendrore dhe lokale, impakti i sektorit energjetik si kosto dhe të ardhura të munguara në financat publike për vitin 2022, vlerësohet në rreth 33,000 milion lekë, nga rreth 5,500 milion lekë në vitin 2021, duke treguar një gjendje jo të mirë financiare të tyre.

Sipas MFE, tre ndërmarrjet e sektorit energjetik të marra së bashku, për vitin 2022 rezultojnë me humbje 24,236 milion lekë, kjo e lidhur drejtpërdrejtë me performancën e KESH SHA, humbja e së cilës është 26,708 milion lekë.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se:

- borxhi i brendshëm i garantuar (përfshirë dhe garancinë sovranë) për shoqëritë e sektorit publik në fund të vitit 2022 ka qenë në vlerën 19,875 milion lekë, me një rënie prej 3,500 milion lekë krahasuar me vitin 2021.
- detyrimet e shoqërive publike nënhamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë në fund të vitit 2022 janë në shumën 37,379 milionë lekë, 77% nga sektori energjetik dhe pjesa e tjetër nga ai ujësjellësve, me një rritje prej 2,258 milion lekë krahasuar me vitin 2021, duke sjellë kosto shtesë për buxhetin dhe në të njëjtën kohë mungesën e aftësisë paguese nga performanca ulët ekonomike-financiare aktuale dhe në perspektivë.
- për vitin 2022 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është 19,654 milion lekë, nga 17,414 milion lekë në 2021, me një rritje vjetore prej 2,239 milion lekë, duke sjellë një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjetik dhe ai i furnizimit me ujë.
- për vitin 2022 KESH SHA është mbështetur nga marrëveshja e huasë e datës 24.03.2022 me MFE-në në vlerën 8,000 milion lekë, si dhe nga mbështetja buxhetore nëpërmjet MIE në vlerën 20,000 milion lekë.
- Korporata e Investimeve Shqiptare SHA, megjithëse nuk ka hartuar dhe miratuar program ekonomik për dy vitet e fundit; nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të vitit 2022; ka rezultuar me humbje për vitin 2021 në vlerën afër 19.5 milion lekë; ortaku i vetëm (Ministri i Financave dhe Ekonomisë) në të njëjtën ditë, më 28.12.2022 ka marrë 4 vendime për zmadhim dhe zvogëlim kapitali me efekt neto në rritje kapitali në vlerën 2,120 milion lekë, pa ndonjë argument, rezultat apo kërkesë ligjore, si dhe për tre vite nga Korporata e Investimeve Shqiptare SHA nuk është paraqitur e realizuar asnjë projekt.

Nga auditimi i kryer në DPT ka rezultuar se OSHEE në fund të vitit 2022 ka detyrime tatimore të papaguara 5,011 milion lekë, duke u renditur në grupin e subjekteve me detyrimet më të larta në shkallë vendi.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se veprimtaria e MFE ka shfaqur mangësi në monitorimin dhe kryerjen e analizave financiare të performancës së shoqërive publike kryesore, pasi nuk ka arritur të zbusë dhe të frenojë vijimin e ndikimit negativ të tyre në financat dhe buxhetin e shtetit.

Për periudhën objekt raportimi, dëmi ekonomik në total i konstatuar në shoqëritë publike që i përket vitit 2022 është në shumën 4,590,611 mijë lekë, kryesisht në zërin të tjera (energji elektrike e faturuar e pakontraktuar, kamatë-vonesa etj.), në shpenzimet operative 1,181,271 mijë lekë etj.

Gjithashtu, janë evidentuar të ardhura të munguar në buxhetet e tyre në shumën 1,545 mijë lekë nga keqadministrimi i pronës shtetërore.

Nga auditimi kanë rezultuar 6,456,116 mijë lekë efekte negative në të ardhura (detyrimeve që koncesionarët kanë ndaj Albpetrol SHA) si dhe efekte negative në shpenzime në shumën 867,830 mijë lekë, kryesisht në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime në shumën 499,244 mijë lekë, 245,626 mijë lekë në shpenzimet për investime etj.

KLSH ka kryer auditimin në 7 shoqëri publike, nga të cilat 3 prej tyre kanë rezultuar me gjetje me impakt në buxhetin e vitit 2022, si më poshtë:

Nga Auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në *Albpetrol SHA*, për periudhën e veprimtarisë janar 2021 - dhjetor 2022, KLSH ka arritur në konkluzionin se janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur kanë qenë materiale, të përhapura të cilat kanë justifikuar dhënien e një *opinionit të kundërt*¹⁶. Kanë rezultuar të ardhura të munguara në shumën prej 6,456,116 mijë lekë e shkaktuar kjo prej detyrimeve që koncesionarët kanë ndaj Albpetrol SHA në 6 raste.

Në fushën e shpenzimeve rezulton se Shoqërisë Albpetrol SHA i është shkaktuar dëm ekonomik në total në vlerën prej 4,535,035 mijë lekë:

- 3,013,481 mijë lekë për energji elektrike të faturuar dhe të pakontraktuar. Për sa më sipër KLSH ka rekomanduar nxjerrjen e përgjegjësive për detyrimet që shoqëritë koncesionare kanë ndaj shoqërisë Albpetrol SHA Patos për energjinë e shitur/faturuar me dhe pa kontrata, si dhe ndjekja e të gjitha rrugëve administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës së mësipërme, për të shmangur lindjen e borxhit të keq;
- 1,180,887 mijë lekë për shkak të mos përllogaritjes së saktë të kamatëvonesave ndaj shoqërisë Bankers Petroleum;
- 170,092 mijë lekë për shkak të trajtimit ushqimor të punonjësve, duke mos kryer azhurnimin e termave të kontratës kolektive sipas kuadrit ligjor e rregullator në fuqi;
- Prej mos marrjes së masave për lajmërimet e detyrueshme të institucioneve doganore dhe tatimore në masën prej 169,286 mijë lekë nga gjobat relative në ngarkim të shoqërisë.
- 558 mijë lekë për shkak të pagesave të përfituara padrejtësisht për dieta;
- 729 mijë lekë për shkak të pagesave të përfituara padrejtësisht për mos respektim të kushteve kontraktuale në dy raste.

¹⁶ *Opinion i kundërt* në auditimet e përputhshmërisë jepet kur aspektet e mospërputhjeve janë materiale dhe të përhapura, veprimtaria e subjektit nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor, dhe rregullator në fuqi.

Gjithashtu, për po këtë periudhë ka rezultuar përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet i fondeve në shumën prej 243,560 mijë lekë, e cila ka ardhur si pasojë e vlerësimeve të gabuara të procedurave të prokurimit në tre raste.

- Nga Auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në *OSHEE SHA*, për periudhën e veprimtarisë korrik 2020 - dhjetor 2022, KLSH ka arritur në konkluzionin se ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të cilat janë materiale, por jo të përhapura që kanë justifikuar dhënien e një *opinionit të kualifikuar*.

Nga auditimi në fushën e shpenzimeve rezulton një dëm ekonomik prej 6,628 mijë lekë si pasojë e likuidimeve të punimeve të pakryera gjatë zbatimit të kontratave për punime ndërtimi.

Gjithashtu, nga auditimi i shpenzimeve ka rezultuar një përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet i fondeve prej 622,204 mijë lekë të detajuara si më poshtë:

- 122,960 mijë lekë prej mos ndjekjes me korrektësi të zbatimit të kushteve kontraktore në drejtim të prodhimit të energjisë elektrike jo vetëm nga këto centrale fotovoltaike;
- 286,235 mijë lekë si rezultat i vazhdimit të dietës ushqimore më tepër nga sa përcaktohen në aktet ligjore për kontratat kolektive;
- 23,843 mijë lekë si pasojë humbjes së çështjeve gjyqësore prej largimeve të padrejta nga puna;
- 189,166 mijë lekë si pasojë e dhënies së shpërblimeve jo konform rezultateve financiare të shoqërisë.

- Nga Auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në *Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA*, për periudhën e veprimtarisë qershor 2021 - tetor 2022, KLSH ka arritur në konkluzionin se janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të cilat kanë qenë materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e një *opinionit të kualifikuar*.

Në fushën e të ardhurave ka rezultuar një dëm ekonomik prej 1,545 mijë lekë, si pasojë e përfitimit tepër nga ana e qiradhënësit prej mos respektimit të kushteve kontraktuale të qirasë mes palëve.

Nga auditimi në fushën e shpenzimeve rezulton një dëm ekonomik prej 48,948 mijë lekë, si më poshtë:

- 47,986 mijë lekë si pasojë e mos respektimit të kushteve kontraktuale të qirasë mes palëve;
- 961 mijë lekë si pasojë e rritjes së paargumentuar së kostove në fazën e hartimit të preventivit dhe zbatimit të kontratës.

Ndërsa nga auditimet e kryera në 4 subjektet e tjera: Hekurudha Shqiptare SHA, OST SHA, Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA, pavarësisht se në aktivitetin e audituar kanë pasur pjesërisht ose plotësisht vitin 2022, gjetjet me impakt financiar i përkasin periudhave të mëparshme.

- KLSH ka kryer Auditimin e Performancës me temë "*Performanca e shoqërive publike të sektorit energjetik në administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021-2022*", në KESH SHA, OST SHA, OSHEE SHA dhe Entin Rregullator të Energjisë, në përfundim të të cilit është dalë me mesazhin:

"Krizë globale energjetike u shoqërua me rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi dhe me mungesë të likuiditeteve financiare të shoqërive të sistemit elektroenergjetik shqiptar, duke vështirësuar garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike.

Keqmenaxhimi i kaskadës së Drinit, solli si pasojë rënien e rezervës hidroenergjetike në liqenin e Fierzës dhe rritjen e kërkesës për import të energjisë elektrike, në një periudhë që përkon me çmime shumë të larta të energjisë elektrike në bursë.

Ndodhur në këto kushte, Qeveria Shqiptare, injektoi nëpërmjet instrumenteve financiarë 165 milion euro dhe 20 miliard lekë, që sistemi elektroenergjetik të mos kalonte në kolaps.

Vlera e importit të energjisë elektrike për 6 mujorin e parë të 2022, u rrit me 156% krahasuar me vlerën e këtyre importeve për vitin 2021.

Shpenzimet për blerjen e energjisë nga importi për vitin 2021 dhe 6 mujorin e parë 2022, arritën vlerën 659,982,839 euro. Strategjitë e ndjekura nga sistemi për diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike, kanë rezultuar deri tani jo eficiente, duke sjellë ekspozimin e përhershëm të sistemit elektroenergjetik kundrejt riskut meteorologjik. Kjo si pasojë, ka sjellë rritjen e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga importi me çmime të larta. KESH përveç disa nismave fillestare në investime për burime fotovoltaike, është larg realizimit të objektivave strategjike, për diversifikimin e portofolit gjenerues, me energji të rinovueshme.

Një nga sfidat e tjera të sistemit, ngelet niveli i lartë i humbjeve në shpërndarjen e energjisë elektrike, e vlerësuar 21% për 2021 dhe 20% në 2022. Niveli i lartë i humbjeve, është pasojë e investimeve të pamjaftueshme në infrastrukturën e sistemit të shpërndarjes dhe mos implementimit të sistemit inteligjent të matjes.

Siguria kibernetike, gjithashtu mbetet një çështje sensitive, në kushtet kur sistemi elektroenergjetik është i klasifikuar, si infrastrukturë kritike e rëndësisë së veçantë për sigurinë kombëtare.

Garantimi i sistemeve të informacionit dhe ruajtja e të dhënave korporative, kërkon që shoqëritë e sektorit elektroenergjetik, të certifikohen me standardin ISO 27001.

Krahas masave të marra për përbalimin e krizës së energjisë elektrike, Qeveria Shqiptare duhet të gjejë zgjidhje të qëndrueshme dhe eficiente për vënien në funksion të TEC-it të Vlorës, si dhe fillimin e operimit të bursës shqiptare të energjisë, për ta bërë të plotë modelin e tregut të energjisë.”

2.6 Rezultatet e auditimeve në fushën e shpenzimeve

2.6.1. Auditime të përputhshmërisë dhe/ose financiare

Nga auditimi në MFE, për aktivitetin e vitit 2022, krahas trajtuar sa më sipër në fushën e shpenzimeve, në mënyrë të përmbledhur ka rezultuar:

- Nga auditimi mbi detajimin e fondeve për investimeve publike me financim të brendshëm të miratuara me ligjin nr. 115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, konstatohet se janë detajuar në institucione të ndryshme 6 Projekte Investimi me përshkrimin “Fond i ngrirë”, me vlerë fillestare 4,325 mijë lekë, në 12 programe të ndryshme buxhetore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore për përkufizimin e projektit të investimit publik. Institucionet më përfaqësuese ku janë detajuar këto fonde përgjatë vitit përfshijnë: Aparatin e Ministrisë së Infrastrukturës si dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar. Rezervimi i fondeve të këtyre investimeve sipas këtij detajimit fillestar nuk krijon mundësinë e zhvillimit të procedurave për prokurimin përgjatë vitit apo kryerjen e pagesave në rast të detyrimeve të mbartura dhe në vijim kryhen rishpërndarje ndërmjet projekteve për çdo njësi shpenzuese.
- Nga auditimi mbi planifikimin, realizimin dhe raportimin e investimeve kapitale me financim të brendshëm konstatohet se raportohet si investim projekti me përshkrim “Vendime gjyqësore në proces” me vlerë për 180,000 mijë lekë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, ndërkohë që për planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve duhet të ishin

përdorur llogaritë e shpenzimeve operative. Nga ky institucion raportohet vlera 32,085 mijë lekë, si investim; vlerë e cila përfaqëson detyrime të prapambetura të periudhave të mëparshme duke filluar nga viti 2016.

Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 883,196 mijë lekë, me kod projekti M56032 “Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale”, ndërkohë që këto fonde përdoren në llogari bankare të nivelit të dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për aktivitetin e shpenzimeve korrente të institucionit.

Nga AZHBR konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 “Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 1” në shumën 591,615 mijë lekë, kapitulli 3 “kosto lokale”. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investorëve. Pjesa e buxhetit të shtetit në kuadër të bashkëfinancimit është në masën 25%, ndërkohë që konstatohet se për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar.

- Nga auditimi i të dhënave në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2022, sipas modulit të kontratave në SIFQ, konstatohet se janë nënshkruar 1,319 kontrata pas datës 15 Tetor për investimet publike, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, ku: 688 kontrata janë nënshkruar nga institucionet e qeverisjes qendrore, me vlerë të kontraktuar për vitin 2022 prej 7,997 milion lekë dhe vlerë totale të kontraktuar gjithsej 27,986 milion lekë dhe 631 nga institucionet e vetëqeverisjes vendore, me vlerë të kontraktuar për vitin 2022 prej 2,048 milion lekë dhe vlerë totale të kontraktuar gjithsej 6,482 milion lekë. Lidhja e kontratave pas kësaj date krijon kushtet për lindjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë për përdorim pa efikasitet të fondeve buxhetore në nivelin e 20% të kostos së projektit në vitin e parë të zbatimit të tij, pasi koha e mbetur për përdorimin e këtij fondi deri në fund të vitit buxhetor është shumë e shkurtër.
- Nga auditimi mbi investimet e raportuara gjatë vitit 2022, konstatohet se 85 institucione të qeverisjes qendrore kanë paguar detyrime të prapambetura në vlerën 6,169 milion lekë të cilat përfaqësojnë rreth 6.8% të investimeve kapitale me financim të brendshëm të realizuara, në kundërshtim me përcaktimet e LOB, duke mbivlerësuar investimet e raportuara faturat e të cilave konstatohet se datojnë që prej vitit 2014.
- Nga FSHZH, në 17 raste për 9 projekte investimi në vlerën 399 milion lekë, është bërë parapagim i kontratave, të cilat nuk rezultojnë të jenë të një rëndësie të veçantë, ashtu sikurse përcaktuar në nenin 61 të LOB dhe në Udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit.
- Në SIFQ gjatë vitit 2022 rezultojnë 642 rekorde unike të dokumentit urdhër-prokurim me vlerë totale 76,190 milion lekë, kjo për faktin se elektronikisht regjistrimi i urdhër-prokurimit është i mundur vetëm për institucionet që kanë akses të plotë në SIFQ, aktualisht vetëm 15 të tilla. Nga kryqëzimi i të dhënave të bazës së të dhënave të urdhër-prokurimeve me të bazën e të dhënave të vendosura në dispozicion për kontratat e regjistruara në SIFQ përgjatë vitit 2022 janë konstatuar parregullsi të cilat janë iniciuar nga institucionet buxhetore dhe janë lejuar të procesohen nga sistemi i thesarit si në vijim:
 - 102 raste të urdhër-prokurimeve të regjistruara në sistem në vitin buxhetor 2022 të cilat lidhen me një kontratë të nënshkruar në vitet e mëparshme buxhetore (2011-2021), pra procedura e prokurimit ka përfunduar para se urdhër-prokurimi të regjistrohet në SIFQ dhe regjistrimi është formal dhe në shkelje të afateve ligjore. Institucionet me problematikë më të mëdha në këtë konstatim përfshijnë MSHMS, AKSHI, ARRSH dhe Bashkia Tiranë.
 - 52 raste në të cilat urdhër-prokurimet rezultojnë të jenë regjistruar 0 deri në 10 ditë diferencë nga data e kontratës, afat ky i pamundur për realizimin e një procedure

prokurimi. Konstatohet se radha e regjistrimit në SIFQ është formale dhe pa asnjë vlerë për kontrollin dhe bllokimin e fondeve disponibël përpara fillimit të procedurës së prokurimit.

Konstatohet se, dokumenti i urdhër-prokurimit nuk regjistrohet në sistem në shkelje me Udhëzimin nr. 9/1, datë 19.01.2018, pjesa III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, pika 15.1 “Faza para angazhimit”.

- Nga auditimi i SIFQ, konstatohet se nuk është respektuar afati 3 ditor për regjistrimin e kontratave nga data e nënshkrimit të tyre në 10,602 raste në vlerën 116,288 milion lekë në kundërshtim me pikën 157 të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Njësitë e qeverisjes vendore zënë 27% të totalit të vonesave në regjistrime. Për më tepër, konstatohet se gjatë vitit 2022 është lejuar regjistrimi i kontratave të “vjetra” në vlerën 13,500 milion lekë që i takojnë periudhës 2007-2020, ndërësa për vitin 2021 në 138 raste në shumën 21,314 milion lekë, problematikë e cila na çon në konkluzionin ka ende kontrata të lidhura por të peregjistruara në Thesar, në pritje të fondeve buxhetore, me ose pa punime të kryera, ndaj auditimi nuk mund të konfirmojë plotësinë e databazës së angazhimeve në SIFQ.
- Nga auditimi u konstatua mos regjistrim në SIFQ i planit të pagesave të kontratës e kushtëzuar nga mos detajimi i planit buxhetor për projekte të investimeve sipas parashikimeve të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Konstatohen raste të projekteve për të cilat ka angazhim në vitin aktual në vlerë të përcaktuar, angazhim 0 lekë për vitet 1 dhe 2 dhe në vijim angazhim në vitin e tretë dhe të katërt në vlerë, përfundim i formuar në bazë të raportit më të fundit për vitin buxhetor, atë të muajit dhjetor të vitit 2022. Ndryshimi i shpeshtë i projekteve të investimit me rialokime apo akte normative si dhe ndërmarrja e angazhimeve në projekte të reja investimesh në kuadër të tavaneve të përcaktuara për programet e shpenzimeve të miratuara, ka sjellë shtyrjen e planit të pagesave si pasojë e planit buxhetor me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura. Në fund të vitit buxhetor 2022 paraqiten edhe projekte përmbledhëse, të cilët e kanë të shtyrë të gjithë shumën e angazhimit të investimit në tejkalim të buxhetit të miratuar tre vjeçar me rreth 50,000 milion lekë.
- Nga auditimi është konstatuar se fondet disponibël të projekteve të investimeve janë buxhetuar vetëm për paguar detyrimet e prapambetura të këtyre projekteve/kontratave, pra detajimi/rishpërndarja buxhetore është ekzaktësisht e barabartë me vlerën e faturës (ve) të prapambetura, përkatësisht në vlerën 3,800 milion lekë. Në njësitë e qeverisjes qendrore, efektet e këtyre konstatimeve vlerësohen në shumën 3,640 milion lekë.

Janë konstatuar raste në të cilat pagesat nga buxheti i shtetit për shlyerjen e faturave kryhen në të njëjtën ditë ose deri në 10 ditë diferencë nga data e regjistrimit të kontratës (data e krijimit të kontratës) në sistemin informatik financiar të qeverisë, për 202 projekte investimesh të procesuara për pagesë në vlerën 2,168 milion lekë, që dëshmon formalitetin e regjistrimit të transaksioneve në sistemin informatik financiar të qeverisë dhe jo duke ndjekur procedurat e parashikuara në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit si pasojë e anashkalimit të kontrolleve të brendshme.

Sa i takon regjistrimit të kontratave dhe kryerjes së pagesës së urdhër shpenzimeve në SIFQ, konstatohen raste në të cilat data e kontratës (data e kontratës fizike) sipas modulit të kontratave është në të njëjtën ditë apo me diferencë deri në 10 ditë nga regjistrimi i urdhër shpenzimit të parë për projektet e investimit të identifikuar me problematika, në 63 projekte investimesh në shumën 471 milion lekë, që dëshmon për kryerjen e pagesave drejt përfituesve të fondeve publike në një kohë shumë të shkurtër nga kryerja lidhja e kontratës, afat i pamjaftueshëm për kryerjen e punimeve apo marrjen në dorëzim të tyre. Gjithashtu në disa raste përfaqësuese këto projekte investimesh përfshijnë lëvrimin e

fondeve në formën e paradhënieve për kryerjen e punimeve, në kundërshtim me parashikimet e bëra në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit duke parafinancuar investimet publike dhe duke mbivlerësuar treguesit e tyre.

- Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të pagesave të procesuara në sistemin SIFQ u konstatuan tejkalime të afateve të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, si nga ana e njësisve shpenzuese ashtu edhe nga degët e thesarit, konkretisht 27,311 fatura në total me vlerë 52,579 milion lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor nga data e furnitorit të përcaktuar në LOB, ku 4,033 prej tyre i përkasin shpenzimeve për investime me vlerë 34,203 milion lekë, ndërkohë që pjesa tjetër prej 23,279 rastesh i përket shpenzimeve operative me vlerë totale prej 18,376 milion lekë.
Për të paktën 20 raste në rreth 2,700 milion lekë janë konstatuar regjistrime dhe pagesa pjesore të faturave, të cilat janë më të vogla se sa vlera e detyrimit të lindur sipas faturës së furnitorit, kjo me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël.
9 transaksione në vlerën 65.4 milion lekë janë kryer në tejkalim të afatit 30 ditor nga data e regjistrimit, të parashikuar në kuadrin ligjor për menaxhimin e shpenzimeve publike.
- Nga auditimi konstatohet se pjesa më e madhe e ekzekutimit të shpenzimeve/investimeve përqendrohet në muajin dhjetor në mbyllje të vitit buxhetor, ku në muajin dhjetor 2022 janë procesuar për pagesë edhe fatura të viteve të mëparshme apo të muajve të mëparshëm të vitit 2022. Nga 65,890 milion lekë fatura të kaluara me datë libri të madh në dhjetor 2022 konstatohen rreth 20,800 milion lekë të pagesa të faturave që i përkasin muajve janar-nëntor 2022, nga ku konstatohet se ekzekutimi i buxhetit nuk është i njëtrajtshëm përgjatë vitit 2022 duke sjellë problematika si pasojë e planit buxhetor, në planin e arkës për procesimin e tyre.
- Sa i takon saktësisë dhe plotësisë informacionit të raportuar në treguesit fiskalë të konsoliduar për vlerat e raportuara të shpenzimeve operative dhe investimeve, u konstatuan nga baza e të dhënave të pagesave deri në 31.03.2023 transaksione me datë fature të vitit 2022 dhe të mëparshëm për të cilat është përdorur buxheti i vitit 2023, të papaguara në kohë në shumën 8,377 milion lekë. Përkatësisht, grupuar në investime dhe shpenzime operative, klasifikimi paraqitet në shumën 5,677 milion lekë për investime dhe 2,700 milion lekë për shpenzime operative.
- Nga auditimi mbi krahasimin e datës së ekzekutimit të transaksioneve të pagesave në SIFQ me datën e regjistrimit të urdhër shpenzimit konstatohen raste në të cilat edhe sipas muajve janë ekzekutuar pagesa jo sipas parimit hyrje e parë - dalje e parë në sistem (FIFO), si dhe ekzekutime të pagesave të faturave të regjistruara në data të mëvonshme, përpara urdhër shpenzimeve të regjistruara në data më të hershme, në kundërshtim me përcaktimet në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit Ky konstatim rezulton i përhapur përgjatë gjithë muajve të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2022, për 21 data të ndryshme të vitit buxhetor, ku pagesat e kryera nuk kanë ndjekur në disa raste parimin FIFO.
- Gjatë vitit 2022, është konstatuar përdorimi i instrumenteve të shkëmbimit SWAP si një mjet për menaxhimin e likuiditetit të lirë në monedhën EUR dhe SDR, të cilat paraqiten me tepricë dhe nga konvertimi i tyre fondet e siguruara në monedhë kombëtare janë përdorur për shlyerjen e kërkesave për pagesë në monedhë kombëtare. Nga shqyrtimi i listës së transaksioneve të SWAP, rezulton se përgjatë vitit 2022, është vazhduar në drejtim të përdorimit të instrumenteve SWAP me Bankën e Shqipërisë në monedhat e huaja në të cilat administrohet TSA, përdorimi i konvertimit të njëanshëm si dhe kryerja e një depozitimi për vendosje në depozitë kur ka pasur tepricë të mjeteve monetare.

- Përgjatë vitit 2022, gjendja e likuiditeteve ka rezultuar e lartë ku në total, për pjesën më të madhe të vitit ajo paraqitet ndërmjet intervalit 60,000 milion lekë – 100,000 milion lekë. Pjesa më e madhe e tepricave është akumuluar përgjatë gjithë vitit në TSA në Euro me një interval të konvertuar në lekë ndërmjet 40,000 milion lekë – 70,000 milion lekë. Sa më sipër, rezulton se nuk janë administruar siç duhet mjetet monetare duke kryer shumë pak investime të mjeteve monetare në vendosje në depozitë në rastin e tepricave të përkohshme të likuiditetit, sidomos për mjetet monetare në valutën Euro. Akumulimi i gjendjes konstatohet se është krijuar nga huamarrjet e mbartura nga viti i kaluar në monedhën Euro si pasojë e Eurobondit të emetuar si dhe nga mbështetjet buxhetore. Mungesa e ndjekjes së duhur e këtyre tepricave jo normale të krijuara gjatë administrimit nuk është në përputhje me përcaktimet e LOB. Për më tepër, mbajtja e tepricave në valutë përtej nevojave normale të funksionimit të sistemit të pagesave i ka ekspozuar mjetet monetare të qeverisjes së përgjithshme ndaj riskut të kursit të këmbimit, ku si pasojë gjatë vitit janë krijuar humbje nga kursi i këmbimit në rreth 4,600 milion lekë të cilat janë reflektuar në zërin të tjera, nën financimin e deficitit në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar. Kjo vlerë paraqet pakësim të mjeteve monetare si pasojë e rivlerësimit me kursin e datës së fundit të vitit si dhe efektin e humbjeve nga konvertimi nëpërmjet instrumenteve SWAP. Kryerja e konvertimeve me anë të instrumenteve SWAP përgjatë vitit 2022, për përballimin e nevojave për flukse dalëse në monedhën kombëtare ka rezultuar me humbje të konsiderueshme si pasojë e diferencës ndërmjet kurseve të ditës dhe kurseve të së ardhmes në vlerën 580 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk janë shfrytëzuar mundësitë për kryerjen e konvertimeve të njëanshme të monedhës së huaj në monedhë vendase.
- Nga Ministria e Mbrojtjes është kryer blerje për armatim të lehtë municion dhe makineri pajisje me vlerë totale prej 1,070,391.00 USD, i cili është klasifikuar si “Investim i trupëzuar” në llogarinë ekonomike 231, nënlllogaria 4320, ndërkohë që përbërja e kësaj vlere përfshin edhe elementë të tjerë që nuk plotësojnë kushtet e klasifikimit si investim: mbështetje logjistike, mbështetje teknike; dhe shpenzime administrative, të cilat përbëjnë rreth 39% (419,053.00 USD) të vlerës totale. Klasifikimi i këtyre shpenzimeve në totalin e vlerës si Investim i Trupëzuar, rrit shpenzimet e amortizimit në vijimësi, duke amortizuar edhe shpenzimet.
- Nga auditimi i transfertave në valutë për vitin 2022, është konstatuar se për shkak të përdorimit të llogarisë “Depozitë e Qeverisë në Euro” për 8 transfertat në valutën USD është kryer shpenzim i panevojshëm në vlerë totale prej 43,276 mijë lekë, si diferencë e vlerave në urdhër-shpenzime nga konvertimi USD-ALL dhe nga transaksionet e konvertimit EUR-USD-ALL për transfertat.
- Nga auditimi konstatohet se, aparati i MFE, si njësi shpenzuese më vete nuk harton raporte monitorimi për fondet e planifikuara dhe realizuara, pasi kryen pagesa dhe nëpërmjet programeve të tjera, të njësisë të veta të varësisë, duke mos mundur identifikimin e buxhetit që administrohet vetëm nga aparati i MFE.
- Nga auditimi i tre procedurave të prokurimit konstatohet se, nga Njësia e Prokurimit me procesverbalet përkatëse janë miratuar Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) ku janë përcaktuar dhe kriteret e veçanta për kualifikim, por nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter të vendosur dhe dokumentuar në procesverbal, ndërsa në dy raste ka vepruar me dy standarde në vendosjen e kriteve, në kundërshtim me kërkesat e LPP. Është konstatuar kryerja e rikonstruksionit dhe shpenzimeve nga buxheti i shtetit për një objekt që nuk është në pronësi të shtetit, si dhe skualifikim i operatorit ekonomik me ofertë ekonomike më të leverdishme, duke i shkaktuar përdorim të buxhetit pa efektivitet gjithsej në shumën 34,446 mijë lekë.

- Për vitin 2022 në të ardhurat e Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rezulton se është kontabilizuar edhe llogaria 7780100 “Korrigjime nga vitet e kaluara”, në vlerën totale 84,304 mijë lekë, nga të cilat vlera 80,104 mijë lekë, referuar ditarëve kontabël dhe librit të madh, i përket kthimit të huasë që MFE i ka dhënë Fondit Kombëtar, në vitet e mëparshme, për IPA 2012, IPA 2013, hua e cila duhet të ishte kthyer brenda vitit kur është bërë disbursimi i shumës. Si rezultat, janë mbivlerësuar të ardhurat e vitit 2022, për vlerën 80,104 mijë lekë, pasi transaksioni i arkëtimit nga Fondi Kombëtar është kthim i një shume të dhënë hua që trajtohet si një shlyerje nga debitorët e vitit të kaluar.
- Konstatohet se nuk ka përfunduar procesi i transferimit të aktiveve të teknologjisë së informacionit nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë te Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Konstatohet se Ministria e Financës edhe Ekonomisë ka kontabilizuar në asetet e veta, edhe asete mbi të cilat nuk ka kontroll, vlerën e konstruksioneve dhe rikonstruksioneve, pra investimeve që janë kryera në shkollat profesionale, për të cila çdo vit llogaritet edhe vlerat e amortizimit. Nga auditimi rezulton se llogaritë e investimeve me burim financime të huaja janë të nënvlerësuar, pasi nuk raportohen projektet me financim të huaj të zbatuara nga CFCU dhe Fondi Kombëtar. Në rastin e krijimit të aseteve nëpërmjet projekteve me financim të huaj, në pasqyrat financiare paraqitet vlera e TVSH së investimit të kryer dhe jo kosto e plotë e asetit.
- Një problematikë e evidente për administrimin e pronës mbetet edhe bilanci i bonove të privatizimit, të shpërndara qytetarëve shqiptarë sipas kontributeve në ekonomi, që do të përdreshin në privatizimin e pronës shtetërore, ku sipas të dhënave zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezulton se, gjithsej janë printuar bono privatizimi me vlerë nominale 83,302 milion lekë, prej të cilave, vlera prej 72,723 milion lekë i është shpërndarë Bankës Tregtare dhe vlera 10,579 milion lekë është gjendje e pashpërndarë në Bankën e Shqipërisë në formën e arkës stok. Aktualisht nuk disponohen statistika mbi përdorimin e bonove të privatizimit për blerjen e pronave, apo sa janë në qarkullim të lirë, edhe pse afati i përdorimit të tyre është shtyrë vit pas viti çka vështirëson gjurmimin e tyre dhe riskun e rifutjes në përdorim.
- Nga auditimi u konstatua se për vitin 2022 në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë kryer likuidime për Vendime Gjyqësore të formës së prerë për ish-punonjës, gjithsej në vlerën 13,567 mijë lekë duke shkaktuar efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit, për të cilët nuk janë analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë nga titullari.

Sa i takon publikimit të raporteve të ndryshme dhe informacionit të nevojshëm për publikun apo palët e treta, konstatohet se në faqen zyrtare të MFE nuk janë përditësuar raportimet e viteve të fundit dhe as të vitit 2022.

· *Nga auditimi i institucionit të Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në auditimin e projekteve të vitit 2022 rezultoi se:*

- Nuk është bërë shpallja e thirrjes së parë të mbështetjes me grant sipas një prioriteti specifik, megjithëse sipas përcaktimit në pikën 3, të nenit 14, të Ligjit 25/2022, thirrjet për grant do të hapen sipas prioritete të përgjithshme që duhet të plotësojnë projektet konkurruese, Veprimi i mësipërm sjell riskun e krijimit të një procesi të pa adresuar të mbështetjes me grant.
- Procesverbalet e Komisionit, që përkojnë me vendimet konkrete të fituesve dhe jo fituesve nuk janë shoqëruar me një relacion shpjegues si është deduktuar vlerësimi i fituesve mbi 80 pikë. Gjithashtu në rregulloren e grantit nuk ka një parashikim mbi një përqindje apo shumë kundrejt totalit të parashikuar për tu shpërndarë në këtë thirrje midis dy kategorive startup apo lehtësues, megjithëse konstatohet se më shumë se 50%, (konkretisht 56%) të

shumës së fondit të miratuar për tu shpërndarë i përket pikërisht kategorisë së lehtësuesve (dhe vetëm 44% i përket kategorisë së startup-eve).

- Nga fondi total i miratuar, referuar vendimit nr. 1 të Komisionit të Vlerësimit konstatohet se, nga 29 përfitues të kategorisë lehtësues, 10 prej tyre ose 34% janë ente publike, prej të cilave 7 janë bashki, dhe 3 akademi. Shuma e miratuar për bashkitë është në masën 77,547 mijë lekë ose 44% të vlerës totale të miratuar. Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues së çdo aplikimi konstatohet se, në shpenzimet e kërkuara dhe të miratuara nga komisioni janë përfshirë kosto për të cilat nuk ka një preventiv, ofertë apo shpenzime të mëparshme si dokumente justifikuese mbi të cilat ato janë mbështetur. Për parashikimin e vlerës e këtyre shpenzimeve nuk ka përcaktim në rregulloren e grantit duke krijuar mundësinë e mospërputhjes së shumës së miratuar për financim dhe faturave reale që do të paraqesin fituesit në momentin e disbursimit të fondit.
- Në vendim mungon një relacion shpjegues në lidhje me skualifikimet, Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelare të startup-eve dhe lehtësuesve të skualifikuar, krahas numrit përkatës identifikues dhe pikëve të caktuara për çdo aplikant. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 “Procesverbali i mbledhjes”, pika 1.

· *Nga auditimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale* u konstatua se:

- 45 projekte investimi të realizuara në vitin 2022 me vlerë 250,909 mijë lekë, të çelura për MSHMS nuk kishin kaluar në procesin ligjor të miratimit të PBA, pra nuk kishin kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të investimeve publike.
- Nuk janë hartuar raportet e monitorimit të buxhetit për periudhat 4- mujore dhe 12 mujore, për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të aparatit, duke konstatuar kështu mangësi në drejtim të procedurave të monitorimit të buxhetit të aparatit.
- Vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë për vitin 2022 paraqiten në shumën prej 22,611 mijë lekë për ekzekutimin dhe pagesën e 13 vendimeve gjyqësore me detyrimin për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa. Komisioni i Posaçëm ka shqyrtuar vetëm një rast dhe nuk është mbledhur për vlerësimin dhe kthimin në punë të 13 punonjësve të tjerë. Mosveprimi i këtij komisioni në MSHMS për kthimin e punonjësve në punë dhe shqyrtimin e vendimeve, rëndon edhe më shumë buxhetin e shtetit me shpenzime për vendime gjyqësore.
- Në fushën e prokurimit publik, regjistrat e parashikimit nuk janë përgatitur, sipas afatit përkatës; nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit të gjitha kategoritë e mallrave dhe shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100 mijë lekë, pavarësisht se këto procedura nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik; Operatorët ekonomik fitues nuk kanë paraqitur dokumente, të cilat vërtetojnë se plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST; në dosjen e prokurimeve (por dhe në SPE) nuk janë administruar kërkesat e KVO-së për ofertën anomalisht të ulët/korrigjimin e gabimeve aritmetike; nga KVO janë skualifikuar operatorë ekonomik me arsyen e gabimit në sasinë e ofertës dhe njësie matëse, duke mos marrë në konsideratë përcaktimet e legjislacionit të Prokurimit Publik.

Nga MSHMS janë paraqitur detyrime të prapambetura për vitin 2022 ndaj të tretëve, për investime në vlerën 3,451 mijë lekë. Shuma e raportuar nuk është e saktë pasi MSHMS nuk ka njohur në kontabilitet detyrimet e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të

prerë. MSHMS e njeh si shpenzim në momentin e likuidimit, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit organik të buxhetit.

· Nga auditimi i *Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit* rezultoi se:

- Nga 65 investimet që janë referuar që prej planifikimit buxhetor afatmesëm dhe deri në realizimin e tyre për vitin 2022, 24 prej tyre ose 37% në shumën 78,974 mijë lekë nuk janë planifikuar në PBA 2022-2024, nga të cilat 2 investime janë planifikuar dhe miratuar në buxhetin fillestar të vitit 2022.
- Është konstatuar se nuk janë hartuar raportet e monitorimit të buxhetit për periudhat 4-mujore dhe 12 mujore, për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të aparatit, duke konstatuar kështu mangësi në drejtim të procedurave të monitorimit të buxhetit të aparatit.
- Për vitin 2022 është paguar shuma prej 8,146 mijë lekë, për ekzekutimin dhe pagesën e 9 vendimeve gjyqësore me detyrimin për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa.
- Në fushën e prokurimit publik, regjistrat e parashikimit nuk janë përgatitur, sipas afatit përkatës; në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim (teknikisht dhe ligjërish), Komisioni i marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim, por plotësimi i tyre është thjesht formal etj.
- Nga auditimi i zbatimit të kontratës “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*” rezultuan disa pasaktësi për punime të pakryera, por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve në vlerën 264 mijë lekë pa TVSH.
- Në kontratën me objekt “*Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ekzistuese (Burrel, Kukës, Libohovë, Përmet, Krujë)*” nga verifikimi në vend-depozitimin e Bashkisë Kukës mbetjet urbane nuk depozitoheshin në të, vetëm në hyrje të saj kishte një sasi të vogël mbetjesh inerte të cilat bllokoni hyrjen e landfillit. Nga ana e Autoritetit kontraktor nuk ka një monitorim të situatës se ku depozitohen mbetjet urbane të kësaj bashkie pasi objekti është në periudhën e garancisë dhe nuk ka kaluar si investim kapital përfituesit. Ndërtimi i vend-depozitimit është kryer si rezultat i situatës emergjente të mbetjeve në bashkinë Kukës. Nisur nga fakti se ky vend-depozitim nuk është vendosur në shfrytëzim edhe pse ka kaluar një vit nga përfundimi i punimeve dhe marrjes në dorëzim gjë që tregon se, situata e mbetjeve në Bashkinë Kukës nuk ka qenë emergjente dhe investimi i kryer nuk ka qenë efikas. Për sa më sipër vlera e investimit prej 27,921 mijë lekë pa TVSH, të kryer në vend-depozitimin në Bashkinë Kukës, nga KLSH konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike deri në këtë fazë të menaxhimit të landfillit.
- Nga auditimi i projekteve për zhvillimit të turizmit rezultoi se:
 - MTM nuk ka zhvilluar proces studimi dhe planifikimi, sipas prioriteteve që ministria duhet të ketë çdo vit, duke mos përcaktuar qartë, zonat me përparësi zhvillimin e turizmit dhe burimet turistike për të cilat do të zhvillohen këto projekte dhe të cilat më pas të do të shndërrohen në produkte turistike. Veprime të cilat mbartin riskun e një procesi të pa adresuar, të përsëritjes së projekteve për fusha të njëjta, të cilat kanë ndodhur gjatë tre viteve.
 - Komisionet e përzgjedhjes së aplikantëve kanë në përbërje 3-4 anëtar, veprime në kundërshtim me ligjin.
 - Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve është mbledhur me pjesëmarrjen e anëtarëve dhe ka përpiluar procesverbale, ku japin listën e përfituesve dhe për të skualifikuarit

shprehen se ka mungesë dokumentacioni ose kërkesa për financim kalon 50% të vlerës së projekti. Në procesverbal mungon një relacion shpjegues në lidhje me skualifikimet, vlera e financimit që është kërkuar nga aplikuese dokumentacioni i cili nuk është dorëzuar etj., Komisioni është mjaftuar vetëm me një renditje në formë tabelore të projekteve që kanë aplikuar nga thirrja, ku dhe në tabelë nuk është argumentuar dhe sqaruar projekt për projekt se çfarë dokumentesh mungojnë dhe për projektet fituese nuk janë cituar dokumentacioni i dorëzuar nga përfituesi.

- Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në procesverbalet e mbajtura ndër vite nuk jep argumente në lidhje me projektet e përzgjedhura dhe të kualifikuara si fitues nëse kanë impakt në planin e zhvillimit turizmit, si dhe nëse ato projekte përputhen me prioritet e përcaktuara, ku për vitin 2022 MTM ka përcaktuar dy prioritete dhe disa shembuj të tipologjisë së aktiviteteve që synojnë arritjen e këtyre prioriteteve.
- *"Krijimi i Identitetit korporativ & Brand Book për 4 bashki"* me përfitues një PF, projekt i cili është shpallur fitues në vitin 2021, ku MTM ka lidhur kontratën me nr. 8131/1, datë 16.11.2021, e cila nuk është realizuar nga përfituesi brenda afateve të përcaktuara. Në vitin 2022, Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve e ka rizgjedhur sërish një projekt, i cili është paraqitur një herë dhe është shpallur fitues, ku përfituesi nuk e ka realizuar projektin brenda përcaktimeve të kushteve të kontratës.
- Nga MTM nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta mbi këto projekte të finalizuar, e cila ka çuar në mungesën e një analize mbi impaktin që kanë pasur dhe kanë këto projekte në zhvillimin e turizmit.
- Nga auditimi tematik në *Ministrinë e Kulturës në lidhje me Projektin "Parku i Artit"* ka rezultuar se:
 - Për procedurën e prokurimit me objekt "Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të ish Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë, Faza II", viti 2022 me fond limit 155,008 mijë lekë pa TVSH, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 21.06.2022 (anuluar) dhe në datën 15.08.2022, nuk janë argumentuar kriteret kualifikuese dhe një pjesë e tyre nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.
 - Në lidhje me kontratën me objekt "Rivitalizimi dhe përmirësimi i zonës së gjelbër – Parku i Artit, Ministria e Kulturës" me vlerën e kontratës 356,049 Euro me TVSH. Bazuar në Volumin 2, Seksioni 1, "Forma e Kontratës", në pikën 6 jepen të dhënat e kontratës e cila është e tipi Lump-Sum. Preventivi i rishikuar i punimeve dhe impakti financiar i volumit të shtuar është në masën 15% të vlerës fillestare në vlerën 5,494 mijë lekë. Me amendimin nr. 2, nr. 2147 prot., datë 14.04.2022, nga AK dhe OE, është nënshkruar ndryshimi i kontratës duke rishikuar çmimin dhe rritur vlerën e kontratës në shumën 339,608 Euro pa TVSH ose 407,530 Euro me TVSH dhe afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar data 31.05.2022. Pra shtesa e vlerës së kontratës është në shumën 42,900 euro pa TVSH (339,608 euro - 296,708 euro) ose 51,480 Euro me TVSH. Sa më sipër amendimi i kontratës është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës së punimeve nr. 1962 prot., datë 14.04.2021 pasi si, konstatohet është tjetërsuar lloji dhe tipi i kontratës, nga Lump-Sum (çelësa në dorë) në kontratë me çmim njësie, duke përfituar operatori ekonomik një vlerë shtesë prej 51,480 Euro me TVSH (5,663 mijë lekë me TVSH), të pa ofertuar, argumentuar dhe të pa mbështetur ligjërisht.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara në *Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*, me objekt:
 - Marrëveshje kuadër: "Mbikëqyrje rehabilitim i veprave të program ujitje –kullimit me lote, ndarë në 19 lote", me fond limit 19,315 mijë lekë.

- Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë për Punë Publike” me Objekt kontrate: “Rehabilitimi i veprave të programit ujitje-kullim”, ndarë në 19 lote”, nga të cilat janë audituar Loti 1, 7,8, 9 dhe 17, me fond limit 377 mijë lekë, ka rezultuar se:
 - Zbatimi i kontratave për secilin lot, lidhja, monitorimi dhe zbatimi i kontratave të mbikëqyrjes dhe të rehabilitimit të veprave të programit ujitje-kullim është kryer nga Drejtoritë e Ujitje-Kullimit sipas rajoneve përkatëse. Nuk ka gjurmë auditimi apo raportim të këtyre DUK-eve në Institucionin Qendror, MBZHR, për zbatimin në kohë dhe me sukses të këtyre kontratave dhe rrjedhimisht nuk ka informacion nga sektori i prokurimit në MBZHR, nëse këto institucione (DUK-et) kanë kryer raportimin në APP për çdo fazë të zbatimit të kontratës pasi DUK janë përgjegjëse për lidhjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratës si dhe do të jenë përfituesit e investimeve në përfundim të realizimit të punimeve nga ana e OE të shpallur fitues sipas procedurave të prokurimit. AK, MBZHR nuk ka dijeni nëse fondi prej 19,315 mijë lekë për mbikëqyrje dhe fondi prej 376,874 mijë lekë për kontrata publike të rehabilitimit të kanaleve për ujitje-kullim është përdorur me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet nga DUK-et përkatëse, mungesë menaxheriale dhe përgjegjësi e strukturave drejtuese si në MBZHR ashtu edhe në Institucionet e varësisë.
 - Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstrukcion i Godinës së QTTB Fushë Krujë dhe Ndërtim Godine”, nga inspektimi në terren i punimeve të realizuara për këtë kontratë, por në lidhje me punimet për ndërtimin e stallës së lopëve, rezultoi se ky investim, në 5 mujorin e parë të vitit 2023 është krejtësisht jo efektiv dhe i pavënë në përdorim nga ana e Ministrisë dhe QTTB, duke mos përmbushur objektivin për të cilin është ndërtuar dhe për pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondit të shpenzuar për këtë objekt në masën prej 67,634 mijë lekë me TVSH.
- Nga auditimi në *Ministrinë e Drejtësisë* rezultoi se:
 - Zëri “Shërbimi i përkthimeve zyrtare”, për të cilin rezultoi se MD ka shpenzuar 46% të shpenzimeve të vitit 2022. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbajtura për marrjen në dorëzim të përkthimeve të kryera, vihet re se në të gjitha rastet, MD shprehet se materialet i jepen përkthyesve zyrtarë të jashtëm për shkak të pamundësisë aktuale të realizimit të përkthimit nga Sektori i Përkthimit Zyrtar, ose për shkak të materialit voluminoz në fjalë. Nga auditimi rezultoi se ky arsyetim përdoret edhe në rastet e përkthimit të materialeve me përmbajtje nga 1 deri në 3 faqe, për të cilat jepet një afat kohor deri në 7 ditë, periudhë e cila është e mjaftueshme për tu përballuar nga Sektori i Përkthimit Zyrtar në MD, sektor i cili përbëhet nga 1 përgjegjës dhe 5 specialistë. Gjithashtu konstatohet se brenda një viti nuk bëhet një shpërndarje e drejtë mes përkthyesve zyrtarë të autorizuar. Nga auditimi rezultoi se për vitin 2022 nuk është miratuar kjo listë, duke bërë që të vijohet automatikisht me përkthyesit e vitit të mëparshëm. Veprimet e mësipërme bien ndesh me Udhëzimin nr. 3165, datë 12.05.2004, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar.
 - Nga auditimi i shpenzimeve për vendime gjyqësore në MD rezultoi se:
 - Vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë për vitin 2022 në paraqiten në shumën prej 20,762 mijë lekë, nga të cilat 78 mijë lekë tarifa përmbarimi për ekzekutim vendimesh për ish-punonjës të larguar padrejtësisht nga puna.
- Nga auditimi në *Agjencinë Kombëtare të Rinisë (AKR)* u konstatua se:
 - Për 12 projektet për organizatat të financuara nga AKR, mosrespektim i afateve të vendosura në kontratë për disbursimin e kësteve, dokumentacioni i dosjes së aplikimit

është i fotokopjuar, nga përfituesi është kërkuar shtyrje e afatit të kontratës, e cila është kërkuar disa ditë para mbarimit të afatit të kontratës, veprim ky në kundërshtim me nenin 13 të kontratës ku përcaktohet se zgjatja në kohë e projektit ndodh pas një kërkesë nga Përfituesi, e dërguar të paktën 1(një) muaj para përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga AKR; mungesë e raporteve përfundimtare. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me nenin 5, nenin 7, dhe nenin 13 të Kontratës e lidhur ndërmjet AKR-së dhe organizatave - palë në proces.

- Për të gjitha procedurat e projekteve për Rininë nuk ka asnjë plan monitorimi periodik me objektiva të qarta, e cila ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve. U konstatua se edhe ato subjekte që i janë nënshtruar monitorimit, në fakt nuk janë dokumentuar me shkresa zyrtare por sipas institucionit vetëm nëpërmjet e-maileve gjë e cila është e pamjaftueshme për të parë performancën e subjekteve përfituese. Monitorimi i projekteve duhet parë si një funksion thelbësor i aktivitetit të AKR-së, për të cilin duhet të ngrihen dhe funksionojnë struktura të plota dhe aktive, të afta të mbulojnë me monitorim një pjesë përfaqësuese të projekteve në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme mbi përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.
- Nga 4 projektet e fituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, 3 prej tyre në përfundim të afatit të kontratave nuk e kanë filluar ende implementimin e projekteve në kundërshtim me kontratat e lidhura. Përkatësisht :
 - Bashkia Tiranë me projektin: “*Rikonstruksioni i Qendrës Kulturore për të Rinjtë, Petrelë*” ka lidhur kontratën nr.363, datë 23.11.2021, me vlerë financimi nga AKR 3,186 mijë lekë, me afat 12 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 2,868 mijë lekë sipas kontratës.
 - Bashkia Elbasan me projektin “*Talent St-Art-Up Elbasan 2*”, ka lidhur kontratën me nr.5374, datë 03.11.2021, vlerë financimi nga AKR 5,504 mijë lekë, me afat 10 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 4,953 mijë lekë sipas kontratës.
 - Bashkia Lezhë me projektin “*Rikonstruksioni i Qendrës Rinore Lezhë*” ka lidhur kontratën me nr. 19199, datë 05.11.2021 vlerë financimi nga AKR 8,541 mijë lekë, me afat 12 mujor. Vlera e paguar nga AKR është në masën 90%, në vlerën 7,687 mijë lekë sipas kontratës.
- Në këto kushte vlera e financuar nga AKR prej 15,508 mijë lekë nuk është përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë, pasi është konstatuar se projektet ende nuk kishin nisur fazën e implementimit në kundërshtim me kontratën.
- Nga ana e kësaj njësie shpenzuese, nuk është hartuar e miratuar dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, si dhe formatet e raporteve të PBA-së;
- Nuk është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-së;
- Është konstatuar se nuk janë hartuar raportet e monitorimit të buxhetit për periudhat 4-mujore dhe 12 mujore, për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të aparatit, duke konstatuar kështu mangësi në drejtim të procedurave të monitorimit të buxhetit të aparatit.
- Nga auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ka rezultuar se:
 - janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjësit e larguar nga puna në mënyrë të paligjshme në shumën 8,210 mijë lekë, të cilat konsiderohen efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.
 - deri në përfundim të vitit 2022 Laboratori Doganor nuk e ka disponuar statusin laborator i akredituar, për shkak të mos përfundimit të procesit të mirëmbajtjes dhe kalibrimit të pajisjeve të laboratorit, ndikuar nga vonesat në procedurat respektive të prokurimit, të cilat

nuk kanë mundur të kontraktjnë në kohë operatorin ekonomik për ofrimin e këtij shërbimi. Ky proces, së bashku me aplikimin për rinovimin e certifikatës dhe ri konfirmimin e akreditimit për periudhën e ardhshme 4 vjeçare, planifikohet të përfundojë brenda vitit 2023, e për rrjedhojë kjo situatë mbart riskun që analizat e kryera nga laboratorit doganor, për periudhën pas muajit Tetor 2022 e në vijim, të jenë të kontestueshme, meqenëse janë kryer gjatë periudhës që laboratorit ka qenë i pa akredituar. Fondet disponibël të akorduara për Laboratorin Doganor pranë DPD-së prej rreth 4 milion lekë, nuk mbulojnë nevojat për shpenzime të kësaj strukture (materiale dhe pajisje laboratorike), pasi ato rezultojnë mbi 6 herë më shumë se fondet akorduara.

- pas përcjelljes së propozimeve të DPD pranë MFE në kuadër të hartimit të PBA-së së fazës së dytë 2022-2024, në vijim të shkresës së MFE, janë rishikuar prioritetet në kërkesa buxhetore, si rezultat i së cilave janë reduktuar fondet e DPD me 43,969 mijë lekë, krahasuar me limitet e planifikuara në fazën e dytë të PBA-së, duke rezultuar me diferenca të konsiderueshme mes taveve buxhetore të përcaktuara gjatë fazave të hartimit të planeve buxhetore afatmesme, krahasimisht me total kërkesat e DPD.

· Nga auditimi në *Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT)*. Nga auditimi rezultoi se :

- janë shpenzuar 3,250 milion lekë më shumë se fondi i akorduar për t'u shpenzuar për kompensimin e shoqërive të transportit me VKM nr. 225, datë 13.04.2022 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës antikrizë*" dhe VKM nr. 569, datë 25.08.2022 "*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetase, rrethqytetase dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës antikrizë faza II*".

Për 27 urdhër-shpenzimi nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës janë kryer likuidimet në tejkallim të afatit kohor 30 ditore nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", neni 52 "*Kryerja e shpenzimeve*". Likuidimi me vonesë i këtyre detyrimeve paraqet risk në rritjen e shpenzimeve buxhetore si rezultat i lindjes së detyrimeve nga penalitetet bazuar në kontratë, pavarësisht se në këtë rast nuk është kërkuar nga kontraktori pagesa e penaliteteve, në kundërshtim me Udhëzimin nr.9 date 20.03.2018 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*" pika 184.

Gjatë vitit 2022, nga buxheti i DPT janë likuiduar shpenzime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish-punonjës të larguar nga puna në mënyrë të padrejtë, në vlerën 77,667 milion lekë, e cilësuar efekt negativ për buxhetin e shtetit.

- gjatë vitit janë krijuar detyrime të reja ndaj përmbaruesve, në vlerën 7,956 mijë lekë. Në fund të vitit 2022, vlera e detyrimeve të prapambetura për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish-punonjësit e administratës tatimore është 137,269 mijë lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Titullari i Institucionit dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime, veprime në kundërshtim me pikën nr. 60, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*". Efektet financiare nga administrimi jo i duhur i burimeve njerëzore konstatohet se vijnë si pasojë edhe e lëvizjeve të shpeshta të punonjësve apo transferimeve si dhe emërimet e punonjësve marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me Kodin e Punës kryhen pa procedurë konkurrimi të hapur. Konstatohet se nga rishikimi i vlerave të projekteve të investimeve, institucioni i DPT ekspozohet në marrjen e angazhimeve buxhetore përtej fondeve të miratuara konstatuar në projektin me kod 18AV812 "*Hapësira harduer për kapacitetin e serverëve*", duke pakësuar fondet për projekte të tjera të vlerësuara prioritare në fillim të vitit deri në

masën 100% të fondit të alokuar, gjë që ka sjellë edhe mos realizimin e tyre. Rezulton se deri më 20.10.2022 kur është lidhur kontrata nga AKSHI fonde të disponueshëm janë në vlerën 215,990 mijë lekë, afërsisht 167,000 mijë lekë më pak se vlera e kontratës, pra përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndarë për këtë projekt në buxhetin e miratuar për vitin 2022.

- Kanë rezultuar angazhime të reja buxhetore jashtë afatit 15 tetor të vitit buxhetor, kryesisht për rikonstrukcione të objekteve ndërtimore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Përgjatë vitit 2022 nuk është finalizuar procesi i kalimit të inventarit në zbatim të VKM nr. 673 ,date 22.11.2017 për “Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, neni IV pika 18. Konstatohet se nuk është bërë kalimi tek AKSHI për sistemet NEXUS, Harta digjitale dhe BI për shkak të mungesës së kodit burim të softuerë-ve si edhe dhomës së serverit tek AKSHI, me justifikim se AKSHI nuk ka kushtet e duhura për ta bërë këtë kalim. Kjo situatë ka bërë që i gjithë procesi i kalimit kapital të mos konkludohet brenda vitit 2022.
- Nga Auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në *FSDKSH*, për periudhën e veprimtarisë janar 2022 deri në dhjetor 2022, në fushën e shpenzimeve, përveç sa trajtuar më lart:
 - Nga auditimi i shpenzimeve, mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore për të larguarit nga puna, rezulton se gjatë vitit 2022, janë kryer shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën totale 5,567 mijë lekë, si dhe shpenzime për ekzekutim vendimi gjyqësor, nëpërmjet shërbimit përmbartimor në vlerën 145 mijë lekë, të cilat përbëjnë efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.
 - Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik ka rezultuar se, është shkaktuar dëm ekonomik në shumën 890 mijë lekë, si dhe në disa raste janë shkelur procedurat e prokurimit publik në lidhje me; përlllogaritjen e fondit limit, përcaktimin e nevojave për prokurim të mallrave dhe shërbimeve dhe përcaktimin e specifikimeve teknike.
 - Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore është konstatuar se, nuk janë respektuar kërkesat e Rregullores nr. 1 “Për funksionimin e FSDKSH” dhe Rregullores nr. 2 “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës për drejtorinë e përgjithshme të Fondit” në lidhje me; “Ngritjen në detyrë, lëvizjen paralele dhe transferimin”, Trajnimet” si dhe “Vlerësimin periodik të punonjësve”.
 - Nga verifikimi i procesit të monitorimit të kontratave të lidhur midis ofruesve të shërbimit parësor dhe spitalor dhe Fondit, rezultoi se Drejtoria e Kujdesit Parësor dhe Spitalor (DPKS) si strukturë përgjegjëse për monitorimin e aktiviteteve të shërbimit parësor dhe spitalor, nuk ka të përcaktuar në Udhëzimin nr. 1, datë 12.01.2021 “Për llogaritjen dhe raportimin e indikatorëve të Qendrës Shëndetësore” procedurat, që duhet të ndjekë në lidhje me procesin e raportimit, verifikimit dhe konsolidimit të informacionit të ardhur nga Drejtoritë Rajonale të Fondit.
- Nga Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë i ushtruar në *Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe DRSSH Tiranë*, për periudhën e veprimtarisë janar 2022 deri në dhjetor 2022, në fushën e shpenzimeve, përveç sa është trajtuar më lart, ka rezultuar se:
 - Nga auditimi në ISSH, ka rezultuar se Drejtoria e Inspektimit, për vitin 2022 nuk ka mbuluar me certifikim 1,296 dosje pensionesh, nga 2,411 dosje të shqyrtuara, apo 52.6 % e tyre. Mos certifikimi brenda afatit 3 vjeçar, për vitet e pa certifikuara (2019-2020), përbën risk me efekt financiar për ISSH dhe buxhetin e shtetit, pasi sjell parashkrimin e tepricave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit.

- Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore ka rezultuar se ISSH, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores për Organizimin e Funksionimin e saj, e cila nuk përshtatet me strukturën organizative aktuale.
 - Nga auditimi i kryer në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, mbi saktësinë e përlllogaritjes së masës së pensioneve, dhe zbatimin e afateve në dhënien e pensioneve ka rezultuar se, nga auditimi i 148 dosjeve të pensionit, kanë rezultuar me mangësi në përlllogaritjen e masës së pensionit 56 dosje, ose 37.8 % e tyre, kjo për shkak përlllogaritjes së pa saktë të elementëve përbërës të pensionit, si pensioni bazë dhe shtesa e pensionit nga inspektorëve përpunues të dosjeve.
 - Nga auditimi mbi respektimin e aftit 42 ditor në përpunimin e një dosje pensioni, ka rezultuar se në 25 % e dosjeve të audituara, nuk është respektuar afati i përpunimit të dosjes.
- Nga Auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në *Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, për periudhën e veprimtarisë janar 2021 - dhjetor 2022*, KLSH ka evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të cilat kanë qenë materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e një *opinionit të kualifikuar*.
- Nga auditimi në fushën e shpenzimeve rezulton një dëm ekonomik prej 1,235 mijë lekë si pasojë e mangësive në procedurat e prokurimit, konkretisht në hartimin e specifikimeve teknike.
- Gjithashtu, nga auditimi i shpenzimeve ka rezultuar një përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve prej 65,125 mijë lekë e cila rezulton si më poshtë:
- 63,250 mijë lekë prej mos respektimit të kushteve kontraktuale gjatë dorëzimit të mallrave objekt kontrate;
 - 1,455 mijë lekë prej copëzimit të procedurave të prokurimit;
 - 420 mijë lekë si pasojë e mangësive në drejtim të përcaktimit të vlerës së fondit limit.
- Nga Auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në *Spitalit Universitar të Traumës, për periudhën e veprimtarisë janar 2021 - dhjetor 2022*, KLSH ka arritur në konkluzionin se ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të cilat kanë qenë materiale, por jo të përhapura, duke justifikuar dhënien e një *opinionit të kualifikuar*.
- Nga auditimi në fushën e shpenzimeve është konstatuar dëm ekonomik në vlerën prej 1,739 mijë lekë si pasojë e mangësive në procedurat e prokurimit, konkretisht në hartimin e specifikimeve teknike:
- 1,011 mijë lekë prej rritjes së vlerës së fondit limit në procedurat e prokurimit;
 - 728 mijë lekë si pasojë e kualifikimit dhe shpalljes fitues në procedurat e prokurimit të operatorëve ekonomikë me mangësi në dokumentacion.
 - Gjithashtu, kanë rezultuar përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve në shumën prej 568,257 mijë lekë si më poshtë:
 - 6,384 mijë lekë prej mangësive në drejtim të përcaktimit të vlerës së fondit limit;
 - 529,713 mijë lekë prej mangësive në drejtim të zhvillimit të procedurave të prokurimit (KVO)
 - 9,275 mijë lekë prej krijimit të stokut të barnave
 - 278 mijë lekë prej mangësive në drejtim të zbatimit të kontratës së shërbimit të pastrimit
 - 22,606 mijë lekë prej përdorimit pa pagesë të energjisë elektrike dhe sipërfaqeve të ambientit të spitalit nga Sani Service
- Nga auditimi i përputhshmërisë dhe financiar të kryer në *MFE dhe DPD “Mbi kontratën e koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”*, për

periudhën nga identifikimi/propozimi i projektit deri në zbatimin e tij në 31.12.2022, në fushën e shpenzimeve ka rezultuar:

- Referuar skemës së financimit të kësaj kontrate me ndryshimet në ligj, ku është ulur çmimi për çdo deklaratë nga 39 euro, në 25 euro për deklarata mbi 1000 Euro, dhe 5 euro nën ose barabartë 1000 Euro, dhe është përcaktuar një tarifë fikse për koncesionarin në 2,260 mijë euro për çdo pikë skanimi, e cila do të rritet me koeficientin 1.03, kontrata koncesionare nga një ofertë e pa kërkuar pa mbështetje buxhetore, është kthyer në një kontratë koncesionare me mbështetje buxhetore që konsiston në diferencën mes të ardhurave të gjeneruara nga pagesat e kryera për çdo tarifë skanimi në deklaratat doganore, dhe pagesës fikse të koncesionarit. Për këtë kontratë mbështetja buxhetore nga viti në vit referuar diferencës mes të ardhurave të gjeneruara nga aplikimi i tarifës së skanimit për çdo deklaratë, krahasuar me pagesat për çdo vend skanimi ka rezultuar në kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit që variojnë në mesatarisht 400 milion lekë për çdo vit, ku konkretisht për periudhën 2025-2022 përllogariten në rreth 3,193,466 mijë lekë.
- Përcaktimi i vendndodhjes fizike të skanerit në Portin e Durrësit ka paraqitur probleme të shumta të cilat lidhen ngushtësisht me efektivitetin e shërbimit të skanerit, deri edhe me cenimin e sigurisë kombëtare, pasi edhe procedurat e iniciuara nga DPD gjatë vitit 2021 për prokurimin e shërbimit të zhvendosjes së skanerit në një vendndodhje të re të përmirësuar me fond limit 62,377,583 ALL pa TVSH, janë në kundërshtim me pikën 5 të nenit 3 të Marrëveshjes nr. 14980 Prot., datë 06.09.2013 “Për dhënie në përdorim të vendit ku do të instalohet skaneri në Degën Doganore Durrës”. Zhvendosja ende nuk është realizuar edhe pas korrespondencave të cilat vërtetojnë shqetësimin e institucioneve ligjzbatuese lidhur me efektivitetin/sigurinë që ofron vendndodhja aktuale e këtij skaneri.

Nga auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve dhe rregulloreve, për periudhën e veprimtarisë 01.10.2017-31.12.2022, rezultuan veprime apo mosveprime në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore e rregullative në fuqi, nga të cilat kanë ardhur pasoja me ndikim në menaxhimin dhe mirëfunksionimin e institucionit.

Nga auditimi në fushën e shpenzimeve ka rezultuar se, buxhetit të shtetit i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 11,207 mijë lekë. Ky dëm ka ardhur në vlerën 7,567 mijë lekë si rezultat i dorëzimit ana e administratorëve të AAPSK-së të 7 pasurive pa kërkuar shpenzimet e administrimit të përballuara nga shteti dhe në vlerën 3,640 mijë lekë pasi 2 (dy) projekte të financuara nga Fondi i Posaçëm me vendim të KNMKKO, nuk kanë justifikuar me dokumentacion financimin e përfituar, dhe zbatimi i tyre ka rezultuar në tejkalim të afateve dhe detyrimeve kontraktuale me AAPSK-në.

Gjithashtu në fushën e shpenzimeve kanë rezultuar dhe problematikat në vijim:

- Sistemi elektronik për mbajtjen dhe azhornimin e regjistrit elektronik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara (RPSK), nuk aksesohet nga administratorët për të gjeneruar të dhënat e pasurive që kanë në administrim, duke sjellë për pasojë mungesën e një baze të dhënash për të gjitha pronat e sekuestruara e të konfiskuara, mangësi në monitorimin e tyre dhe shpenzime pa efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit.
- Në 2 (dy) raste, për një kohë të konsiderueshme prej 1 viti dhe më shumë se 14 vite, konkretisht për pasuritë e konfiskuara me vendimet gjyqate të vitit 2006 dhe 2021 nuk është kryer asnjë veprim për administrimin e pasurive të paluajtshme si raportim dhe kalim për vendimarrje destinimi te Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar.
- Pas marrjes në dorëzim të pasurive të sekuestruara nga administratorët, në asnjë rast nga 23 praktikat e audituara, nuk janë marrë masa për sigurimin e pasurisë për dëmtimet nga

zjarri, uji apo faktorë të tjerë natyrorë, ndërsa në lidhje me veprimet e “bllokimit” të pasurive pranë ASHK-së është vepruar me vonesë të konsiderueshme.

- Nuk është shitur asnjë pasuri e luajtshme e sekuestruar, të cilave jo vetëm i janë faturuar shpenzime pagat e administratorëve të pasurive, por edhe u ka rënë vlera nga amortizim.
- Mungesa e kryerjes së inventarizimit fizik të pronave dhe llogarive në administrim të AAPSK, ka rritur riskun e humbjes apo tjetërsimit të tyre, nisur dhe nga fakti që janë konstatuar 24 automjete, nuk rezultojnë të jenë dorëzuar nga administratorët në ambientet magazinuese të AAPSK-së.

- Nga auditimi i përputhshmërisë *“Mbi vlerësimin e sistemit të licencimit, shfrytëzimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarisë minerare i zhvilluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM) dhe në tre (3) shoqëri tregtare në likuidim e sipër që veprojnë në sektorin Minerar, për periudhën 2018 – 2022, në fushën e shpenzimeve janë konstatuar 33,020 mijë lekë përdorim i fondeve publike pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, si më poshtë vijon:*

- Nga auditimi i veprimtarisë monitoruese të AKBN për periudhën 2018-2021 lidhur me investimet për raportet e monitorimit janë konstatuar mangësi që kanë sjellë uljen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike në vlerën 26,200 mijë lekë;
- Nga auditimi i shpenzimeve të shoqërive minerare në likuidimit rezultoi se këto shoqëri kanë kryer pagesa për ekspertët kontabël për shërbimet e ekspertizës së pasqyrave financiare dhe për shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare vjetore në vlerë gjithsej 6,820 mijë lekë;
- Procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive është vonuar dhe tej zgjatur dhe nuk është përfunduar në kohë, deri në shkrirjen dhe çregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive. Shpenzimet që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave me status “SHA në likuidim e sipër” janë të konsiderueshme dhe përbejnë shpenzime pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të buxhetit të shtetit.

- *Në auditimin e përputhshmërisë në “Agjencinë Kombëtare të Pyjeve” për periudhën 01.09.2020 deri në 30.11.2022 janë konstatuar mangësi, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin dhe sigurimin e performancës në Pyje; vlerësimin e gjendjes në pyje; organizimin e punës për inventarizimin edhe kërkimin në fushën e pyjeve; organizimin e punës dhe hartimin dokumenteve për menaxhimin e pyjeve, si dhe veprimtarinë financiare në zbatim të ligjshmërisë dhe hartimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, e më konkretisht:*

- Transaksionet financiare të realizuara gjatë aktivitetit të subjektit, nuk paraqiten plotësisht në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare;
- Në mungesën e plotësisht të saktë të aktiveve afatgjatë dhe rakordimin me inventarët kontabël dhe fizikë;
- Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) nuk është i plotë, pasi në këtë fond pyjor nuk janë të pasqyruara ato sipërfaqe pyjorë të cilat i kanë kaluar në pronësi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Nga 385 ekonomi pyjore në gjithë vendin vetëm 76 (20 %) prej tyre janë të pajisura me plane mbarështimi apo plane që janë në proces;
- Nga 61 bashki 21 prej tyre kanë të mbuluar 4% -100% të territorit me plane mbarështimi, ndërsa pjesa tjetër e bashkive nuk kanë hartuar asnjë plan mbarështimi të paktën 10 vitet e fundit etj.

Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Pyjeve (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), në 4 raste, për shumën 40 mijë lekë, për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksa makine, nuk ka nxjerrë përgjegjësinë përkatëse;

Si rezultat i dhënies së masave disiplinore “Largim nga shërbimi civil” si dhe zgjidhjes së kundërligjshme të kontratave të punonjësve në 22 raste është penalizuar nga vendimet e gjykatave për pagesën e tyre në shumën e përgjithshme 13,625 mijë lekë, duke shkaktuar efekte ekonomike negative në administrimin e fondeve publike.

- Në auditimin e përputhshmërisë në “*Agjencinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës*” për periudhën e aktivitetit nga data 01.09.2020 deri në 30.12.2022 janë konstatuar mangësi në zbatimin e procedurave në përputhje me kuadrin ligjor, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit për procedurat e monitorimit, vlerësimin dhe kryerjes së inspektimeve në fushën e mjedisit dhe të ujërave, dhënie mendimi për pajisjen e subjekteve me leje mjedisore të Tipit A dhe B, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, si dhe aktivitetit ekonomiko-financiar e më konkretisht:
 - Nuk ka hartuar/plotësuar regjistrin e aktiveve, si dhe në inspektimet nuk përfshihet veprimtaria e subjektit lidhur me ujërat, por vetëm për pusët, si dhe nuk është ndërmarrë asnjë hap për të filluar procedurën e arkëtimit të gjobave;
 - Nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun Lezhë, Shkodër, Kukës;
 - Në shumë raste në inspektimet e kryera sipas procesverbalit subjekti nuk gjendet në adresën e dhëne, ose nuk kryen aktivitet, si dhe janë anuluar inspektime, pa shkak;
 - Në 97 raste, në praktikën e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, që dëshmojnë realizimin e procedurave si: akt-verifikime apo akt inspektime në terren, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi.
- Nga auditimi në institucionin *Gjykata e Lartë*, ka rezultuar se:
 - shumica e raportuar e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 është zero, por kjo nuk është e saktë, pasi shumica e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer në vlerën prej 1,044 mija lekë.
 - në fushën e prokurimit publik, regjistrat e parashikimit nuk janë përgatitur, sipas afatit përkatës; nga AK nuk janë pasqyruar në regjistrin e realizimit të gjitha kategoritë e mallrave dhe shërbimeve vlera e të cilave nuk e kalon shumën 100 mijë lekë, pavarësisht se këto procedura nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik etj.
- Nga auditimi në “*Autoritetin e Mediave Audiovizive*” rezultoi se:
 - caktimi pranë organit kolegjal të AMA-s, i një Sekretariati Teknik, me tre punonjës për periudhën nga 1 Janar 2022
 - 30 Qershor 2022 në vlerën 360 mijë lekë është veprim në kundërshtim me nenin 2, pika 1, të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, që shprehimisht ka përcaktuar se: “Çdo organ kolegjal ka një kryetar dhe një sekretar, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe...”, si dhe në tejkallim të pozicioneve të strukturës organike të AMA-s, të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.
 - Në subjektin AMA, bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezultoi se niveli i detyrimeve të subjekteve dhe ish-subjekteve të licencuara/ autorizuara dhe subjekteve të palicencuara/ autorizuara nga AMA paraqitet me një trend rritës, ku në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2022 evidentohet shumica prej 487,000 mijë lekë.
 - Dobësi në planifikimin e buxhetit, informacioni i paargumentuar dhe një raportim jo i përshtatshëm, mungesa e një kostimi dhe analize të mjaftueshme e të detajuar për kategoritë e shpenzimeve “Studime, kërkime dhe anketime” etj.

- Nga auditimi në *DSHTD* u konstatua se:
 - Planifikim fondeve për investime dhe mirëmbajtje bëhet bazuar në historikun e institucionit, dhe jo duke e argumentuar e mbështetur në nevojat reale të tyre;
 - Planifikimi fondeve për punime, të cilat përcaktohen si të paparashikuara ose emergjente, bazohet në historikun e investimeve të kryera për godinat, fonde të cilat në pjesën më të madhe të rasteve nuk realizohen në nivelin e plotë të tyre.
- Nga auditimi i kombinuar (financiar dhe të përputhshmërisë) në *subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës* për periudhën e aktiviteti nga data 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022.
 - Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022, ka shpenzuar vlerën 5,002 mijë lekë, e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e DP së ASHK. Këto vendime gjyqësore kanë si shkak vendimmarrjen e pa drejtë të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit.
- Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në *Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës* për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022 është konstatuar në vitin 2021 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është ngritur në tejkalim të afateve të paracaktuara në VKM-në e sipërcituar si dhe nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve.
- Nga auditimi i përputhshmërisë të ushtruar në *Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan* për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më 30.06.2022 është konstatuar se në periudhën 2020-2022 nuk është ngritur komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, si dhe nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve.
- Nga auditimi i kryer në *Institutin e Integritit të ish të Përndjekurve Politik (IIPP) dhe Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK)* për periudhën 2018 deri më 30.06.2022, ka rezultuar se:
 - Në IIPP, Komisioni i Monitorimit nuk ka përfshirë në monitorim dokumentacion të mjaftueshëm justifikues mbi shpenzimin e kryer në përdorimin e fondeve të dhëna; për periudhën 2018-2020, janë kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën totale 4,312 mijë lekë.
 - Në ISKPK mungojnë aktet administrative në lidhje me botimet dhe konferencat; nuk është hartuar dhe miratuar metodologjia për vlerësimin e punimeve, nuk është mundësuar ruajtja e dokumentacionit mbi procesin e botimeve, nuk është hartuar dhe miratuar një akt administrativ për të evidentuar procedurën e ndjekur për pagesa të pjesëmarrësve në konferenca, mangësi në procedurat e prokurimit etj.
- Nga auditimi i *Institutit të Gjeoshkencave* rezultoi:
 - Një shkallë e ulët e realizimit të Investimeve, e cila tregon se niveli i bashkëpunimit midis Institutit të Gjeoshkencave dhe Universitetit Politeknik të Tiranës është i pamjaftueshëm dhe mbart riskun e ndryshimit të destinacionit të Investimeve të parashikuara për IGJEO nga ana e UPT, i cili realizon procedurat e prokurimit për Institucionet e varësisë. Sipas vlerësimit të audituesve shtetëror të pavarur, realizimi i investimit për IGJEO rezulton të jetë *shumë i ulët*; në krahasim me planifikimin për vitin 2022 investimet janë realizuar në masën 41%, pra nuk janë realizuar 19,489 mijë lekë investime.

2.6.2 Auditimet e Teknologjisë së Informacionit (TI)

KLSH, duke i konsideruar auditimet në fushën e teknologjisë së informacionit me rol të rëndësishëm në menaxhimin e financave publike, si dhe zhvillimin dhe zgjerimin e shpejtë të sistemeve dhe aplikacioneve software-ike në vitet e fundit, i ka kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit të këtyre auditimeve. Teknologjia e informacionit është konsideruar tashmë një fushë e një rëndësie të veçantë, jo vetëm për shkak të shpenzimeve në fushën e prokurimeve publike por edhe për dobishmërinë në menaxhimin e ofrimit të shërbimeve publike me efektivitet dhe me kosto optimale si dhe me ndikim pozitiv në buxhetin e shtetit. Për subjekte e audituara mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310, nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014 si dhe Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit në KLSH, është arritur në konkluzionet e përgjithshme si më poshtë:

- KLSH në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit në *Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për periudhën e aktivitetit 01.01.2021 - 30.04.2023*, konstatoi se:
 - pajisjet fizike ku hostohet sistemi e-Taxation i cili përmban të dhëna të rëndësishme për vendin dhe jetike për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, janë në ezaurim të hapësirës së tyre dhe funksionojnë në limitet e ciklit jetësor si dhe me sisteme operimi jashtë suportit teknik çka do të thotë që operojnë në kushte jo optimale sigurie. Në aktet ligjore mbi infrastrukturën kritike, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, nuk e kanë vlerësuar me rëndësi kritike sistemin e-Taxation, duke mos krijuar kushtet për përmbushjen në kohë të detyrimeve për sigurinë kibernetike të kësaj infrastrukture. Aksesimi në të dhëna nga struktura TIK e AKSHI-t atashuar pranë DPT, menaxhimi i pagjurmueshëm i ndryshimeve të funksionaliteteve të sistemeve si dhe monitorim jo i vazhdueshëm i aksesit të përdoruesve, mund të krijojnë hapësira për veprime në tejkalim të kompetencave të AKSHI-t. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si administrator i të dhënave, nevojitet të luajë rol interaktiv në lidhje me Teknologjinë e Informacionit, për sa kohë në sistemet informatike kryhen veprime nga përdorues të brendshëm dhe të jashtëm dhe të dhënat e sistemeve janë tregues i aktivitetit të institucionit.
- KLSH në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit në *Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për periudhën e aktivitetit 01.01.2020 - 30.12.2022*, konstatoi se:
 - me gjithë përpjekjet dhe investimet e kryera në fushën e teknologjisë nga ana e FSDKSH, situata në këtë drejtim nuk është e konsoliduar. Nisur nga ky fakt, zhvillimi i sistemeve ndër vite nuk është zhvilluar sipas një planifikimi strategjik afatgjatë. Nga ana tjetër, si rezultat i investimeve në sistemet e reja, disa prej sistemeve ekzistuese nuk gjejnë përdorim pasi funksionalitetet e tyre janë zëvendësuar nga sistemet e reja. Megjithatë, edhe sistemet e reja kanë shfaqur një sërë problematikash të cilat vështirojnë ndjeshëm punën e përdoruesve me sistemet duke ulur performancën e tyre e, si rrjedhojë, edhe nivelin e shërbimit ndaj qytetarit. Pjesa më e madhe e infrastrukturës software dhe hardware e FSDKSH është lënë nën administrimin e AKSHI-t dhe ofertuesve të shërbimeve. Në gjykimin tonë, është me rëndësi përcaktimi i nivelit të shërbimit që AKSHI i ofron FSDKSH, me qëllim rritjen e efektivitetit, kufizimin/monitorimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe vazhdueshmërinë e punës, etj. Sistemi i regjistrimit të të siguruarve (AHIS) shfaq një sërë problematikash të

cilat vështirësojnë ndjeshëm punën e përdoruesve me sistemin, duke ulur performancën e tyre në punë e si rrjedhojë edhe nivelin e shërbimit ndaj pacientit. Gjithashtu këto probleme riskojnë saktësinë dhe përmbajtjen e informacionit që regjistron e mban sistemi, aksesueshmërinë e tyre e, si rrjedhojë, përdorueshmërinë e informacionit nga strukturat shëndetësore. Duke patur në konsideratë që ky është sistemi qendror me të cilin ndër veprojnë sistemet të tjera në FSDKSH dhe jashtë saj, por është edhe sistemi qendror që realizon menaxhimin dhe regjistrimin e popullsisë pranë çdo mjeku të qendrave shëndetësore, mosfunksionimi i tij do të sillte pasoja serioze dhe impaktonte negativisht ofrimin e shërbimeve pa ndërprerje. Sistemi i recetës elektronike eRx, i cili ka rëndësi të veçantë për procesin e menaxhimin e recetave të rimbursueshme për pacientët e kategorive të ndryshme në të gjithë Republikën, shpeshherë ka punuar me ndërprerje dhe ngadalësime serioze, duke kompromentuar vazhdimësinë e punës. Edhe pse kanë kaluar disa vite që nga implementimi dhe përdorimi i tij në shkallë të gjerë, edhe në këtë auditim u konstatuan disa mangësi, çka nënkupton që nuk janë marrë masat e nevojshme për minimizimin e problematikave apo përmirësimin e situatës. Mungesa e strategjisë institucionale dhe strategjisë së teknologjisë së informacionit mbart riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së FSDKSH. Rregulloret dhe përshkrimet e punës të papërditësuara kanë sjellë mospërcaktimin e saktë të detyrave specifike të punonjësve dhe kryerjen e tyre nga persona pa kompetencat e duhura teknike në fushën e TI.

- KLSH në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit në *Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) për periudhën e aktivitetit 01.01.2021 - 30.12.2022*, konstatoi se: investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur problemet e sigurisë së informacionit, si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës nuk është mbështetur në praktikën më të mirë.

Pajisjet fizike, programet softuerike të cilat ndërveprojnë në mënyrë që sistemet të operojnë, janë të pa përditësuara (në fund të jetës) e nuk ofrohet suport nga prodhuesi. Nga auditimi i sistemeve kryesore, duke u bazuar në performancën e veprimeve me tregues si: koha e përgjigjes, koha e përpunimit, përdorimi i burimeve të sistemit, komentet e përdoruesve, rezultoni se sistemet i përgjigjen me vonesë kërkesave të përdoruesve.

Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave, si dhe të vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit është i pamjaftueshëm.

ISSH nuk ka marrë masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK tek AKSHI, si dhe dorëzimin e Sistemeve dhe Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

- KLSH në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit në *Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A (UKT) për periudhën e aktivitetit 01.01.2020 - 30.09.2022*, konstatoi se: në shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A mungojnë strategjia, politikat dhe aktet rregullativë që përcaktojnë drejtimin, përgjegjësitë dhe detyrimet mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit.

Gjithashtu, ka munguar një planifikim dhe zhvillim në shërbime të reja informatike, që do të ndihmonin shoqërinë për arritjen e objektivave institucionale. Hapat e ndërmarrë në drejtim të rritjes së përdorimit, përmirësimit dhe sigurisë së shërbimeve që ofrohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit janë të pamjaftueshëm, për të hyrë në procesin e sigurisë së të dhënave dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve pa ndërprerje. Megjithatë

nuk ka pasur problematika të mëdha në të dhënat elektronike, mundësia për humbjen e tyre, ndërprerjen apo tjetërsimin është e lartë.

Gjithashtu janë konstatuar parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik në fushën e teknologjisë së informacionit në lidhje me mungesën e dokumentimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike, në përlllogaritjen e fondit limit, argumentimin tekniko ligjor të kapacitetit teknik etj.

- KLSH në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit në *Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)* për periudhën e aktivitetit 01.01.2020 - 30.12.2022, konstatoi se: mungesa e strategjisë, akteve rregullative, pajisjeve kompjuterike dhe internetit në tabletat për inspektim, problematikat në funksionalitetet e sistemit “e-inspektimi”, janë disa nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave që gjeneron Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial .

Sistemi e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme gjatë procesit të inspektimit duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve në ofrimin e shërbimeve kundrejt bizneseve dhe qytetareve.

Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në infrastrukturën network dhe atë kompjuterike është i pamjaftueshëm, si dhe shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar.

- KLSH në përfundim të auditimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit në *Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH)* për periudhën e aktivitetit 01.01.2020 - 30.12.2022, konstatoi se: Rrjeti Akademik Shqiptar është i vetmi institucion në vend që ka zhvilluar dhe ndërtuar disa sisteme informatike me programues të cilët janë punonjës të institucionit, duke ofruar zgjidhje në informatizimin e proceseve të administrimit të brendshëm dhe akademik të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe informatizime të rëndësishme për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Për Rrjetin Akademik Shqiptar nuk është financuar asnjë e ardhur nga buxheti i shtetit apo buxhetet e universiteteve, me qëllim mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që ka ndërtuar dhe ofron për Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga Ministria e Arsimit dhe Institucionet e Arsimit të Lartë Publik, megjithëse si institucione themeluese të RASH, *nuk është zbatuar* pika 5/c e VKM nr.88, datë 14.02.2018, në të cilën ato përcaktohen si burime të financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, duke vendosur institucionin në kushtet e riskut të ekzistencës së tij dhe të zhvillimeve e produkteve informatike të rëndësishme që ka ofruar deri tani.

2.6.3 Auditimet e performancës

Auditimet e performancës janë përqendruar kryesisht në institucionet të cilat kanë për detyrë, ofrimin e shërbimeve për qytetarët në kohë me cilësi dhe me kosto optimale, krahas çështjeve të tjera me ndjeshmëri në opinionin publik apo që i përkasin grupeve të ndryshme sociale në vendin tonë. Në mënyrë të përgjithshme janë konstatuar të meta e mangësi në drejtim të efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për garantimin e një jetese dinjitoze të fëmijëve jetim në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, menaxhimit në mënyrë efektive të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri, veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse drejt menaxhimit të integruar të burimeve ujore, garantimit nga qeveria shqiptare të monitorimit, ndjekjes dhe raportimit mbi nivelin e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm etj.

Janë 7 auditime të performancës në periudhën e aktivitetit të audituar të të cilëve është përfshirë viti 2022, plotësisht ose pjesërisht, për të cilët është dalë me mesazhet si më poshtë:

- Auditimi i Performancës me temë: *“Performanca e Shërbimit të Paraburgimit”*, i ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë; Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale; si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Drejtoritë Vendore të Policisë, për periudhën 01.01.2019-30.06.2022, për të cilin është dalë me mesazhin e auditimit: *“Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale duhet të luajnë një rol proaktiv në garantimin e të drejtave të shtetasve të paraburgosur, nëpërmjet krijimit të një qasje të re, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre, vetë respektit dhe dinjitetit njerëzor. Sistemi penitenciar ka nevojë edhe për një bashkëveprim më dinamik ndërmjet institucioneve shtetërore përgjegjëse, veçanërisht midis Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.”*
- Auditimi i Performancës me temë *“Fuqizimi Ekonomik i gruas në vendin tonë”*, i kryer në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministrinë e Financave; Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisë; Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e tyre të varësisë nga ku u konstatua se këto institucione ende duhet të angazhohen në drejtim të: rritjes së impaktit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor për të konkretizuar angazhimin e grave në të gjitha fushat e ekonomisë të vendit tonë që sigurojnë fuqizimin e tyre.
KLSH në përfundim të auditimit ka dalë me mesazhin e auditimit: *“Vendosja e parimit të barazisë gjinore si një parim thelbësor i ciklit buxhetor është e vetmja rrugë e duhur për të rrënjosur kulturën e barazisë gjinore në vendin tonë. Për këtë qëllim institucionet duhet të angazhohen maksimalisht në drejtim të: rritjes së impaktit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor; promovimit dhe vendosjes treguesve të matshëm sasior e cilësor gjinor në buxhetet e institucioneve; koordinimit midis institucioneve për zbatimin e strategjive të barazisë gjinore dhe integrimin e tyre me strategjitë sektoriale; monitorimit të saktë të këtyre politikave për të konkretizuar angazhimin e grave në të gjitha fushat e ekonomisë të vendit tonë që sigurojnë fuqizimin e tyre”*.
- Auditimi i performancës me temë *“Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”*, i ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit për veprimtarinë nga data 01.01.2019. deri më datën 31.12.2022, me mesazh të auditimit: *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës së bashku me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të nxisin rinovimin e flotës së mjeteve rrugore, vënien në zbatim të stimujve financiare për të shtuar numrin e mjeteve rrugore me emetim të ulët, plotësimin e legjislacionit në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare si dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit.*
- Auditimi i performancës me temë *“Shërbimi përbarimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”*, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Përbarimit Shtetëror, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022 me mesazhin e auditimit: *Për të siguruar mirë funksionimin e sistemit të përbarimit shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit duhet të krijojë një frymë të re bashkëpunimi me të gjitha institucionet e përfshira në ekzekutimin e vendimeve, në përputhje me ligjin e ri organik, në drejtim të rritjes së cilësisë së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, garantimit të të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimit të shërbimit të ofruar.*
- Auditimi i performancës me temë *“Trajtimi i sëmundjeve tumorale”*, i ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet e varësisë së saj; në Qendrën Spitalore Universitare *“Nënë Tereza”* (Spitali Onkologjik); në Spitalet Rajonale Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër, Berat dhe Lezhë, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022

me mesazh auditimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet shëndetësore, për shkak edhe të numrit në rritje të pacientëve me sëmundje tumorale, krahas punës së vazhdueshme në promovimin e stilit të jetës së shëndetshme, të nxisin, politikat e parandalimit, depistimit, trajtimit në kohë të kancerit dhe uljes së mortalitetit të popullsisë në vend. Arritja e parandalimit të sëmundjeve tumorale në fazën e hershme të tyre nëpërmjet bashkërendimit të politikave shëndetësore, rritjes së buxheteve financiare, sigurimit të pajisjeve mjekësore, shtimit të ambienteve spitalore, plotësimit me medikamente si dhe përmirësimit të strukturave të dedikuara me personel mjekësor të mirë kualifikuar të jetë një sfidë e vazhdueshme për institucionet shëndetësore.

- Auditimi i performances me temë “Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese (hemodializë, dializë peritoneale, transplant)”, kryer në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe institucionet e varësisë, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalet Rajonale; Elbasan, Durrës, Lezhë, Shkodër, Korçë, Berat, Fier, Vlorë, ku ndër të tjera u konstatua se në Shqipëri, si pasojë e mungesës së trajtimit dhe parandalimit efektiv të progresionit të tyre drejt stadeve të avancuara të Insuficiencës Renale Kronike (IRK) dhe rritjes së kostove të trajtimit, funksionimi i kujdesit shëndetësor parësor në lidhje me menaxhimin e Sëmundjeve Kronike të Veshkave (SKV) nuk është plotësisht efektiv, në përputhje me objektivat e sistemit shëndetësor, të cilat kërkojnë të ndërmerren një sërë aktivitete për parandalimin e Sëmundjeve Kronike të Veshkave (SKV) si: krijimi i një regjistri për pacientët me SKV; themelimi i kabineteve të reja mjekësore të nefrologjisë në shërbimin shëndetësor parësor; sigurimi i aksesit të barabartë për të gjithë qytetarët në shërbimet shëndetësore; vlerësimi i prevalencës së SKV dhe nivelit të identifikimit të tyre në kuadër të programit të "check-up", duke themeluar një unitet të veçantë në QSUNT për parandalimin dhe trajtimin e tyre, i bazuar në ekzaminimet përkatëse të check-up, etj.

Auditimi është ushtruar për periudhën 01.01.2020 deri në 31.12.2022 dhe është dalë me mesazhin e auditimit: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet spitalore, Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të rrisin vëmendjen për përmirësimin e politikave të kujdesit shëndetësor në nivel kombëtar dhe rajonal, për depistimin dhe parandalimin e sëmundjeve kronike të veshkave, përmirësimin në shërbimin e Terapisë Renale Zëvendësuese (hemodializa, dializë peritoneale, transplant), monitorimin periodik të ofrimit të shërbimit dhe të protokolleve të shërbimit si dhe trajnimin dhe kualifikimin e stafit mjekësor në mënyrë të vazhdueshme dhe në përshtatje me zhvillimet më të fundit shkencore, duke ndikuar në cilësinë e jetës dhe jetëgjatësinë e pacientëve të prekur me sëmundjet kronike të veshkave.

- Auditimi i Performancës me temë “Rezervat e shtetit në shërbim të qytetarit”, i ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtoritë Rajonale në varësi të saj, nga ku u konstatua se, rezerva materiale e shtetit, si një garanci për qytetarin, nuk ka arritur të përmbushë plotësisht misionin për të cilin është krijuar. Orientimi i veprimtarisë së strukturave përgjegjëse drejt aktivitetit dytësor, burimet njerëzore dhe financiare të kufizuara, kanë lënë jashtë vëmendjes aktivitetin parësor të saj për përbalimin e situatave me të cilat mund të përballet vendi.

Periodha e veprimtarisë së audituar është 01.01.2019 - 28.02.2023, dhe mesazhi i auditimit: Institucionet përgjegjëse duhet të përdorin gjithë instrumentet në dispozicion për të përmbushur pritshmërinë e qytetarit lidhur me sigurinë që ato duhet të ofrojnë për jetën dhe shëndetin e tyre.

Rezerva materiale e shtetit si një garanci për qytetarin, duhet të përmbushë plotësisht misionin për të cilin është krijuar. Kalimi nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, duhet të sjellë zhvillime pozitive, të cilat ti shërbejnë forcimit të rolit të saj. Orientimi i

veprimtarisë së strukturave përgjegjëse, burimet njerëzore dhe financiare duhet të fokusohet drejt aktivitetit parësor për përbalimin e situatave të parashikuara. Asetet e trashëguara, pasuri kombëtare, duhet të administrohen për të qenë një vlerë e shtuar në rezervën materiale të shtetit. Parë nga perspektiva e zhvillimeve gjeopolitike, ndryshimeve klimaterike dhe demografike përmbushja e kufijve minimalë të përcaktuar të rezervës materiale e shtetit, duhet të jetë garanci për qytetarin.

DEFICITI BUXHETOR

Deficiti i buxhetit (i cili përbën deficitin fiskal të buxhetit të shtetit) ka pësuar rënie në planifikim gjatë ndryshimeve buxhetore në vitin 2022, duke filluar me vlerën 100,883 milion lekë dhe duke përfunduar në 83,863 milion lekë me AN nr. 19, datë 29.12.2022, kjo e bazuar në ritmet (vlerat) më të larta të rritjes së të ardhurave gjithsej në krahasim me ritmet e rritjes (vlerave) së shpenzimeve gjithsej. Duhet theksuar se në PBA 2022-2024 ky deficit ka qenë programuar 51,585 milion lekë.


Deficiti i buxhetit të shtetit është në vlerën 78,225 milion lekë, pra 5,638 milion lekë më pak se plani përfundimtar buxhetor ose realizuar 93 %, më i ulti i tre viteve të fundit, i cili arriti në 3.7% të PBB.

Vlera e deficitit fiskal në vitin 2022 është 7,172 milion lekë më i ulët se në vitin 2021, çka duhet konsideruar një tregues pozitiv dhe nisje e qëndrueshmërisë ekonomike, në kushtet e rritjes së të ardhurave me ritme më të shpejta se sa rritja e shpenzimeve.

Duhet theksuar se në vitin 2022 deficiti është përdorur totalisht në muajin dhjetor, pasi në të gjithë muajt e tjerë, bilanci buxhetor ka rezultuar me suficit nga 9,172 milion lekë në muajin nëntor në 21,871 milion lekë në muajin mars, kjo për shkak të ecurisë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Ndryshe ka ndodhur në vitin 2021, në të cilin suficit mujor ka pasur vetëm në janar dhe ka lindur nevoja e përdorimit të deficitit gjithë periudhën tjetër të vitit.

Financimi i deficitit është bërë kryesisht nga huamarrje të brendshme në vlerën + 87,765 milion lekë dhe financim i huaj – 9,539 milion lekë, ndryshe nga viti i kaluar në të cilin ishte e kundërta e këtij raporti.

Grafiku 17 Struktura faktike e deficitit fiskal për vitet 2021 - 2022



Burimi: Të dhëna të MFE të përpunuara nga KLSH

Në financimin e brendshëm të deficitit buxhetor në vitin 2022 peshën kryesore e zënë burimet e tjera dhe huamarrja e brendshme dhe në vlerë të papërfillshme të ardhurat nga

privatizimi, ndërsa në financimin e huaj kryesisht nga mbështetja buxhetore dhe huaja afatgjatë e marrë.

Tabela 22 Planifikimi dhe realizimi i treguesve për financimin e deficitit 2022

ZËRI BUXHETOR						Në milion lekë
	Ligji nr.115/2021 Buxheti 2022	AN nr.3 12.03.'22	AN nr.12 29.07.'22	AN nr.17 01.12.'22	AN nr.19 29.12.'22	Fakti në tregues fiskale
DEFICITI	-100,883	-100,883	-83,863	-83,863	-83,863	-78,225
Financimi Deficitit	100,883	100,883	83,863	83,863	83,863	78,225
Brendshëm	100,251	100,251	83,383	88,088	90,088	87,765
<i>Të ardhura nga privatizimi</i>	0	0	0	0	0	191
<i>Hua-marrje e brendshme</i>	50,000	50,000	33,000	33,000	33,000	26,156
<i>Të tjera</i>	50,251	50,251	50,383	55,088	57,088	61,417
I Huaj	632	632	480	-4,225	-6,225	-9,539
<i>Hua afatgjatë (e marrë)</i>	25,752	25,752	23,652	15,829	13,829	11,140
<i>Ndryshimi i gjendjes së arkës</i>	0	0	0	0	0	589
<i>Ripagesat</i>	-42,529	-42,529	-42,529	-39,042	-39,042	-38,386
<i>Mbështetje buxhetore</i>	17,409	17,409	19,357	18,987	18,987	17,117

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Huamarrja e brendshme me anë të instrumenteve të bonove të thesarit dhe obligacioneve sipas raportimit në treguesit fiskalë të konsoliduar paraqitet në shumën 26,156 milion lekë, me nën realizim përkundëjt planit në shumën 33,000 milion lekë. Gjithashtu ripagesat për borxhin e huaj paraqiten me nën realizim duke shlyer principal të borxhit të jashtëm në shumën 38,386 milion lekë përkundëjt 39,042 milion lekë të planifikuara.

Nga auditimi i MFE, rezultoi se:

- Regjistrimi i deficitit dhe strukturës së tij në planin operativ dhe në planin e SIFQ, ka ndryshime të theksuara krahasuar me planin përfundimtar vjetor të ndryshuar, përkatësisht 110,732, 159,998 dhe 83,863 milion lekë, gjë që tregon se raportet e ofruara nga SIFQ nuk mund t'i shërbejnë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit për të kontrolluar saktësinë e detajimit të buxhetit fillestar dhe më pas atij operativ, si dhe analizat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të buxhetit.
- Huamarrja e brendshme që ka shërbyer për financimin e deficitit në treguesit fiskale të buxhetit të konsoliduar paraqitet në shumën 26,156 milion lekë ndërkohë që sipas raportimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit është në vlerën 26,308 milion lekë, e konfirmuar edhe në akt - rakordimin ndërmjet strukturave të thesarit dhe strukturave të borxhit, Pra, në pasqyrën e treguesve të buxhetit të konsoliduar huamarrja e brendshme për financimin e deficitit është paraqitur më pak për vlerën prej 152 milion lekë.
- Ripagesat në kuadrin e financimit të huaj të deficitit, nga -38,386 milion lekë në treguesit e konsoliduar të buxhetit është -38,394 milion lekë sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit, pra janë paraqitur më pak për vlerën 8 milion lekë
- Të dhënat në lidhje me huanë e huaj afatgjatë të marrë të cilat në treguesit e buxhetit të konsoliduar raportohen në shumën 11,140 milion lekë, sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit është në vlerën 35,945 milion lekë. Pra, në pasqyrën e treguesve të buxhetit të konsoliduar huaja e jashtme afatgjatë e marrë për financimin e deficitit është paraqitur më pak për vlerën prej 24,805 milionë lekë.

MENAXHIMI DHE RAPORTIMI I BORXHIT PUBLIK

Sipas Raportit të treguesve të buxhetit të konsoliduar faktik 2022 të përgatitur nga MFE, borxhi publik neto për vitin 2022 ishte 1,364.1 miliardë lekë, ose 63.9% e PBB, në rënie nga 70.6% e PBB për vitin 2021.

Ndërsa stoku bruto i borxhit që përfshin dhe likuiditetin për financimin e borxhit ndaj PBB-së gjithashtu pësoi rënie, duke arritur nivelin 64.6% e PBB, në rënie me pothuaj 9.9 pikë përqindje nga viti 2021, si dhe më i ulët se sa pritshmëritë fillestare prej rreth 78.8%.

Treguesit e mësipërm shfaqin efektet nominale të rritjes ekonomike, ecurinë pozitive të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2022.

Sipas Raportit të MFE, borxhi publik gjatë vitit 2022 përgjithësisht është menaxhuar në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve.

Për sa i përket huamarrjes, gjatë vitit 2022, ka pasur një kërkesë më të ulët për letrat me vlerë të borxhit të qeverisë në tregun e brendshëm, si rezultat i një niveli pasigurie të lartë në tregje dhe pritshmërive për rritje të normave të interesit, shkaktuar nga zhvillimet e konfliktit Rusi-Ukrainë. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 386.1 miliard lekë, nga të cilat 92.7% u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 7.3% nëpërmjet burimeve të huaja. Në tregun e brendshëm huamarrja bruto rezultoi në vlerën prej 357.9 miliard lekë.

Gjatë 2022 u maturuan instrumente të borxhit të brendshëm në vlerën prej 331.5 miliard lekë, duke rezultuar në një financim neto në vlerën 26.3 miliard lekë, dhe më i ulët se viti i kaluar, gjë e cila nuk ka ndikuar në financat publike, pasi kjo periudhë nga ana tjetër është karakterizuar nga zhvillime pozitive në drejtim të të ardhurave buxhetore, dhe një niveli likuiditeti të mjaftueshëm gjatë gjithë periudhës.

Huamarrja e huaj, në vlerën prej 28.3 miliard lekë, krahasuar me vitin e kaluar, u ul me 107.8 miliardë lekë, pasi gjatë vitit 2022 nuk u emetua Eurobond, niveli i mbështetjes buxhetore ishte më e ulët se vitin e kaluar dhe gjithashtu vlera e kredive të disbursuara për financimin e projekteve është më e ulët se në vitin 2021.

Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë ndjekur një tendencë rritëse duke filluar nga muaji Mars 2022, rritje kjo e ndikuar nga pasiguria e lartë, rritja e normës bazë të interesit në tregun vendas si edhe nga pritshmëritë për rritje të mëtejshme të normave të interesit në përgjigje të inflacionit të rritur. Banka e Shqipërisë ka rritur 5 herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2022 duke arritur në nivelin prej 2.75%, krahasuar me 0.5% që ishte në fillim të vitit.

Për sa i përket raporteve të kostos dhe riskut në portofolin e borxhit, pavarësisht se viti 2022 është ndikuar nga zhvillime jo të favorshme në tregjet financiare, ndër të cilat ritheksojmë rritjen e normës bazë të interesit brenda vendit nga Banka Qendrore, portofoli i borxhit të brendshëm është arritur të menaxhohet duke mbajtur në nivele të qëndrueshme raportet e riskut, si dhe në drejtim të mbajtjes së kostove në nivelin më të ulët të mundshëm sipas kushteve të tregut. Krahasuar me vitin 2021, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 3.8 miliard lekë më të larta, kryesisht si rezultat i rritjes së stokut të borxhit në vlerë nominale si dhe rritjes së normave të interesit.

Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë vitit 2022 është vijuar me praktikatat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë.

Nga auditimi në MFE, borxhi publik për vitin 2022 ka rezultuar 1,378,623 milion lekë, nga i cili borxhi qeverisjes qendrore 1,378,421 milion lekë dhe 202 milion lekë borxhi i pushtetit lokal, pra pothuajse tërësisht nga njësitë e qeverisjes qendrore.

Raporti i borxhit publik ndaj PBB përgjatë vitit 2022, sipas MFE ka rezultuar 64.6%, tregues i cili është në rënie në krahasim me një vit më parë që ishte 74.5%, dhe në vlerë absolute është 4,317 milion lek më pak se viti 2021, por gjithsesi më i larti i periudhës 2015-2020. Rënia e treguesit të borxhit publik në raport me PBB ka ardhur kryesisht nga dy faktorë: si pasojë e rritjes së GDP-së (278,292 milion lekë më shumë në 2022), si dhe nga rënia e nivelit të stokut të borxhit në vlera nominale (4,317 milion lekë më pak në 2022). Është llogaritur

një efekt i kursit të këmbimit në portofolin e borxhit të shprehur në valutë prej rreth 31.7 miliardë lekë, ose rreth 1.5% të PBB-së.

Referuar Buletinit të Borxhit T4 2022 të përgatitur nga MFE, sipas tabelës 1.4. Stoku i borxhit të Qeverisë Qendrore, përfshirë borxhin e garantuar, rezulton në masën 67% kundrejt PBB-së, me një diferencë prej 2.4% më shumë se pasqyrimi në Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit Vjetor, Situatën Makroekonomike dhe Fiskale gjatë vitit 2022, i cili është 64.6%. Kompozimi i borxhit shtetëror i klasifikuar në të brendshëm dhe të jashtëm dhe i garantuar ose jo paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 23 Stoku i borxhit të brendshëm dhe të jashtëm, shtetëror dhe i garantuar i qeverisjes qendrore 2017-2022

	<i>Në milion lekë</i>					
Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Stoku i borxhit të brendshëm	577,056	580,311	597,290	644,088	702,256	732,654
<i>Stoku i brendshëm shtetëror*</i>	546,939	565,093	582,136	630,791	678,881	712,779
<i>Stoku i brendshëm i garantuar</i>	30,117	15,218	15,154	13,297	23,375	19,875
Stoku i borxhit të jashtëm	510,286	526,258	514,754	579,950	680,369	645,768
<i>Stoku i jashtëm shtetëror</i>	490,518	496,804	488,056	544,434	648,848	613,421
<i>Stoku i jashtëm i garantuar</i>	19,768	29,454	26,698	35,516	31,521	32,346
Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore	1,087,342	1,106,569	1,112,044	1,224,038	1,382,625	1,378,421

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Rënia në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore i atribuohet kryesisht rënies së stokut të borxhit të jashtëm në rreth 34,602 milion lekë, e ndikuar nga huamarrja e huaj e cila është ulur për shkak se gjatë vitit 2022 nuk u emetua Eurobond, niveli i mbështetjes buxhetore ishte më e ulët se vitin e kaluar dhe gjithashtu vlera e kredive të disbursuara për financimin e projekteve është më e ulët se në vitin 2021.

Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit publik sipas instrumenteve, më shumë se 60% të peshës vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (bono thesari, obligacione, eurobond), të cilët vlerësohen të jenë në rritje nga viti në vit kryesisht për shkak të emetimeve më të shpeshta në tregjet ndërkombëtare, por edhe si rezultat i rritjes së huamarrjes në tregun e brendshëm, bazuar në rritjen e nevojave për financim gjatë viteve të fundit duke filluar nga viti 2020.

Borxhi i brendshëm, borxhi i brendshëm shtetëror

Nga auditimi konstatohet se janë emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 357.86 miliard lekë me çmim blerje/pastër në total, nga të cilat 245.53 miliard lekë bono thesari dhe 112.33 miliard lekë obligacione. Nga analiza konstatohet se instrumentet e emetuar janë të gjitha në monedhë kombëtare dhe nuk ka instrumente të emetuar në monedhë të huaj. Sipas raportimit në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar, 26.31 miliard lekë të kësaj huamarrje janë përdorur për financimin e deficitit, ndërkohë që pjesa tjetër është përdorur për rifinancimin e titujve të maturuar sipas instrumenteve të brendshëm. Borxhi i ri është huazuar plotësisht nëpërmjet titujve afatshkurtër (32,36 miliard lekë nga 26.31 miliard lekë huamarrje neto). Nga analiza vërehet një reduktim i huamarrjes afatgjatë në vlerën 6.05 miliard lekë, gjë e cila nuk është plotësisht në linjë me objektivat strategjike afatmesëm për reduktimin e riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit në lidhje me afatin e maturimit. Në këtë drejtim, prioritet mbetet zgjatja e jetëgjatësisë së borxhit nëpërmjet uljes së mëtejshme të përqendrimit të titujve afatshkurtër në portofol”.

Maturimet përgjatë vitit 2022 paraqiten në shumën 331.55 miliard lekë në total me çmim blerje, nga të cilat 213.17 miliard lekë për bonot e thesarit dhe 118.38 miliard lekë për obligacionet. Procedura e planifikimit, zhvillimit dhe raportimit të ankandëve të bonove të thesarit dhe obligacioneve është zhvilluar në Bankën e Shqipërisë, si autoriteti përkatës i mandatuar për emetimin këtyre instrumenteve për llogari të shtetit shqiptar.

Stoku i borxhit të brendshëm dominohet kryesisht nga instrumentet afatgjatë të obligacioneve me një vlerë stoku në fund të vitit 2022 në shumën 472,290 milion lekë, përkundrajt 240,490 milion lekë të stokut të instrumenteve afatshkurtër.

Stoku i borxhit për vitin 2022 është rritur me 33,898 milion lekë ose rreth 5%, duke kaluar nga 678,881 milion lekë në vitin 2021 në 712,779 milion lekë në vitin 2022. Në lidhje me instrumentet afatshkurtër konstatohet se është rritur pesha specifike e bonove të thesarit 3 mujore, 6 mujore (ku përfshihet emetimi i letrave me vlerë 6 mujore për rivlerësimin e valutës) dhe 12 mujore dhe financimi i nevojave buxhetore me anë të instrumenteve afatshkurtër, me një efekt neto në instrumente afatshkurtër në 38,378 milion lekë ose rreth 19% e totalit të stokut të bonove të thesarit, duke kaluar nga 202,112 milion lekë në vitin 2021 në 240,490 milion lekë në vitin 2022. Konstatohet një rënie e stokut të borxhit afatgjatë prej 4,479 milion lekë ose rreth 1% të totalit të stokut afatgjatë, nga 476,769 milion lekë në fund të vitit 2021 në 472,290 milion lekë në fund të vitit 2022.

Tendenca përgjatë vitit 2022, nuk ka shkuar në drejtim të rikompozimit të portofolit me instrumente më afatgjatë duke mos qenë në përputhje me objektivat strategjike afatmesëm për rritjen e maturitetit të portofolit të borxhit.

Nga auditimi në MFE i letër-këmbimit shkresor me Bankën e Shqipërisë (BSH), lidhur me kërkesën e kësaj të fundit për rinovimin e titujve shtetërorë për mbulimin e vlerës negative të llogarisë “Rezerva e Rivlerësimit të Valutave”, MFE me shkresën nr. 12142/2 prot., datë 21.12.2022, njofton se do të rinovojë emetimin letra me vlerën në shumën 6,019,805,285 lekë, me datë emetimi 22.12.2022 dhe me afat maturimi 6 mujor, emetim i bonove të thesarit për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit të BSH.

Borxhi i brendshëm i garantuar

Në fund të vitit 2022 borxhi i brendshëm i garantuar ka pasur rënie me 3,500 milion lekë duke kaluar nga niveli i 23,375 milion lekë në fund të vitit 2021 në 19,875 milion lekë në fund të vitit 2022. Ulja e stokut të garancive të brendshme konstatohet se vjen kryesisht nga efekti rezultat i dy garancive sovraane, konkretisht: *Garancia Sovrane Nr.1 dhe Garancia Sovrane Nr.2, stoku i të cilave është zvogëluar si rezultat i pagesave të bëra nga bizneset përfituese, si dhe nuk ka pasur disbursime të reja gjatë vitit 2022.* Garancitë e brendshme përfshijnë masa emergjence të ndërmarra nga Qeveria në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, të detajuar në 6 marrëveshje garancie dhe VKM nr. 349, datë 26.05.2022 “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve, që tregtojnë me shumicë produkte ushqimore bazë për të mundësuar financimin e nevojshëm për mbajtjen e rezervave, me qëllim përbalimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, si dhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit.”

Borxhi i jashtëm, Mbi raportin e disbursimeve

Përgjatë vitit 2022 janë regjistruar në sistemin e brendshëm të menaxhimit të borxhit transaksionet e disbursimit për 40 kredi me një total në monedhë kombëtare në shumën 35,944,698,236.74 lekë nga të cilat 3 kredi janë evidentuar si garanci që kanë pasur disbursime gjatë vitit në shumën 7,671,061,271.03 lekë. Pjesa tjetër prej 37 projektesh përfshin një shumë të disbursuara prej 28,273,636,965.71 lekë. Nga këto 37 projekte 4 prej tyre që janë klasifikuar si mbështetje buxhetore në shumën 17,116,895,000.00 lekë që kanë pasur këtë trajtim duke qenë se janë transferuar drejtpërdrejt në llogarinë e unifikuar të thesarit në monedhën të huaj dhe jo në llogarinë speciale në Bankën e Shqipërisë për projektin përkatës.

Mbi pagesat e principalit

Në sistemin e brendshëm të regjistrimit të transaksioneve të borxhit janë evidentuar shlyerje principali në shumën 38,394,095,697.09 lekë, duke përfshirë edhe pagesat e kryera për përfituesit e garancive. Nga testet e zhvilluara në lidhje me pasqyrimin e transaksioneve të shlyerjes të principalit në llogarinë e unifikuar të thesarit të marrë nga strukturat e thesarit nuk rezultuan me diferenca të tjera. Përgjatë vitit 2022 kreditë shtetërore dhe garancitë për të cilat është paguar më shumë janë nga Projekti “Rruga Rrëshen-Kalimash”, Plani i ristrukturimit të KESH dhe Rruga Tiranë -Elbasan.

Borxhi i jashtëm i garantuar

Përgjatë vitit 2022 borxhi i jashtëm i garantuar paraqitet në rritje me 825 milion lekë sipas raportimeve në regjistrin e borxhit në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë: nga 31,521 milion lekë në 32,346 milion lekë në fund të vitit 2022.

Buxheti i Shtetit për vitin 2022, ka paguar principal 3,753.76 milion lek për rastet e garancive të huaja, kur përfituesit e garancive kanë dështuar të përmbushin detyrimet e tyre. E njëjta situatë paraqitet edhe për shpenzimet e interesit, ku Buxheti i Shtetit ka paguar 354.98 milion lekë shpenzime interesi. Shuma e paguar nga vetë njësitë përfituese të garancive gjatë vitit 2022 është 1,135.88 milion lekë për principalin dhe 154.22 milion lekë për interesat, duke vazhduar tendencën e akumulimit të detyrimeve ndaj buxhetit si në vitet e kaluara.

Tabela 24 Principali dhe interesi i shlyer nga buxheti dhe njësitë përfituese 2022

<i>Në milion lekë</i>			
Emërtimi	Principali i shlyer	Interesi i shlyer	Totali
Buxheti i shtetit	3,753.76	354.98	4,108.74
Njësia përfituese	1,135.88	154.22	1,290.10
Totali	4,889.64	509.20	5,398.84

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga auditimi në MFE është konstatuar se pagesat e kryera nga Buxheti i Shtetit për garancitë e huaja jo performuese nuk kryhen në përputhje me kërkesat e nenit 42 të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi nga MFE nuk shqyrtohet nëse kërkesa për pagesë kur huamarrësi nuk ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, sipas kushteve dhe afateve të marrëveshjes së huasë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë. Aktualisht konstatohet se procesi konsiston në komunikim paraprak nga MFE me përfituesin e garancisë i cili konfirmon nëse është apo jo në gjendje që të shlyejë këstin e radhës dhe në rast paafësie nga ana e tij procedohet me pagesën nga Buxheti i Shtetit.

Mbi shërbimin e borxhit

Shpenzimet për interesa përgjatë vitit 2022, kanë rezultuar në rritje në krahasim me vitin e kaluar, duke shënuar vlerën prej 39,820.37 milion lekë, përkundrajt 36,378.05 milion lekë që rezultuan një vit më parë, pra me një rritje prej 3,442.31 milion lekë në total.

Tabela 25 Shpenzimet për interesa për borxhin 2017-2022

<i>Në milion lekë</i>						
Shpenzimet e interesit	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Interesat e borxhit të brendshëm	21,414.59	23,157.97	22,837.89	22,350.91	23,470.40	24,210.32
Interesat e borxhit të jashtëm	10,489.19	13,355.40	12,304.93	12,042.49	12,907.66	15,610.05
Interesat e borxhit gjithsej	31,903.78	36,513.37	35,142.82	34,393.40	36,378.05	39,820.37

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në krahasim me vitin 2021, rritja më e madhe në interesat e borxhit në 2022 konstatohet në interesat e borxhit të jashtëm me rreth 2,702.39 milion lekë, si dhe 739.92 milion lekë interesa më shumë të paguara për borxhin e brendshëm.

Interesat e Borxhit të Brendshëm

Shpenzimet e interesit të borxhit të brendshëm kanë ardhur në rritje në krahasim me një vit më parë, ku interesat për vitin 2022 vlerësohen në shumën 24,210.32 milion lekë përkundrejt 23,470.40 milion lekë në vitin 2021. Pjesa më e madhe e interesave për shërbimin e borxhit të brendshëm është e akumuluar në drejtim të interesave për kuponat e obligacioneve.

Tabela 26 Interesat e paguara sipas instrumenteve të borxhit të brendshëm 2021-2022

Viti	Në milion lekë	
	2021	2022
Interesa Borxhi i Brendshëm	23,470.40	24,210.32
Interesa Bono Thesari	3,733.82	3,566.26
Interesa bono thesari 3/mujor te emetuara ne tregun financiar	30.19	34.16
Interesa bono thesari 6/mujor te emetuara ne tregun financiar	39.65	40.20
Interesa bono thesari një vjeçar te emetuara ne tregun financiar	3,663.97	3,491.90
Interesa Obligacione	19,645.00	20,626.79
Interesa obligacione ne tregun financiar me afat maturimi mbi 15 vjet		176.19
Interesa obligacione ne tregun financiar me afat maturimi 6 deri 10 vjet	11,026.83	11,501.08
Interesa obligacione ne tregun financiar me afat maturimi nga 1 deri 5 vjet	8,618.17	8,949.51
Interesa Garancia Sovrane	91.57	17.27
Interesa për Garancinë Sovrane I	91.57	17.27

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Interesat e bonove të thesarit 3 mujore paraqiten në vlerën 34.16 milion lekë, duke qenë se gjatë vitit janë emetuar më shumë bono të tilla kurse vitin e kaluar kanë qenë në vlerën 30.19 milion lekë. Interesat e bonove të thesarit 6 mujore paraqiten në rritje me rreth 0.54 milion lekë në raport me një vit më parë, duke qenë se janë kryer më shumë emetime të këtij instrumenti. Edhe kuponët e obligacioneve paraqiten jo në të njëjtat nivele me një vit më parë, përkatësisht me një ndryshim ndërmjet maturiteteve përkatëse, ku interesi i paguar për obligacionet me maturitet 1-5 vjet paraqitet në rritje me rreth 331.34 milion lekë si edhe interesi i paguar për obligacionet me maturitet 6-10 vjet paraqiten me rritje me rreth 474.25 milion lekë. Konstatohet se në ndryshim nga viti 2021 paraqiten pagesa për obligacionet me afat maturimi mbi 15 vjet në shumën 176.19 milion lekë.

Interesat e Borxhit të Jashtëm

Shpenzimet e interesit të borxhit të jashtëm kanë ardhur në rritje në krahasim me një vit më parë, pasi për vitin 2022 vlerësohen në shumën 15,610.05 milion lekë përkundrejt 12,907.66 milion lekë të deklaruara në vitin 2021.

Tabela 27 Interesat e paguara sipas instrumenteve të borxhit të jashtëm 2020-2022

Viti	Në milion lekë		
	2020	2021	2022
Interesa Borxh i Jashtëm Deklaruar	12,396.00	12,907.66	15,610.05
Interesa Borxhi i Jashtëm	11,440.00	11,702.55	14,827.22
Interesa huamarrje afatgjate nga institucionet ndërkombëtare	5,650.52	5,054.66	5,589.28
Interesa huamarrje afatgjate nga qeveri te huaja	1,175.19	1,085.99	1,206.65
Interesa huamarrje afatgjate për huamarrje te tjera te jashtme	4,614.01	5,561.90	8,031.29
Komisione Huamarrje e Jashtme	956.00	1,205.11	782.83

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Rritja në shërbimin e borxhit i atribuohet rritjes së interesave të huamarrjes së jashtme në krahasim me vitin e kaluar me rreth 3,124.67 milion lekë, konkretisht: ka rritje me 2,469.39 milion lekë të “Interesa të huamarrjes afatgjatë për huamarrje të tjera të jashtme”; me 534,62 milion lekë të “Interesave të huamarrjes afatgjatë nga institucionet ndërkombëtare” dhe me 120.66 milion lekë të “Interesave të huamarrjes afatgjatë nga qeveri të huaja”.

Nga auditimi konstatohet se, është rritur ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit duke qenë se ka emetime të instrumenteve (eurobond) në tregjet ndërkombëtare nga vitet e kaluara, si dhe efekte nga ndryshimi i normave bazë të interesit në tregjet ndërkombëtare

për huatë të cilat janë me norma të ndryshueshme interesi, ku në kushtet e pritshmërive për rritjen e normave nga autoritet monetare ndërkombëtare ekspozojnë buxhetin e shtetit në pagesa të rritura aktuale dhe të pritshme për shpenzime interesi për shërbimin e borxhit të jashtëm.

Mbi regjistrimin dhe arkëtimin e të drejtave të lindura nga marrëdhënia e nënhuasë, garancive dhe huave nga buxheti, të drejtat për të arkëtuar nga marrëdhëniet e nënhuasë KLSH ka konstatuar krijim të detyrimeve të reja në shumën 3,404 milionë lekë të subjekteve nënhuamarrëse në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë përgjatë vitit 2022, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse. Nga auditimi në lidhje me marrëveshjet e nënhuasë konstatohet se stoku i kredive në lidhje me këtë komponent të borxhit shtetëror është përkeqësuar përgjatë vitit 2022.

Tabela 28 Detyrimet për marrëdhëniet e nënhuasë 2018-2022

Në lekë

Sektori/Institucioni	Detyrimi fund 2018	Detyrimi fund 2019	Detyrimi fund 2020	Detyrimi fund 2021	Detyrimi fund 2022
Energjia	12,688,764,872	16,980,772,829	22,772,169,156.00	27,128,734,793	28,778,860,247
<i>KESH</i>	<i>6,932,415,130</i>	<i>8,649,361,190</i>	<i>12,887,266,141.80</i>	<i>15,286,928,519.72</i>	<i>17,429,281,567</i>
<i>OSHEE</i>	<i>1,510,620,353</i>	<i>2,583,655,499</i>	<i>2,593,797,377</i>	<i>2,640,445,990.15</i>	<i>2,687,239,704</i>
<i>OST</i>	<i>4,245,729,389</i>	<i>5,747,756,140</i>	<i>7,291,105,637</i>	<i>9,201,360,283.46</i>	<i>8,662,338,976</i>
Ujësjetës	5,981,938,063	6,409,007,664	7,177,075,469	7,991,844,828	8,599,808,111
<i>Ujësjetësi Durrës</i>	<i>1,156,396,669</i>	<i>1,339,229,523</i>	<i>1,467,625,951</i>	<i>1,686,424,196</i>	<i>1,824,320,619</i>
<i>Ujësjetësi Korçë</i>	<i>977,275,071</i>	<i>1,284,074,366</i>	<i>1,634,770,700</i>	<i>1,907,687,217</i>	<i>2,119,219,634</i>
<i>Ujësjetësi Vlorë</i>	<i>1,847,464,146</i>	<i>1,965,131,665</i>	<i>2,052,373,975</i>	<i>2,055,067,587</i>	<i>1,998,204,242</i>
<i>Te tjerë ujësjetës</i>	<i>2,000,802,177</i>	<i>1,820,572,110</i>	<i>2,022,304,843</i>	<i>2,342,665,828</i>	<i>2,658,063,616</i>
Bashki	2,571,631,379	3,877,431,361	5,050,189,246	6,372,067,193	7,499,711,329
<i>Bashkia Tirane</i>	<i>2,533,853,418</i>	<i>3,825,880,230</i>	<i>4,994,602,981</i>	<i>6,314,169,682</i>	<i>7,418,298,901</i>
<i>Të tjera bashki</i>	<i>37,777,961</i>	<i>51,551,131</i>	<i>55,586,265,20</i>	<i>57,897,511</i>	<i>81,412,428</i>
Mikrokredi	31,270,041	70,269,933	87,028,161	104,079,093	121,432,799
<i>FAF</i>	<i>310,382</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>0</i>
<i>Unioni Kursim Kredi</i>	<i>30,959,658</i>	<i>70,269,933</i>	<i>87,028,161</i>	<i>104,079,093</i>	<i>121,432,799</i>
Armo	5,363,783	6,456,933	7,742,595	8,713,772	9,335,313
TOTALI	21,278,968,137	27,343,938,720	35,094,204,628	41,605,439,680	45,009,147,798

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sektorët me përkeqësim të situatës financiare paraqiten sektori i energjetikës kryesisht me nënhuatë e KESH, OSHEE dhe OST me rreth 1,650 milion lekë të rritjes totale të detyrimeve nga 3,404 milion lekë në total, pushteti vendor me rreth 1,128 milion lekë, sektori i ujësjetësve me rreth 608 milion lekë, Institucionet e Mikrokredisë me nënhuatë, Unioni i Kursim Kredisë me 17 milion lekë, dhe ARMO me 0.62 milion lekë.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi është përgjegjësi ligjore e huamarrësve, të cilët kanë marrë fonde, që ti kthejnë fondet e marra hua në përputhje me marrëveshjet e nënhuave, duke krijuar një situatë ku detyrimet ndaj shtetit si pasojë e mos pagesave janë rritur me 3,404 milion lekë, me një trend rritës nga viti në vit. Nga analiza e stokut të detyrimeve për periudhën 5 vjeçare 2018-2022 rezulton se janë me një rritje totale në masën 112%. Niveli i kthimeve nga nënhuatë, vlerësohet i ulët për sa i përket detyrimit për të përmbushur kushtet e marrëveshjeve përkatëse. Nga 103 projekte për të cilat Buxheti i Shtetit ka të drejta për të arkëtuar, përgjatë vitit 2022 janë arkëtuar vetëm nga 27 prej tyre në shuma të vogla, me vlerë totale të kthimeve nga nënhuatë në shumën 3,242,121,387 lekë, nga të cilat interesa në shumën 1,190,989,560 lekë, komisione 11,656,254 lekë dhe principal i paguar në shumën 2,039,475,574lekë.

Të drejtat për të arkëtuar nga marrëdhëniet e garancisë

Garancitë shtetërore përgjatë vitit 2022 paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre dhe situatës së rënduar financiare të cilën kalon kryesisht sektori energjistik. Për vitin 2022 gjendja e detyrimeve në lidhje me garancitë shtetërore që subjektet përfituese kanë ndaj shtetit është rritur nga 17,415 milion lekë në vitin 2021 në 19,654 milion lekë në 2022, me një rritje vjetore prej 2,239 milion lekë.

Tabela 29 Institucionet dhe projektet specifike me problematikat më të mëdha 2018-2022

Në mijë lekë

Institucioni/projekti	Detyrimet 31.12.2018	Detyrimet 31.12.2019	Detyrimet 31.12.2020	Detyrimet 31.12.2021	Detyrimet 31.12.2022
Ministria e Energjisë dhe Industrisë (KESH, OST)	9 025 642	10 870 489	12 968 270	14 040 954	15 982 039
<i>Elektrifikimi i Zonave Rurale</i>	658 915	828 829	1 002 646	1 141 750,31	1 243 409,29
<i>Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë I</i>	27 660	37 586	52 912	63 834	69 860
<i>Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë II</i>	650 661	960 796	976 024	952 827	901 303
<i>TEC-i Vlorë</i>	4 465 018	5 222 945	5 879 703	6 277 091	6 305 168
<i>Transmetim, Shpërndarje e Energjisë</i>	1 815 979	2 321 047	2 818 323	3 119 622	3 123 957
<i>Hidrocentrali mbi Lumin Drin</i>	371 759	477 481	560 467	616 463	614 230
<i>Nënstacioni i Transmetimit të Energjisë</i>	1 034 998	1 021 161	1 037 346	1 012 691	957 931
<i>Plani i ristrukturimit të KESH</i>	0	0	640 850	625 619	2 766 180
<i>Projekti i efikasitetit në energji</i>	652	644	0	231 056	0
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës/UKT	1 285 030	1 390 135	1 536 390	1 621 144	1 648 195
<i>Furnizimi me Ujë i Tiranës II</i>	783 343	849 735	941 285	995 140	1 013 434
<i>Ujësjetësi i Tiranës I</i>	493 283	532 108	586 682	617 781	626 982
<i>Rehabilitimi i rrjetit hidrik të Tiranës</i>	8 404	8 292	8 424	8 223	7 779
Hekurudha Durrës	238 498	257 687	284 291	299 311	303 529
<i>Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit</i>	238 498	257 687	284 291	299 311	303 529
Ministria e Financave (ndihme në mallra)	94 409	129 976	185 695	218 484	230 057
Ndërmarrja e Ujësjetës-Kanalizime Krujë	59 548	63 739	69 783	73 005	73 644
Radio Televizioni Shqiptar	165 685	486 821	840 635	1 161 744	1 416 644
TOTALI	10 868 812	13 198 847	15 885 064	17 414 642	19 654 107

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022 janë akumuluar në masën më të madhe nga kompanitë private me kapital shtetëror përfituese në sektorin energjetik në shumën 1,941 milion lekë. Gjatë vitit 2022 konstatohet se Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa si pasojë e paftësisë paguese edhe të Radio Televizionit Shqiptar, duke rritur stokun e detyrimeve me 255 milion lekë. Gjithashtu edhe në sektorin e ujësjetësve për projektet në Ujësjetës Kanalizime Tiranë situata paraqitet problematike duke vendosur Buxhetin e Shtetit në risk për kryerjen e pagesave që kanë dështuar të kryhen nga ky përfitues i garancisë dhe rritjen e detyrimeve në shumën 27 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se nuk janë përmbushur përcaktimet e ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për aq kohë sa stoku i detyrimeve jo vetëm që nuk është ulur përgjatë vitit 2022, por është rritur me 2,239 milion lekë. Niveli i kthimeve nga garancitë, vlerësohet i ulët për sa i përket detyrimit për të përmbushur kushtet e marrëveshjeve përkatëse. Nga 27 projekte për të cilat Buxheti i Shtetit ka të drejta për të arkëtuar, përgjatë vitit 2022 janë arkëtuar vetëm për 9 prej tyre në shuma të vogla nga UKT, ATK, Albtelecom, KESH, OST, AKUM, Albpetrol dhe Servcom, në total 5,360,120 euro dhe 629,050,634 lekë.

Të drejtat për të arkëtuar nga kreditë shtetërore të tjera

Nga auditimi mbi konfirmimin e gjendjes së detyrimit që subjektet përfituese të marrëveshjeve të nënhuasë apo garancisë kanë ndaj Buxhetit të Shtetit është konstatuar se për kredinë me numër identifikimi 88 sipas regjistrimit të borxhit ekzistojnë detyrime në 31.12.2022 nga subjektet përfitues të ndryshëm. Kjo kredi ndërmjet *Medio Credito Centrale* (kreditori) dhe Qeverisë Shqiptare (huamarrësi) është nënshkruar me 06.07.1998 dhe është

regjistruar si kredi shtetërore, detyrimet e së cilës në total në fund të vitit 2022 rezultojnë 3,582,256 euro.

Ecuritë e Garancive Sovrane 1, 2 dhe 3 për vitin 2022.

Ecuria e Garancisë Sovrane Nr. 1 (GS1)

Deri më 31.12.2022, vlera e kredive të miratuara nga 12 bankat nënshkruese, rezulton në një total prej 5,901,304,786 lekë, nga të cilat janë disbursuar 5,333,740,211 lekë dhe ku numri i kontratave të miratuara deri në fund të periudhës është 500.

GS1 është përdorur në masën prej rreth 54% (vlera e miratimeve kundrejt totalit) ku bankat që e kanë shfrytëzuar më tepër skemën e garancisë (në vlerë absolute) janë BKT, Raiffeisen Bank dhe OTP Bank. Kreditë e miratuara nga këto tre banka përbëjnë pothuajse 60% të totalit të kredive sipas kësaj skeme garancie. Nga kjo skemë kanë përfituar biznese në sektorët e ekonomisë si: tregti, prodhim, turizëm, media, shërbime, edukim, ndërtim, miniera, industri nxjerrëse dhe ajo përpunuese, aktivitete të qiradhënies, transport, shërbime spitalore apo shëndetësore, aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike.

Ecuria e Garancisë Sovrane Nr. 2 (GS2)

Gjatë muajit dhjetor 2022, vlera e kredive të miratuara nga bankat nën skemën e GS2, është rritur me vlerën prej rreth 635 milionë lekë, ku janë shënuar 11 kontrata të reja. Vlera e disbursimeve është rritur me 846 milionë lekë. Deri në fund të muajit dhjetor 2022, vlera e kredive të miratuara nga 12 bankat nënshkruese, rezulton në një total prej 18,782,266,484 lekë, nga të cilat janë disbursuar 18,315,872,627 lekë. Numri i kontratave të miratuara deri në fund të periudhës është rreth 616 (Kontrata kredie, Linja Kredie ose Overdraft). GS2, deri në fund të muajit dhjetor 2022 është përdorur në masën prej rreth 75% (Vlera e miratimeve kundrejt totalit 60% te garantuar) ku bankat që kanë qenë më aktive në përdorimin e saj, janë ABI dhe Raiffeisen Bank, nisur nga fakti i përdorimit të vlerës limit fillestar dhe asaj të rialokuar. Kjo skemë ka kredituar biznese në sektorët e ekonomisë si: tregti, prodhim, turizëm, media, shërbime, ndërtim, industri përpunuese dhe transport.

Ecuria e Garancisë Sovrane Nr. 3 (GS3)

GS3 e miratuar në vlerën 3,000,000,000 lekë, deri në fund të muajit dhjetor 2022 është përdorur në masën prej rreth 14% (Vlera e miratimeve kundrejt totalit 60% te garantuar) ku nga 4 bankat e përcaktuar në VKM vetëm 2 prej tyre (BKT dhe Raiffeisen Bank) kanë kredituar bizneset. Kjo skemë ka kredituar biznese në sektorët e ekonomisë në tregti dhe prodhim.

Nga auditimi në MFE ka rezultuar se, bazuar në modelin e Bankës Botërore për përgatitjen e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB), janë shqyrtuar dhe analizuar nga ana e MFE-së alternativat përkatëse, duke gjeneruar modelin me rezultatet e treguesve kryesorë. Strategjitë alternative të huamarrjes janë analizuar dhe krahasuar nga MFE duke konsideruar dy indikatorë paralelisht: koston e borxhit, si dhe zhvillimet mbi treguesit e riskut për secilën prej strategjive, pas të cilave ka rezultuar se, sipas SAMB 2022-2026 strategjia S3 ka avantazhe të dukshme sa i takon treguesve të risqeve, ku konkretisht: financimi në tregun e brendshëm në vitet 2022-2026 është planifikuar të mundësohet kryesisht nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit në një masë gjithnjë në ulje ndër vite, në një nivel mesatar prej rreth 58% të huamarrjes në tregun e brendshëm, duke vijuar me emetimin e instrumenteve afatmesme, këto çdo vit në rritje (mesatarisht në masën prej 29%), si dhe atyre afatgjata në masën prej 13%.

Gjithashtu, përmirëson ndjeshëm profilin e maturimit të borxhit, për rrjedhojë treguesit e riskut të rfinancimit dhe ato të normës së interesit, si dhe konsiderohet se sjell zhvillime pozitive edhe në drejtim të riskut të kursit të këmbimit duke mundësuar rënie graduale të

peshës së borxhit në valutë të huaj nga rreth 50%, niveli që arriti ky tregues në fund të vitit 2021, në nivelin e projektuar prej rreth 45% në fund të periudhës së strategjisë.

Strategjia S3 paraqet gjithashtu avantazhe sa i takon nivelit të nevojave bruto për financim gjatë periudhës së strategjisë, ku ky nivel është ndjeshëm më i ulët krahasuar me strategjitë e tjera. Niveli i shërbimit të borxhit gjithashtu, si dhe ripagesat e principalit, në këtë Strategji janë më të ulëta krahasuar me të tre alternativat e tjera të strategjisë.

Një ndër objektivat kryesore të SAMB është reduktimi i riskut të rifinancimit kryesisht në portofolin e borxhit të brendshëm, pasi borxhi i jashtëm paraqet më pak risk duke qenë se është i përbërë nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe me profile amortizimi të shtrira gjatë në kohë. Gjatë vitit 2022, si rezultat i emetimit të shtuar të titujve afatshkurtër për qëllime të sigurimit të financimit të nevojshëm, treguesit e riskut të rifinancimit nuk kanë shfaqur përmirësim. Konkretisht, jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është ulur me 13 ditë, nga 793 ditë (2.2 vite) në fund të vitit 2021 në 780 ditë (2.17 vite) në fund të vitit 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një kufi minimal 2,5 vite.

Gjithashtu, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti është rritur nga 46.6% në dhjetor 2021 në 47.9% në dhjetor 2022 ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një tavan prej 40%.

Për rrjedhojë tendenca faktike e borxhit të vitit 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të SAMB 2022-2026.

Konstatohet se tendenca e borxhit që rifiksohet brenda 1 viti, rezulton të jetë rritur me 1% duke kaluar nga 48% në vitin 2021 në 49% në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një tavan prej 43%.

Gjithashtu, konstatohet se, edhe koha mesatare në rifiksion ka ardhur në ulje nga 2,19 vite në 2021 në 2,17 vite në vitin 2022, ndërkohë që objektivi strategjik 2022-2026 e parashikon me një kufi minimal 2,5 vite.

Për rrjedhojë tendenca faktike e vitit 2022 nuk ka shkuar në drejtimin e përmirësimit të arritjes së objektivit të strategjisë 2022-2026, duke cenuar ekuilibrat me ligjin e buxhetit vjetor, kuadrin makroekonomik dhe fiskal të qeverisë, si edhe me politikat monetare që Banka e Shqipërisë ka planifikuar të zbatojë në periudhën afatmesme.

Risku i normave të interesit gjithashtu nuk ka shfaqur përmirësim gjatë vitit, kjo në rrethanat e përdorimit rregullisht të instrumenteve afatshkurtër (bono thesari 3, 6 dhe 12 mujore). Konkretisht, pesha e titujve që rivlerësojnë normën e interesit brenda vitit është rritur nga 48.0% në 49.0%, ndërkohë që edhe koha mesatare në rifiksion është ulur nga 2.19 vite në 2.17 vite.

Ndryshe nga treguesit e tjerë, risku i kursit të këmbimit gjatë 2022 ka pasur një përmirësim të ndjeshëm, pasi është mbajtur në nivele të qëndrueshme nën tavanin e përcaktuar në strategjinë e borxhit (SAMB). Konkretisht, totali i stokut të borxhit në valutë ndaj stokut të borxhit total rezultoi 46.8% në fund të vitit 2022, duke u ulur me 3 pikë përqindje, krahasuar me fundin e vitit 2021.

Gjatë vitit 2022 ky tregues është ndikuar pjesërisht edhe nga nënçmimi i pjesës më të madhe të valutave të huaja, kryesisht Euros, kundrejt lekut, por gjithashtu edhe nga një huamarrje e ulët nga burimet e jashtme, e cila në terma neto (diferenca ndërmjet huamarrjes së jashtme vjetore me borxhin e jashtëm të shlyer gjatë vitit) ka qenë negativ.

II. MBI KONTABILITETIN E SEKTORIT PUBLIK, SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIN FINANCIAR, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM

Kontabiliteti i sektorit publik dhe sistemi i raportimit financiar në institucionet e qeverisjes së përgjithshme.

Nga auditimet e kryera nga ana e KLSH në MFE dhe njësitë e tjera shpenzuese për vitin 2022, evidentohet se kuadri rregullator dhe politikat e miratuara nga ministria përgjegjëse për financat, të zbatueshme për njësitë shpenzuese të sektorit publik, bazohen në disa udhëzues të karakterit administrativ që adresojnë procedurën e hartimit, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare të sektorit publik, në mungesë të një kuadri të plotë ligjor mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, që ti shërbejë rritjes e llogaridhënies dhe ushtrimit të autoritetit të MFE nëpërmjet sanksioneve në rast të mos zbatimit të këtyre dispozitave.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcaktuar objektivat e saj vjetore e afatmesme, referuar parashikimeve të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 për fushën e kontabilitetit publik e menaxhimit financiar si dhe Dokumentit të Politikave për Zhvillimin e mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik 2021-2022.

Në zbatim të rekomandimeve KLSH, nga ana e MFE përgjatë vitit 2022, në kuadër të zhvillimeve për kontabilitetin në sektorin publik, janë kryer:

- *Përafrime ligjore në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar:*

Gjatë periudhës 2021-2022, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, referuar edhe rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka realizuar disa ndryshime të udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nëpërmjet miratimit të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022 “Mbi ndryshimin e udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Nga DH/MFKK janë hartuar draftet e kuadrit të ri rregullator bazuar në kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (IPSAS), të cilat kanë përfunduar brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2022. Nga ana e konsulentit ndërkombëtar janë hartuar dhe diskutuar me MFE-në udhëzimet në lidhje me inventarët, provigjionet, aktivet afatgjata materiale, aktivet afatgjata jomateriale, mbi shpenzimet, mbi përfitimet sociale dhe përfitimet e punonjësve, instrumentet financiarë, konsolidimin e pasqyrave financiare si dhe të ardhurat. Gjithashtu, ka përfunduar dokumenti për rishikimin e proceseve të punës për kontabilitetin dhe raportimin financiar si dhe është realizuar vlerësimi mbi funksionalitetin e sistemit të thesarit AGFIS.

- *Ngritja e kapaciteteve të kontabilistëve publikë:*

Një nga aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2022 nga MFE është rritja e kapaciteteve për kontabilistët dhe financierët në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik bazuar në standardet IPSAS, nëpërmjet organizimit të trajnimeve në mënyrë intensive për stafin e angazhuar në fushën e kontabilitetit, proces i është zhvilluar gjatë harkut kohor 2021 – 2022, duke u trajnuar mbi 400 kontabilistë të institucioneve publike.

- *Përkthimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik:*

Gjatë vitit 2022 është realizuar përkthimi i *Handbook-ut* të standardeve IPSAS, të cilët përfshijnë dhe fjalorin e termave kyç si dhe kuadrin konceptual të tyre.

- *Pilotimi i kuadrit rregullator të fushës së kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me IPSAS në shtatë institucione pilot:*

Në vitin 2022 është realizuar procesi i pilotimit të hartimit të pasqyrave financiare bazuar në kuadrin e ri rregullator të fushës së kontabilitetit të sektorit publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe në institucionet e tjera të përzgjedhura si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti Rrugor Shqiptar, AKSHI, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës si dhe Bashkia Tiranë.

KLSH, bazuar dhe në zbatim të direktivave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të datës 20.7.2023 për rolin e KLSH në forcimin dhe përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve publike, është fokusuar nëpërmjet auditimeve financiare dhe të kombinuara si dhe atyre mbi bazë sistemi, duke realizuar vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik, nga ku ka rezultuar sa vijon:

• **Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme (MFE):**

- Për periudhën objekt auditimi, kuadri unifikues dhe baza rregullatore e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm në institucionet e qeverisjes së përgjithshme të sektorit publik, (të qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale), përfaqësohet nga një akt nënligjor teknik, siç është Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.2.2022, i cili konsiderohet një nivel i ulët në hierarkinë e dispozitave ligjore të kësaj fushe. Në këtë kontekst, nuk është shënuar ndonjë progres në fushën e legjislacionit të kontabilitetit të sektorit publik, *(madje ka hapa prapa, meqenëse deri në mesin e vitit 2018, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin buxhetor publik rregullohej nga një ligj i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, përkatësisht, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i shfuqizuar).*

Sa më sipër, nuk janë përmbushur:

- kërkesat e Nenit 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, Kreu VII “Kontabiliteti i sistemit buxhetor”, të Ligjit nr.9936, dt. 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, që ka përcaktuar se, *(citur): “Ministri i Financave është përgjegjës për krijimin e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar. Ministri i Financave përcakton njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë shpenzuese, të cilat janë të detyruara të mbajnë kontabilitet dhe të raportojnë sipas standardeve të përcaktuara.... Kontabiliteti dhe raportimi në sektorin publik rregullohen me ligj të veçantë dhe Ministri i Financave nxjerr udhëzim për standardet dhe procedurat e kontabilitetit, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*
- detyrimet e Kreut 5.4, (Produkti 5.4.2), të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, miratuar me VKM nr. 824, dt. 18.12.2019, mbi përfundimin e akteve ligjore në përputhje me IPSAS dhe planin e miratuar të veprimit strategjik të vendit, që ka përcaktuar si afat përfundimtar nxjerrjen e akteve ligjore Tremujorin e Katërt të vitit 2022.
- Nuk janë hartuar e miratuar aktet e detyrueshme që synojnë të vendosin në zbatim SNKSP-të / IPSAS mbi kontabilitetin me bazë të drejtat e detyrimet e konstatuara, që është korniza rregullatore për çdo nivel qeveritar dhe është vonuar procesi i vënies në zbatim i këtyre standardeve. Zbatimi i paketës së standardeve të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara SNKSP është një sipërmarrje e ndërlikuar, ndonëse Projekti shumëfazësh

për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik shqiptar ka filluar që në v.2018 dhe shtrihet sipas dokumenteve strategjike deri në vitin 2027, periudhë kjo relativisht shumë e gjatë.

- Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë *nuk kanë hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse, të konsoliduara për sektorin publik*, për periudhën objekt auditimi 1.1.2022-31.12.2022. Nga auditimi i kryer nga KLSH, në lidhje me zbatimin e standardeve të raportimit financiar dhe sistemin e kontabilitetit të sektorit publik, ka rezultuar se, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk janë hartuar e dorëzuar në Qeveri dhe Kuvend, Pasqyrat Financiare Përmbledhëse, të Konsoliduara as në nivel grupi (ministrie), as në nivelin e përgjithshëm për Njësitë e Sektorit Publik për vitin 2022, duke mos u dhënë kështu mundësinë përdoruesve të interesuar, të brendshëm dhe të jashtëm të marrin informacion të saktë e të besueshëm si dhe të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.
- Nuk ofrohet siguri mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit kontabël, të përmbledhur në nivel grupi (ministrie, bashkie, etj.), pasi në shumë raste pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore kanë shfaqur pasaktësi dhe mospërputhje. Si përfundim, *për vitin 2022, pasqyrat financiare të sektorit publik, nuk janë përfshirë në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të shtetit, të përgatitur nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.*
- Për periudhën objekt auditimi, rezultojnë se *69 institucioneve buxhetore të analizuar, kanë shfaqur probleme të shkeljes së afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale*, e më konkretisht:
 - Për vitin 2021, evidentohet se 28 njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 1016 institucione të qeverisjes së përgjithshme gjithsej (të qeverisjes qendrore, të vetëqeverisjes vendore, të fondeve speciale, të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve, etj., të regjistruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit), që nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë **pasqyrat financiare individuale** të institucioneve buxhetore pranë Degës së Thesarit, me tejkallim dhe shkelje të afateve ligjore të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.
 - Për vitin 2022, 41 njësi shpenzuese/ institucione buxhetore, nga 1046 institucione gjithsej (të qeverisjes së përgjithshme, të vetëqeverisjes vendore, të fondeve speciale, të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve, etj., të regjistruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit), ose rreth 4 % e tyre, nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Degës së Thesarit, me tejkallim dhe shkelje të afateve ligjore të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.
 - Bazuar në informacionet e administruara nga DPTH, rezultojnë se, nuk janë depozituar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (PFK)* nga institucionet buxhetore dhe ekstra- buxhetore, si vijon:
 - Për vitin 2021, nuk kanë depozituar pasqyrat financiare të konsoliduara 72 njësi të qeverisjes së përgjithshme, nga 138 subjekte gjithsej që sipas MFE që kanë detyrimin për hartimin dhe depozitimin e këtyre PFK-ve, ose 53 % institucioneve nuk kanë përmbushur këtë detyrim, ku peshën kryesore në këtë parregullsi e zënë institucionet e vetëqeverisjes vendore. Analizuar sipas strukturës së referuar, këto institucione detajohen si më poshtë vijon:

- 2 ministri, (*Ministria e Kulturës dhe Kryeministria*), 3 Këshilla të Qarqeve, 51 bashki dhe 17 institucione qendrore.
- Për vitin 2022, nga 97 njësi të qeverisjes së përgjithshme, ose nga 70.3 % e institucioneve që kanë detyrimin për hartimin dhe depozitimin e PFK-ve, që sipas strukturës së referuar më lartë detajohen si më poshtë vijon:
 - 5 ministri: (*Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Ministria e Kulturës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Kryeministria*), 8 Këshilla të Qarqeve, 56 bashki, 28 institucione qendrore dhe të tjera.
- Nuk rezulton që të gjithë Njësitë e Zbatimit të Projekteve (NJZP) për v.2021 dhe 2022 të kenë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë DPTH së MFE-së si dhe, nuk janë përfshirë Pasqyrat Financiare të NJZP-ve, si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore, në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 20, shkronja “c”, të UMF nr. 5, datë 21.2.2022, i cili ka parashikuar se: *“Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjnauar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:c. Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e llogarisë qendrore të qeverisë, të llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik”*.
- Nuk janë marrë masat rast pas rasti nga NPA, mbi nxjerrjen e përgjegjësive administrative ndaj nëpunësve autorizues dhe zbatues të institucioneve buxhetore e ekstra-buxhetore, për mosdorëzimin apo dorëzimin jashtë afat ligjor të përcaktuar, të pasqyrave financiare individuale dhe të përmbledhura.
- Mungesa e rakordimit dhe e shpjegimeve në lidhje me mospërputhjet/ mosrakordimet e informacioneve dhe të dhënave të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, me të dhënat e pasqyrave financiare të dorëzuara fizikisht nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme.
- Në një numër rastesh, nuk sigurohet krahasueshmëria e të dhënave të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara dhe raporteve financiare të përgatitura nga ana e organeve shtetërore për ushtrimin e mëparshëm dhe bilancin e çeljes për vitin ushtrimor; gjë që tregon për moskryerjen e kontroleve sistematike të informacioneve që dërgojnë institucionet shtetërore në ministritë e linjës, në shkelje të parimeve dhe normave kontabël.
- Mungon regjistri i aktiveve dhe pasurive shtetërore në nivel qendror dhe për gjithë institucionet e qeverisjes së përgjithshme dhe për pasojë nuk ofrohet siguri e mjaftueshme se institucionet e sektorit publik kanë vendosur e zbatuar kontrole dhe monitorime të plota mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre në mënyrë efikase. Dobësi janë evidentuar në kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor të aseteve dhe mungesa e vlerësimit të pasurive të institucioneve buxhetore e ekstra-buxhetore me qëllim pasqyrimin në kontabilitet të aktiveve, me vlerën e tyre të drejtë.
- Llogaritë kryesore inventariale të pasurisë, (sintetike dhe analitike), rezultojnë me pasaktësi për shumë institucione buxhetore e njësi shpenzuese të testuara, pasi mungojnë analizat e tyre. Praktika të njëjta të mos regjistrimit në kontabilitet të vlerës së *“Ndërtesave”* dhe mos evidentimit të gjendjeve të llogarisë *“Toka, troje e terrene”* konstatohen gjerësisht, si në auditimet e institucioneve në nivelin qendror, duke vazhduar edhe me ato në nivel vendor, edhe pse për vite më radhë janë dhënë rekomandime për përmirësimin e kësaj gjendjeje, duke shënuar një përmirësim të pandjeshëm, në raport me vitet paraprake. Nga kryqëzimet e informacionit dhe auditimi i treguesve të pasqyrave

financiare të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) rezulton se, për vitin 2020, 2021 dhe 2022, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në **10 institucione qendrore** (Ministri dhe institucione të tjera qendrore) nga 12 gjithsej të përfshira në analizë, vlerën e llogarisë 210, “Toka, troje dhe terrene”, e kanë të pasqyruar me vlerën zero lekë, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të kontabilitetit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit 60 dhe 62, pika 3.3,”Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci) kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë

- Rritje të vazhdueshme të llogarive të arkëtueshme dhe të detyrimeve të pagueshme, shtim i stokut të detyrimeve të shtetit nga vendimet e Gjykatave të Arbitrazhit dhe GJEDNJ, nivel i lartë i shpenzimeve buxhetore nga vendimet gjyqësore / përmbartimore, me ndikim në rritjen e shpenzimeve shtesë, etj.
- Nga kryerja e testimeve substanciale, për verifikimin e mbartjes së tepriceve në llogari në fund të periudhës tek ato në fillim periudhës së vitit pasardhës, (tepricat e çeljes) në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata materiale, u konstatua se, *ekzistojnë mospërputhje midis shumave të bilancit të mbylljes të vitit paraardhës dhe atij të çeljes në vitin pasardhës, për Pasqyrat Financiare Përmbledhëse për 5 Institucione të Qeverisjes Qendrore (ministri)*. Kjo situatë e mospërputhjes së të dhënave krijon probleme e pasaktësi të informacionit kontabël, si dhe shton vështirësitë e konsolidimit në nivel grupi dhe më tej në nivel të qeverisjes së përgjithshme, pasi efekti i përgjithshëm i mosrakordimeve vetëm për institucionet e analizuara është në shumën prej **47,891,252,473 lekë**. Më hollësisht:

▸ *Ministria e Financave dhe Ekonomisë:*

Në bilancin e konsoliduar të vitit 2021, në formatin nr.1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, totali i aktiveve nuk është i barabartë me totalin e pasivit të bilancit të konsoliduar për vitin 2020 dhe 2021. Gjithashtu, shuma totale e aktivitetit të bilancit të konsoliduar (pasqyra nr.1), për datën 31.12.2021 është 503,821,359,488 lekë, kurse shuma totale e aktivitetit të bilancit të dt. 31.12.2022 për ushtrimin paraardhës është 455,965,038,944 lekë, duke rezultuar me diferencë dhe mos barazim për vlerën -47,856,320,544 lekë;

▸ *Ministria e Brendshme:*

Nga auditimi i PFK të Ministrisë së Brendshme, konstatohet se, ekzistojnë mospërputhje të të dhënave të kolonës “ushtrimi i mbyllur” i bilancit të konsoliduar të datës 31.12.2021, (*dërguar MFE me shkresën nr. 2396/2, dt 29.4.2022 të MB*), pasqyruar totali i aktivitetit dhe pasivit për 30,812,751,940 lekë, me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, në bilancin e datës 31.12.2022, (*dërguar në MFE me shkresën e MB nr. 3030/1, datë 28.4.2023, protokoll i MFE nr. 9407, dt 23.5.2023*), ku totali i aktivitetit dhe pasivit pasqyruar për v.2021 është: 30,817,636,787 lekë. Sa më sipër, rezulton diferenca në vlerën prej + 4,884,847 lekë, për të cilën nuk kuadrojnë të dhënat dhe pasqyruar me tepër çelje ushtrimi i mëparshëm, në fillim të vitit 2022;

▸ *Ministria e Arsimit dhe Sporteve:*

Nga auditimi i PF përmbledhëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, konstatohet se, ekzistojnë mospërputhje e të dhënave të kolonës “ushtrimi i mbyllur” i bilancit të konsoliduar të datës 31.12.2021, (*dërguar MFE me shkresën nr. 2810/1, dt 29.4.2022*), ku është pasqyruar totali i aktivitetit dhe pasivit për 30,564,666,353 lekë, me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, në bilancin e datës 31.12.2022, (*dërguar në MFE me shkresën e MAS nr. 2802, datë 28.4.2023 (ska nr. protokollit të MFE)*), pasqyruar totali i aktivitetit dhe pasivit për vitin e mëparshëm 2021 për: 30,562,057,766 lekë, me një

diferencë mosakordimi në vlerën prej - 2,608,587 lekë, sa nuk kuadrojnë të dhënat dhe pasqyruar me tepër çelje ushtrimi i mëparshëm, në fillim të vitit 2022;

• *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:*

Konstatohet se, nuk përputhen të dhënat e kolonës “ushtrimi i mbyllur” (i bilancit të datës 31.12.2021, i pasqyruar për 391,217,673,910 lekë) me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, (në bilancin e datës 31.12.2022, i pasqyruar për 391,212,997,609), duke patur një diferencë mosakordimi në vlerën prej - 4,676,301 lekë, sa pasqyruar me pak çelje ushtrimi i mëparshëm, në fillim të vitit 2022.

• *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:*

Nga kryerja e testeve substanciale, për verifikimin e mbartjes së tepricave në fund të periudhës tek ato në fillim të periudhës (tepricat e çeljes) në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata, u konstatua se, ekzistojnë mospërputhje midis shumave të bilancit të mbylljes dhe atij të çeljes në vitin pasardhës, pasi: të dhënat mbi gjendjen e ushtrimit paraardhës në PFK të vitit 2022 (në formatin 1, “Totali i aktiveve”, rreshti nr.1 janë në shumën prej 45,664,255,457 lekë, kurse në pasqyrën financiare të konsoliduar të vitit 2021, totali i aktiveve gjithsej në ushtrimin e mbyllur është regjistruar për tepricën neto 45,687,017,651 lekë në pasqyrën nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël”, duke rezultuar një mbartje më pak të vlerave të llogarive në bilancin e çeljes prej -22,762,194 lekë, etj.

• **Sistemi i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme (MIE):**

- Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë hartuar Pasqyrat Financiare Përmbledhëse Vjetore për v. 2022, por ato përmbajnë parregullsi, mangësi e mospërputhje, ndaj nuk është e mundur që të ofrohet siguri e plotë mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit të përmbledhur në nivel grupi (ministrie).
- Probleme të shkeljes së afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale, nga institucionet buxhetore dhe ekstra-buxhetore. Njësitë e Zbatimit të Projekteve të MIE nuk kanë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë MIE dhe MFE-së për v. 2022. Nga ana e institucionit “Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë” dhe “Agjencisë Kombëtare Bërthamore Tiranë” nuk janë dorëzuar PFK të vitit 2022.
- Teprica debitore e llog.486 “Shpenzimet e periudhave të ardhshme”, sipas PFK të MIE për vitin 2022 është 542,573,164 lekë. Pra, nuk rezulton të jenë kryer veprimet sistemuese dhe mbyllëse të llogarisë 486. Sa më sipër, analiza e pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) tregon se, për vitin 2022, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në shumicën e institucioneve buxhetore të vartësisë, nuk janë hartuar në përputhje me përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022.
- Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve kundrejt listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar nga VKM dhe kaluar në përgjegjësi administrimi të ministrisë dhe subjekteve të varësisë direkte; Përfshirja e vlerës e Planeve të Përgjithshme Vendore, pjesë e llog.202 “Studime dhe kërkime” të MIE, në vlerën 1,345,048,518 lekë, e cila ka marrë në debi të saj vlerën e financimit të kontratave për studim-projektimet e kryera si dhe vlerën e financimit të Planeve të Përgjithshme Vendore.

- Nga auditimi i llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” konstatohet se për vlerën prej 34,145,203 lekë mungon analiza inventariale, nuk ka ndonjë të dhënë ngase përbëhet kjo shumë (por vetëm shënimi gjendje nga vitet e kaluara ish-Ministria e Energjetikës) dhe MIE nuk disponon dokumentacion për këtë aktiv. Gjithashtu nga auditimi i llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” konstatohet se për 2 (dy) aktive në vlerë 2,804,028,855 lekë mungon analiza e tyre dhe MIE nuk disponon dokumentacion për këto aktive, pasi për aktivin në vlerën prej 269,377,038 lekë është vendosur shënimi “Gjendje nga vitet e kaluara, ish-Ministria e Transportit” dhe për aktivin në vlerë 2,534,651,817 lekë është vendosur shënimi “Gjendje nga vitet e kaluara, ish-Ministria e Energjisë”.
- Evidentohet një nivel i lartë i detyrimeve të subjekteve debitore dhe klientëve dhe rezultojnë një trend në rritje për to për periudhën e audituar. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet në shumën prej 4,694 milionë lekë në fund të v. 2022. Evidentohet se, janë shtuar të drejtat e tjera për arkëtim, për zëra të tilla si “Divident i Albpetrolit” për **2,155,452,687 lekë**, (nga kjo shumë janë arkëtuar vetëm 1 milionë lekë); masa e dëmit sipas urdhrorit nr.313. datë 23.12.2020 “Për përfundimet e inspektimit financiar publik” për 7 zyrtarë të institucionit, me nga 126,322 lekë/secili. Për vitin ushtrimor 2022 janë shtuar detyrimet debitore në kuadër të Llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, për OSHEE Grup sha, për detyrimet e tarifës koncesionare, sipas kontratës koncesionare nr.5535/5, datë 24.10.2016 në shumën 1,495,990,439 lekë. Përfshirja e detyrimeve të OSHEE Grup sha, për sa llogarituri tarifa koncesionare e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et të dhëna me koncesion për periudhën 2016-2021, i përket një periudhe 5 vjeçare, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në kontabilitet.
- Ekzistojnë mospërputhje midis të dhënave të bilancit të konsoliduar të MIE, i mbyllur më datën 31.12.2022, (sa pasqyruar në formatin 7/b, krahasuar me të dhënat e regjistruara në Formatin nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël për AAM). Më konkretisht, Aktivitet Afatgjata Materiale më dt. 31.12.2022 në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1) janë pasqyruar për 182,171,229 mijë lekë dhe në Pasqyrën e Aktiveve “Gjendja dhe ndryshimi aktiveve afatgjata F7 janë 182,163,506 mijë dhe paraqesin diferencën ose nuk rakordojnë prej **7,723 mijë lekë**.
- Mos rakordim i të dhënave dhe vlerave të bilancit të konsoliduar të MIE në rubrikën “ushtrimi i mbyllur” (të datës 31.12.2021) evidentuar 391,217,673,910 lekë, me të dhënat e rubrikës “ushtrimi paraardhës”, (të bilancit të datës 31.12.2022) pasqyruar 391,212,997,609 lekë, për diferencën prej **4,676,301 lekë**, në kundërshtim me paragrafin 31, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018, i ndryshuar.
- **Zbatimi i kriterëve, rregullave dhe procedurave të administrimit dhe dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit**, sipas rezultateve të auditimit të kryer në **MBZHR**:
 - Mungesë e regjistrimit në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare për periudhën 2022, të tokave bujqësore që MBZHR administron, (në sipërfaqe totale 19,033.95 ha), duke cenuar transparencën dhe pasqyrimin e plotë të të dhënave pasurore në administrim të MBZHR.
 - Mungesë e përditësimit, inventarizimit, dhe regjistrimit e gjithë fondit të tokës bujqësore që ka në administrim MBZHR, duke bashkëpunuar dhe koordinuar punën me Drejtoritë Rajonale të Administrimit të Tokave në Qarqe dhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.
 - Në 10 nga 21 kontrata të lidhura, ose 48% të tyre, qiramarrësit nuk kanë paguar në kohë detyrimin për qiranë duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit si dhe shtim

të detyrimeve të prapambetura në lidhje me kamatëvonesat e llogaritura në vlerën totale **55,830 mijë lekë**.

- Në 12 nga 21 kontrata të lidhura, ose *57% të kontratave të qirasë*, qiramarrësit *nuk kanë kryer investime në terren* për të cilat në dosjet e kontratave të audituara nuk ka dokumente justifikuese (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/ shërbimesh), për rrjedhojë 57% e kontratave nuk provon realizimin e investimit. Pra 12 kontratat e qirasë nuk janë kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, të cilat duhej të realizoheshin brenda 3 vjetëve nga momenti i dorëzimit, si dhe nuk kanë kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para në një vlerë prej 426,029 mijë lekë.
 - Në lidhje me monitorimin e kontratave nga Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të kontratave, për vitin 2022, ky sektor ka monitoruar: 14 kontrata nga 51 gjithsej, ose 27 % e kontratave. MBZHR nuk disponon një plan vjetor për monitorimin e kontratave, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve, nuk u gjenden raporte për çdo vit për monitorimin e kontratave, në kundërshtim me VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies së tokës me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” i ndryshuar, Kreu VII, pika 5. Gjithashtu për monitorimet e kryera nga sektori u konstatua se nuk kishte të dhëna të hollësishme për kontratat e monitoruara në lidhje me gjendjen faktike të investimeve të kryera dhe kulturave të mbjella duke e justifikuar me dokumentet përkatëse, të cilat duhet të jenë pjesë e dosjeve, në funksion të ruajtjes së gjurmës së auditimit.
 - MBZHR nuk ka ngritur në vazhdimësi grupet e punës për vlerësimin dhe identifikimin e kontratave që kanë problematika të mos përputhjes së vlerës së investimit të parashikuar në plan biznes me atë të lidhur në kontratë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8318, dt.01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjeve, livadheve e kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar (Neni 15), dhe VKM nr.460, datë 22.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, (pikat 8 dhe 9).
 - Megjithëse janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit, janë hasur probleme ndër vite me zaptimin e tyre nga palë të treta pa tagra pronësie dhe për pasojë nuk ka një shfrytëzim të plotë të ngastrave të tokës të dhënë me qira.
 - Nuk janë dorëzuar **garancitë e kontratave** nga ana e subjekteve, në kundërshtim me detyrimet kontraktuale sipas nenit 8 “Sigurimi i garancisë së kontratës “pasi sigurimi i kontratës lëshohet për një afat 1-vjeçar dhe duhet të rinovohet çdo vit deri në realizimin e investimeve të parashikuara në planin e biznesit, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- ♣ Në subjektin **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** rezultoi se:
- Nga auditimi i detyrimeve dhe vendimeve gjyqësore u konstatua se këto detyrime nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë njohur në momentin e likuidimit.
 - Nga auditimi i analitik i zërave të llogarisë nr.28 “*Caktime të Aktiveve Afatgjata*” shuma prej 235,323,285 lekë është mbartur përpara vitit 2017, por Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nuk ka informacion se cilat janë këto projekte/investime të zhvilluara përpara vitit 2017, si dhe nuk kanë emërtesa të tyre, mungojnë kartelat inventariale dhe nuk dihet se çfarë përfaqësojnë këto vlera të kontabilizuara.
 - Nga auditimi analitik i llogarisë 230 “*Investime për aktive afatgjata jo materiale*” gjatë vitit ushtrimor 2021, për 8 projekte në shumën 17,372,947 lekë kanë qenë aktive afatgjata jo materiale në proces ku investimi i tyre ka qenë i pa përfunduar. Këto projekte nuk janë

paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2021 konkretisht në llogarinë nr.230 , pasi kjo llogari është paraqitur në vlerën 0 lekë. Këto projekte të pa përfunduara në vitin 2021 duhet të pasqyroheshin në llogarinë nr.230 “Investime për aktive afatgjata jomateriale”, dhe në momentin e marrjes në dorëzim të kapitalizohen më pas tek klasa e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivitetit;

- Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” evidentohet se përbëhet nga fondet e ngurtësuar për 10 objekte, nga të cilat për 7 objekte në vlerën prej 20,730,648 lekë, janë fonde që gjenden të ngurtësuar nga viti 2014, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive.
 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto dhe rakordimi me pasqyrimin e vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C ka një pasqyrim jo të drejtë të vlerave në pasqyrë. Aktivet neto nuk rakordojnë me fondet neto, dhe për disa zëra nuk ka informacion sesi sektori i financës ka arritur në rezultatet e mësipërme. Gjithashtu, në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve neto nuk janë plotësuar të gjithë zërat që përfaqësojnë ndryshimet e ndodhura nga burimet e brendshme.
 - Auditimi i procesit të inventarizimit ka evidentuar se nga strukturat e MTM-së paraqiten mangësi pasi, nuk ka relacione shpjeguese nëse janë zhvilluar procedurat për vlerësimin e inventarëve, e më pas nxjerrjen jashtë përdorimi. Pra, nga ana e MTM-së nuk është ngritur një komision i vlerësimit të aktiveve, rrjedhimisht nuk ka patur as komisione për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimi të aktiveve.
 - Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, mbështetur në Urdhrat përkatës për kalim pa pagesë, u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, ku nga MTM-ja është regjistruar në kontabilitet vlera e kostos historike të tyre;
 - Regjistri elektronik për aktivet afatgjata të MTM nuk është përditësuar me vlerën aktuale të aktiveve që institucioni ka në pronësi.
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** rezultoi se:
- Nga auditimi i llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” rezultoi se shpenzimet në shumën prej 3,980,859 lekë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime në momentin e ndodhjes së tyre, por janë njohur në një periudhë të më vonshme, të cilës nuk i përkasin;
 - Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se shuma e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë, detyrimet nuk janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por janë njohur në momentin e likuidimit. Sa më sipër, vepruar në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, paragrafi 34 dhe 42.
 - Nga auditimi i analitik i zërave të Llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” në vlerën 634,356,074 lekë, u konstatua një diferencë prej 1,141,162 lekë e debituar në llogarinë 4342, vlerë e cila është e paargumentuar. Gjithashtu u konstatua se, në lidhje me letër kredinë e “Qendrës Hap” është regjistruar vlerë prej (2,240,650.8) lekë në kontabilitet, ndërsa në SIFQ vlera është (224.065,80) lekë me një diferencë prej 2,000,000 lekë, vlerë e cila është e paargumentuar, me efekt në pa saktësinë e raporteve dhe të pasqyrave financiare;

- Nga auditimi analitik i Llogarisë 213 “*Rruge, rrjete, vepra ujore*”, u konstatua se në këtë llogari është kontabilizuar “*Regjistri elektronik i ndihmës ekonomike*” me kosto historike në shumën prej 71,400,000 lekë, vlerë e pasqyruar gabim në këtë llogari kontabël, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare të institucionit;
 - Nga auditimi analitik i Llogarisë 28 “*Caktime*”, u konstatuat se, në këtë zë janë pasqyruar, Vlera prej 22,337,073 lekë, e cila ka të bëjë me “*Rikonstruksione të ambienteve*”; Vlera prej 113,416,554 lekë, e cila ka të bëjë me regjistrin e PAK; Vlera prej 164,496,000 lekë, e cila ka të bëjë me “*Sistemin e Shërbimit Social*”, të cilat janë aktive nën administrimin e MSHMS, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 25, datë 20.01.2011 “*Për disa ndryshime të vendimit nr. 248 datë 10.04.1998 për miratimin e planit kontabël publik “ dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”; Klasa 2 “*Aktivitet Afatgjatë*”, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të llogarisë financiare të institucionit;
 - Nga auditimi i llogaritjes së amortizimit u konstatua se amortizimi vjetor i aktiveve për zërat “*Kompjuter, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softë e sisteme informacioni*” është përlllogaritur me 20% dhe jo me 25%; si dhe për llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*” transferuar nga Ish-Ministria e Mbrojtjes Sociale, amortizimi vjetor është llogaritur mbi vlerën e mbetur dhe jo me metodën lineare, me efekt material në fondet neto të institucionit;
 - Nga auditimi i “*Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto*” dhe rakordimit me vlerat në pasqyrën e pozicionit financiar në rubrikën C, u konstatua një pasqyrim jo i drejtë të vlerave në pasqyrë, duke dubluar ndryshimin e gjendjes së inventarit, me ndikim material në fondet neto të institucionit;
 - Nga auditimi i pasqyrës “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (vlera neto)*” për zërin “*kompjuter*”, nga institucioni është përlllogaritur amortizim vjetor më i lartë se vlera e aktiveve, ku si rrjedhojë vlera e amortizimit të akumuluar është më e lartë se vetë kostoja historike e aktiveve.
- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** rezultoi se:
- Nuk janë kryer procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke mos koordinuar sistemet e kontrollit mbi kontabilizimin e detyrimeve të MBZHR.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme

KLSH gjatë auditimeve të realizuara për veprimtarinë e vitit 2022 është fokusuar në vlerësimin e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm publik, pajtueshmërinë e veprimtarisë së subjekteve të audituara me kuadrin ligjor, cilësinë e raportimit financiar, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me vlerën për para. Drejtime kryesore të këtyre vlerësimeve kanë qenë integriteti dhe vlerat etike të subjekteve publike, planifikimi zbatimi dhe monitorimi i buxhetit të shtetit, kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare të llogaridhënës vjetore (individuale dhe të konsoliduara), rregullshmëria e administrimit të shpenzimeve publike dhe garantimi i vjeljes së të ardhurave, zbatimi i kontratave publike, borxhi publik dhe detyrimet e gjykatave ndërkombëtare, shkeljet dhe paligjshmëritë në procedurat e prokurimeve me fondet publike, apo në fushën e koncesioneve, problematikat e stokut të detyrimeve të prapambetura, administrimit fiskal, funksionimi i organeve drejtuese, efektiviteti i mekanizmave antikorrupsion, eficensa e njësisë të auditimit të brendshëm, etj.

Për këtë, KLSH ka analizuar Raportin e përgatitur nga Këshilli i Ministrave dhe të paraqitur përpara Kuvendit të Shqipërisë “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale për vitin 2022”¹⁷, i cili ka integruar si pjesë të vetën edhe Raportin Vjetor “Mbi Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në fushën e menaxhimit të sistemit buxhetor dhe atij të kontrollit të brendshëm.

Përsa më sipër, vlerësimet tona janë mbështetur në:

- Raportin Vjetor të konsoliduar mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik hartuar nga MFE për vitin 2022;
- Vlerësimet analitike të rezultateve të Pyetësorëve të Vetëdeklarimeve të hartuara nga NJQP si për çështjet e Menaxhimit e Financave Publike, Kontrollit dhe Kontabilitetit në sektorin publik, ashtu dhe matjet për Indikatorët e Performancës së Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme mbi zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe rankimi i tyre bazuar në 18 (tetëmbëdhjetë) treguesit e miratuar të performancës.
- Rezultateve të auditimeve të pavarura të ushtruara nga ana e KLSH në lidhje me vlerësimin e stadi dhe cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në institucionet e qeverisjes së përgjithshme të sektorit publik, etj.

Që në fillim të raportit të hartuar nga MFE¹⁸ është nënvizuar se: “...për sa i përket vlerësimin të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2022, evidentohet se, zhvillimet kryesore u fokusuan në drejtim të përmirësimit të funksionalitetit të sistemit nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike dhe monitorimit të gjendjes dhe progresit të sistemit të kontrollit të brendshëm duke nxitur angazhimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me rëndësinë strategjike dhe operacionale të zbatimit të instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Pavarësisht rolit dhe ndërhyrjes së Drejtorisë së Harmonizimit për Menaxhimin Financiar, Kontrollin dhe Kontabilitetin në rritjen e ndërgjegjësimin për përmirësimin e funksionalitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në të gjitha hallkat e tij, përsëri evidentohen mangësi, fillimisht lidhur me respektimin e kërkesave ligjore të fushës si dhe në cilësinë e realizimit të veprimtarisë dhe përmbushjes së qëllimit për të cilat njësitë publike janë krijuar”.

Konkluzioni i përgjithshëm:

KLSH bazuar në analizën e përgjithshme të indikatorëve të analizuar, konsistencës si dhe shkallës së maturimit të 17 Parimeve të Kontrollit të Brendshëm, por edhe në vlerësim të raportit të paraqitur nga Qeveria mbi funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, vlerëson ekzistencën e një sistemi të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2022 që konsiderohet “pjesërisht efektiv”, ku ndikimin kryesor kanë mangësitë lidhur me menaxhimin e riskut, aktivitetet e mjedisin e kontrollit dhe vlerësimin e raportimin në kohën e duhur të problematikave të sistemit të kontrollit të brendshëm, dobësi që kërkojnë adresim nëpërmjet thellimit të reformave strukturore në fushat e kontrollit të brendshëm.

Analiza e sistemit sipas pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike.

MFE u ka shpërndarë për plotësim pyetësorët e vetëvlerësimin 152 njësive të sektorit publik, referuar Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit

¹⁷ - “Raport mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale për vitin 2022”, Tiranë, Maj 2023.

¹⁸ - “Raport mbi Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2022”, Tiranë, Maj 2023, faqe 5.

të menaxhimit financiar dhe kontrollit”. Nga këto njësi, 146 prej tyre kanë depozituar përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit pranë MFE.

Disa prej njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur duke pasur mangësi në dokumentacionin e dërguar apo vonesa në depozitimin e informacionit të kërkuar, ku përfshihen: Bashkia Konispol, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Finiq, Bashkia Memaliaj, Bashkia Kavajë, Bashkia Vorë, Bashkia Delvinë, Bashkia Himarë, Qarku Lezhë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretariati i Këshillit Ekonomik Kombëtar si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Sipas të dhënave nga auditimi rezultoi se, pjesa më e madhe e njësive publike që nuk kanë plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit të MFK u përkasin bashkive dhe këshillave të qarkut. Pyetësori i vetëvlerësimit përbëhet nga 17 parime të cilat ndahen në 5 ndarje kryesore (Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi) dhe konsistojnë në 114 pyetje në total.

Nga përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit janë evidentuar vlerësimet në vijim nga DH/MFKK sipas paraqitjes në tabelën nr. 30, për të cilat janë ndërtuar të dhënat e krahasueshme.

Tabela 30 Vlerësimi i komponentëve të MFK për sistemin

Elementi	Vlerësimi 2021	Vlerësimi 2022
Mjedisi i kontrollit	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 1: Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike</i>	Efektiv	Efektiv
<i>Parimi 2: Titullari / Njësia Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 3: Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 4: Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 5: Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Menaxhimi i riskut	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 7: Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 8: Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 9: Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Aktivitetet e kontrollit	Efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 10: Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit</i>	Efektiv	Efektiv
<i>Parimi 11: Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 12: Njësia Publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave</i>	Efektiv	Pjesërisht efektiv
Informimi dhe komunikimi	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 13: Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 14: Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm</i>	Efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 15: Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Monitorimi	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 16: Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
<i>Parimi 17: Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë</i>	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv
Total	Pjesërisht efektiv	Pjesërisht efektiv

Burimi: Të dhënat nga DH/MFKK në MFE përpunuar nga KLSH.

Nga krahasimi i rezultateve të vitit 2021 me vitin 2022, evidentohet një rënie në nivelin e vlerësuar të efektivitetit dhe cilësisë së Kontrollit të Brendshëm Publik, pasi rezultoi se:

- Vlerësimi i përgjithshëm Kontrollit të Brendshëm për të dy vitet 2021 dhe 2022 vijon të jetë i njëjtë, ku për 5 komponentët dhe 17 parimet, është rankuar si “*pjesërisht efektiv*”;
- Asnjë komponent i Kontrollit të Brendshëm për vitin 2022 nuk është klasifikuar si efektiv;

- ▶ Një komponent i Kontrollit të Brendshëm, “Aktivitetet e kontrollit” është vlerësuar më dobët, pasi nga vlerësimi “*efektiv*” në vitin 2021, ka kaluar në vlerësimin “*pjesërisht efektiv*” në vitin 2022;
- ▶ Nga analiza për Parimet 12 dhe 14, respektivisht pjesë e komponentit të “Aktiviteve të Kontrollit” dhe “Informimit e Komunikimit”. janë vlerësuar më dobët, pasi nga vlerësimi “*efektiv*” në vitin 2021, janë kaluar në vlerësimin “*pjesërisht efektiv*” në vitin 2022, si dhe
- ▶ Asnjë prej 17 parimeve të vlerësuara për vitin 2022 nuk paraqitet në përmirësim nga viti i mëparshëm.

Vlerësimi i cilësisë së MFK

Referuar dispozitave ligjore të fushës së kontrollit të brendshëm (neni 18, pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar), MFE realizon vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm bazuar në raportet vjetore të konsoliduara të përfituesve të fondeve publike mbi statusin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm. Procedurat për realizimin e procesit të vlerësimit të cilësisë janë përcaktuar në dokumentin e Metodologjisë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 311, datë 23.12.2020.

Për vitin 2022, përmes Planit Vjetor është planifikuar realizimi i procesit të vlerësimit të cilësisë në 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme (NJQP) ku, është arritur të finalizohet procesi i vlerësimit të cilësisë në 16 NJQP, ndërkohë në 4 prej tyre ky proces nuk u realizua, ku DH/MFKK ka paraqitur si shkak mosangazhimin e këtyre institucioneve për vënien në dispozicion të grupit të vlerësimit të dokumenteve zyrtarë. Sa i përket vlerësimit të sistemit të brendshëm, nga DH/MFKK rezulton se vlerësimi në institucione është konsideruar “pjesërisht efektiv”.

Nga auditimi i dosjeve të Kontrollit të Cilësisë nga KLSH konstatohet se përgjithësisht ekziston diferencë kohore mes realizimit të kontrollit dhe daljes së Raportit Përfundimtar mbi cilësinë e sistemeve të KB, duke cënuar koherencën e gjetjeve dhe rekomandimeve lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe asistencës teknike në këtë institucion.

Referuar manualit të MFK, Kapitulli II “Rolet dhe Aktorët në Sistemin e MFK-së”, pika 2.2.2, theksohen objektivat e realizimit të monitorimit/Vlerësimit të cilësisë, ku një ndër objektivat e realizimit të këtij procesi është përgatitja e raportit vjetor për NPA dhe Ministrin e Financave mbi statusin e përgjithshëm të MFK-së. Nga auditimi i KLSH është konstatuar se, disa prej vlerësimeve të cilësisë të realizuara në 6 mujin e parë të vitit 2022 kanë analizuar sistemet e MFK për vitin 2021, ndaj paraqitja e tyre duke u bërë pjesë e Raportit Vjetor 2022 të DH/MFKK i cili i dorëzohet NPA, nuk paraqet në mënyrë të drejtë situatën për vitin 2022, pasi përfshihen në të edhe vlerësimet e cilësisë për periudhën që i takon vitit 2021.

Trajnimet mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në nenin 26/c të Ligjit nr.10926, datë 08.07.2010 i ndryshuar parashikohet roli i Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe një ndër to është “Përcaktimi i nevojave dhe udhëheqjen e trajnimeve në vijueshmëri në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik”. Në Planin Vjetor të DH/MFKK janë parashikuar të kryhen trajnime gjatë gjithë vitit në 18 bashki në kuadër të projektit “Financat Lokale”, trajnime specifike në varësi të kërkesave të institucioneve për asistencë lidhur me implementimin e sistemit të MFK (gjatë gjithë vitit),

si dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve të njësive publike mbi zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe kontabilitetin në sektorin publik në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Përsa i përket realizimit të trajnimeve, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 19 të tilla me 1083 pjesëmarrës.

Regjistri i NA dhe NZ

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, nen 26, pika 1, germa *dh* citon se “*Struktura Përgjegjëse e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në Ministrinë e Financave është përgjegjëse për krijimin dhe përditësimin e regjistrit të nëpunësve autorizues dhe nëpunësve zbatues të njësive publike*”. Nga shqyrtimi i Regjistrave të NA dhe NZ (në format Excel) u konstatuan dublikime të personave të autorizuar si NA apo NZ, mungesa të caktimit të NA apo NZ apo mangësi informacioni. KLSH thekson se konstatimi është kryer për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 – 31.12.2022, periudhë në të cilën DH/MFKK ka administruar regjistrat përkatës të NA dhe NZ referuar të dhënave nga degët e thesarit. Ndërkohë, me ndryshimet ligjore, përkatësisht me miratimin e Ligjit nr. 14, datë 16.02.2023 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, DH/MFKK nuk do të angazhohet në mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të NA dhe NZ.

Vlerësimi i indikatorëve të sistemit të MFK

Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit ka realizuar analizimin e 18 (tetëmbëdhjetë) treguesve të performancës, referuar Metodologjisë për Monitorimin e Performancës së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike, miratuar me Urdhrin e MFE nr. 117, datë 01.04.2019 “Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike” i ndryshuar.

Indikatorët e vlerësimit Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit janë 3 nga 18 vlerësuar nga DH/MFKK si në vijim:

- *Indikator 12* – Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara;
- *Indikator 13* – Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm;
- *Indikator 14* – Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik.

Lidhur me *Indikatorin 12*, i cili përcakton respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në NJQP, DH/MFKK e ka vlerësuar këtë tregues me 2.57 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 64%). Sipas DH/MFKK përmirësim ka në procesin e vlerësimit të cilësisë apo ofrimin e asistencës teknike, çka ka mundësuar rritjen e ndërgjegjësimit të menaxherëve dhe stafit për njohjen dhe zbatimin e instrumenteve të MFK. Nga DH/MFKK për vitin 2022 është evidentuar se një pjesë e institucioneve nuk kanë hartuar një plan veprimi për vitin 2023, nuk kanë respektuar formatin e rishikuar dhe miratuar në manualin e MFK si dhe kanë ende në përdorim planin e veprimit për vitin 2022, gjë e cila ka ndikuar edhe vlerësimin me pikë për secilin institucion.

Indikator 13, i cili përcakton përmbushjen e kriterëve ligjore, cilësinë e raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si dhe gjithëpërfshirjen e informacionit mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike (nëpërmjet pyetësorëve të vetëvlerësimit) është

vlerësuar mesatarisht në nivelin 3.06 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 76%), me një rritje të lehtë nga vlerësimi i vitit 2021 ku paraqitej në nivelin 3.0 pikë. DH/MFKK ka evidentuar një performancë mesatarisht të kënaqshme në këtë fushë kryesisht për ministrinë e linjës dhe institucionet e pavarura, ndërkohë vlerësimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore vijon të jetë më i ulët se për grupet e tjera të marra në analizë, specifiku 2.75 pikë. DH/MFKK ka konkluduar se pjesa më e madhe e institucioneve kanë respektuar afatin kohor të dërgimit të raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si dhe i kanë paraqitur ato në formatin e duhur. Ndërkohë, ende ka njësi (kryesisht njësi të vetëqeverisjes vendore), të cilat nuk kanë depozituar pyetësorët në formatin e duhur apo përmbajtja dhe cilësia e informacionit të përfshirë nuk ishte në nivelin e dëshiruar për të realizuar një analizë të thelluar të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, janë evidentuar institucione të cilat nuk kanë zbatuar kërkesat ligjore në fuqi duke mos depozituar pranë MFE-së, deklaratën dhe raportin për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm apo pyetësorin e duhur të vetëvlerësimit.

Indikatori 14, i cili vlerëson se në çfarë mase dhe sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjshmërisë menaxheriale është vlerësuar nga DH/MFKK në nivelin 2.91 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 73%), duke reflektuar një performancë të mirë në këtë fushë, të ngjashme me atë të dy viteve paraardhëse. Megjithatë, nga krahasimi më të dhënat e vitit të kaluar KLSH evidenton se për vitin 2021, ky tregues ka qenë në nivelin 2.95 pikë nga 4 të plota, duke paraqitur një rënie të lehtë për vitin 2022.

Tabela 31 Vlerësimi i indikatorëve të performancës nga DH/MFKK

Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Ndryshimi vjetor
Indikatori 13	1.9	2.57	+ 0.67
Indikatori 14	3.0	3.06	+ 0.06
Indikatori 15	2.95	2.91	- 0.04

Burimi: Të dhënat nga DH/MFKK, në MFE përpunuar nga KLSH.

Përgatitja e Raportit Vjetor 2022

KLSH ka evidentu se, MFE në kuadër të hartimit të Raportit Vjetor 2022, iu ka dërguar njësive publike të qeverisjes së përgjithshme pyetësorët e vetëvlerësimit (*dërguar në 152 NJQP dhe vetëm 146 kanë kthyer përgjigje lidhur me këta pyetësorë*). Disa prej njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur duke pasur mangësi në dokumentacionin e dërguar apo vonesa në depozitimin e informacionit të kërkuar¹⁹. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të audituesve të KLSH-së evidentohet se nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues nuk janë ndërmarrë masa sa i takon subjekteve që nuk kanë dorëzuar deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, referuar nenit 29, pika 1, të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar. Për më tepër, përmes ndryshimeve ligjore, përkatësisht miratimit të Ligjit nr. 14, datë 16.02.2023, janë forcuar masat lidhur me subjektet që nuk respektojnë përcaktimet për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i treguesve të performancës

Në Raportin Vjetor 2022, përkatësisht në Kapitullin I “Vlerësimi i performancës së Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme

¹⁹ - Bashkia Konispol, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Finiq, Bashkia Memaliaj, Bashkia Kavajë, Bashkia Vorë, Bashkia Delvinë, Bashkia Himarë, Qarku Lezhë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretariati i Këshillit Ekonomik Kombëtar; si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

të Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit kanë kryer analiza për gjenerimin e të dhënave për 18 tregues performance mbi planifikimin, zbatimin dhe ekzekutimin e buxhetit si dhe treguesit për implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, specifikuar si në tabelën nr. 32.

Tabela 32 Treguesit e Performancës dhe burimet e të dhënave sipas Drejtorive në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	Drejtoria e Harmonizimit të MFKK	Drejtoria e Harmonizimit të AB
1.Realizimi i shpenzimeve buxhetore (në %)	1.Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit	1.Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara	1.Organizimi i NJAB-ve dhe kapacitetet e AB
2.Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik (në %)	2.Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme	2.Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm	2.Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të
3. Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura	3.Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit	3.Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik	3.Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve
4.Realizimi i shpenzimeve kapitale	4.Numri i urdhër prokurimeve të paautorizuara		4.Zbatimi i rekomandimeve të AB-së
5. Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit	5.Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës		
	6.Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi		

Burimi: Raporti Vjetor 2022 i KBFP

Bazuar në vlerësimet e treguesve të mësipërm nga drejtoritë përkatëse të MFE, është realizuar rankimi i ministrive të linjës, bashkive, institucioneve të pavarura dhe njësisve shpenzuese me buxhet të madh për vitin 2022, ku KLSH ka identifikuar se:

- 5 nga 10 ministri të vlerësuara, bazuar në indikatorët e performances së mësipërme, kanë pësuar rënie në rankimin e vitit 2022 ndaj vitit 2021;
- 6 nga 11 njësi shpenzuese me buxhet të madh kanë pësuar rënie në rankimin e vitit 2022 ndaj vitit 2021;
- 6 nga 9 bashki qendër qarku dhe 30 nga 34 bashkitë e tjera të analizuar, bazuar në indikatorët e performances së mësipërme, kanë pësuar rënie në rankimin e vitit 2022 ndaj vitit 2021;

Në Raportin Vjetor 2022 të hartuar nga MFE, cilësohet se *“Bazuar në vlerësimet e treguesve të mësipërm nga drejtoritë përkatëse, është realizuar rankimi i ministrive të linjës, bashkive, institucioneve të pavarura dhe njësisve shpenzuese me buxhet të madh për vitin 2022, ku vlen të theksohet se, niveli i vlerësimit maksimal në pikë për pjesën më të madhe të institucioneve ka pësuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar.”* Nga shqyrtimi dhe analizimi i këtyre treguesve, KLSH konstaton se për pjesën më të madhe të NJQP, në rreth 80% të NJQP vlerësimi me pikë ka patur tendencë rritje ose ka qëndruar njësoj si në vitin 2021, ndërsa për pjesën tjetër rreth 20%, vlerësimi në pikë ka pësuar rënie. Krahasimisht me vitin 2021, ku mesatarja e vlerësimit në total për NJQP paraqitej në 39.1 pikë, për vitin 2022 paraqitet në 42.7 pikë.

Sipas analizës, nga 152 NJQP të paraqitura në vlerësim ku 9 prej tyre nuk kanë ndryshim me vlerësimin e vitit 2021, 30 NJQP kanë vlerësim në rënie krahasimisht me vitin 2021, detajuar në tabelën nr. 33.

Tabela 33 Analiza e vlerësimit të NJQP për vitin 2022

Emërtimi	Rritje në vlerësim nga viti 2021	Njësoj në vlerësim si viti 2021	Rënie në vlerësim nga viti 2021	Total
Nr. i NJQP	113	9	30	152
NJQP (në %)	74.34%	5.92%	19.73%	100%
NJQP më përfaqësuese	<ol style="list-style-type: none"> 1. Agjencia e Trajtimin të Pronave 2. Bashkia Vlorë 3. Bashkia Devoll 4. Kryeministria 5. Komisioni i Prokurimit Publik 6. Agjencia për Mbështetje për Shoqërinë Civile 7. Komiteti Shtetëror i Kulteve 8. Agjencia e Zhvillimit të Territorit 9. Avokatura e Shtetit 10. Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkëqeverisje 11. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar 12. Inspektoriati Qendror 13. Komiteti për Pakicat Kombëtare 14. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore 15. Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Mbrojtjes 2. Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit 3. Bashkia Elbasan 4. Bashkia Finiq 5. Bashkia Pogradec 6. Bashkia Roskovec 7. Bashkia Kurbin 8. Qarku Vlorë 9. Departamenti i Administratës Publike 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë 2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit 3. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme 4. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve 5. Bashkia Bulqizë 6. Bashkia Tropojë 7. Bashkia Pukë 8. Qarku Fier 9. Shërbimi Informativ Shtetëror 10. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 11. Autoriteti i Konkurrencës 12. Kolegji i Posaçëm i Apelit 13. Akademia e Shkencës 14. Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit 15. Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet ish-sigurimit 16. Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara 	

Burimi: Të dhënat nga Raporti Vjetor 2022 i KBFP përpunuar nga KLSH.

Sipas analizës së të dhënave të Raportit të paraqitur nga MFE, konstatohet se në 16 NJQP më përfaqësuese që kanë pësuar ulje në vlerësim për vitin 2022, rënia e tyre varion nga 21 deri në 5 pikë, ku kryeson Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet ish-sigurimit. Në këtë listë, paraqiten me rënie të konsiderueshme edhe Ministri Linje, përkatësisht: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. MFE rezulton me rënie në vlerësim në performancën e saj, ndërkohë që është institucioni përgjegjës dhe mbikëqyrës për procesin e vlerësimit të NJQP.

Rezultatet e auditimit të KLSH-së mbi analizën e komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm në institucionet e qeverisjes së përgjithshme, shoqëritë anonime, etj.:

• **Mjedisi i kontrollit**

• **Autoriteti i Mediave Audiovizive**

Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma e auditimit, si dhe mungon shtrirja e gjurmës së auditimit në të gjitha proceset kryesore që përfshin veprimtaria e institucionit, të tilla si fushën e licencimit dhe dhënies së autorizimit, gjurma e proceseve të inspektimit të përcaktuara në procedurën standarde të punës, gjurma e dokumentacionit për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit, kontabilizimit dhe ndjekjes së detyrimeve debitore të subjekteve dhe ish subjekteve të licencuara / autorizuara dhe subjekteve të palicencuara / autorizuara nga AMA etj, veprime në kundërshtim me parashikimet e nenit 6, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik si dhe kërkesat e Kreut III, Kapitulli III.3, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, të Ministrisë të Financave.

- Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), në kundërshtim të neneve 8 (pika 8/b), 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menxhimin Financiar dhe

Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe të përcaktimeve të kreut III, të Manualit “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar,

- Nuk janë marrë masat për përgatitjen dhe dërgimin në Ministrinë përgjegjëse për financat, të Pyetësorëve të Vetëvlerësimit, Deklaratave e Raporteve për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Planet e Veprimit për MFK-në, në kundërshtim me nenin 18, “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar.

· **Aparati i MFE-së**

Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2022, janë konstatuar mangësi në zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të Ministrisë të Financave, duke sjellë problematika në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat potencialisht ndikojnë në efektivitetin dhe dobinë institucionale.

· **DPT**

- Gjatë vitit 2022 nuk është mbledhur asnjëherë Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), strukturë kyçe e organizimit institucional për të diskutuar dhe marrë vendime mbi përgatitjen e kërkesave buxhetore në lidhje me programet përkatëse, në shkëlqje të ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si edhe në mungesë të ushtrimit të përgjegjësive të NA në rolin e koordinatorit të GMS të përcaktuara në Udhëzimin nr.7 datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, Kreu II, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon një regjistër të aktiveve, në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

· **Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik** rezultoi se:

- Komisioni i planifikimit strategjik nuk ka dokumentuar procesverbalet e mbledhjeve të kryera, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”.

· **Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes** rezultoi se:

Fusha e përgjegjësive dhe e kompetencave të këtij institucioni publik, (*miratuar me VKM nr. 511, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, shfuqizuar nga VKM nr. 610, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes*), ka elementë të mbivendosjes së tyre me ato të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, institucion i krijuar nga Ligji Nr.107/2021, datë 4.11.2021 “Për bashkëqeverisjen”.

- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e sipërmarrjes është njëkohësisht dhe Kryetar i Këshillit të startup-eve dhe Kryetar i Komisionit të vlerësimit të dhënies se granteve për mbështetjen e startup-eve. Përmbushja e detyrës së vlerësimit të fituesve apo jo fituesve pas një procesi konkurrues nga Ministri cenon linjën e raportimit të procesit të vlerësimit të projekteve inovative. Veprim në kundërshtim me Ligjin 90/2012, datë 27.9.2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Seksioni 1 “Ministrisë”, Neni 11 “Struktura e ministrisë”, pika 1 dhe Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu II

“Përgjegjshmëria menaxheriale”, Neni 8 Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1 dhe pika 8/a dhe d.

- Ministria ka funksionuar pa një rregullore të brendshme të miratuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, neni 29, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe nenit 8” Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika nr.1 dhe nr.8, të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

• **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, rezultoi se:

- Në lidhje me respektimin e strukturës organike: për vitin 2022, 25 (njëzetepesë) punonjësit e emëruar në zbatim të VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, nuk kanë kontrata pune. Marrëdhëniet e tyre të punës janë rregulluar nëpërmjet aktit administrativ/urdhrit të ministrit për emërimin në detyrë, duke vepruar jo në përputhje me VKM Nr.1151, datë 24.12.2020 e ndryshuar, pika 6 dhe VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar. Nga MBZHR janë ndjekur standarde të ndryshme në lidhje me kontraktimin e përkohshëm të punonjësve, pasi për studentët e ekselencës të emëruar në përputhje me VKM-në nr.586, datë 30.8.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore” i ndryshuar janë lidhur kontratat e punës.
- Në 1(një) rast akti i emërimit me Urdhrin Nr.79, datë 21.02.2022 të një punonjësi nuk është bërë në përputhje me VKM Nr.35, datë 19.01.2022 e ndryshuar, pasi marrëdhëniet e punës dhe ato financiare i fillojnë me datë 01.01.2022, ndërkohë që akti ka dalë më vonë datë 21.02.2022.

• **Agjencia Kombëtare e Rinisë** rezultoi se:

- Funksiononte mbi bazën e Rregullores së brendshme e pa përditësuar;
- Nuk ka lidhur ë Kontratë Individuale të Punës me punonjësit e institucionit, si dhe nuk ka një kontratë tip,ku të përcaktohen të gjithë elementët e cituar në Kodin e Punës; mangësi dokumentacioni në dosjet e personelit.

• **Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët** rezultoi se:

- Nuk janë ndërmarrë hapa për zhvillimin e kompetencave të rëndësishme për hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit mbi situatën e të rinjve; zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore; nuk janë monitoruar standardet për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë, të parashikuara në Ligjin nr.75/2019 “Për Rininë” neni 5.
- Nuk janë hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikat: për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse; programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar; për marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës; sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit, në zbatimin të VKM-së nr. 524, datë 22.9.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët” pikat 3 dhe 4.

• **Ministria e Drejtësisë** rezultoi se:

- Funksiononte mbi bazën e Rregullores së brendshme të funksionimit të MD e cila ka listuar në mënyrë të përgjithshme detyrat e drejtuesve dhe specialistëve dhe vetëm përshkrimet e Drejtorive, por pa detajime të përshkrimeve konkrete të punës të

përgjegjësve të sektorit dhe specialistëve, sipas drejtorive ku bëjnë pjesë dhe sipas detyrimeve e angazhimeve të veprimtarisë së tyre ditore.

- Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se janë ngritur Grupet e Menaxhimit Strategjik për secilin vit objekt auditimi, ato nuk kanë funksionuar rregullisht pasi në dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi zbatimin e MFK, nuk rezultojnë të ketë proceverbale të mbledhjeve të këtyre grupeve, si dhe vendime rast pas rasti, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
- **Instituti i Gjeoshkencave rezultoi se:**
 - IGJEO nuk disponon laborator për kryerjen e analizave të ndryshme, në kundërshtim me përcaktimet e rregullores së Departamentit të Gjeologjisë e vitit 2022.
 - Mungon një dokumentacion / regjistër i arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, si gjurmë mbi zbatimin e një prej pikave kryesore në misionin e Institucionit, që ka të bëjë me formimin universitar, të thelluar, të studentëve dhe në kualifikimin e shkencëtarëve të rinj.
- **Avokatura e Shtetit rezultoi se:**
 - Për periudhën 2021-2022, mungon gjurma e rikrijimit dhe e funksionimit të Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së. Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së evidentohet të ketë ushtruar veprimtarinë e tij deri në shkurt të vitit 2021, ndonëse ai ka si funksion orientimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë me Avokaturën e Shtetit mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përcaktimin e planit të punës/veprimit me afate konkrete për realizimin e detyrave në kuadër të ekzekutimit të vendimeve, apo paraqitjes së rekomandimeve/zgjidhjeve të mundshme, në kuadër të këtij plani, etj. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e nenit 19/8, “*Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së*”, Kreu V/I, i Ligjit nr.10018, datë 13.11.2018 “Për avokaturën e shtetit, i ndryshuar”.
 - Nga auditimi i dosjeve fizike të vendimeve të GJEDNJ-së u konstatua se, në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive, e për pasojë nuk është bërë inventarizimi/numërimi total i tyre.
- **Kuvendi i Shqipërisë rezultoi se:**
 - Mungon Gjurma e Auditimit për ndjekjen, regjistrimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për institucionin e Kuvendit të Shqipërisë.
- **Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS), është ushtruar auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së këtij subjekti me ligjet dhe aktet normative, me objekt shpërblimin dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë në zbatim të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar rezultoi se: Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk është e përditësuar me ndryshimet që ka pësuar struktura organike e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.144, datë 16.12.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”;**
- **DPD:** Nga auditimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, konstatohet se DPD nuk ka miratuar Rregulloren e Brendshme të re mbi funksionimin e DPD dhe të Degëve Doganore, pas miratimit të strukturës së re sipas VKM-së nr.355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin 921 për personelin e administratës doganore”. Nga auditimi konstatohet se deklarata për cilësinë e kontrollit të brendshëm për komponentët e MFK-së për vitin 2022, është dërguar mbi një muaj me vonesë nga parashikimi i pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, që është fundi i muajit Shkurt i vitit aktual. Në përmirësim të situatës është rekomanduar

marrja e masave për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme dhe plotësimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit me qëllim dërgimin në afat të deklaratës mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

- **ARRSH:** Për sa i takon MFK nga auditimi ka rezultuar se në rregulloren e brendshme të institucionit, rregullat apo proceset kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësi, por ato nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën dhe identifikimin e punës, përgjegjësinë individuale, afatet e kryerjes, vendimmarrjen individuale, dokumentacionin e miratuar, si edhe veprimtaritë e kontrollit të nevojshme. Me përjashtim të Drejtorisë Planifikimit të Buxhetit dhe Financës, manualët për proceset kryesore në sektorët dhe drejtoritë e ARRSH janë akoma në proces hartimi. Qeverisja e ARRSH përfaqëson mënyrën me të cilën ajo drejtohet dhe kontrollohet, por nga auditimi rezulton se Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka funksionuar rregullisht, mungojnë minutat e takimit, vendimet dhe raportet, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion stafit menaxhues të njësisë publike.
- **Hekurudha Shqiptare:** Në lidhje me MFK, nga auditimi i kryer pranë këtij institucioni ka rezultuar se Sistemi i Kontrollit të Brendshëm vlerësohet jo efektiv dhe me mangësi në lidhje me funksionimin e të pesë komponentëve që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar, duke ndikuar drejtpërdrejt në mosfunksionimin e plotë të sistemit të kontrollit të brendshëm të kësaj njësie. Gjithashtu, ka rezultuar se HSH ka përcaktuar koordinator të menaxhimit të riskut një specialist IT, ndërkohë që koordinator i menaxhimit të riskut duhet të jetë Nëpunësi Autorizues. Grupi Menaxhimit Strategjik nuk ka të dokumentuar mbledhjet e zhvilluara, të cilat duhet të jenë minimalisht 4 herë në vit. Për periudhën objekt auditimi institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit.
- **OSHEE:** Për periudhën objekt auditimi ka rezultuar se shoqëria OSHEE sh.a dhe tre shoqëritë e kontrolluara prej saj, kanë funksionuar pa rregullore të brendshme, si dhe nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.

SUT: Nga auditimi i kryer në këtë institucion u konstatua mungesa e implementimit të një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në SUT. Ky konkluzion u arrit nga mungesa e monitorimit dhe kontrollit gjatë fazës së hartimit dhe emetimit të dokumentacionit administrativ nga strukturat përgjegjëse pranë SUT, mungesa e hartimit të gjurmës së auditit, mungesa e kontrollit të brendshëm dhe mos funksionimi efektiv i ligjit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin etj.

- **Porti Detar Sarandë:** Ka rezultuar se për periudhën objekt auditimi nga ana e Administratorit nuk janë ndërmarrë hapa për futjen dhe implementimin në rregulloren e shoqërisë të miratuar me vendimin nr. 6, datë 28.04.2016 të Këshillit Mbikëqyrës, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, ku si parësore ka qenë caktimi i nëpunësit autorizues, neni 8, pika 2, si dhe atij zbatues, neni 12 si dhe nuk është caktuar ende nëpunësi autorizues dhe zbatues.
- **Në institucionet e vetëqeverisjes vendore:**
 - Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme (*Bashkitë Belsh, Konispol, Mallakastër, Mat, Tepelenë, Kuçovë*).
 - Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen (*Bashkitë Belsh, Devoll, Mat, Shkodër, Sarandë*).
 - Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm (*Bashkitë Belsh, Mallakastër, Lezhë, Roskovec, Sarandë, Këlcyrë*).
 - Në Rregulloren e Brendshme të njësisë nuk janë përcaktuar qartë detyrat dhe objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë (*Bashkitë Belsh, , Konispol, Lezhë,*

Kuçovë).

- Nuk ka plan trajnimi me qëllim zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit, (*Bashkitë Belsh, Kolonjë, Cërrik, Patos, Gramsh, Tepelenë, Këlcyrë, Kuçovë, Berat, Dimal, Rrogozhinë, Gjirokastër*).
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve të përhershme, të përkohshme dhe strukturave konsultative të Bashkisë si dhe nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij (*Bashkitë Belsh, Këlcyrë*).
- Nuk kanë miratuar kodin etik për administratën (*Bashkitë Kolonjë, Cërrik, Sarandë, Këlcyrë*).
- Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS-së, (*Bashkitë, Lezhë, Cërrik, Krujë, Rrogozhinë, Tepelenë, Sarandë*).
- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, (*Bashkitë Patos, Krujë, Berat, Gjirokastër, Parmet, Libohovë, Vau Dejës Sarandë, Finiq, Delvinë, Libohovë*).
- Në procesin e largimeve nga puna dhe marrjes së detyrës nuk është ngritur asnjë komision, nuk ka praktika për të dokumentuar dorëzimin apo marrjen e detyrës, (*Bashkitë Gramsh, Këlcyrë, Has, Vau Dejës*).
- Në rregulloren e brendshme të institucionit ka mbivendosje të detyrave, kryerja e funksioneve të caktuara me ligj i ngarkohet strukturave të tjera etj., nuk janë përcaktuar objektiva konkret dhe të matshëm për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë (*Bashkitë Berat, Dimal Vau Dejës*).

Menaxhimi i riskut

Institucioni i **Autoritetit të Mediave Audiovizive** rezultoi se:

- Nuk është hartuar regjistri i riskut për gjithë hallkat dhe drejtoritë e këtij institucioni publik, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296/ 2010 i ndryshuar, Manualit të MFK, si dhe përcaktimet e Nenit 10, “Menaxhimi i riskut lidhur me menaxhimin e aktiveve” të Udhëzimit të AMA me nr. 739, datë 12.12.2018. Nuk është hartuar e miratuar Strategjia e Menaxhimit të Risqeve për institucionin e AMA për vitet 2019-2022, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296/2010,
 - Nga ana e Nëpunësit Autorizues të institucionit të AMA-s nuk janë zbatuar përgjegjësitë për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut (EMR), në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 50, të Aneksit nr. 6, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021 “Për disa ndryshime dhe një shtesë në urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.
 - Nuk është caktuar Koordinatori i Deleguar i Riskut dhe MKF (KDR; KDMFK), si dhe nuk është hartuar plani i veprimit të MFK, në kundërshtim me kërkesat e pikës 1/b, të Udhëzimit nr. 16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”, të Ministrisë së Financave.
- **MFE:** Rezulton se nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut dhe për më tepër, konstatohet se nuk janë kryer takime me stafin menaxhial për çështje të menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme në menaxhimin e riskut.

Regjistri i Riskut për vitin 2022 i cili përmbledh regjistrat e risqeve dhe planet e veprimit së të gjithë strukturave të MFE, rezulton të mos ketë reflektuar ndryshime në risqe për këtë vit. Për vitin 2022, MFE nuk ka takime të dokumentuara për veprimtarinë e GMS, i cili duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Për më tepër, GMS ka për detyrë rishikimin jo më pak se dy herë në vit të regjistratit të riskut.

· **Instituti i Gjeoshkencave** rezultoi se:

- Mungon në strukturën e IGJEO një njësi e specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore brenda fushës së veprimtarisë së Institucionit, si një nga fushat prioritare të veprimtarisë së Institutit të Gjeoshkencave.
- Nga verifikimi në terren rezulton se stacioni sizmik i Shkodrës ka problematika, pasi pajisjet janë në kushte jo të mira dhe mungon infrastruktura. Kjo gjendje sjell një risk për dëmtimit të pajisjeve, gjithashtu cenohet seriozisht aktiviteti i monitorimit sizmik në vend.

· **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** rezultoi se:

- Nuk janë kryer takime me stafin menaxhial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe MTM nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut;
- Nuk janë përgatitur dhe nuk janë dërguar te NA, regjistri i riskut nga drejtoritë përkatëse, të cilët përmbledhen në regjistrin e riskut të vitit 2022 të MTM-së;
- Nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS, i cili duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit, GMS nuk ka kryer përgjegjësinë e rishikimit, jo më pak se dy herë në vit të regjistratit të riskut.

· **FSDKSH** nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e kësaj njësie ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e FSDKSH-së, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

· **Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër:**

Nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, por ka në fuqi një regjistër risku në format elektronik për përdorim të brendshëm, kjo dhe nga fakti se çdo dokumentacion me karakter strategjik përgatitet nga DPT, duke përfshirë dhe njësitë e saj të varësisë.

· **ARRSH:** Regjistri i riskut është rishikuar çdo vit, por nga auditimi formularëve të plotësuar të regjistratit të riskut ka rezultuar se nuk bëhet dallimi i riskut të mbetur nga ai i qenësishmi (i natyrshëm), dhe se menaxhimi i riskut nuk kryhet në mënyrë sistematike, apo periodike gjatë vitit. Gjithashtu, ka rezultuar se regjistri nuk është plotësuar korrekt, p.sh. kur niveli i riskut nuk ndryshon dhe mbetet i lartë nuk kërkohet marrja e masave të kontrollit, apo kur niveli i riskut ulet kërkohen në mënyrë të panevojshme masa të tilla. Proceset kryesore sipas objektivave, me qëllim adresimin e risqeve, duhet të vendosin “zotëruesit” e proceseve të punës, dhe jo Drejtorin e Përgjithshëm si “zotërues” të tyre. Topologjia e riskut nuk është e plotë dhe e qartë, risqet e brendshme duhet të lidhen më shumë me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore (kapacitetet e nevojshme), anën ligjore të mbikëqyrjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës).

· **NJVQV:**

- Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut, (*Bashkitë Belsh, Konispol, Gramsh, Finiq, Berat, Dimal, Kuçovë, Këlcyrë, Shijak, Kavajë, Krujë, Përrenjas, Himarë*).
- Nuk është hartuar një regjistër risku në nivel bashkie, ku të identifikohen dhe të bëhet vlerësimi i risqeve për të gjitha drejtoritë si dhe një plan-menaxhimi i risqeve, (*Bashkitë*

Belsh, Kolonjë, Konispol, Cërrik, Tepelenë, Finiq, Këlcyrë, Shijak, Kavajë, Krujë, Përrenjas, Himarë, Gramsh, Has, Sarandë, Rrogozhinë, Libohovë)

- Regjistri i riskut nuk përditësohet rregullisht (*Bashkitë Dimal, Patos, Berat*).
- Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, (*Bashkitë, Lezhë, Cërrik, Sarandë*).
- Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe nuk është ngritur grupi i punës së riskut, (*Bashkitë Lezhë, Tepelenë, Këlcyrë*).
- Nuk është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut, (*Bashkitë Konispol, Cërrik, Gramsh, Roskovec, Këlcyrë, Kuçovë, Berat, Has, Patos, Rrogozhinë, Dimal, Tepelenë, Permet, Finiq, Sarandë, Krujë, Mallakastër, Kavajë*).
- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë bashkisë (*Bashkitë Sarandë, Dimal, Këlcyrë, Libohovë, Tepelenë*)

Në të njëjtat përfundime me këto të arritura nga KLSH përmes auditimeve të ushtruara nga ana e saj, ka arritur dhe raporti i Raporti i KE: “*Screening report Albania*”, i datës 20.7.2023, i cili në kuadër të vlerësimeve për Kapitullin 32 – *Financial control*”, (Fq. 128-132), është shprehur se:

Për sa i përket menaxhimit të rrezikut, zbatimi i procedurave në lidhje me identifikimin e rrezikut nuk është i kënaqshëm, megjithëse numri i institucioneve që kanë hartuar dhe zbatuar instrumentet e menaxhimit të rrezikut janë rritur. Analiza vjetore e kryer nga MFE për vlerësimin e sistemit të kontrollit brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme tregoi se 104 nga 138 njësi kanë regjistër rreziku, nga të cilat 47 kanë një regjistër të konsoliduar të rrezikut për të gjithë institucionin.

Për sa i përket mashtrimit, megjithëse institucionet kanë procedura ligjore dhe struktura përkatëse denoncuese, analiza tregoi një nivel të ulët të zbatimit të këtyre procedurave, duke rezultuar në një numër të ulët për parregullsitë e raportuara dhe mungesën e të dhënave konkrete për korrupsionin dhe mashtrimin. Duke e identifikuar këtë dobësi si një nga çështjet më urgjente, vendi tregoi se synon të ofrojë udhëzime për njësitë publike, të përditësojë rregulloret e brendshme dhe të intensifikojë trajnimet me zyrtarët publikë për kërkesat e raportimit.

Si dhe në të njëjtin kuadër:

Për sa i përket menaxhimit të rrezikut, zbatimi i procedurave në lidhje me identifikimin e rrezikut është me vonësë, edhe pse numri i institucioneve që kanë hartuar dhe zbatuar instrumentet e menaxhimit të riskut janë rritur. Menaxhimi i rrezikut nuk është inkorporuar sistematikisht në menaxhimin e proceseve financiare dhe operationale. Niveli i zhvillimit të regjistrave të rrezikut dhe strategjive të rrezikut nëpër institucionet është i ulët.

Aktivitetet e Kontrollit

- Në subjektin “**Kuvendi i Shqipërisë**” është identifikuar:
 - Nevoja për marrjen e masave mbi rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi statusin, trajtimin financiar dhe kompensimin e shpenzimeve për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, duke u mbështetur në praktikat dhe modelet më të mira të vendeve evropiane si dhe reflektuar ndryshimet e aktiviteteve dhe mjedisit të kontrollit të brendshëm në vend.
 - Parregullsi në kryerjen e inventarizimit vjetor të aktiveve afatgjata për periudhën objekt auditimi. Për periudhën objekt auditimi, procesi i kontrollit të ekzistencës fizike të

aktiveve është shtrirë në disa muaj, duke e vështirësuar verifikimin dhe rakordimin e të dhënave të inventarit sipas një date të caktuar, me qëllim për ta kryqëzuar më tej informacionin e të dhënave të bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare me atë të rezultuar nga inventarizimi i gjendjes fizike të aktiveve.

· **AMA:**

- Procedurat e delegimit, nuk janë shoqëruar në çdo rast me raportimin mbi realizimin e detyrave të deleguara, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, Ligjit për MFK, si dhe Kreut III “Procedura e delegimit sipas autorizimit që delegon”, të Udhëzimit nr.4, datë 29.1.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Ministrisë së Financave, si dhe udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” .

· **MSHMS** rezultoi se:

- Parregullsi dhe mungesë dokumentesh në dosjet e personelit.

· **MiSHMS:**

- Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurma e auditimit për proceset kryesore, në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr.4, të VKM nr. 511, date 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së ministrit të shtetit për mbrojtjen e sipërmarrjes”, nenit 4, pika 19, si dhe nenit 16, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Nuk është hartuar dhe depozituar tek nëpunësi i parë autorizues në MFE sipas afateve ligjore në fuqi, Pyetëtori i Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti Vjetor përkatës mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të kësaj njësie publike të qeverisjes qendrore.
- Objektivat e “Strategjisë për ndërveprim mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike”, të institucionit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, nuk janë shoqëruar me indikatorë të matshëm, ç’ka do të lehtësonte matjen e performancës institucionale drejt realizimit të këtyre objektiveve.
- Me Urdhrin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Nr. 4, (nr. 2841 prot), datë 16.05.2022 “Për emërimin e menaxherit të skemës së granteve dhe masave mbështetëse”, është caktuar si menaxhere e grantit Këshilltari i Ministrit. Emërimi i një funksionari politik në krye të funksionit administrativ të menaxhimit të grantit, (detyrat e të cilit janë të përcaktuara në rregulloren e grantit si zbatim dhe menaxhimi i grantit), bie në kundërshtim me Ligjin 90/ 2012 “Për funksionimin e administratës shtetërore”, Neni 17 “Kabinetet”, pika 1, si dhe Kreu III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, Seksioni 1 “Ministritë”, Neni 11.

· **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** rezultoi se:

- Në lidhje me rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore, për periudhën 2022 ka raste të largimit të punonjësve nga shërbimi civil, të cilët nuk kanë dorëzuar detyrën dhe dokumentacionin e administruar prej tyre me procesverbal, e cila sjell si pasojë thyerjen e Kodit të Etikës dhe veprime jo në përputhje me VKM Nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirim nga shërbimi civil”, pika 19, 20,21 dhe 22.

- **MFE:** Nga auditimi konstatohet se nuk është miratuar Gjurma e Auditimit si dokument i unifikuar për të gjitha proceset e institucionit. Për më tepër, dokumentacioni i dorëzuar ka paraqitur parregullsi të cilat konsistojnë në: dosje me mangësi dokumentacioni justifikues, databaza me mangësi informacioni, të dhëna të cilat kanë mangësi në rakordime si dhe

dokumentacioni i cili paraqet mungesë të gjurmës audituese. Nga KLSH konstatohet se nga ana e MFE nuk është ruajtur gjurma audituese, duke e bërë të vështirë gjurmimin e qarkullimit të informacionit dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion (sidomos databazat) nuk ofron informacion për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Për vitin 2022, Titullari i MFE nuk ka urdhëruar krijimin e komisionit për inventarizimin e asetëve të MFE.

· **Instituti i Gjeoshkencave** rezultoi se:

- Dosjet e personelit dhe disa nga kontratat e rinovuara nuk administrohen nga IGJEO, në kundërshtim me rregullores së brendshme të Institutit.
- Gjatë periudhës objekt auditimi puna studimore mbi vlerësimin i Biomassës ka qenë mjaft e reduktuar nga ana e Departamentit të Hidrologjisë, studimi i së cilës është ndër objektivat e institucionit.
- Mungojnë të dhëna mbi zhvillimin e modeleve gjeo-informatike gjatë periudhës objekt auditimi, e cila është një nga detyrat e Institutit referuar rregullores në fuqi.
- Nga auditimi rezulton se nuk janë kryer procedurat e inventarizimit fizik të pasurisë për stacionet sizmike, hidrologjike dhe meteorologjike, pronësi e IGJEO-s, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, pika 74.

· **Ministria e Drejtësisë** rezultoi se:

- Nga auditimi me përzgjedhje i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se në mënyrë të përsëritur në vitin 2022, për likuidimin e dietave për shërbimet e kryera brenda vendit, personat udhëtues kanë paraqitur foto të printuar të faturave tatimore, të cilat referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të jenë origjinale dhe gjithashtu në këtë format nuk është i mundur as skanimi i kodit të fiskalizimit, për garantimin e rregullshmërisë së faturës tatimore, veprime në kundërshtim me kuadrin ligjor tatimor dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

· **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** rezultoi se:

- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MTM nuk ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës.

· **Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (MAS)**, është ushtruar auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së këtij subjekti me ligjet dhe aktet normative, me objekt shpërblimin dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë në zbatim të Ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar rezultoi se:

- Në përbërje të grupit të punës për trajtimin e shpërblimeve për sportistët elitë mungon specialisti i fushës (*referuar llojit të sportit për të cilin aplikohet për shpërblim*);
- Mungon baza e të dhënave/data bazë tip e miratuar, ku të pasqyrohen dhe përditësohen të dhëna mbi shpërblimin e sportistëve elitë. Praktikën e aplikimit për dhënie shpërblimi për sportistët elitë, nuk janë të administruara në dosje të inventarizuara me dokumentacionin përbërës dhe të protokolluar sipas legjislacionit “Për arkivat”.
- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021, nuk parashikon ndonjë afat ligjor për ndjekjen e procedurës për shpërblimin e sportistëve elitë si dhe të drejtën e ankimit së bashku me organin që e shqyrton, në rastet kur kërkesa për shpërblim nuk pranohet, nuk merret në shqyrtim apo refuzohet. Po kështu, ligji Nr. 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, neni 27, pika 1, germa “c”, si dhe VKM Nr.789, datë 15.12.2021, nuk përcaktojnë konkretisht se cilat janë veprimtaritë ndërkombëtare të parashikuara në

- pikën 1, germa "a" dhe "b", në rastet e sporteve individuale për të cilët duhen referuar rregulloret ndërkombëtare të këtyre veprimtarive.
- Nga auditimi i praktikës së ndjekur për shpërblimin e një sportisti, sipas kërkesës së Federatës Shqiptare të Bodybuilding & Fitnes, rezultoi se refuzimi i kërkesës nga ana e MAS-it nuk është në përputhje me kriteret e Ligjit Nr. 79/2017 "Për sportin" i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, (neni 27, pika 1, germa "c", VKM nr.789, datë 15.12.2021, pika 13 dhe Urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr.352, datë 17.06.2019 "Për miratimin e rregullores së brendshme së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë" Kreu IV, neni 21, pika 2);
 - Në 4 raste praktikat për dhënien e shpërblimit sportistëve elitari, kanë mungesë dokumentacioni.
- **DPT:** Titullari i Institucionit nuk ka miratuar Gjurmët e Auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të miratuara nga MFE, si dhe nuk rezulton arkivimi i tyre. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces. Institucioni nuk disponon Manualin e Proceseve të Punës. Ai përshkruan të gjitha proceset e punës në institucion duke lejuar identifikimin e dobësive, si mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës.
 - **Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ)** rezultoi se: Bazuar mbi evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit është arritur në konkluzionin se gjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë disa vende vakante për mjekë. QKTGJ nuk ka respektuar afatin 5 (pesë) ditor, në fillim të muajit për të shpallur vendin vakant, por ka raportuar dhe kërkuar të shpallen vendet vakante pas më shumë se 2 muaj, pas krijimit të vakancës.
 - Auditimi i kryer në **Albpetrol sha:** Në lidhje me MFK rezulton se institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen, ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit si dhe mungojnë programe për trajnimin e stafit. Gjithashtu, ka rezultuar se nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës dhe ky vlerësim mungon në dosjeve personale të punonjësve, nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, lista e proceseve, si dhe nuk janë përcaktuar persona përgjegjës për monitorimin dhe zvogëlimin e risqeve, duke mos u identifikuar dhe vlerësuar risqet që rrezikojnë realizimin e objektivave të institucionit.
 - **ARRSH:** Në rregulloren e brendshme të ARRSH nuk janë përfshirë mjaftueshëm veprimtaritë e kontrolleve parandaluese, për shkak se rregulloret nuk përshkruajnë me detaje proceset. Gjithashtu, veprimtaritë e kontrolleve menaxheriale të pamjaftueshme kanë sjellë mungesën e përgjegjësive të përcaktuara menaxheriale.
 - **Aktivitetet e kontrollit NJVQV**
 - Nuk ka plan investimesh për programet e Teknologjisë së Informacionit (TI). Nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një plan menaxhimi të riskut të TI për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, (*Bashkitë Belsh, Konispol, Lezhë, Cërrik, Divjakë, Patos, Roskovec, Sarandë, Këlcyrë*).
 - Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit për detajimin e procedurave kryesore të njësisë, (*Bashkitë Kolonjë, Divjakë, Tepelenë, Sarandë, Këlcyrë, Lezhë*).

- Nuk ka rregulla të miratuara për komunikimin elektronik, apo sisteme të ndryshme online edhe për faktin se nuk ka ecuri në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit në ushtrimin e veprimtarisë, (*Bashkitë Tepelenë, Libohovë*).
- Nuk ka plan-veprime vjetore operationale të miratuara, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme. Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë (*Bashkitë Belsh, , Krujë, Rrogozhinë, Këlcyrë, Konispol, Libohovë*).

Informimi dhe komunikimi

· Auditimi i kryer në **QKUM**

Ka rezultuar se QKUM nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv. Në Rregulloren e brendshme të institucionit, nuk është përcaktuar në formë të kuptueshme mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave. Sistemi i IT i QKUM aktualisht nuk është pajisur me një procedurë të përshtatshme rezervë (back-up) nga ku të mundësojë ripërfitim të të dhënave në rastin e një aksidenti në sistem ose ndaj rrezikut të një sulmi kibernetik.

· **DPT:**

-Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet periodike 4 dhe 8 mujore të monitorimit buxhetor, si dhe raporti 12 mujor, nuk janë publikuar në faqen e web-it të Institucionit ose të MFE-së, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; dhe pikën nr. 271, Kreu VI, “Raportet e monitorimit”, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të MFE.

· **NJVQV:**

- Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut (*Bashkitë Belsh, Konispol, Lezhë, Tepelenë, Sarandë*).
- Sistemi i komunikimit të institucionit nuk është eficient. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, (*Bashkitë Himarë, Fier, Sarandë*).

Monitorimi

· **MSHMS** rezultoi se:

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm
- Mungesa e raporteve të monitorimit periodik për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të saj, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik.

· **Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes** rezultoi se:

- Nuk janë hartuar plane veprimi dhe raporte performance (6-mujore e vjetore) mbi ecurinë e zbatimit të “Strategjisë për ndërveprim mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike”.

· **Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS)**, është ushtruar auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së këtij subjekti me ligjet dhe aktet normative, me objekt shpërblimin dhe

përfitimim e trajtimit të arsimitarëve dhe rimbursimin e plotë të çmimit të biletës së transportit të mësuesve që udhëtojnë në linjën Librazhd-Gorenjë dhe anasjelltas rezultoi se:

- Mungesa e raportimit nga ZVAP Librazhd pranë MAS-it sipas kërkesave të VKM Nr. 682, datë 29.07.2015, pika 5/1, e ndryshuar.
- Mos përputhje në çmimin e biletës së transportit ndërqytetës të Aneksit 1, Pasqyra 1, “Çmimet e biletave të transportit të udhëtarëve me autobus sipas distancës kilometrike” të VKM-së Nr. 146, datë 26.2.1998 me ndryshime dhe Aneksit 1 “Tabela e kilometrave dhe çmimi i biletave për linjat rrethqytetase të Bashkisë Librazhd “ (Sektori i Taksave), miratuar nga Bashkia Librazhd.

· **Kontrata e Skanimit. (MFE dhe DPD):**

Referuar auditimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për kontratën koncesionare të skanimit në dogana, ka rezultuar se veprimtaria e MFE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe DPD në cilësinë e përfaqësuesit ekzekutiv të autoritetit në kontratë dhe autoritetit përgjegjës për aktivitetin në doganat e Republikës së Shqipërisë ka paraqitur mangësi në të gjithë elementët e MFK.

Sa i takon *Monitrimin të Kontrollit*, nuk është ngritur një grup pune (i përhershëm për afatin e kontratës) për monitorimin e zbatimit të kësaj kontrate me specialistë të fushës, me ndarje të qartë të detyrave, për mbikëqyrjen e përshtatshme të zbatimit të kontratës; nuk është përmbushur detyrimi kontraktual për punonjësit në analizimin e imazheve dhe për më tepër, asnjë plan veprimi apo plan trajnimi nuk është miratuar, për të përcaktuar periodicitetin dhe shtrirjen e këtyre trajnimeve.

Lidhur me *Menaxhimin e Riskut* është konstatuar mungesa e përfshirjes së aktivitetit të kontratës koncesionare në Regjistrin e Riskut; si dhe mungesa e hartimit të objektivave SMART, mangësi e cila ka ndikuar në monitorimin e ecurisë drejt përmbushjes së tyre, duke mos kryer vlerësim të performancës së koncesionit dhe duke riskuar realizimin e qëllimeve për të cilat u iniciua ky partneritet publik – privat.

Në kuadër të *Veprimtarive të Kontrollit*, është konstatuar mungesa e hartimit dhe miratimit të hartës së procesit të punës, gjurmës së auditimit dhe planit të kontrollit të brendshëm, e cila sjell mungesë të uniformitetit në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera/ përgjegjësitë dhe afatet për kryerjen e një aktiviteti, mosverifikimin e aktiviteteve të kryera; si dhe mosmenaxhimin e risqeve kryesore dhe mosdhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Për më tepër janë konstatuar parregullsi në ruajtjen e dokumentacionit lidhur me kontratën koncesionare.

Sa i takon *Informacionit dhe Komunikimit*, është konstatuar mungesa e përmbushjes së detyrimit të lidhjes me serverin/switchin lokal, e cila sjell si pasojë mospërcjelljen në kohë reale të analizave të imazhit të skanimit; si dhe problematika e mungesës së të dhënave nga degët doganore, e cila nuk mundëson kryerjen e një analize midis të dhënave të degëve dhe të dhënave të koncesionarit.

Në kuadër të Monitorimit dhe Raportimit janë shfaqur problematika të theksuara si mungesë e analizës së të dhënave dhe mungesë të rakordimit të dhënave të koncesionarit dhe atyre të Degëve Doganore, pasi nuk janë respektuar detyrimet e Manualit të Procedurave Standarde të Punës për Skanimin, lidhur me mbajtjen e detajuar të dhënave për skanimet duke filluar që nga origjina e kërkesës për skanim e deri në përcaktimin nëse nga kontrolli fizik pas skanimit janë konstatuar shkelje. Në këtë kuadër, nga MFE dhe DPD nuk është ndërmarrë asnjë hap për të orientuar monitorimin e kontratës koncesionare në kuadër të vlerësimit të performancës së saj dhe vlerës së shtuar të ofrimit të shërbimit të skanimit. Gjithashtu, mungesa e mbajtjes së Regjistrin të Skanimit, i cili është një regjistër apo një bazë të dhënash elektronike, në të cilat regjistrohen të gjithë Urdhrat e Skanimit, të lëshuara nga autoritetet doganore, ka sjellë pamundësinë e detajimit të skanimeve të kryera në kuadër të vlerësimit

të veprimtarisë së shoqërisë koncesionare lidhur me shërbimin e ofruar. Mungesa e të dhënave të detajuara dhe të gjurmueshme gjatë procesit të skanimit, bën që të humbasë *gjurma e auditimit*, i cili është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësive, apo ndërmjet vetë njësive dhe institucioneve të jashtme.

- **Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan** nuk ka hartuar një plan strategjik i cili përmban objektivat afatmesëm dhe vjetore prioritare të institucionit, si dhe nuk ka përgatitur planet e masave dhe veprimet në mënyrë që të monitorojë zbatimin e tyre ,nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre; nuk ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut, por ka në fuqi një regjistër risku në format elektronik.

Gjithashtu, konstatohet se njësia nuk ka përcaktuar koordinatorin e riskut, për asnjë nga vitet objekt auditimi, nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit, duke mosrespektuar kërkesat e nenit “8” dhe pikës “2” të nenit “21” të Ligjit nr.10926 të datës 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Njësia nuk ka plotësuar pyetësorët e vetëvlerësimit në zbatim të formatit të miratuar pjesë e Manualit për MFK, si dhe nuk është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për efekt konsolidimit deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

- Nga auditimi i **Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara:**

Në lidhje me vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se nga AAPSK nuk është ngritur një sistem funksional të kontrollit të brendshëm dhe efektiv për menaxhimin financiar, duke qenë se u evidentuan problematika që lidhen me mungesën e hartimit të strategjisë së menaxhimit të riskut dhe gjurmës së auditimit.

- **Albpetrol sha:**

Nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive, nuk është plotësuar pyetësori i vetëvlerësimit, deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ku të përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi, nevoja për përmirësim, si dhe kjo deklaratë nuk është raportuar në MFE, nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Nga auditimi ka rezultuar gjithashtu se nuk ka një procedurë të veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Aktualisht Shoqëria ka faqe zyrtare e cila është e dedikuar për aktivitetin e kërkimit, prodhimit të naftës dhe gazit. Për periudhën nga 03.09.2019, deri më datën 31.12.2020, posta elektronike zyrtare dhe faqja e shoqërisë kanë pasur mungesë të certifikatës së sigurisë, mungesë rinovimi licencash, duke çuar në pasigurinë e funksionimit të sistemit të komunikimit në faqen zyrtare.

- Nga auditimi i kryer në **Institutin e Integritetit të ish të Përndjekurve Politik (IIPP) dhe Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK)** për periudhën 2018 deri më 30.06.2022:

- *Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollit të IIPP*

Titullari nuk ka miratuar planet vjetore të punës së institucionit, si dhe raportet vjetore të veprimtarisë së institucionit. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit lidhur me procedurën e aplikimit, miratimit dhe monitorimit të fondit të ndihmës ekonomike për individët dhe

financimit të shoqatave në kundërshtim me neni 16, pika 2 dhe neni 4, pika 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Nga auditimi është konstatuar se nuk është përcaktuar në aktet e brendshme veprimtaria e kontrollit në kundërshtim me neni 22, pika 1 dhe 3 të ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Rezulton se mungon një sistem informacioni dhe komunikimi që të sigurojë dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve nëpërmjet dokumentimit dhe qarkullimit të dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve.

Konstatohet se rregullorja është e pa përditësuar dhe nuk përmbush funksionin për strukturën aktuale të këtij Institucioni.

▸ *Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin të ISKK*

Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit. Rregullorja është e pa përditësuar duke qenë se instituti ka kalur në proces ristrukturimi.

· **DRT Shkodër**

▸ Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nuk ka një Kod Etike të miratuar. DRT Shkodër bazohet në rregulloren e brendshme të institucionit, për procedurën për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

▸ Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër funksionon në bazë të rregullores së brendshme të miratuar me Urdhrin nr. 19, datë 22.02.2017 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, rregullore e cila nuk është përditësuar në përputhje me ndryshimet strukturore.

· Në **FSDKSH** ka rezultuar se:

▸ Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel- it apo Word-it.

▸ Drejtoria e Ekonomike për mbajtjen e Kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar mbetet i lartë.

▸ Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

· Nga auditimi në **ISSH**, mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe Manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm ka rezultuar se, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm ka funksionuar në mënyrë të plotë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

· Nga auditimi i përputhshmërisë i ushtruar në **Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara**, në lidhje me vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se nga AAPSK nuk është ngritur një sistem funksional dhe efektiv për menaxhimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, duke qenë se u evidentuan problematika që lidhen me mungesën e hartimit të strategjisë së menaxhimit të riskut dhe gjurmës së auditimit.

· **Monitorimi në NJVQV**

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti (*Bashkitë Belsh, Konispol, Lezhë, Mat, Këlcyrë, Gjirokastrë*).
- Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur (*Bashkitë Belsh, Konispol, Lezhë, Roskovec, Tepelenë, Sarandë, Patos Gramsh*).
- Nuk ka sektor të auditit të Brendshëm, për rrjedhojë nuk ka vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm (*Bashkitë Belsh, Këlcyrë Përmet, Konispol*).
- Njësia e Auditit të Brendshëm ka mungesë të specialistëve referuar strukturës së miratuar (*Bashkitë Kolonjë, Berat, Patos, Rrogozhinë, Peqin,*)

• **Organizimi dhe funksionimi i shërbimit të auditimit të brendshëm publik**

KLSH përmes auditimeve të ushtruara nga ana e saj, ka arritur në të njëjtat përfundime me këto të arritura nga dhe raporti i Raporti i KE: “*Screening report Albania*”, i datës 20.7.2023, i cili në kuadër të vlerësimeve për Kapitullin 32 – *Financial control*”, (Fq. 128-132), në lidhje me stadin e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve audituese, ku shprehet se:

NjQH ka kryer vlerësimin e jashtëm të cilësisë së aktiviteteve të auditimit të brendshëm në njësitë publike për të vlerësuar nivelin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me kërkesat e Kornizës Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale (IPPF). Sipas vlerësimit, vetëm 45% e Njësive të Auditimit të Brendshëm të vlerësuara ishin “përgjithësisht” ose “pjesërisht” në përputhje me standardet e IPPF.

Niveli i zbatimit efektiv të rekomandimeve të auditimit të brendshëm mbetet i dobët.

Një seri e udhëzimeve dhe instruksioneve për përmirësimin e monitorimit dhe raportimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit brendshëm janë përgatitur dhe shpërndarë për shqyrtim në strukturat e auditimit të brendshëm. *Zbatimi i këtyre udhëzimeve duhet të ndihmojë audituesit e brendshëm për të përmirësuar cilësinë e auditimeve sipas standardeve.*

Planifikimi nga Njësitë e Auditit të Brendshëm dhe nga DH/AB

Për vitin 2022 shërbimi i Auditimit të Brendshëm mbulon 138 njësi publike shpenzuese. Në 136 prej tyre janë ngritur strukturat e auditimit të brendshëm, nga të cilat në vetëm 3 prej tyre këto struktura nuk janë bërë funksionale. DH/AB konstaton se mungesa e funksionalitetit të këtyre 3 strukturave është ndjekja e procedurave për plotësimin e pozicioneve sipas strukturës së miratuar dhe largimit të përkohshëm të audituesve. Këto struktura janë: Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Spitali Rajonal Lushnje.

Dy Njësi Publike e kanë të mbuluar shërbimin e AB sipas Akt-Marrëveshjeve të lidhura midis palëve, respektivisht: Bashkia Finiq – *Akt-Marrëveshje me Bashkinë Dropull, nr. 17390/1 Prot., datë 05.11.2021*; Bashkia Libohovë – *Akt-Marrëveshje me Bashkinë Dropull, nr. 8447 Prot., datë 12.05.2021*.

Nga lista e vitit 2022 në krahasim më vitin 2021 nuk figurojnë 2 NJAB si në vijim: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Ndryshimet e planit përgjatë vitit 2022

Nga informacioni i vënë në dispozicion të KLSH rezulton se 48 NJAB kanë kryer ndryshim të planit për vitin 2022 të miratuara nga Titullari i Institucionit përkatës, nga të cilat vetëm 36 prej tyre e kanë argumentuar ndryshimin e Planit Vjetor 2022 me relacionin përkatës.

KLSH evidenton se plani i konsoliduar për vitin 2022 ka përfshirë 127 NJAB me 1181 angazhime auditimi gjithsej. Nga të dhënat rezulton se 3 NJAB me 10 angazhime auditimi që kanë raportuar me vonesë dhe të dhënat nuk janë pasqyruar në Planin e Konsoliduar janë: Kryeministria, Universiteti i Mjekësisë, Bashkia Divjakë.

Bashkë me ndryshimet e planit vjetor me pakësime prej 52 angazhime auditimi, Plani i Konsoliduar për vitin 2022 rezulton gjithsej me 1181 angazhime auditimi. Pas ndryshimit të Planeve Vjetore 2022 rezultojnë gjithsej 1139 angazhime auditimi.

Plani i konsoliduar vjetor 2023

KLSH auditoi procedurën e dorëzimit të Planeve Strategjike/Vjetore të NJAB-ve pranë MFE dhe konstatohet se:

Në sektorin publik janë krijuar 136 struktura të Auditimit të Brendshëm, të ngritura në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, nga të cilat 133 janë funksionale, dhe 3 ende nuk janë funksionale (*Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile; dhe Spitali Rajonal Lushnjë*).

Përsa i përket afateve të dorëzimit të Planeve Vjetore të këtyre NjAB-ve pranë DH/AB rezulton se nga të dhënat e Planit Strategjik dhe Vjetor 2023-2025, kanë raportuar gjithsej 128 NjAB nga 133 të tilla, ku 17 prej tyre i kanë dorëzuar Planet Vjetore përtej afatit të datës 20.10.2022. Ndërkohë, 2 NjAB (Ujësjiellës Kanalizime Elbasan dhe Ujësjiellës Kanalizime Korçë) nuk kanë raportuar.

Kapacitetet audituese të NJAB gjatë 2022

Sa i takon kapaciteteve audituese dhe zhvillimit të auditimeve përgjatë vitit, nga analiza e kryer nga KLSH konstatohet se:

NJAB me asnjë auditim të zhvilluar gjatë vitit 2022 (ose që nuk kanë raportuar) rezultojnë 11 institucione publike si në vijim: Njësia Vendore e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor Tiranë; Gjykata Kushtetuese, Spitali Rajonal Elbasan, Qendra Spitalore Lushnjë, Spitali Rajonal Gjirokastrë, Qendra Spitalore Korçë, Spitali Memorial Fier, Bashkia Librazhd, Bashkia Has, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (struktura jofunksionale).

Realizimi i planit të vitit 2022

KLSH ka analizuar të dhënat e informacionet e përfshira në Raportin Vjetor 2022, ku thuhet se *“Për vitin 2022, universi i auditimit të 135 NJAB-ve përfshiu për auditim 1109 (me ndryshimet) fusha dhe sisteme. Përgjatë vitit 2022, nga 126 NJAB u përfunduan 1008 angazhime auditimi që rezultuan në një nivel të realizimit të Planit Vjetor në vetëm 91 %, niveli më i ulët gjatë 5 viteve të fundit”*. Ndërkohë në grafikun nr. 2 të Raporti Vjetor 2022 të DH/AB rezultojnë 1181 auditime të planifikuara dhe 1008 auditime të realizuara. Konstatohet se në Raportin Vjetor 2022, DH/AB ka krahasuar realizimin faktik me planin fillestar, pa marrë parasysh ndryshimet përgjatë vitit 2022 të Planeve Vjetore të NJAB dhe NJAB që nuk kanë raportuar në kohë dhe nuk janë bërë pjesë e Planit të Konsoliduar.

Raporti Vjetor 2022 i DH/AB nuk paraqet në mënyrë konsistente të dhënat reale lidhur me realizimet dhe planifikimet, duke ndikuar kështu në përlllogaritjet e realizimit faktik kundrejt atij të planifikuar për secilin prej angazhimeve të auditimit. Në tabelën nr. 9 të Raportit Vjetor të DH/AB paraqiten llojet e angazhimeve të realizuara ku shumatorja e tyre arrin në 999 dhe jo në 1008 angazhime siç është shënuar në tabelë. Për më tepër, në përlllogaritjet e kryera lidhur me realizimin në përqindje (të treguar në Grafikun nr. 2 të Raportit Vjetor të DH/AB) konstatohet se planifikimi paraqitet në 1181 auditime dhe realizimi në 1008

auditime, ndërkohë që në Grafikon nr. 3 të Raportit Vjetor të DH/AB rezulton se planifikimi në përqindje është përlogaritur në vlerat që paraqiten edhe në tabelë.

Tabela 33 Krahasimi i realizimit të angazhimeve të auditimit me planifikimin

Emërtimi	Auditime të Kombinuar	Auditime përputhshme	Auditime Financiare	Auditime Performance	Auditime të TI	Auditime Tematike	Shtërbime të Këshillimit	Total
Plani fillestar	621	420	80	34	14	0	12	1181
<i>NJAB që kanë raportuar me vonesë</i>	3	4	3	0	0	0	0	10
Plani (me vonesa)	624	424	83	34	14	0	12	1191
Plani i ndryshuar	612	393	76	30	12	0	16	1139
<i>NJAB planifikuar pa raportuar</i>	5	0	4	0	0	0	0	9
Planifikimi me ndryshimet e miratuara	607	393	72	30	12	0	16	1130
Realizimi	469	379	89	28	4	29	10	1008
Realizimi sipas DH/AB (në %)	84%	98.4%	123.6%	93.3%	33.3%	-	62.50%	90.9%
Realizimi sipas KLSH (në %)	77.3%	96.4%	123.6%	93.3%	33.3%	-	62.5%	89.2%

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE përpunuar nga KLSH

KLSH vlerëson se mangësitë në planifikimin e veprimtarisë audituese mbartin riskun që angazhimet e auditimit nuk sigurojnë që risqet kryesore janë adresuar dhe fushat apo sistemet me risk të lartë e të mesëm që kanë ndikim thelbësor në arritjen e objektivave të jenë mbuluar me auditim. Ato gjithashtu tregojnë për një eficiencë të ulët në planifikimin e burimeve të faktorëve të cilët mund të ndikojnë në të gjithë cilësinë e procesit të auditimit si gjatë punës në terren ashtu dhe në arritjen e objektivave të auditimit. Dobësitë në planifikimin e veprimtarisë dhe ndryshimet e shpeshta gjatë vitit, bartin riskun që veprimtaria audituese të mos realizohet në mënyrë sistematike dhe të disiplinuar, duke vazhduar të jetë e orientuar nga inspektimet financiare.

Nga ana e NJAB-ve, gjatë vitit 2022, janë realizuar auditime që kanë konkluduar në gjetje me rëndësi deri në dëm ekonomik në sistemin e prokurimeve, ku janë identifikuar numri më i madh i shkeljeve të procedurave të prokurimit publik. Po ashtu dobësi identifikohen në fushën e tatim taksave dhe doganave kanë rezultuar më një numër të konsiderueshëm të devijimeve dhe shkeljeve të cilat kanë sjellë dhe efekt financiar negativ. Të tjera sisteme ku paraqitet nivel i lartë i gjetjeve dhe nënsistemet përkatëse përfshihen: sistemi i pagave dhe shpërblimeve, administrimi i aseteve, planifikimi buxhetit dhe sisteme të tjera operationale sipas natyrës së subjekteve të audituara. Nga auditimet janë evidentuar problematika të ndryshme në hallka të ndryshme të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes në nivel qendror dhe vetëqeverisjes vendore, ashtu dhe agjencive shtetërore dhe shoqërië aksionere publike.

Shkeljet e disiplinës financiare të konstatuara nga NJAB-të gjatë auditimeve, kanë shkaktuar efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit prej 406.3 milion Lekë nga të cilat rreth 41.2% e dëmit është konstatuar në tatime-taksa dhe rreth 25.5% në sisteme të tjera specifike të njësive publike.

Vlera e zbuluar e shkeljeve financiare gjatë vitit 2022 është ulur në krahasim me vitin 2021.

Tabela 34 Gjetjet me efekt financiar negativ nga NJAB sipas sistemeve për vitin 2022

Nr.	Gjetjet me efekt financiar negativ sipas sistemit	Gjetje në vlerë (mijë lekë)	Gjetje në numër
1	Prokurim, blerje dhe investime	20,743.64	939
2	Paga, shpërblime, trajtime, komisione	36,986.70	719
3	Fondet e sig. shoq dhe shëndetësore	8,460.40	24
4	Tatime, taksa dhe dogana	167,269.37	480
5	Admin. prone dhe pasurie	20,117.32	1,165
6	Privatizime, shitje dhe qiradhënie	20,880.11	103
7	Koncesione dhe ankande	28,135.86	25
8	Legalizime, Urbanistikë, kth. Pronash	0	14
9	Kreditim, subvencione	5	50
10	Të tjera	103,682.21	3,741
	TOTALI	406,280.60	7,260

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE përpunuar nga KLSH

Për vitin 2022, niveli i pranimit të rekomandimeve paraqitet në nivelin 99.2%, ku nga 7808 rekomandime të dhëna janë pranuar 7745 dhe nuk janë pranuar 63 rekomandime. Në funksion të ndjekjes deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve, NJAB kanë vazhduar të monitorojnë zbatueshmërinë e rekomandimeve deri në dy vite pas lëshimit të raportit përfundimtar të auditimit. Në këtë këndvështrim niveli i zbatimit të rekomandimeve i shtrirë në dy vite (2021-2022) paraqitet në nivelin 56%.

Strukturat e auditimit

Në pikën 1 të nenit 10 të Ligjit nr.114/2015, datë 20.10.2015 i ndryshuar referohet që, “Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në geramat a-c të kësaj pike”.

Rezulton se bazuar në Raportin Vjetor 2022 të DH/AB, shërbimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik gjatë vitit 2022 është realizuar nga 136 NJAB, të krijuara në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Struktura organike e miratuar për stafin auditues në NJAB ka parashikuar 499 auditues të brendshëm, por në fund të vitit 2022 janë evidentuar të punësuar vetëm 435, duke paraqitur riskun që veprimtaria audituese të mos mbështetet nga burimet e nevojshme dhe kapacitetet profesionale njerëzore që do të mundësonin realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimit të auditimit. Nga evidencimi i vendeve vakante (64 të tilla), konstatohet se ndarja e tyre rezulton si më poshtë: 15 vende vakante në ministrinë e linjës, 19 vende vakante në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 15 vende vakante në institucionet qendrore, 5 vende vakante në institucionet e pavarura, 3 vende vakante në universitetet publike, 2 vende vakante në qendrat spitalore dhe 5 vende vakante në shoqëritë aksionere.

Tabela 35 Të dhëna mbi audituesit e brendshëm, 2022

Nr. NJAB gjithsej	Auditues të Brendshëm		Vende Vakante	Auditues të Brendshëm të certifikuar	Auditues të Brendshëm të pa certifikuar	Auditues të Brendshëm në proces certifikues
	Plan	Fakt				
136	499	435	64	309	51	75

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE përpunuar nga KLSH

Struktura profesionale e audituesve të brendshëm konsiston në: 348 ekonomistë, 67 juristë dhe 20 me profesione të tjera specifike sipas sektorëve të ekonomisë.

Tabela 36 Paraqitja e audituesve të certifikuar për vitin 2022

Auditues të certifikuar	Auditues në proces certifikimi	Auditues të pacertifikuar	Auditues gjithsej
309	75	51	435
71.03%	17.24%	11.72%	

Burimi: Të dhënat nga DH/AB në MFE përpunuar nga KLSH

Pra, në total paraqitet një nivel prej 11.72% të audituesve të cilët janë të pacertifikuar. Numri më i madh i audituesve të pa certifikuar (30 të tillë) i përket njësive të vetëqeverisjes vendore dhe shoqërive aksionere publike.

Eksperienca në profesion është një kriter bazë për punësimin dhe zhvillimin në karrierë të audituesve e diferencuar për drejtues të NJAB dhe auditues të brendshëm. Kriteri i eksperiencës përmbushet nga 245 auditues të brendshëm që kanë vjetërsi pune mbi 5 vjet dhe 190 kanë vjetërsi në auditim deri në 5 vjet. Evidentohen:

- 24 njësi me më pak se tre auditues, nga të cilat 17 NJAB me 1 punonjës dhe 7 NJAB me 2 punonjës (tre më pak se vjet);
- 17 njësi me drejtues të NJAB me më pak se 5 vjet në auditim të brendshëm ose të jashtëm, 11 njësi me drejtues të NJAB të pa certifikuar ose në proces certifikimi;
- 25 njësi kanë punësuar më shumë se 1/3 të punonjësve të pa certifikuar.

KLSH ka konstatuar se për periudhën e audituar, shërbimi i auditimit të brendshëm nuk shtrihej në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, konkretisht në 11 institucione të pavarura, 9 njësi publike në varësi të Kryeministrisë (të Grupit Buxhetor 87) dhe në 9 njësi të pushtetit vendor (Bashki) nuk realizohet shërbimi i auditimit të brendshëm. Në këto kushte, krijimi i njësive të auditimit duke mos përmbushur kriteret mbart risk të lartë dhe mund të ketë efekt në funksionimin dhe performancën e auditimit, risk i evidentuar dhe nga DH/AB në Raportin Vjetor 2022 të kësaj Drejtorie.

Në njësitë e vetëqeverisjes vendore që realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë krijuar NJAB përfshihen 50 Bashki, ku janë të punësuar 134 auditues të brendshëm kundrejt 153 të miratuar në strukturat organike përkatëse. Kapacitete profesionale të auditimit të brendshëm në njësitë e vetëqeverisjes vendore vlerësohet të jenë jo plotësisht në përputhje me kriteret ligjore të rekrutimit. Nga 134 auditues të brendshëm të punësuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore 74 janë të certifikuar, 30 auditues janë në proces certifikimi dhe 30 janë auditues të rekrutuar rishtazi dhe që nuk janë certifikuar.

Ndërkohë njësitë e vetëqeverisjes vendore relativisht të vogla (Finiq dhe Libohovë) e kanë realizuar shërbimin e auditimit me akt-marrëveshje me njësi auditimi të brendshëm të njësive të tjera publike (konkretisht me Bashkinë Dropull). Njësitë e vetëqeverisjes vendore (Belsh, Pukë, Konispol, Delvinë, Tropojë, Pustec, Këlcyrë, Përmet dhe Poliçan) nuk kanë realizuar shërbimin e auditimit të brendshëm me asnjë nga format e përcaktuara në kuadrin rregullator.

Hartimi, zhvillimi dhe administrimi i politikave kombëtare për zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm nga certifikimi e trajnimi i vazhdueshëm i tyre në përshtatshmëri me praktikat bashkëkohore të fushës

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të audituesve të brendshëm

Në ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, (nenin 20 të tij) përcaktohet se “*Trajnimi i vijueshëm profesional organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas procedurës së miratuar me urdhër të Ministrisë të Financave.*”

Sipas Urdhrit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 248, datë 31.12.2021, është miratuar Programi i Trajnimit të Vijueshëm Profesional (TVP) të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik për vitin 2022, i cili përfshin 8 module kryesore. Implementimi i programit të miratuar ndiqet nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, e

cila raporton te Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe te Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm.

Gjatë vitit 2022, referuar Raportit Vjetor dhe auditimit të kryer nga KLSH , rezulton se DH/AB ka zhvilluar trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik sipas moduleve të Programit të trajnimit të miratuar, me 8 tema trajnimi të zhvilluara në 40 orë në platformë online, ku kanë marrë pjesë 310 auditues të brendshëm të certifikuar. Nga shqyrtimi i të dhënave të Regjistrimit të pjesëmarrësve në TVP të publikuar në faqen zyrtare të MFE, rezulton se janë regjistruar për TVP 318 auditues të brendshëm dhe 3 auditues të brendshëm të cilët nuk e ushtrojnë më detyrën .

Sipas pikës 2 të nenit 20 të Ligjit Nr.114/2015 me ndryshime parashikohet se: *“Të gjithë audituesit e certifikuar në detyrë, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, i nënshtrohen trajnimit të vijueshëm profesional, të paktën 80 orë në dy vjet”. Kriteri i 80 orëve në dy vite e bën të vështirë kontrollin e plotësimin të këtij kushti dhe të dhënat mbahen për çdo auditues, duke llogaritur periudhën e fillimit të detyrës dhe duke e ndarë në periudha dy vjeçare. Këto të dhëna mbahen nga DH/AB dhe janë dhe të evidentuara nga kjo strukturë.*

Nga 318 auditues të brendshëm të regjistruar në TVP, rezulton se 4 prej tyre nuk kanë realizuar asnjë orë trajnimi nga DH/AB si dhe asnjë orë shtesë njohje, duke përfunduar me 0 orë trajnim gjithsej për vitin 2022. Ndërkohë, 10 auditues të brendshëm kanë rezultuar në fund të vitit me më pak se 40 orë gjithsej trajnim, dhe 304 auditues të brendshëm rezultojnë të kenë kryer 40 orë dhe më shumë trajnim gjithsej.

Certifikimi i audituesve të brendshëm

Sa i përket certifikimit të audituesve të brendshëm, në kreun VI “Kriteret e kualifikimit të audituesve të brendshëm” neni 19 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” përcaktohet se *“Certifikimi i audituesve të brendshëm organizohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, sipas procedurës së miratuar me urdhër të Ministrisë të Financave”.*

Procesi i certifikimit të audituesve të brendshëm ka nisur përmes Urdhrit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 191, datë 19.07.2022 “Për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik për sezonin 2022-2023”. Kalendarin e veprimtarisë së Komisionit të Kualifikimit është miratuar përmes Vendimit nr. 2 të Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, datë 13.07.2022, ku programi konsiston në 6 module, planifikuar si proces i plotë në periudhën 18.07.2022 – 10.07.2023.

Lidhur me certifikimet, në Planin Vjetor të DH/AB është përcaktuar detyra e organizimit të procesit të certifikimit të kandidatëve për auditues të brendshëm për sezonin 2022-2023, planifikuar të zhvillohet në Janar 2022-Qershor 2023, me indikator realizimi 40 kandidatë të regjistruar si Auditues të Brendshëm në këtë sezon. Në Raportin Vjetor 2022 të DH/AB, rezulton se pas vlerësimit nga ana e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, 81 auditues të brendshëm në NJAB e sektorit publik u vlerësuan të plotësonin kriteret për ndjekjen e certifikimit.

KLSH konstaton se nga publikimet e vitit 2022, Regjistri Kombëtar i Audituesve të Certifikuar i publikuar në faqen zyrtare të MFE nuk jep informacione të mjaftueshme në lidhje me statusin e audituesve: aktiv ose pasiv në kryerjen e funksionit të audituesit, duke sjellë si pasojë paraqitjen e të dhënave jo të plota për audituesit e certifikuar në vite.

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë nga DH/AB

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë nga DH/AB në NjAB i referohet nenit 24 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Kapitullin VII të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të MF nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, si dhe Metodologjisë së vlerësimit të jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhër të MF nr. 22, datë 06.03.2017.

Sipas Planit Vjetor të DH/AB të miratuar përmes shkresës nr. 23648 Prot., datë 31.12.2021, rezulton se për vitin 2022 janë parashikuar të kryhen 25 vlerësime të jashtme të cilësisë (VJC) në periudhën Janar-Dhjetor 2022, me objektiv zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm nga NjAB. Përmes shkresës nr. 20967 Prot., datë 14.11.2022 është ndryshuar plani vjetor i VJC në sektorin publik për vitin 2022, ku është hequr VJC për Spitalin Rajonal Korçë dhe është shtuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, duke e lënë të njëjtë numrin e angazhimeve për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, në 25 të tilla. Nga krahasimi plan-fakt, konstatohet se janë realizuar në total 24 Vlerësime të Jashtme të Cilësisë, ku paraqitet të mos jetë kryer VJC në Spitalin Rajonal Lushnjë, i parashikuar në datat 12-23 Dhjetor 2022.

Për vitin 2022 janë dhënë opinionet e mëposhtme që kanë rezultuar nga Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë për 24 subjekte (3 Institucione Qendrore, 5 Universitete, 2 Spitale Rajonale, 1 Shoqëri Aksionere dhe 13 Bashki):

- ▶ **10 opinione pjesërisht pozitive:** veprimtaria e AB në disa fusha është në mospërputhje me kërkesat e SNA;
- ▶ **10 opinione thujse negative:** veprimtaria e AB në pjesën më të madhe është në mospërputhje të pjesshme me kërkesat e SNA, përmirësime të rendësishme janë të nevojshme përputhshmëri e pjesshme;
- ▶ **3 opinione negative:** veprimtaria e AB përgjithësisht në mospërputhje të plotë me kërkesat e SNA;
- ▶ **1 opinion pozitiv:** veprimtaria e AB përgjithësisht në përputhje me kërkesat e SNA.

Më hollësisht, opinionet paraqiten si në tabelën nr.37.

Tabela 37 Opinionet e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, 2022

Vlerësimi	Mospërputhje e plotë	Përputhje në disa fusha	Përputhje e pjesshme	Përputhje e plotë
Subjektet	1. Spitali Rajonal Elbasan 2. Spitali Rajonal Fier 3. Bashkia Tepelenë	1. Ujësjellës Kanalizime Durrës sha 2. Bashkia Kukës 3. Bashkia Malësi e Madhe 4. Bashkia Mirditë 5. Bashkia Selenicë 6. Bashkia Skrapar 7. Bashkia Memaliaj 8. Bashkia Prrenjas 9. Bashkia Rrogozhinë 10. Bashkia Divjakë	1. Enti Kombëtar i Banesave 2. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit 3. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare 4. Universiteti i Tiranës 5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë 6. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër 7. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës 8. Bashkia Maliq 9. Bashkia Bulqizë 10. Bashkia Peqin	1. Universiteti Bujqësor i Tiranës

Burimi: Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, MFE.

Nga shqyrtimi i 6 dosjeve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë në subjektet: Universiteti i Tiranës, Ujësjellës Kanalizime sh.a. Durrës, Spitali Rajonal Elbasan; Universiteti Bujqësor i Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Bashkia Tepelenë, rezulton se këto vlerësime i janë referuar germës *dh* të nenit 24, të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2017, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 06.03.2017, “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të jashtëm

të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik” dhe Planit Vjetor të punës në DH/AB për vitin 2022, miratuar nga Ministri i MFE me shkresën nr. 23648 Prot., datë 31.12.2021.

Pyetëtori i vetëvlerësimit të NJAB

Pyetëtori i vetëvlerësimit për vitin 2022 është plotësuar nga 125 NJAB (nga 136 NJAB që kanë raportuar). Nga 136 NJAB që kanë detyrimin për të raportuar veprimtarinë e tyre pranë DH/AB:

- 2 njësi publike megjithëse e kanë të miratuar strukturën e NJAB nuk e kanë të plotësuar me stafin auditues (Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Agjencia Kombetare e Mbrojtjes Civile) dhe për këtë arsye nuk kanë dërguar raport për vitin 2022;
- 1 njësi publike nuk ka dërguar raportin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2022 (Spitali Rajonal Gjirokastrë).

Krahas këtyre rasteve ka institucione të cilat në Raportin Vjetor të Veprimtarisë kanë të përfshirë Pyetësorë të vjetër, ku përfshihen: Spitali Rajonal Kukës.

Në këtë kuadër janë evidentuar 7 njësi auditimi pa veprimtari për shkaqe të ndryshme të arsyeshme: *Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Spitali Rajonal Elbasan, Spitali Rajonal Korçë, Bashkia Has (auditues të brendshëm të emëruar në muajt e fundit të vitit), Bashkia Librazhd (auditues të brendshëm dalë në pension), Spitali Lushnjë dhe Gjykata Kushtetuese*. Nga analiza në tërësi e “Pyetësorit të vetëvlerësimit”, konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e NJAB nuk kanë qenë të qarta dhe koncize në përgjigjet e tyre. Të dhënat tregojnë që përgjigjet e dhëna nuk janë plotësisht në përputhje me të dhënat reale, të cilat janë konsoliduar nga të dhënat e raporteve vjetore të veprimtarisë së NJAB.

Pyetëtori i vetëvlerësimit përmban pyetje për të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe analiza për vitin 2022 paraqitet e ndarë në 4 grupime kryesore:

· Funksionimi i NJAB sipas akteve ligjore

Nga analiza e të dhënave të pyetësorëve të vetëvlerësimit, sa i përket kuadrit ligjor (paraqitur në tabelën nr. 20) rezulton se vetëm 78% e NJAB janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Për më tepër, në 80% të NJAB ka komunikim të rregullt me me titullarin dhe është e pavarur nga ana funksionale. Nga të dhënat e konsoliduara të pyetësorëve, rezulton se në 91% të NJAB audituesit e brendshëm nuk përfshihen në veprimtari operacionale. Pjesa tjetër 9% e tyre rezulton në kundërshtim me kriteret ligjore, ku në to vihet re përfshirje e audituesve të brendshëm në veprimtari operacionale.

Objektivat e NJAB gjithnjë duhet të jenë në përputhje me objektivat e njësisë publike. Nga analiza e të dhënave, vihet re se 87% e NJAB i kanë objektivat e tyre në përputhje me objektivat e njësive publike në të cilat ato operojnë.

· Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhim i risqeve nga NJAB

Nga analiza e përgjigjeve të NJAB në pyetësorët e dorëzuar në MFE, rezulton që 66% e tyre e bazojnë planin e auditimit plotësisht në vlerësimin e riskut të veprimtarisë së njësisë publike. Vetëm 57% e NJAB kanë vlerësuar drejt risqet e lidhura me objektivat e njësisë publike, kurse 37% e NJAB kanë nevojë për përmirësime në këtë vlerësim. Nga të dhënat e analizuara vetëm 53% e NJAB e përmbushin kriterin e kontributit në hartimin e regjistrit të riskut. Për më tepër, 80% e NJAB vlerësojnë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe 19% e vlerësojnë pjesërisht, duke mos përmbushur detyrimin ligjor.

· *Vendosja e kontrolleve efektive dhe monitorimi i rekomandimeve*

Nga analiza e pyetësorëve, 65% e NJAB e vlerësojnë përshtatshmërinë e kontrolleve të vendosura, kurse 32% e tyre i vlerësojnë ato pjesërisht. Në lidhje me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna rezulton që vetëm 80% të NJAB i monitorojnë në vazhdimësi këtë komponent dhe 19% e NJAB i monitorojnë ato pjesërisht. 87% të drejtuesve të NJAB paraqesin analizën vjetore të veprimtarisë në KAB dhe tek titullari i njësisë publike. Manuali i auditimit të brendshëm ka një procedurë të qartë në lidhje me raportimin e angazhimit të auditimit dhe vihet re se 13% e NJAB e realizojnë pjesërisht këtë kërkesë të Manualit.

· *Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese*

Në lidhje me Programin e Sigurimit të Cilësisë vetëm 58% të NJAB rezultojnë të kenë hartuar, miratuar dhe zbatuar këtë program dhe 30% e NJAB e kanë zbatuar pjesërisht këtë program. Në lidhje rishikimin e brendshëm të cilësisë nga ana e drejtuesve të NJAB rezulton se vetëm 61% e tyre realizojnë këtë proces në përputhje me standardet. Në këtë tregues evidentohet se 8% e NJAB nuk e realizojnë fare këtë proces për shkak të strukturave të cunguara dhe jashtë kritereve (me 1 ose 2 auditues).

Në 63% të NJAB rekomandimet e rishikimit të brendshëm të cilësisë merren në konsideratë nga audituesit. Në këtë element evidentohet se 4% e tyre nuk bien dakord me rekomandimet e dhëna nga ana e rishikuesve.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në këtë analizë, DH/AB në Raportin Vjetor 2022 ka theksuar se do të ketë një nga prioritetet e saj ndërgjegjësimin dhe koordinimin më të madh të informacionit me NJAB për mirëfunksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në përafrim të plotë me standardet ndërkombëtare.

Vlerësimi i indikatorëve që tregojnë nivelin e zbatimit të objektivave në përmbushje të strategjisë për auditimin e brendshëm në sektorin publik

Sa i takon vlerësimin të indikatorëve në lidhje me zbatimin e objektivave në përmbushje të strategjisë për auditimin e brendshëm në sektorin publik, rezulton se në Raportin Vjetor të KBFP 2022, nuk është paraqitur një vlerësim lidhur me këto katër indikatorë, edhe pse Raporti citon se Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit ka analizuar 18 tregues të performancës ku përfshihen:

- **Indikator 15** “Organizimi dhe kapacitetet e AB”;
- **Indikator 16** “Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të”;
- **Indikator 17** “Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor”;
- **Indikator 18** “Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm”.

Indikator 15 përbëhet nga nëntreguesit: Njësia publike realizon shërbimin e AB; NJAB është krijuar në përputhje me kërkesat ligjore; NJAB dhe AB plotësojnë kërkesat ligjore; AB trajnohen në përputhje me kërkesat ligjore (TVP).

Indikator 16 përbëhet nga nëntreguesit: Plani strategjik dhe vjetor i përmbahet strukturës së përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe është paraqitur në afatet e përcaktuara në DH/AB Plani strategjik dhe vjetor është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore (përfaqëson një univers gjithëpërfshirës dhe miratohet nga titullari) Plani strategjik dhe vjetor është bazuar në vlerësimin e riskut që mbulon të gjitha sistemet e njësisë; Plani strategjik dhe vjetor ka parashikuar lloje të ndryshme auditimi (përputhshmërie, të kombinuar, performance, të fondeve të BE (nëse ka), etj.

Indikator 17 përbëhet nga nëntreguesit: Raporti sipas strukturës së përcaktuar në MAB dhe është paraqitur në afat në DH/AB. Raporti përfshin analizën e gjetjeve dhe rekomandimeve të AB; Raporti përfshin vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm; Raporti evidenton dobësitë dhe përcakton prioritetet të qarta për të ardhmen.

Indikator 18 përbëhet nga treguesi: shkalla e zbatimit të rekomandimeve të AB. Për indikatorët e mësipërm, DH/A, ka vënë në dispozicion informacion mbi vlerësimin (0-4) për secilin prej indikatorëve, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në vijim.

Tabela 38 Vlerësimi i indikatorëve nga DH/AB për vitin 2022

<i>Indikator 15 "Organizimi dhe kapacitetet e AB"</i>	
0 pikë	2
1 pikë	2
2 pikë	9
3 pikë	49
4 pikë	74
<i>Indikator 16 "Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të"</i>	
0 pikë	3
2-2.5 pikë	5
3-3.5 pikë	73
4 pikë	52
<i>Indikator 17 "Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor"</i>	
0 - 0.5 pikë	10
1 - 1.5 pikë	6
2 - 2.5 pikë	6
3 - 3.5 pikë	16
4 pikë	96
<i>Indikator 18 "Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm"</i>	
0 pikë	34
1 pikë	34
2 pikë	16
3 pikë	19
4 pikë	30

Burimi: Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, MFE

Nga 191 njësi të paraqitura në databazën e mbajtur nga DH/AB rezulton se në total për të katërt treguesit (pikë maksimale 16 në total): 31 njësi rezultojnë me 0 pikë, prej të cilave 9 Bashki janë pa shërbim dhe 28 njësi rezultojnë me pikë maksimale 16 pikë.

Rezulton se në total, 33 njësi paraqiten me 0-4 pikë (ku përfshihen dhe 9 bashki pa shërbim) duke paraqitur një performancë të ulët për shkak të mosfunksionimit të NJAB-ve. Ndërkohë, 28 njësi paraqiten në performancë optimale me 16 pikë në total nga vlerësimi i të katërt treguesve.

Nga auditimet e kryera nga ana e KLSH ka rezultuar :

Kuvendi i Shqipërisë rezultoi se:

- Njësia e Auditimit të Brendshëm e këtij institucioni në strukturë, nuk përgjigjet dhe raporton përpara Titullarit të Njesisë Publike, ose Byrosë së Kuvendit, por tek Njësia Autorizues i institucionit, veprime jo në përputhje me kërkesat e standardeve dhe kuadrin e praktikave profesionale ndërkombëtare mbi organizimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm të pavarur dhe eficient në sektorin publik.
- Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, e miratuar me vendimin nr. 42, datë 16.07.2015, i ndryshuar, të Byrosë së Kuvendit, në disa nene të saj nuk është e harmonizuar me kuadrin ligjor, standardet dhe kërkesat profesionale mbi organizimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm të pavarur dhe eficient në sektorin publik. Për rrjedhojë, ngritja dhe organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Nenin 10, "Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm", kreu IV, të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"; pikën nr.3, të VKM nr.83,

datë 3.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar; ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe pikën nr.22, të VKM nr.893, datë 17.12.2014;

· **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** rezultoi se:

Struktura e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është e organizuar në rang Drejtorie dhe përmban në organikën e saj 5 auditues (1 drejtor dhe 4 specialist), sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr.185, datë 15.11.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, me ndryshimet përkatëse ku rezultoi se gjatë vitit 2021, DAB ka funksionuar me strukturë të paplotësuar, duke pasur 2 vende vakante në pozicionin e specialistit.

Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar.

· **Subjekti DPT:**

DAB gjatë vitit 2022 ka ndryshuar planin vjetor të auditimit të brendshëm, duke u bazuar në Nenin 12, shkronja “ç” të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Kapitullin III “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm”, në pikën 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetorë të auditimit të brendshëm në sektorin publik” të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Ndryshimi është bërë me arsyetimin e shmangies së auditimit paralel duke qenë se në periudhën në fjalë këto drejtori kanë qenë në proces auditimi nga KLSH, ku është kryer anulimi i auditimeve për drejtoritë e Menaxhimit të Riskut në DPT, drejtorinë e Kontrollit Tatimor në DPT; Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT; Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara - Rajoni Verior; DRT Durrës; DRT Tiranë; DRT Vlorë; dhe DRT Shkodër.

Konstatohet se veprimet e sipërcituara kanë ardhur si pasojë e moskoordinimit të punës së titullarit të DAB, i cili ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, neni 25 “Marrëdhënia me Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Gjithashtu, rezulton se ndryshimi i Planit Vjetor të Auditimit nuk ka ndodhur sipas përcaktimeve të nenit 12 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe përcaktimeve të kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, por është miratuar vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, pa miratimin e strukturës përkatëse në MFE.

DAB nuk e ka arritur objektivin e përmbushjes së Planit Vjetor të ndryshuar. Nga auditimi mbi analizën e ngarkesës së punës të audituesve të DAB përgjatë vitit, konstatohet se nuk është planifikuar shpërndarje e drejtë të angazhimit të burimeve njerëzore si rezultat i planifikimit jo eficient, duke evidentuar raste të mbingarkesës të disa audituesve krahasimisht me ngarkesë të ulët të disa audituesve të tjerë. Kjo ka sjell si pasojë një numër të ulët të auditimeve të realizuara për vitin 2022 të cilat kanë çënuar mbarëvajtjen e punës në këtë drejtori me pasojë mos realizimin të planit të auditimeve për këtë periudhë.

Përsa i përket efektivitetit të punës audituese, konstatohet një rënie e gjetjeve si në numër edhe në vlerë ku nga krahasimi me vitin paraardhës nga 137 gjetje në vlerën 118,500 mijë lekë, në vitin 2022 kanë rezultuar 26 gjetje në vlerën 7,600 mijë lekë.

Megjithëse në auditimet e ushtruara nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka pasur propozim për rikontroll, nuk janë marrë masa nga strukturat përgjegjëse për vazhdimin e procedurës për kryerjen e tyre.

DPD Tiranë:

-Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm është konstatuar se Plani Strategjik “Për drejtorinë e AB në DPD për vitin 2022-2024” nuk i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë MFE brenda datës 20 Tetor, në kundërshtim me pikën 3.3 të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100 datë 25.10.2016. Struktura e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm është parashikuar të funksionojë me 8 vende pune (1 Drejtor dhe 7 Auditues), ku pavarësisht se përgjatë vitit 2022 ajo ka rezultuar e plotësuar, 3 auditues të drejtorisë dhe drejtori(pra 4 persona që përbëjnë 50% të strukturës) rezultojnë të transferuar në pozicione të tjera.

Gjetjet që kanë ardhur si rezultat i auditimeve nga DAB për vitin 2022, vijnë kryesisht nga zbatimi i gabuar apo i pjesshëm i legjislacionit apo procedurave doganore. Kryesisht gjetjet më të shumta kanë rezultuar në sistemin e vendimmarrjes, sistemin e skanimit, sistemin e mostrimit/transportimit/ruajtjes/administrimit të rezultateve të mostrave, sistemi i mbikëqyrjes së operatorëve që veprojnë nën regjimet doganore, sistemi i mbikëqyrjes së magazinave doganore. shërbimit ndaj tatimpaguesit, funksionimin e kontrollit të brendshëm. Gjetjet e auditimit në vlerë janë gjetje me efekte në fushën e tatimeve, taksave, doganave në shumën 91,356,776 lekë. KLSH ka rekomanduar marrjen e masave për miratimin e planit strategjik brenda afateve ligjore të përcaktuara.

FSDKSH:

Në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2022, ka rezultuar se nga FSDKSH nuk janë marrë masa për ndryshimin e akteve administrative në lidhje me varësin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm nga Drejtori i Përgjithshëm, problematikë kjo e trajtuar dhe në raportin e mëparshëm të auditimit të KLSH, për vitin 2021. Gjithashtu edhe në Kartën e re të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me nr.7084 prot., datë 07.12.2022, nuk është parashikuar varësia e dyfishtë nga të dy organet drejtuese, konkretisht Seksioni II.1-Statusi Organizativ.

ISSH:

Nga auditimi i funksionimit të auditimit të brendshëm referuar Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” me ndryshime dhe Manualit të Auditimit të brendshëm në sektorin publik, ka rezultuar se:

- DAB ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 3 vende vakante të lira, dy në pozicionin auditues, në Degën e auditimit financiar dhe një në pozicionin auditues, në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut, veprime që nuk janë në përputhje me strukturën organike të miratuar, të miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 5, datë 20.07.2010 “Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së”;
- Drejtorja e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 ka planifikuar 14 angazhime auditimi, ka realizuar 12, ose 93.3 % të planit. Konstatohet se nuk është planifikuar dhe kryer asnjë auditim në sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave.

ARRSH:

Nga auditimi në këtë institucion ka rezultuar se Njësia e Auditit të Brendshëm nuk funksionon në mënyrë të decentralizuar si një veprimtari e pavarur funksionalisht pasi është pjesë përbërëse e ekzekutivit në formën e sektorit dhe në varësinë e drejtorit të përgjithshëm të ARRSH, i cili miraton planin e angazhimeve të AB. Misioni i AB është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë publike, në mënyrë të pavarur dhe objektive për sistemin e kontrollit të brendshëm. Auditimi i brendshëm, duke qenë një strukturë e varur nga Drejtori i përgjithshëm brenda ekzekutivit të ARRSH nuk arrin të kryejë një aktivitet të pavarur dhe objektiv, që jep siguri dhe këshilla, si dhe për t’i shtuar vlerë operacioneve të njësisë publike.

Për sa më sipër i është rekomanduar Titullarit të ARRSH marrja e të gjitha masave të nevojshme për kalimin e auditit të brendshëm jashtë strukturës ekzekutive të ARRSH, me qëllim sigurimin e funksionit të decentralizuar të auditimit të brendshëm, si një veprimtari e pavarur funksionalisht dhe që raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi.

· **OSHEE:**

Nga Drejtoria e AB në OSHEE sh.a për periudhën 1.07.2020 - 31.12.2021 nuk është realizuar plani i auditimeve sipas periudhës së përcaktuar në planin strategjik 2020-2022, planin strategjik 2021-2023 dhe planet vjetore të auditimit, pasi disa nga auditimet e planifikuara nga DAB për çdo vit të mbetura pa u audituar janë mbartur në vitin pasardhës, ose nuk janë realizuar (DEK, Drejtoria Ligjore, njësia PIU, etj.). Nga auditimi mbi kryerjen e angazhimeve të auditimit, referuar dokumentacionit të dosjeve të auditimit, u konstatua se nga në 6 angazhime të përzgjedhura për periudhën objekt auditimi janë tejkaluara afatet e hartimit të Projekt Raportit dhe të Raportit Final, në tejkalim të afatit 10 ditor për hartimin e tyre.

· **MSHMS** rezultoi se:

Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm

· **Funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm në VQV:**

- Nuk ka strukturë funksionale për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm (*Bashkitë Belsh, Konispol, Këlcyrë, Kuçovë, Has, Divjakë, Përmet*).
- Specialistët e Njësisë së Auditit të Brendshëm nuk janë të gjithë të kualifikuar/certifikuar/trajnuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin publik”, (*Bashkitë Mallakastër, Patos, Krujë, Shkodër, Roskovec, Kuçovë*).
- Në dosjet e auditimit ka mungesa të dokumenteve që vërtetojnë kryerjen e të gjitha fazave të auditimit që nga planifikimi i angazhimit për auditim dhe deri në vlerësimin e cilësisë së auditimit në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Auditit të Brendshëm (*Bashkitë Kolonjë, Lezhë, Mirditë, Roskovec, Tepelenë, Sarandë*).
- Njësitë e audituara në përgjithësi nuk kanë paraqitur plan veprimet për zbatimin e rekomandimeve, dhe nuk është bërë ndjekja e tyre nga Njësia e Auditit, duke sjellë një mungesë të informacionit në lidhje me statusin e rekomandimeve të lëna (*Bashkitë Kolonjë, Patos, Mat, Krujë, Roskovec*).
- Nuk janë ndërmarrë angazhime auditimi në fusha me risk të lartë siç janë prokurimet, aktiviteti i Drejtorisë Financës, Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorisë së të Ardhurave apo Menaxhimi i Aseteve, (*Bashkitë Kolonjë, Fier, Devoll, Vlorë, Mallakastër, Lezhë, Divjakë, Mat, Gramsh, Shkodër, Malësi e Madhe, Roskovec, Sarandë, Kukës*).
- Njësitë e Auditit të Brendshëm funksionojnë sipas numrit të miratuar të punonjësve, (*Bashkitë Kolonjë, Himarë, Devoll, Mallakastër, Cërrik, Divjakë, Patos, Berat, Kukës*).
- Nuk është realizuar plani i auditimeve në masën 100% (*Bashkitë Himarë, Mallakastër, Lezhë, Cërrik, Patos, Kuçovë, Berat*).
- Nuk është kryer një analizë dhe vlerësim i riskut në hartimin e planit vjetor të auditimit si dhe gjatë realizimit të auditimit nuk janë kryer etapat dhe procedurat e auditimit, (*Bashkitë Himarë, Kuçovë*).
- Nuk janë kryer auditime me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, (*Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Roskovec*).

Anekset e Raportit

1. Lista e auditimeve që kanë shërbyer për hartimin e Raportit të Zbatimit të Buxhetit²⁰

1	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë
2	Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
3	Gjykata e Lartë
4	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
5	Autoritetin e Mediave Audiovizive
6	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik
7	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
8	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
9	Instituti i Gjeoshkencave
10	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të Qeverisjes së Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
11	Sistemi i përgjithshëm i raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të Qeverisjes së Përgjithshme në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
12	Ministria e Drejtësisë
13	Ministria e Kulturës, Auditim tematik " <i>Parku i artit</i> "
14	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
15	Avokatura e Shtetit
16	Shpërblimi dhe trajtimi i sportistëve, në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve
17	Qendra Kombëtare e Tranfuzionit të Gjakut
18	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
19	Banka e Shqipërisë
20	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Drejtoria e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, Aparati i MFE dhe Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
21	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
22	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
23	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
24	Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoritë Rajonale Tiranë
25	Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës
26	Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan
27	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër
28	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj
29	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (Për aktivitetin 2018-2020)
30	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
31	Instituti i Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë
32	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizimit
33	Kontrata e Konkensionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera dhe tarifës së shërbimit të skanimit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të doganave
34	Licensimi dhe monitorimi i subjekteve me veprimtari minerare, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
35	Bashkia Has
36	Bashkia Cërrik
37	Bashkia Vau i Dejës
38	Bashkia Belsh

²⁰ https://www.klsh.org.al/cat_list/256

39	Bashkia Lezhë
40	Bashkia Kamëz
41	Drejtoria e Objekteve Publike Tiranë
42	Auditim Performance: “Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë”
43	Njësitë administrative Petrelë
44	Njësia administrative Farkë
45	Njësia administrative Zall Herr
46	Njësia administrative Dajt
47	Bashkia Kolonjë
48	Bashkia Fier
49	Bashkia Prrenjas
50	Bashkia Dimal
51	Bashkia Patos
52	Bashkia Kuçovë
53	Bashkia Mallakastër
54	Bashkia Finiq
55	Bashkia Berat
56	Njesia administrivë Kashar
57	Njesia administrivë Zall Bastar
58	Njesia administrivë Vaqarr
59	Bashkia Konispol
60	Bashkia Gramsh
61	Bashkia Krujë
62	Bashkia Kavajë
63	Bashkia Tiranë, Drejtoria Tirana Parking
64	Bashkia Dropull
65	Bashkia Këlcyrë
66	Bashkia Delvinë
67	Bashkia Tepelenë
68	Bashkia Librazhd
69	Bashkia Permet
70	Bashkia Rrogozhinë
71	Bashkia Sarandë
72	Bashkia Libohovë
73	Bashkia Peqin
74	Bashkia Gjirokastër
75	Bashkia Memaliaj
76	Bashkia Shijak
77	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrim Gjellbërimit
78	Bashkia Himarë
79	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës Sarandë
80	Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
81	Agjencia e Trajtimit të Pronave
82	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë
83	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri
84	Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug
85	Ujësjetës Kanalizime Durrës SHA
86	Ujësjetës Kanalizime Tiranë SHA
87	Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoritë Rajonale, Projekti i sigurisë dhe mirëmbajtjes së rrugëve financuar nga IBRD
88	Porti Detar Sarandë SHA

89	Autoriteti Rrugor Shqiptar
90	Hekurudha Shqiptare SHA
91	Albpetrol SHA
92	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
93	Operatori i Sistemit të Transmetimit OST
94	Spitali Universitar i Traumës
95	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
96	Auditimi i performance me temë: Në Korporatën Elektroenergetike Shqiptare SHA, Operatorin e Sistemit të Transmetimit SHA, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA dhe Entin Rregullator të Energjisë
97	Qendra e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK), Vlorë
98	Shtëpia e Foshnjes 'Lulet e vogla', Korçë
99	Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoritë Rajonale
100	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
101	Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë, Shkodër, Kukës
102	<i>Auditim Performance me temë: “Performanca e Shërbimit të Paraburgimit”</i>
103	<i>Auditim Performance me temë: “Fuqizimi Ekonomik i Gruas në Vendin tonë”</i>
104	<i>Auditim Performance me temë: “Ndikimi i mjeteve të transportit rrugor në cilësinë e ajrit”</i>
105	<i>Auditim Performance me temë: “Shërbimi përmbarimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”</i>
106	<i>Auditim Performance me temë: “Trajtimi i sëmundjeve tumorale”</i>
107	<i>Auditim Performance me temë: “Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese (hemodializë, dializë peritoneale, transplant)”</i>
108	<i>Auditim Performance me temë: “Rezervat e shtetit në shërbim të qytetarit”</i>
109	<i>Auditim IT: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA (Auditim paralel me ZKA e Kosovës)</i>
110	<i>Auditim IT: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial</i>
111	<i>Auditim IT: Instituti i Sigurimeve Shoqërore</i>
112	<i>Auditim IT: Rrjeti Akademik Shqiptar</i>
113	<i>Auditim IT: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor</i>
114	<i>Auditim IT: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</i>

2. Përmbledhje e dëmit ekonomik dhe efektit financiar negative për buxhetin 2022

Në mijë lekë

I.	Të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit	2022
1	Nga shkeljet në zbatim të legjislacionit tatimor dhe doganor	63,105,827
2	Nga keqadministrimii pronës shtetërore të dhënë me qera dhe koncensione	1,545
3	Nga shkeljet në zbatim të legjislacionit për taksa dhe tarifa vendore	1,748
4	Të ardhura të tjera	49,999
	Totali i të ardhurave të munguara të konstatuara në zbatim të buxhetit të shtetit, viti 2022*	63,159,119

II.	Dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shpenzime	2022
1	Në shpenzimet operative	1,351,488
2	Në shpenzime për investime	37,357
3	Shpenzime të tjera	3,243,019
	Totali i dëmit të konstatuara në zbatim të buxhetit të shtetit, viti 2022	4,631,863

I.	Efekte negative në të ardhurat e buxhetit	2022
1	Nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qera dhe koncensione	708,035
2	Nga shkeljet në zbatim të legjislacionit për taksa dhe tarifa vendore	987,405
3	Të ardhura të tjera	12,157,095
	Totali i efekteve në zbatim të buxhetit të shtetit, viti 2022	13,852,535

II.	Efekte negative për shpenzimet e buxhetit	2022
1	Në shpenzimet për paga, sigurime dhe shpërblime	552,757
2	Në shpenzimet operative	135,642
3	Në shpenzime për investime	1,191,018
4	Shpenzime të tjera	38,876,885
	Totali i efekteve në zbatim të buxhetit të shtetit, viti 2022	40,756,302

Shënim: * Nga auditimi në Avokaturën e Shtetit, si pasojë e mos veprimit në kohë nga Autoritetet shtetërore si palë të interesuara për njohje të vendimit nga Gjykata e Apelit, rezultoi të mos jenë arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit shumat prej: Euro 2,407,000; USD 427,488.72; GBP 106,755 (ose e konvertuar ne ALL 334,477,132), vlerë e cila nuk është përfshirë në totalin e të ardhurave të munguara të konstatuara në zbatim të buxhetit për vitin 2022.

Per efekt perlllogaritjeje, eshte marrë në konsiderate kursi mesatar i kembimit të BSH, më datë 31.12.2022 në faqen:

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

Konkretisht: 1 GBP = 128.92 ALL

1 USD = 107.05 ALL

1 EURO = 114.23 ALL